

**RAPORT I MONITORIMIT TË
ZBATIMIT TË BUXHETIT 12 M VITI 2024**

BASHKIA SHKODER

Shkurt 2025

| | |
|--|-----|
| REALIZIMI I BUXHETIT TË 12 M TE VITIT 2024 | 4 |
| REALIZIMI I TE ARDHURAVE TE BASHKISË NGA BURIMET E VETA VENDORE PËR 12 M E VITIT 2024..... | 8 |
| Kategorizimi i të ardhurave..... | 10 |
| Realizimi i të ardhurave nga të ardhurat vendore 2024 | 11 |
| Analiza e peshës specifike sipas zërave | 21 |
| Fluksi monetar mujor i të ardhurave të veta, viti 2024 | 22 |
| Realizimi i të ardhurave 2024, krahasuar me vitet e kaluara | 22 |
| REALIZIMI I SHPENZIMEVE TË BUXHETIT TË 12 M TE VITIT 2024..... | 30 |
| Shpenzimet nga transfertat e pakushtezuar dhe te ardhurat e veta vendore | 47 |
| Transferta e pakushtezuar sektoriale | 56 |
| Transferta e kushtëzuar | 59 |
| VETËVLERËSIMI FINANCIAR PER PERIUDHEN 12 M 2024 PER SITUATEN E GJENDJES FINANCIARE TE BASHKISË SHKODER | 65 |
| TREGUESIT E PERFORMACES..... | 66 |
| FUNKSIONI 01: SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE..... | 69 |
| Programi 01110: Planifikim, Menaxhim dhe Administrim | 69 |
| FUNKSIONI 03: RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE..... | 90 |
| Programi 03140: Shërbimet Policore Vendore | 90 |
| Programi 03280: Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile | 95 |
| FUNKSIONI 4: ÇËSHTJET EKONOMIKE..... | 101 |
| Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik..... | 101 |
| Programi 04220 -Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve..... | 117 |
| Programi 04240: Menaxhimi i Ujitjes dhe Kullimit | 122 |
| Programi 04260: Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave..... | 127 |
| Programi 04520: Rrjeti rrugor rural | 134 |
| Programi 04570: Transporti publik dhe lëvizshmëria..... | 145 |
| FUNKSIONI 05 : MBROJTJA E MJEDISIT..... | 152 |
| Programi 05100: Menaxhimi i mbetjeve..... | 152 |
| FUNKSIONI 06: STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT..... | 162 |
| Programi 06140: Urbanistika | 162 |
| Programi 06260 : Zhvillimi i komunitetit | 167 |
| Programi 06370: Furnizimi me ujë | 176 |
| FUNKSIONI 7 : SHENDETESIA | 183 |
| Programi 07220 “ Shërbimet e kujdesit parësor ”..... | 183 |
| FUNKSIONI8: ARGËTIMI, KULTURA DHE FEJA | 188 |
| Programi 08130: Sport dhe argëtim | 188 |

| | |
|--|-----|
| Programi 08220: Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore | 204 |
| FUNKSIONI 9: ARSIMI | 235 |
| Programi 09120 : Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor. | 235 |
| PROGRAMI 09230 Arsimi i mesëm i përgjithshëm. | 248 |
| FUNKSIONI 10 : MBROJTJA SOCIALE | 258 |
| Programi 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët” | 258 |
| Programi 10661: Strehimi social..... | 303 |

REALIZIMI I BUXHETIT TË 12 M TE VITIT 2024

Realizimi i buxhetit te 12 M te vitit 2024, është bërë, duke respektuar nenin 64 te ligjit 139/2015 “ Per veteqeverisjen vendore “, i ndryshuar, ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 “ Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise”, të ndryshuar , ligjin nr 68/2017 date 27.4.2017 “ Per financat e veteqeverisjes vendore “te ndryshuar , ligjin nr. 10296 date 8.7.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, ligjin nr. 97/2023 datë 07.12.2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, i ndryshuar , udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22 date 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit te njesive te qeverisjes vendore”, udhezimi nr. 9 date 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit “ , Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, Udhëzimin Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1 datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, VKB nr. 55 datë 29.12.2023 datë “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër ” i ndryshuar

Bashkia Shkoder, administron dhe menaxhon fondet, sipas programeve në zbatim të Udhëzimit nr.7, datë 25.02.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Shtojca nr.1 që përban listën e programeve që përdorin njësitë e vetëqeverisjes vendore ka ndryshuar nëpërmjet riklasifikimit të programeve, duke ulur numrin e tyre nga 36 në 20 struktura e programeve te buxhetit vendor Shkodër do të jetë si më poshtë:

| Nr | Funksioni | Nr | Programi |
|----|---|--------------|---|
| 1 | SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE | 01110 | Programi 01110 - Planifikim menaxhim administrim ndryshon duke përfshirë edhe objektivin dhe aktivitetet e programit 01120 “Çështje financiare dhe fiskale”, programit 01170 “Gjendja Civile” dhe programit 01710 “Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm”; |
| 3 | RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE | 03140 | Programi 03140 “Shërbimet e Policisë Vendore” ndryshon duke përfshirë edhe objektivin e programit 03600 “Marrëdhëniet në komunitet”; |
| | | 03280 | Programi 03280 “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile” nuk ndryshon; |
| 4 | CESHTJE EKONOMIKE | 04130 | Programi 04130 “Mbështetja për zhvillim ekonomik” ndryshon duke përfshirë edhe objektivin dhe përshkrimin e programit 04160 “Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi”, programit 04740 “Projekte zhvillimi” dhe programit 04760 “Zhvillimi i turizmit”; |
| | | 04220 | Programi 04220 “Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve” nuk ndryshon; |

| | | | |
|----------|---|--------------|--|
| | | 04240 | Programi 04240 “Menaxhimi i infrastruktuës së ujitjes dhe kullimit” nuk ndryshon |
| | | 04260 | Programi 04260 “Administrimi i pyjeve dhe kullotave” nuk ndryshon; |
| | | 04520 | Programi 04520 “Rrjeti rrugor rural” nuk ndryshon; |
| | | 04570 | Programi 04570 “Transporti publik” nuk ndryshon; |
| 5 | MBROJTJA E MJEDISIT | 05100 | Programi 05100 “ Menaxhimi i mbetjeve” ndryshon duke përfshirë edhe objektivin dhe përshkrimin e programit 05320 “Programe për mbrojtjen e mjedisit” dhe programit 05630 “Ndërgjegjësimi mjedisor”; |
| 6 | STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT | 06140 | Programi 06140 “Planifikimi Urban Vendor” ndryshon duke përfshirë edhe objektivin dhe përshkrimin e programit 06210 “Programet e zhvillimit”; |
| | | 06260 | Programi 06260 “Shërbimet publike vendore” ndryshon duke përfshirë edhe objektivin dhe përshkrimin e programit 06440 “Ndriçim rrugësh”; |
| | | 06370 | Programi 06370 “Furnizimi me ujë dhe Kanalizime” është riklasifikim me kod të ri i programit 06330 “Furnizimi me ujë” si dhe përfshin edhe objektivin dhe përshkrimin e programit 05200 “Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve”; |
| 7 | SHENDETESIA | 07220 | Programi 07220 “Shërbimet e kujdesit parësor” nuk ndryshon; |
| 8 | ARGETIMI KULTURA DHE FEJA | 08130 | Programi 08130 “Sport dhe argëtim” nuk ndryshon; |
| | | 08220 | Programi 08220 “Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore” nuk ndryshon; |
| 9 | ARSIMI | 09120 | Programi 09120 “Arsimi bazë përfshirë parashkollorin” nuk ndryshon; |

| | | | |
|-----------|-------------------------|--------------|---|
| | | 09230 | Programi 09230 “Arsimi i mesëm i përgjithshëm” përfshin edhe përshkrimin e programit 09240 “Arsimi profesional”; |
| 10 | MBROJTJA SOCIALE | 10430 | Programi 10430 “Përkujdesja Sociale” riklasifikohet në emërtim dhe ndryshon duke përfshirë objektivin dhe përshkrimin e programeve 10140 “Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara”, 10220 “Sigurimi shoqëror”, 10550 “Papunësia, arsim dhe aftësim”; |
| | | 10661 | Programi 10661 “Strehimi social” nuk ndryshon. |

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë, vijnë nga dy burime:

Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifatat vendore, të ardhura të tjera, donacione, grante nderkombetare dhe të ardhura që trashëgohen.

Nga burimet qendrore, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e transferuara dhe transfertat e kushtëzuar.

Buxheti i 12 M të vitit 2024, në total në 000/leke me të gjitha burimet e financimit të realizuara, paraqitet si më poshtë:

| N r | TE HYRAT DHE FINANCIMET NE LLOGARITE E THESARIT | Plani Fillestar 2024 | Plani Korrigjuar 2024 | Realizimi 2024 |
|-------------|--|-----------------------------|------------------------------|-----------------------|
| I | TE ARDHURAT E VETA | 954,000 | 954,000 | 1,028,338 |
| | Të ardhura nga taksat vendore | 376,487 | 376,487 | 425,749 |
| | Të ardhura nga taksat e ndara | 152,163 | 152,163 | 176,374 |
| | Të ardhura nga tarifatat vendore | 391,990 | 391,990 | 374,073 |
| | Të ardhura të tjera | 33,360 | 33,360 | 52,142 |
| II | GRANTE NDERKOMBETARE | 1,035 | 3,412 | 2,127 |
| II I | TRANSFERTAT | 1,413,317 | 1,454,162 | 1,454,162 |
| 1 | Transferte e Pakushtëzuar | 936,996 | 957,789 | 957,789 |
| 2 | Transferte e Pakushtëzuar Sektoriale | 459,996 | 480,048 | 480,048 |
| 3 | Transferte specifike për mbrojtjen e mjedisit | 16,325 | 16,325 | 16,325 |
| IV | TE TRASHEGUARA | 272,846 | 719,510 | 719,510 |
| 1 | Transferte e pakushtëzuar | 185,811 | 281,587 | 281,587 |

| | | | | |
|---|--|------------------|------------------|------------------|
| 2 | Transferte e Pakushtezuar Sektoriale | 2,750 | 59,257 | 59,257 |
| 3 | Te ardhura | 84,285 | 378,054 | 378,054 |
| 4 | Donacione | | 612 | 612 |
| | TOTALI | 2,641,198 | 3,131,084 | 3,204,137 |
| | Shpenzime me llogari jashte thesari | 10,052 | 13,489 | 13,489 |
| | TOTALI VITI 2024 | 2,651,250 | 3,144,573 | 3,217,626 |
| 1 | Transferte e pakushtezuar | 237,220 | 141,444 | 141,444 |
| 2 | Transferte e Pakushtezuar Sektoriale | 86,285 | 29,778 | 29,778 |
| 4 | Te ardhura | 656,723 | 342,174 | 342,174 |
| 5 | Donacione | 4,907 | 4,295 | 4,295 |
| | TE TRASHEGUARA | 985,135 | 517,691 | 517,691 |
| | Shpenzime me llogari jashte thesari te trasheguara | | 72,950 | 72,950 |
| | TOTALI TE TRASHEGUARA | 985,135 | 590,641 | 590,641 |
| | TOTALI | 3,636,385 | 3,735,214 | 3,808,267 |
| | TOTALI PA LLOGARI JAShte THESARI | 3,626,333 | 3,648,775 | 3,721,828 |
| | Transferta e kushtezuar | | 1,304,616 | 1,304,616 |
| | TOTALI & TRANS. TE KUShteZUAR | 3,626,333 | 4,953,391 | 5,026,444 |

REALIZIMI I TE ARDHURAVE TE BASHKISË NGA BURIMET E VETA VENDORE PËR 12 M E VITIT 2024.

Bashkia Shkodër, në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ka të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe kryerjes së shpenzimeve. Financimin e buxhetit të saj, bashkia e realizon nga:

- a. burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifat vendore, të ardhura të tjera dhe të ardhura që trashëgohen;
- b. grantet e projekteve të huaja dhe donacionet;
- c. burimet qendrore, ku përfshihen transferta e pakushtëzuar, transferta e kushtëzuar dhe transferta specifike.

Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Rëndësi e veçantë iu dha shfrytëzimit dhe vënies në efikasitet të aseteve të veta, implementimit të procedurave online e të thjeshta, zgjerimit të bazës taksapaguese, rritjes së nivelit të arketimeve nëpërmjet politikave lehtësuese, taksave të ulta dhe rritjes së frymës së konkurrencës së ndershme, thjeshtimit dhe standartizimit të procedurave, si dhe trajtimit të qytetarëve dhe bizneseve si partnerë të përbashkët të bashkisë. Objektivat kryesisht të fokusuar në lehtësimin maksimal fiskal dhe shpërndarjen e drejtë të ngarkesës tatimore, kanë ndikuar në nxitjen e zhvillimit dhe zgjerimit të biznesit, duke ruajtur dhe madje duke induktuar me efikasitet rritjen e të ardhurave për zërat kryesorë që lidhen me biznesin. Janë ndërtuar bazë të dhënash gjithnjë edhe më të sakta duke dhënë edhe një panoramë më të saktë të taksapaguesve biznes dhe familjar. Gjithashtu mundësimi i shlyerjes së pagesave pranë taksapaguesit, dhënia e shërbimeve të përmirësuara dhe informimi i taksapaguesit nëpërmjet zyrave me Një Ndalese dhe agjentit tatimor Ujesjelles Kanalizime të shpërndara gjeografikisht në territorin e bashkisë pranë qytetarit, si dhe shtrirja e përshtatja e afateve të pagesave me qëllim lehtësimin e taksapaguesit, kanë ndikuar në përmirësimin e vazhdueshëm të klimës së biznesit dhe marrëdhënies me taksapaguesin. Objektivat e përcaktuar e të realizuar, dhe që kanë ndikuar në përmirësimin e klimës së biznesit, duke ruajtur e madje duke rezultuar si politika efikase në rritjen e të ardhurave, janë ulja e taksave të pronës deri në minimumin ligjor të lejuar, mbështetja e disa aktiviteteve të veçanta si bizneset e prodhimit, lehtësimi kryesisht i bizneseve të vogla, mbështetja me tarifa zero për fermerët, tarifa minimale për tregjet dhe ambulantët etj, me rezultat dhenie frymëmarrje financiare biznesit si dhe Vendimit nr.25, datë 26.06.2020 “Për disa ndryshime në VKB NR.1, datë 22.1.2016 “Për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Shkodër”, të ndryshuar përjashtimin nga taksat dhe tarifat vendore për një periudhë tre mujore të vitit 2020, për të gjitha kategoritë e taksapaguesveindividë, familje, persona fizik dhe juridik, ambulant, OJF, institucione publike në të gjithëterritorin e Bashkisë Shkodër.

Politikat e ngjashme për gjendjen sa më pranë taksapaguesit nëpërmjet taksave dhe tarifave të ulëta e në harmoni me shërbimin që ofrohet, si psh: dhënia e lehtësive fiskale për shtresat familjare në nevojë, taksa në minimumin e lejuar ligjor për tokën bujqësore, mundësia e

arkëtimit në këste dhe pranë njësive administrative ku banojnë etj, janë zbatuar dhe kanë rezultuar të suksesshme jo vetëm për zbutjen e vështirësive ekonomike për shtresa të veçanta të familjeve dhe reduktimin e papunësisë, por edhe për vetë rritjen e arkëtimeve nga viti në vit. Keto politika të lehtësimit fiskal dhe inçentivues, shoqëruar paralelisht me përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit, kanë ndikuar pozitivisht edhe në objektivin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve. Rritja e vazhdueshme e të ardhurave si nga biznesi, ashtu edhe nga taksapaguesi familjar, kundrejt fokusimit për uljen e barrës fiskale nga ana tjetër, vërteton efikasitetin e këtyre politikave, kundrejt rezultatit pozitiv që bashkia ka arritur në rritjen e bazës së taksapaguesve, si familjar, ashtu edhe atij biznes. Vëmendje e veçantë gjate vitit 2024 i është kushtuar monitorimit të detajuar dhe implementimi i regjistrave të sakte elektronikë të kapaciteteve fiskale, duke përfshirë gjithë territorin e bashkisë. Për këtë arsye ju kushtua vëmendje e veçantë dhe mbështetje logjistike më tej strukturave e konstatimeve në vend të këtyre kapaciteteve, u ushtruan verifikime të vazhdueshme në të gjitha njësitë administrative, duke vijuar me formalizimin e të dhënave dhe dixhitalizimin e tyre, me efekt arritjen e rezultateve shumë të mira në pothuajse të gjithë zërat kryesore të të ardhurave. Kujdes të veçantë gjatë vitit 2024 ju kushtua përmirësimit të mëtejshëm të sistemeve të kompjuterizuara, detajimit të raporteve, emetimit të statistikave, saktësisë dhe detajimit të të dhënave për bizneset, etj. Sot është e mundur hedhja on-line në sistemin e taksave të gjobave të IMT dhe Policisë Bashkiake, bashkëpunimi me Policinë e Shtetit për hedhjen në kohë të gjobave nëpërmjet sistemit e-gjoba, llogaritja automoatike e kamatvonesave, llogaritja e menjëhershme dhe emetimi i akt-marrëveshjeve pranë ZIN për subjektet shfytëzuese të hapësirave publike, parkingjeve, ambulanteve etj. Vazhdon përdorimi i aplikacionit për smartphone “Taksat e Mia Shkodër”, ku mundësohet llogaritja e taksës së ndërtesës, truallit dhe tokës bujqësore sipas adresave, vitit fiskal, dhe kategorisë familjare. Objektivi kryesor për realizimin e të ardhurave buxhetore të planifikuara është realizuar në masën **106% (taksa dhe tarifa vendore)**, referuar planifikimit buxhetor. Referuar arkëtimeve mujore gjatë vitit 2024, është siguruar njëtrajshmëri në nivelet e të hyrave mujore, duke garantuar kështu të ardhurat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të veta të bashkisë për gjithë periudhën e vitit buxhetor. Të ardhurat e veta u realizuan nga administrata e bashkisë, Njësitë Administrative, Institucionet dhe agjentët tatimorë, institucionet shtetërore etj. Vijimi i performancës së punës dhe i procesit bashkëpunues, garanton më tej sigurimin e të ardhurave të veta buxhetore vjetore për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë territorit të bashkisë. Realizimi i të ardhurave për vitin financiar me 106% tregon përparime në disa sektorë dhe sfida të vazhdueshme në sektorë të tjerë. Për të përmirësuar performancën do të bëhet përqendrimi në digjitalizim, forcimi i kapaciteteve administrative dhe bashkëpunimi ndërinstytucional. Këto masa do të sigurojnë një mbledhje më efektive të të ardhurave dhe një menaxhim më të mirë të burimeve financiare vendore.

Bashkia Shkodër me burimet e veta arriti të menaxhojë situatën dhe të ofrojë shërbimet e duhura ndaj qytetarëve në të gjithë territorin e saj.

Kategorizimi i të ardhurave

- Taksat vendore:
 - Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, për ndërtesa, troje dhe toka bujqësore
 - Taksa e ndikimit në infrastrukturë
 - Taksa e fjetjes në hotel
 - Tatimi thjeshtuar mbi fitimin, biznesi vogël nga 5-8 milion, agjent DRT Shkodër
 - Taksa e tabelës për qëllime reklamimi ose identifikimi

- Taksat e ndara:
 - Taksa vjetore e e qarkullimit të mjeteve
 - Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë, agjent tatimor ASHK
 - Taksa e rentës minerare
 - Tatimi mbi të ardhurat personale

- Tarifat vendore
 - Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave
 - Tarifa për ndriçimin publik
 - Tarifa për gjelbrimin
 - Tarifa të shërbimit administrativ
 - Tarifa për parkimin e mjeteve e liçensuara dhe vendparkime publike
 - Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri
 - Tarifa për zënien e hapësirave publike
 - Tarifa të institucioneve të arsimit, kultures, sportit, etj


- Të ardhura të tjera:
 - Të ardhura nga Institucionet e arsimit, kulturës, sportit etj.
 - Të ardhura nga kundravajtjet administrative
 - Të ardhura nga dhënia me qira e asetëve
 - Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime
 - Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve
 - Grante nga ndihma nderkombetare
 - Të ardhura nga donacione/sponsorizime
 - Të ardhura të tjera (komision si agjent tatimor).

Realizimi i të ardhurave nga të ardhurat vendore 2024

| | |
|--|------------------|
| Të ardhurat nga Burimet e Veta Vendore /mijë lekë | 1,030,466 |
| Të ardhura nga taksat vendore | 425,749 |
| Të ardhura nga taksat e ndara | 176,374 |
| Të ardhura nga tarifat vendore | 374,073 |
| Të ardhura nga burime të tjera vendore | 54,269 |

Rritja e të ardhurave të veta vendore në kuadër të konsolidimit të ecurisë së decentralizimit por gjithashtu ruajtja e qëndrueshmërisë së transfertave gjatë vitit 2024 krijoi kushtet e favorshme për Bashkinë Shkodër për të nxitur politika të reja në drejtim të cilësisë së shërbimeve publike. Duke marrë në konsideratë rëndësinë që kanë burimet e financimit për përmirësimin e jetës së qytetarëve, në këtë seksion janë analizuar të gjitha burimet kryesore të të ardhurave të Bashkisë Shkodër.

Ecuria e treguesve fiskalë të Bashkisë Shkodër ka rezultuar pozitive në mbledhjen e të ardhurave ku të ardhurat nga burimet e veta vendore për vitin 2024 u realizuan në vlerën **1,030,466 mijë Lekë**. Ato përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, nga taksat e ndara, të ardhurat nga tarifat vendore dhe të ardhurat nga burime të tjera. Pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë të ardhurat nga taksat vendore me **41%** dhe të ardhurat nga tarifat vendore me **36%** të totalit. Grafiku i mëposhtëm tregon peshën e të ardhurave sipas kategorive.



Realizimi i të ardhurave në lidhje me planin e vitit 2024


Realizimi i planit të të ardhurave në total është në masën 106%

mijë/leke

| Bashkia Shkodër, Realizimi i të ardhurave viti 2024 | | | | |
|--|---|-----------------------|----------------------------|--|
| | | | Bashkia Shkoder | |
| | LLOJET E TË ARDHURAVE | Plan viti 2024 | Realizimi viti 2024 | Krahasimi në % me planin mujor 2024 |
| A | TË ARDHURAT E VETA | 970,216 | 1,030,466 | 106% |
| A.I | TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE | 376,487 | 425,749 | 113% |
| I.1 | Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për BV | 950 | 2,214 | 233% |
| I.1.0 | Të ardhura nga taksa mbi BV | 50 | 345 | 690% |
| I.2 | Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme | 212,566 | 196,542 | 92% |
| I.2.1 | Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat | 175,840 | 171,114 | 97% |
| I.2.1.1 | <i>Ndërtesa banimi</i> | 84,000 | 62,460 | 74% |
| I.2.1.2 | <i>Ndërtesa të tjera</i> | 91,840 | 108,654 | 118% |
| I.2.2 | Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore | 21,736 | 6,785 | 31% |
| I.2.3 | Të ardhura nga taksa mbi truallin | 14,990 | 18,644 | 124% |
| I.3 | Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel | 24,000 | 33,960 | 141% |
| I.4 | Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë | 123,921 | 176,295 | 142% |
| I.4.1 | <i>Nga ndërtimet e reja</i> | 96,000 | 89,824 | 94% |
| I.4.2 | <i>Ndërtimet ne proces legalizimi</i> | 27,921 | 50,942 | 182% |
| I.4.3 | <i>Kontributi I subjekteve private në fondin publik të banesave sociale</i> | 0 | 35,530 | |
| I.5 | Të ardhura nga taksa e tabelës | 15,000 | 16,394 | 109% |
| I.5.1 | <i>Takse Tabele</i> | 15,000 | 16,371 | 109% |
| I.5.2 | <i>Takse Reklame</i> | 0 | 23 | |
| A.II | TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA | 152,163 | 176,374 | 116% |
| II.1 | Të ardhura nga taksa vjetore e qarkullimit te mjeteve | 93,128 | 105,131 | 113% |
| II.2 | Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë | 19,000 | 9,579 | 50% |
| II.3 | Të ardhura nga taksa e rentës minerare | 35 | 310 | 885% |
| II.4 | Të ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale | 40,000 | 61,355 | 153% |
| A.III | TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE | 391,990 | 374,073 | 95% |
| III.1 | Te ardhura nga tarifa e pastrimit, largimit të mbeturinave | 195,324 | 180,172 | 92% |
| III.1.1 | Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Familje | 89,860 | 60,241 | 67% |
| III.1.2 | Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Institucione | 464 | 472 | 102% |
| III.1.3 | Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Biznesi | 105,000 | 119,458 | 114% |
| III.2 | Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik | 59,476 | 50,148 | 84% |
| III.1.1 | Të ardhura nga tarifë për ndriçimin publik nga Familje | 38,500 | 29,381 | 76% |
| III.1.2 | Të ardhura nga tarifë ndriçimi publik nga Institucione | 176 | 176 | 100% |
| III.1.3 | Të ardhura nga tarifë ndriçimi publik nga Biznesi | 20,800 | 20,591 | 99% |
| III.3 | Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin | 26,310 | 26,790 | 102% |
| III.1.1 | Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga Familje | 11,950 | 11,479 | 96% |
| III.1.2 | Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Institucione | 160 | 135 | 84% |
| III.1.3 | Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Biznesi | 14,200 | 15,175 | 107% |


| | | | | |
|-----------------|--|----------------|----------------|-------------|
| III.5 | Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ | 110,880 | 116,964 | 105% |
| III.5.1 | Nga tarifa administrative, kontroll territorit, AMTP, etj. | 4,500 | 1,960 | 44% |
| III.5.2 | Nga tarifa për vulosje veterinerë të bagëtive të therura | 0 | 0 | |
| III.5.3 | Nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit | 812 | 744 | 92% |
| III.5.4 | Nga tarifa parkimi për mjetet | 4,500 | 11,307 | 251% |
| III.5.5 | Nga tarifë për dhënie liçensa për tregtimin e naftës | 6,400 | 9,308 | 145% |
| III.5.6 | Nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave. | 100 | 0 | |
| III.5.7 | Nga tarifat e shërbimeve që kryen struktura e MKZ | 1,423 | 2,570 | 181% |
| III.5.8 | Nga tarifa për zënien e hapësirave publike | 60,000 | 66,721 | 111% |
| III.5.9 | Tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille | 1,400 | 0 | |
| III.5.10 | Nga linjat ajrore dhe nëntokësore | 500 | 113 | 23% |
| III.5.11 | Nga dokumentat për tender, ankand etj. | 15 | 1 | 8% |
| III.5.12 | Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit | 4,000 | 0 | |
| III.1.11 | Nga tarifa të institucioneve të arsimit, kultures, sportit, etj | 27,230 | 24,240 | 89% |
| III.1.11.1 | <i>Biblioteka "Marin Barleti"</i> | 15 | 190 | 1267% |
| III.1.11.2 | <i>Muzeumet</i> | 2,755 | 3,606 | 131% |
| III.1.11.3 | <i>Teatri "Migjeni"</i> | 2,400 | 3,363 | 140% |
| III.1.11.4 | <i>Qendra Kulturore e fëmijëve</i> | 0 | 0 | |
| III.1.11.5 | <i>Pallati sportit " Qazim Dervishi"</i> | 0 | 0 | |
| III.1.11.6 | <i>Stadiumi Loro Borici</i> | 0 | 0 | |
| III.1.11.7 | <i>Qendra Komunitare</i> | 10 | 0 | |
| III.1.11.8 | <i>Nga mensat (konviktet)</i> | 50 | 0 | |
| III.1.11.9 | <i>Nga kopshtet</i> | 15,000 | 11,300 | 75% |
| III.1.11.10 | <i>Nga çerdhet</i> | 7,000 | 5,781 | 83% |
| A.IV | TË ARDHURA TË TJERA | 49,576 | 54,269 | 109% |
| IV.1 | Të ardhura nga kundravajtjet administrative (Gjobat) | 26,500 | 40,441 | 153% |
| IV.1.1 | <i>Gjobe Kësti</i> | 9,500 | 14,430 | 152% |
| IV.1.2 | <i>Gjoba Policia Ndërtimore</i> | 9,000 | 4,879 | 54% |
| IV.1.3 | <i>Gjobe Gjendja Civile</i> | 0 | 0 | |
| IV.1.4 | <i>Gjobe Policia Bashkiake</i> | 8,000 | 21,132 | 264% |
| IV.2 | Të ardhura nga dhënia me qira | 2,689 | 3,714 | 138% |
| IV.3 | Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime | 2,000 | 1,599 | 80% |
| IV.4 | Grante nga ndihma nderkombetare | 16,216 | 6,326 | 39% |
| IV.5 | Grante nga buxheti I pushtetit qendror | 0 | 0 | |
| IV.6 | Grante nga institucione ndërkombëtare | 0 | 0 | |
| IV.7 | Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve | 1,800 | 0 | |
| IV.8 | Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara | 0 | 0 | |
| IV.9 | Shitja e asetëve financiare | 0 | 0 | |
| IV.10 | Të ardhura nga privatizimi | 0 | 0 | |
| IV.11 | Të ardhura te tjera | 371 | 62 | 17% |
| IV.12 | Të ardhura nga garanci financiare | 0 | 0 | |
| IV.13 | TË ARDHURA NGA DONACIONET | 0 | 2,127 | |

Grafiku i mëposhtëm paraqet nivelin e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave sipas kategorive kryesore.



Grafiku i mëposhtëm pasqyron peshën specifike të të ardhurave të realizuara për zërat kryesorë, në raport me totalin e të ardhurave të realizuara për vitin 2024.

- Taksa mbi ndërtesën
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin
- Taksa vendore në shërbimin hotelier
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja
- Taksa e tabelës
- Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme
- Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura
- Taksa mbi të ardhurat personale
- Tarifa me menaxhimin të mbetjeve
- Tarifa për ndriçimin publik
- Tarifa për gjelbërimin
- Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë
- Tarifa e liqensimit të veprimtarive të transportit
- Tarifa e parkimit për mjete e liqensuara dhe vendparkime publike
- Tarifa për dhënie liqense për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj
- Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrëfiksj
- Tarifa për zënie dhe përdorimin e hapësirës publike dhe fasadave
- Tarifa për linjat ajrore dhe nëntokore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)
- Tarifa nga dokumentat për tender, ankand etj
- Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj
- Të Ardhurat e Tjera
- Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë
- Kundravajtjet administrative (Gjobat)
- Sekuestrime dhe Zhdëmtime
- Grante nga ndihma ndërkombëtare
- Të tjera



Zërat kryesorë, që janë me tejkalim në krahasim me planin e vitit 2024 janë: të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat për biznesin, të ardhurat nga taksa e truallit, të ardhurat nga taksa e fjetjes në hotel, taksa e ndikimit në infrastrukturë, të ardhura nga taksa e mjeteve të përdorura, të ardhura nga tarifa e parkimit të mjeteve të liçensuara dhe parkimeve të rezervuara, tarifa për zënien e hapësirës publike, taksa e tabelës si dhe të ardhurat nga kundravajtjet administrative që vijnë si rezultat i mbledhjes së detyrimeve aktuale po ashtu edhe atyre të prapambetura nëpërmjet bllokimit të llogarive të biznesit apo akt-marrëveshjeve për pagesë me këste.

Të ardhurat për këto zëra janë realizuar me tejkalim si rezultat i zgjerimit të bazës së taksapaguesve si efekt i rritjes së kontrollit në terren dhe konkretisht realizimit të **4885 akt-kontrolleve**, ushtrimit të masave shtrënguese ligjore me rreth **841** bllokime llogari bankare biznes dhe **1270** bllokime llogari bankare individ, **413** Urdhër Ekzekutive dhe **234** akt-marrëveshje për detyrimet e prapambetura. Gjithashtu sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i taksapaguesve nëpërmjet njoftimeve në media dhe në web, nëpërmjet dërgimit të rreth **5054** njoftim-detyrimeve, përmirësimit të sistemit informatik SiTTV dhe lidhjes me Zyrën me 1-Ndalesë, rivlerësimit të kategorive dhe aktivitetit të subjekteve, mbështetjes nga agjentët tatmorë etj.

Zërat ndikues me mosrealizim janë taksa e tokës bujqësore, si rezultat i mungesës së informacionit të plotë nga ASHK me pasojë vështirësinë e krijimit të regjistrave të saktë që lidhin pronën dhe taksapaguesin e taksës së tokës bujqësore. Këto diferenca në të ardhurat buxhetore totale plotësohen nga zëra të tjerë me tejkalim dhe kanë ndikuar në realizimin e mbledhjes së të ardhurave në masën **106%** për Taksa & Tarifa dhe Grante.

Agjenti tatimor Ujësjiellës Kanalizime sh.a. vazhdon të jetë i bllokuar nga subjekte të treta, shoqëri përmbarimore në bankat e nivelit të dytë, Drejtoria e Tatimeve etj dhe si pasojë detyrimi që Ujësjiellës Kanalizime sh.a. ka ndaj Bashkisë Shkodër nuk është transferuar rregullisht në llogari të saj. Nga ana e Bashkisë Shkodër janë marrë masa për gjetjen dhe ndjekjen e rrugëve ligjore për transferimin e shumave përkatëse të palikujduara duke u bazuar në akt marrëveshjen e lidhur Ujësjiellës Kanalizime sh.a. dhe korrespondencën me bankat e nivelit të dytë.

Realizimi i të ardhurave sipas Njësi Administrative


Tabela e mëposhtme pasqyron realizimin e të ardhurave në çdo njësi administrative gjatë vitit 2024, të kategorizuar sipas klasifikimit ekonomik në 000/lekë.


| | Bashkia Shkoder | Njësia Qendër | Postribë | Guri i Zi | Bërdicë | Velipojë | Dajç | Ana e Malit | Rrethina | Pult | Shosh | Shalë |
|---|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|
| LLOJET E TË ARDHURAVE | Realizimi Viti 2024 | Realizimi Viti 2024 | Realizimi Viti 2024 | Realizimi Viti 2024 | Realizimi Viti 2024 | Realizimi Viti 2024 | Realizimi Viti 2024 | Realizimi Viti 2024 | Realizimi Viti 2024 | Realizimi Viti 2024 | Realizimi Viti 2024 | Realizimi Viti 2024 |
| TË ARDHURAT E VETA | 1,030,466 | 765,412 | 10,715 | 11,613 | 19,048 | 160,526 | 9,790 | 7,666 | 37,502 | 2,113 | 730 | 5,351 |
| TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE | 425,749 | 286,858 | 4,548 | 4,824 | 8,307 | 92,762 | 4,458 | 2,731 | 18,404 | 343 | 132 | 2,382 |
| Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël | 2,214 | 2,214 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur) | 345 | 345 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme | 196,542 | 123,140 | 3,901 | 3,087 | 4,115 | 44,638 | 4,368 | 2,144 | 9,511 | 343 | 63 | 1,232 |
| Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel | 33,960 | 14,100 | 0 | 0 | 0 | 18,454 | 0 | 0 | 186 | 0 | 69 | 1,150 |
| Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja | 176,295 | 132,696 | 640 | 1,688 | 3,625 | 28,960 | 90 | 550 | 8,045 | 0 | 0 | 0 |
| Të ardhura nga taksa e tabelës | 16,394 | 14,363 | 7 | 48 | 567 | 709 | 0 | 36 | 663 | 0 | 0 | 0 |
| TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA | 176,374 | 142,423 | 3,231 | 2,706 | 5,334 | 5,860 | 1,577 | 2,628 | 8,410 | 1,577 | 526 | 2,103 |
| Të ardhura nga taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve të përdorura | 105,131 | 71,489 | 3,154 | 2,628 | 5,257 | 5,782 | 1,577 | 2,628 | 8,410 | 1,577 | 526 | 2,103 |
| Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme | 9,579 | 9,579 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Të ardhura nga taksa e rentës minerare | 310 | 0 | 77 | 77 | 77 | 77 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Të ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale | 61,355 | 61,355 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE | 374,073 | 284,306 | 2,793 | 3,912 | 5,028 | 60,851 | 3,663 | 2,250 | 10,184 | 193 | 69 | 824 |
| Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave | 180,172 | 148,608 | 2,055 | 3,001 | 3,488 | 9,825 | 2,790 | 1,786 | 7,579 | 187 | 69 | 783 |
| Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik | 50,148 | 43,856 | 488 | 520 | 511 | 2,291 | 770 | 439 | 1,266 | 6 | 0 | 0 |
| Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin | 26,790 | 25,553 | 0 | 106 | 74 | 956 | 0 | 0 | 100 | 0 | 0 | 0 |
| Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë | 116,964 | 66,288 | 250 | 284 | 956 | 47,779 | 103 | 25 | 1,238 | 0 | 0 | 41 |
| TË ARDHURA TË TJERA | 54,269 | 51,826 | 142 | 171 | 378 | 1,052 | 93 | 57 | 504 | 0 | 3 | 43 |
| Të ardhura nga kundravajtjet administrative (Gjobat) | 40,441 | 38,109 | 142 | 171 | 378 | 941 | 93 | 57 | 504 | 0 | 3 | 43 |
| Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë | 3,714 | 3,714 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime | 1,599 | 1,487 | 0 | 0 | 0 | 112 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | | | | | | | | | | | | |
|--|--------------|--------------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|
| Grante nga ndihma nderkombetare | 6,326 | 6,326 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e sherbimeve | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Shitja e aseteve financiare | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Të ardhura nga privatizimi | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Të ardhura te tjera | 62 | 62 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Të ardhura nga garanci financiare | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| TË ARDHURA NGA DONACIONET | 2,127 | 2,127 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |



Grafiku paraqet planin dhe realizimin e të ardhurave në % për secilën Njësi Administrative më vehte.






Analiza e peshës specifike sipas kategorive

Pjesën më të madhe të të ardhurave e përbëjnë të ardhurat nga taksat me **41%** dhe të ardhurat nga tarifatat me **36%** të totalit.


Grafiku i mëposhtëm paraqet peshën e të ardhurave sipas kategorive:



Analiza e peshës specifike sipas zërave


Të ardhurat që mbulojnë pjesën më të madhe të realizimit nga burimet e veta për vitin 2024 janë zërat e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave nga bizneset dhe familjet me **17%** të të ardhurave të veta, taksa mbi ndërtesat për biznese dhe banesa me **17%**, taksa mbi truallin **2%**, taksa e ndikimit në infrastrukturë **17%**, taksa vjetore e mjeteve të përdorura **10%**, tarifa për zënien e hapësirës publike **6%**, tarifa e ndriçimit publik **5%**, tarifa e gjelbërimit **3%**, taksa e tabelës **2%**, tarifa nga institucionet e varësisë me **2%**, taksa e fjetjes në hotel **3%**, gjobot **4%**, etj.

Grafiku vijues paraqet peshën specifike sipas zërave kryesorë të ardhurave të veta të realizuara për vitin 2024.



Fluksi monetar mujor i të ardhurave të veta, viti 2024

Falë fokusimit për zgjerim të vazhdueshëm të bazës taksapaguese, evidentimit të kapaciteteve, ndjekjes së hapave ligjorë ndaj subjekteve debitore, marrjes së masave shtrënguese, lidhjes së akt- marrëveshve ndërmjet bashkisë dhe subjekteve debitore biznes/individ, të ardhurat kanë ruajtur një nivel konstant të arkëtimeve. Në këtë mënyrë është siguruar plotësimi buxhetor dhe fluiditeti i nevojshëm financiar për ushtrimin e funksioneve të veta.




Referuar arkëtimeve të të gjithë vitit, niveli më i lartë i arkëtimit është në muajin Maj, Qershor, Korrik, Tetor dhe Dhjetor, periudha të përcaktuara për afatin e fundit të shlyerjes së detyrimit nga biznesi sipas VKB nr.1, datë 22.01.2016 “Për taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Shkodër” të ndryshuar dhe falë efektit të njoftimit, sensibilisimit dhe fillimit të ndjekjes së masave administrative shtrënguese të ushtruara ndaj subjekteve debitore.

Realizimi i të ardhurave 2024, krahasuar me vitet e kaluara

| Emërtimi /000 Lekë | Viti 2016 | Viti 2017 | Viti 2018 | Viti 2019 | Viti 2020 | Viti 2021 | Viti 2022 | Viti 2023 | Viti 2024 |
|-------------------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|------------------|
| Totali | 506,154 | 612,033 | 702,144 | 682,068 | 665,465 | 738,309 | 970,365 | 941,029 | 1,030,466 |
| Taksat vendore | 195,811 | 278,096 | 280,071 | 268,810 | 233,917 | 259,082 | 344,708 | 303,651 | 425,749 |
| Taksat e ndara | 54,448 | 57,207 | 81,214 | 94,614 | 126,722 | 164,666 | 118,568 | 166,877 | 176,374 |
| Tarifatat vendore | 239,277 | 241,838 | 305,624 | 287,610 | 274,154 | 287,445 | 353,966 | 358,161 | 374,073 |
| Burime të tjera vendore | 16,618 | 34,892 | 35,235 | 31,034 | 30,672 | 27,116 | 153,123 | 112,339 | 54,269 |

Krahasuar me vitin 2023, realizimi i të ardhurave ka një rritje me rreth **+89,437 mijë Lekë** të të ardhurave të veta, ose **9.5%** më shumë se viti i kaluar. Kjo rritje vjen si rezultat i realizimit

të disa taksave dhe tarifave mbi nivelin 100%, si taksa vendore në shërbimin hotelier, taksa e ndikimit në infrastrukturë, taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura, tarifa për zënien dhe përdorimin e hapsirës publike dhe fasadave etj, ashtu siç shihet edhe nga tabela e mësipërme.



Analiza e zërave kryesore që kanë ndikuar tek të ardhurat e veta të bashkisë ndër vite



Detyrimi i taksës së pasurisë për biznesin shlyhet bashkë me detyrimet e tjera vjetore, ndërsa detyrimi për familjet llogaritet dhe shlyhet së bashku me faturën e shërbimit të furnizimit me ujë të Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Sh.A. Shkodër, në cilësinë e agjentit tatimor.

Taksa e ndërtesës, krahasuar me vitin e kaluar, ka pothuajse të njëjtin nivel arkëtimi me një diferencë të vogël me **-374 mijë lekë**.

Ky nivel arkëtimi i të ardhurave nga ndërtesat për qëllimi biznesi, ka ardhur si rezultat i ndërgjegjësimit të bizneseve për shlyerjen e detyrimeve vendore, rritjes së numrit të njësive të bizneseve të reja, zgjerimit të aktiviteteve të bizneseve si dhe ndjekjes dhe arkëtimit të detyrimeve të prapambetura nëpërmjet marrjes së masave shtrënguese.


Gjatë vitit 2024, janë rregjistruar rreth **763 biznese te reja**, të cilat janë faturuar për taksat dhe tarifatat vendore sipas VKB Nr.1, datë 22.01.2016 “Për taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Shkodër”, i ndryshuar.

Taksa e truallit, krahasuar me vitin e kaluar, ka një rritje arkëtimi më shumë me **+3,030 mijë Lekë** më shumë se vitin e kaluar.

Taksa e tokës bujqësore, krahasuar me vitin e kaluar, ka pësuar një rënie me **-1,441 mijë Lekë** më pak. Për efekt të lehtësimit fiskal për fermerët, në gjithë bashkinë Shkodër niveli i taksës së tokës bujqësore është ulur me **30%**, pra deri në nivelin e lejuar të referencës ligjore, me ndikim nxitjen e fermerëve, por dhe në zgjerimin e bazës së taksapaguesve. Mosmbulimi i plotë i territorit të Bashkisë Shkodër nga ana e agjentit tatimor Ujësjiellës Kanalizimi, sidomos në Njësitë Administrative ka sjellë për pasojë nivel të ulët në lidhje me taksën e tokës bujqësore.


Janë përfshirë falë monitorimit të sistemit të Z1N, në skemën e pagesave të taksave dhe tarifave familjare rreth **614 familje**, nga të cilat **355 familje** në qytet dhe **259 familje** në Nj.A., të cilat janë faturuar në Sistemin e Integruar të Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Shkodër.

Zgjerimi i bazës taksapaguese dhe rritja e arkëtimit ka ardhur si rezultat i verifikimeve të kapaciteteve dhe krijimit dhe formalizimit të bazës së të dhënave, i kontakteve konstante në terren me subjektet dhe familjarët, nxitjes së marrjes së masave shtrënguese të vazhdueshme të debitorëve, si dhe i politikave lehtësuese dhe sensibilizuese të bashkisë.



Tatim fitimi i biznesit të vogël administrohet, pas miratimit të ndryshimeve ligjore sipas ligjit 142/2015 dt 17.12.2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa me ligjin 9632, datë 30/08/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, dhe Ligjit Nr. 122/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632,


datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar arkëtohet nga bizneset e vogla,dhe më pas i transferohet bashkisë nga drejtoria tatimore, në rolin e agentit tatimor.



Kjo taksë zë një nga zërat më të rëndësishëm tek të ardhurat e veta të bashkisë. Në raport me vitin e kaluar kjo taksë ka një rritje në arkëtim me **+110,592 mijë Lekë**, si rezultat i rritjes së kërkesave për ndërtime në territorin e bashkisë. Gjithashtu Bashkia Shkodër ka bërë lajmërimet në të gjitha Njësitë Administrative dhe është bërë marrja e masave shtrënguese nëpërmjet bllokimit të llogarive bankare të kësaj takse për legalizimin e ndërtimeve pa leje.



Të ardhurat nga taksa e hotelit burojnë kryesisht nga zonat turistike, konkretisht plazhi Velipojë, pastaj vijnë zona e Shalës dhe Njësia Qendër, të cilat faturohen bazuar në monitorimet dhe verifikimet e herëpashershëm të shfrytëzimit të kapaciteteve në terren. Krahasuar me vitin e kaluar të ardhurat kanë një rritje prej **28%** ose e shprehur në lekë **7,351 mijë**. Kjo ka ardhur si rrjedhojë e rritjes së kapaciteteve të bizneseve, monitorimit të vazhdueshëm në terren si dhe rritjes së numrit të vizitorëve të huaj të cilët kanë ardhur për arsye turistike në vendin tonë.



Taksa e tabelës për qëllime reklamimi, ka një trend në rritje me një diferencë prej **+2,281 mijë Lek** krahasuar me vitin e kaluar, si rrjedhojë e rritjes së kapaciteteve të bizneseve, monitorimit të vazhdueshëm në terren.

Taksat e ndara

Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë administrohet nga ASHK (Agjensia Shtetërore e Kadastrës), në rolin e agjentit tatimor. Taksa mbledhet nga agjenti tatimor i cili ia transferon të ardhurat e grumbulluara bashkisë. Krahasuar me vitin e kaluar kjo taksë është realizuar me **-1,071 mijë Lekë** si rezultat i mbylljes së sporteve të ASHK-së dhe kalimit të aplikimeve online nëpërmjet portalit e-albania gjë që ka sjellë për pasojë vërshtirësi në kalimin e pronësisë.


Taksa vjetore e mjeteve të përdorura grumbullohet bazuar në ligjin 9975, dt. 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” të ndryshuar, ku përcaktohet administrimi i taksës kombëtare të regjistrimit të mjeteve të përdorura, pas arkëtimit nga institucioni i Drejtorisë Shërbimit Transportit Rrugor në rolin e agjentit tatimorë. Krahasuar me vitin e kaluar, rezulton një rritje e të ardhurave nga kjo taksë me një vlerë **+3,781mijë lekë**, ose **3.7%** më shumë.

Taksa e rentës minerare që grumbullohet bazuar në ligjin 9975, dt. 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” të ndryshuar, dhe shpërndahet si taksë e ndarë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Rezulton me një rritje të të ardhurave nga viti i kaluar me një vlerë **309 mijë lekë**.


Tatimi mbi të ardhurat personale, sipas ligjit Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, si taksë e ndarë, duhet të transferohet **2%** bashkisë. Gjatë vitit 2022 Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka transferuar vlerën prej **28,847 mijë lekë** në favor të bashkisë dhe gjatë vitit 2023 ka transferuar vlerën **54,876 mijë Lekë** dhe gjatë vitit 2024 vlerën **61,355 mijë lekë**.

Në total të ardhurat nga taksat e ndara janë realizuar **+9,497 mijë lekë** më shumë se vitin e kaluar.


Tarifat Vendore



Tarifat vjetore të pastrimit në total arrijnë vlerën e arkëtuar prej **180,172 mijë lekë** të ndarë sipas kategorive konkretisht: nga biznesi për vitin 2024 arrijnë në total vlerën e **119,458 mijë Lekë** dhe nga taksapaguesit familjarë në vlerën **60,241 mijë Lekë** dhe institucione ne vleren **472 mije leke**. Një ndikim kanë patur edhe vonesat e arketimeve nga agjenti tatimor Ujësjiellës Kanalizime sh.a. për detyrimet e prapambetura, të palikujduara në afat.




Tarifat vjetore të ndriçimit, që janë arkëtuar për vitin 2024 arrijnë në total vlerën e **50,148 mijë Lekë**. Krahasuar me vlerën e vitit të kaluar kemi një rritje me vlerë **+2,539 mijë Lekë** ose **+5.3%** më shumë.



Tarifat vjetore të gjelbërimit, që janë arkëtuar nga biznesi dhe familjarët për vitin 2024 arrijnë në total vlerën e **26,790 mijë Lekë**. Krahasuar me vitin e kaluar kemi një rritje me vlerë **1,201 mijë Lekë**.

Rritja e të ardhurave nga tarifat vendore ka ardhur edhe si rezultat i zgjerimit të bazës së taksapaguesve si dhe ndjekjes së subjekteve debitore, marrjes së masave shtrënguese dhe ndjekjes së afateve të subjekteve që kanë lidhur akt-marrëveshje për shlyerje detyrimesh.

Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë



Edhe pse tarifat për shërbimet që ofrojnë këto insitucione kulturore, arsimore, sportive etj. kanë një tendencë rritje duke dhënë lehtësi fiskale kryesisht për disa kategori të veçanta përfituesve si nxënës, studentë, grupe rinore etj, falë përmirësimit të shërbimit me efekt rritjen e fluksit të përfituesve të shërbimeve, shfrytëzimit me efikasitet të ambjenteve si dhe rritjes së numrit të aktiviteteve kryesisht kulturore në përgjithësi, ka rezultuar që në total gjatë vitit 2024 janë krijuar rreth **116,964 mijë Lekë** të ardhura.

Nëpërmjet mbledhjes së tyre dhe gjetjes së burimeve të reja, këto tarifa lehtësojnë dhe mundësojnë shërbimin më cilësor dhe më të standartizuar të vetë atyre ndaj qytetarëve, pavarësisht se institucionet nuk kanë qëllim në vetvete krijimin e të ardhurave.

Të ardhura të tjera



Të ardhurat e tjera burojnë nga gjobat, kamatëvonesat, qira, grante, donacione etj, për vitin 2024 janë arkëtuar në vlerën **54,269 mijë lekë**.

Të ardhurat nga Gjobat



Të ardhura nga kundravajtjet administrative (Gjobat) për vitin 2024 arrijnë në total vlerën e **40,441 mijë Lekë**. Krahasuar me vlerën e vitit të kaluar kemi një rritje me vlerë **+18,220 mijë Lekë**.

Të ardhurat nga Donacionet


Të ardhurat nga donacionet dhe Grantet për vitin 2024 janë në masën **6,326 mijë lekë**. Këto donacione kanë ardhur nga projekti "Hold On- Nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë", projekti "TVESA@Sh – Konsolidimi i sistemeve për fuqizimin e viktimave në Shqipëri @ Shkodër, si dhe "Punësim dhe mësim për përfshirjen Sociale".

REALIZIMI I SHPENZIMEVE TË BUXHETIT TË 12 M TE VITIT 2024


Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, të 12 M vitit 2024, nga burimet e veta te financimit, arritën 4 282 683 mijë lekë me një nivel realizimi prej 85 për qind.

TOTALI I SHPENZIMEVE PERFSHIRE DHE TRANSFERTEN E KUSHTEZUAR

| Emertimi | Plani Korrigjuar | Likuidimi ne thesar | Realizimi ne % | Obligime me fature/kontrate | Totali realizimit | Realizimi ne % |
|-------------------------------------|------------------|---------------------|----------------|-----------------------------|-------------------|----------------|
| Paga dhe Sigurime | 1,199,958 | 938,532 | 78% | - | 938,532 | 78% |
| Shpenz. Operative | 1,264,340 | 800,373 | 63% | 234,420 | 1,034,793 | 82% |
| Subvencione | 705 | - | 0% | - | - | 0% |
| Transferime | 1,327,899 | 1,234,897 | 93% | 14,310 | 1,249,207 | 94% |
| Investime | 1,160,489 | 408,600 | 35% | 591,930 | 1,000,530 | 86% |
| Totali shpenzimeve me Thesar | 4,953,391 | 3,382,402 | 68% | 840,660 | 4,223,062 | 85% |
| Shpenzime me llogari jashte thesari | 86,439 | 59,621 | 69% | | 59,621 | 69% |
| TOTALI | 5,039,830 | 3,442,023 | 68.3% | 840,660 | 4,282,683 | 85% |



Peshen me te madhe te realizimit ne perqindje e zene shpenzimet per transferimet ne masen 94 %, shpenzimet kapitale ne 86 % , shpenzimet operative ne masen 82 % dhe shpenzimet per paga me 78 % .







Shpenzimet per paga rreth 64.25 % jane realizuar me burim financimi Burimet e Veta , rreth 33.05 % me Transferte e pakushtezuar sektoriale dhe 0.14 % me Donacion dhe 2.56 % me transferte te kushtezuar.

Shpenzimet operative rreth 88.15 % jane realizuar me Burimet e veta, 11.50 % me Transferte e pakushtezuar sektoriale, 0.09 % me donacion dhe 0.26 % me transferte te kushtezuar .

Shpenzimet per transferime jane realizuar me 83.92 % me transferte te kushtezuar , 11.84 % me burimet e veta dhe 4.24 % me Transferte e pakushtezuar sektoriale.

Shpenzimet per investime 81.28 % jane realizuar me Burimet e veta dhe 3.37 % me transferte sektoriale , 15.32 % me transferte te kushtezuar dhe 0.02 % me donacion .

Realizimi i shpenzimeve sipas burimeve te financimit paraqitet si me poshte:



**TOTALI I SHPENZIMEVE PA
PERFSHIRE TRANSFERTEN E
KUSHTEZUAR**

| Emertimi | Plani Korrigjuar | Likuidimi ne thesar | Realizimi ne % | Obligime me fature/kon trate | Totali realizim it | Realizimi ne % |
|--|---------------------|------------------------|----------------|---------------------------------------|--------------------------|-------------------|
| Paga dhe Sigurime | 1,175,252 | 914,474 | 78% | - | 914,474 | 78% |
| Shpenz. Operative | 1,255,708 | 797,650 | 64% | 234,420 | 1,032,070 | 82% |
| Subvencione | 705 | - | 0% | - | - | 0% |
| | P01110.Q3.O1.A12. Sistem Informacioni i Integruar për Menaxhimin Financiar të Bashkisë Shkodër dhe Institucioneve e Varësive & të trashëguara | Bashkia Shkodër | Pa realizuar | - | 1,943 | - |
| | P01110.Q3.O1.A13 Rikonstruksion i Dhomës së Serverave (sistemi i ftohjes i dhomes se serverave + ups per acces controll) | Bashkia Shkodër | - | - | - | - |
| | P01110.Q3.O1.A14 Blerje vegla pune | Bashkia Shkodër | Realizuar | 200 | 200 | 167 |
| | P01110.Q3.O1.A15 Rikonstruksion godina ish konvikti Safet Spahia | DPMOP | Në proces zbatimi kontrate | - | 32,409 | - |
| Permbushja e Detyrimeve Gjyqësore dhe regjistrimi i pronave ne pronësi të Bashkisë (Nr.i vendimeve gjyqësore të formes së prerë dhe numri vjetor i pronave të rregjistruara në ASHK) | P01110.Q3.O2.A1. Detyrime dhe kompensime legale & të trashëguara | Bashkia Shkodër | Realizuar në vazhdimësi | - | 15,440 | 7,366 |
| | P01110.Q3.O2.A2.Shlyerja e detyrimeve te prapambetura & të trashëguara | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 1,013 | 571 |
| | P01110.Q3.O2.A3. Shërbimi për regjistrimin e pronave në pronësi të Bashkisë Shkodër | Bashkia Shkodër | Realizuar në vazhdimësi | 1,000 | 1,000 | 266 |
| Nëpunës të trajnuar (Nr.punonjesish) | P01110.Q3.O3.A1.Trajnimi i burimeve njerëzore të Bashkisë së Shkodrës | Bashkia Shkodër | Pa realizuar | 700 | 700 | - |
| | P01110.Q3.O3.A2. Udhëtime e dieta për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë | Bashkia Shkodër | Realizuar në vazhdimësi | 685 | 685 | 653 |
| Subjekte Tregtare të Inspektuara (Nr.subjekte dhe individe) | P01110.Q3.O4.A1 .Paga per drejtorine e te ardhurave ,pagesa e tarifës për vendosje barre siguruese dhe hipotekore dhe shpenzime korente dhe kapitale & të tasheguara | Bashkia Shkodër | Realizuar në vazhdimësi | 34,292 | 40,674 | 36,099 |
| | P01110.Q3.O4.A2. Pagesa e komisionit si agjent tatimor & të trashëguara | Bashkia Shkodër | Realizuar në vazhdimësi | 3,500 | 6,485 | 5,221 |

| | | | | | | |
|---|---|-----------------|--------------|----------------|----------------|----------------|
| Transparenca Publike (Nr.faqe web dhe nr.video spoti informativ) | P01110.Q3.O5.A1. Mirëmbajtje e faqes zyrtare web www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj & të trashëguara | Bashkia Shkodër | Realizuar | 1,000 | 267 | 211 |
| | P01110.Q3.O5.A2. Informimi I qytetarëve përmes mediave vizive për përfitimin e shërbimeve nga Bashkia Shkodër | Bashkia Shkodër | Pa realizuar | 500 | 500 | - |
| 01110 Planifikim , menaxhim dhe administrim | | | | 265,094 | 382,647 | 279,353 |
| Të trashëguara | | | | 75,388 | 1,294 | - |
| Totali | | | | 340,482 | 383,941 | 279,353 |

Aparati i Bashkisë ka si objektiv formalizimin, përmirësimin e punës, shërbimeve administrative dhe rritjen e transparencës.

Për 12-mujorin e vitit 2024 në programin “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara për vitin 2024, nga administrata e Bashkisë janë analizuar si më poshtë aktivitetet:

P01110.Q1.O1.A1. Vazhdimësia e menaxhimit efektiv e administratës së Bashkisë së Shkodrës në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe honorare për kryetarët e fshatrave & te trashëguara

Në këtë aktivitet perfshihen të gjitha aktivitetet dhe shpenzimet e lidhura me pagesën e punonjësve të administratës vendore dhe pagesa e honorare për kryetarët e fshatrave. Me VKB nr. 55, datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar me VKB 55 date 30.09.2024”, është miratuar numri i punonjësve të Bashkisë Shkodër për vitin 2024, ndërsa niveli i pagave me VKB nr. 54, datë 30.09.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”, Paga dhe shtesat mbi paga. Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli për vitin 2025, bazohet tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, të pages bazë minimale në shkallë vendi Vendimit nr.113, datë 01.03.2023 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi"; brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar, në mbështetje të ligjit nr.35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, VKM nr. 328 dt. 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 325 dt. 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civile dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar ; VKM nr. 326 datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar. Per pagesen e keshilltareve de kryetareve te fshatrave : nenit 51 ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar – Te drejtat e keshilltarit ku thuhet – Këshilltari kryen funksion me shperblim mujor të barabartë me 10 % të pagës mujore te kryetarit te bashkise perkatese.; nenit 9 te ligjit nr.35/2023, datë 25.05.2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike ku thuhet : shperblimin mujor të kryetareve të fshatrave në masën deri në 10 përqind te pagës mujore të kryetarit perkates te njesise se veteqeverisjes vendore. Për shpërblimin e kryetarëve të fshatit të Njësive Administrative në territorin e Bashkisë Shkodër, zbatohet ligjit nr.35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë

minimale në shkallë vendi”, i ndryshuar, i cili rregullon efektet e masës së shpërblimit për kryetarët e fshatrave të Njësi Administrative. Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Realizohet në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11. 05. 1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 10383 datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyruar të kujdesit shëndetësor” dhe udhëzimin nr 23 dt 09.12.2014 ”Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore” Kompensim për kryefamiljarët me ngarkesë me më shumë se tre persona në ngarkim në familje Sipas VKM Nr. 499, dt 13.08.1998, i ndryshuar , VKM. Nr. 683 dt 28.10.1988 dhe udhëzimit të M.P.Ç.Sociale, nr 3311, dt 24.12.1998, të punësuarit në sektorin buxhetor përfitojnë shpërblim sipas rastit. Aparati i Bashkisë ka si objektiv formalizimin, përmirësimin e punës, shërbimeve administrative dhe rritjen e transparencës

P01110.Q1.O1.A2. Shërbimet e deleguara (Gjendja Civile) transfertë e kushtëzuar

| Aktiviteti | Institucioni | Statusi | Plan fillestar 2024 | Plan I rishikuar 2024 | Realizimi |
|--------------------------------------|-----------------|-------------------------|---------------------|-----------------------|-----------|
| Shërbime të deleguara-Gjendja civile | Bashkia Shkodër | Realizuar në vazhdimësi | 22,395 | 26,532 | 24,324 |

Është realizuar në vazhdimësi prodhimi i dokumentave në shërbim të qytetarëve dhe mbështetja e funksionimit të Gjendjes Civile përmes realizimit në kohë të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

P01110.Q1.O1.A3. Rekrutimi i burimeve njerëzore në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve & te trashëguara

Ky aktivitet synon rekrutimin e burimeve profesionale për të qënë pjesë e administratës vendore përmes procedurave të përcaktuara me ligj, në mënyrë transparente, me profesionalizëm dhe në bazë të meritave, aftësive profesionale, pavarësisë dhe integritetit, vazhdimësisë së karrierës, përgjegjësisë dhe korrektesës në zbatimin e ligjeve. Procesi i rekrutimit është një nga proceset më komplekse të menaxhimit të shërbimit civil dhe të reformës në administratën publike.

Këto rekrutime realizohen me procedurën e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Kjo procedurë realizohet përmes konkursit të hapur në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM Nr. 242, datë 18/03/2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar, VKM Nr. 243, datë 18/03/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar dhe është realizuar rekrutimi për vendet vakante të shpallura. Realizuar në vazhdimësi pagesa e ekspertëve të jashtëm sipas ligjit.

P01110.Q1.O1.A4. Anëtarësimi në Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë (Shoqatën për autonominë vendore)

Shoqata për autonominë vendore është një shoqatë jopolitike, jofetare dhe jofitimprurëse. Shoqata është një bashkim vullnetar dhe i pavarur i Bashkive dhe mban statusin e një organizate jofitimprurëse (OJF) me një shtrirje gjeografike në të gjithë territorin e vendit. Përprjekjet e saj të vazhdueshme kanë synuar sensibilizimin e strukturave dhe institucioneve të pushtetit qendror për përsheptimin e procesit të decentralizimit, si dhe konsolidimi i rolit të bashkive në ushtrim të rolit të tyre qeverisës, duke dhënë në vazhdimësi rezultate konkrete. Roli dhe kontributi i shoqatës sot është mjaft i vlerësuar dhe i njohur jo vetëm nga anëtarët e saj por edhe nga institucionet në pushtetin qendror, donatorët, shoqatat ndërkombëtare të autoriteteve vendore.

Qëllimi i saj është që të lehtësojë vendosjen e kontakteve ndërmjet Bashkive brenda vendit dhe partnerëve të tyre jashtë vendit, si shoqata simotra e institucione ndërkombëtare, me qëllim shkëmbimin e informacioneve, eksperiencave dhe zhvillimin e programeve të përbashkëta të bashkëpunimit. Anëtare e Shoqatës, mund të jetë çdo bashki e RSh, e cila pranon statutin e shoqatës, angazhohet të punojë për realizimin e misionit dhe qëllimeve të shoqatës, si dhe të paguajë kuotën e anëtarësisë sipas kushteve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme për pagesën e kuotizacionit vjetor.

Synimi i këtij projekti është Mbrojtja e interesave të përbashkëta të Bashkive me qëllim decentralizimin dhe demokratizimin e vërtetë të qeverisjes sipas parimeve të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore dhe garantimi i pagesës së kuotizacionit vjetor nga buxheti i bashkisë.

Ky aktivitet nuk është realizuar.

P01110.Q1.O1.A5. Kuota e anëtarësisë për financimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut

Në zbatim të udhëzimit Nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” të ardhurat e qarqeve nga kuota e njërive vendore, kuotat e miratuara nga këshilli i qarkut bëhen pjesë e buxhetit të njërive të qeverisjes vendore. Mes njërive të qeverisjes vendore dhe këshillit të qarkut mbahet një akt-marrëveshje për detyrimin vjetor ndaj këshillit të qarkut. Mbi bazën e titullit për arkëtim që lëshon këshilli i qarkut bëhet transferim i brendshëm nga njëria vendore në favor të këshillit të qarkut nëpërmjet strukturës përgjegjëse për thesarin në sistemin informatik financiar të qeverisë. Ky aktivitet është realizuar .

P01110.Q1.O1.A6. Organizimi i pritjeve të përfaqësuesve të institucioneve vendase dhe të huaja.

Ky aktivitet ka si synim që në kuadër të bashkëpunimit me shtete të tjera, në nivel lokal, rajonal dhe më gjërë, të vendosë dhe nxitë bashkëpunimet midis qyteteve dhe partnerëve lokal, rajonal dhe ndërkombëtar në të gjitha fushat, për zhvillimin dhe konsolidimin e marrëdhënieve dypalëshe Në kuadër të eksperiencave për arritjen dhe zhvillimin e kontakteve të krijuara nga përfaqësuesit tanë kemi synim arritjen e standarteve në nivele të përafërta me qytetet e tjera evropiane. Janë realizuar darka dhe dreka pune në kuadër të bashkëpunimeve me partnerë lokalë dhe rajonalë për 627 persona.

Gjithashtu për rritjen e harmonisë fetare në qytetin e Shkodrës është shtruar Iftar për komunitetin mysliman dhe qytetarët e Shkodrës me rastin e Muajit të Madhnueshëm të Ramazanit.

P01110.Q2.O1.A1. Mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore (Këshillit Bashkiak) shpenzime korente dhe kapitale & te trashëguara

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Këshilli Bashkiak përbëhet nga 51 këshilltarë të zgjedhur, sipas dispozitave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Është siguruar mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore dhe realizuar shpërblimi mujor në mënyrë sistematike dhe me korrektësi për anëtarët e Këshillit Bashkiak.

P01110.Q3.O1.A1. Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin administratës së Bashkisë së Shkodrës & te trashëguara

Është realizuar në vazhdimësi funksionimi normal i të gjithë administratës së Bashkisë së Shkodrës nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse bazë si ujë, energji elektrike, ngrohje, komunikim postar, shërbim telefonie dhe shërbime të tjera.

P01110.Q3.O1.A2.Shërbim me kancelari dhe shtypshkrime për Administratën e Bashkisë së Shkodrës & te trashëguara

Është mundësuar sigurimi dhe furnizimi i vazhdueshëm me kancelari, letër, bojë, shtypshkrime etj. sipas kërkesave të drejtorive. Sigurimi dhe furnizimi i vazhdueshëm me kancelari, letër, dhe bojëra për printera e fotokopje dhe shtypshkrime i mundëson punonjësve përmbushjen e detyrave dhe objektivave. Ky shërbim është realizuar.

P01110.Q3.O1.A3. Shërbime mbështetëse bazë të mirëmbajtjes (materiale hidraulike, elektrike etj)

Është realizuar dhe siguruar në vazhdimësi mbështetja për shërbimet mbështetëse bazë për mirëmbajtjen dhe furnizimin me materiale elektrike, hidraulike.

P01110.Q3.O1.A4. Blerje pajisje zyre për administratën e Bashkisë së Shkodrës & të trashëguara

Është realizuar blerja e kondicionereve (loti i I-rë) dhe është në proces zbatimi i kontratës për blerja pajisje zyre (loti II-të)

P01110.Q3.O1.A5. Sigurimi i ndërtesave administrative të Bashkisë së Shkodrës

Bashkia Shkodër ka detyrim ligjor për sigurimin nga zjarri dhe rreziqet e tjera të pronave dhe inventarit të saj ekonomik. Sigurimet e ndërtesave reduktojnë barrën financiare dhe lehtësojnë vazhdimësinë e institucionit duke ulur kostot publike në rast të ndodhjes së fatkeqësive.

Ky shërbim është realizuar për ndërtesën e Bashkisë Qendër, magazinave dhe Njësive Administrative.

P01110.Q3.O1.A6. Shërbim i mirëmbajtjes për godinat administrative të Bashkisë së Shkodrës & të trashëguara

Ndërtesa e Bashkisë Qendër dhe e Njësive Administrative duhet të jetë në kushte fizike normale të pranueshme për administratën, me qëllim kryerjen e detyrave të përditshme si edhe për qytetarët të cilët paraqiten në ato ambiente për të marrë shërbimin e nevojshëm.

Realizuar për vitin me fonde të trashëguara. Në proces prokurimi (vlerësimi) për vitin e ardhshëm.

P01110.Q3.O1.A7. Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e administratës së Bashkisë së Shkodrës & të trashëguara

Janë siguruar në vazhdimësi dhe realizuar furnizimi sistematik me karburant i mjeteve të transportit për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme të administratës vendore të Bashkisë Shkodër sipas nevojave në Bashkinë qendër, Njësi Administrative etj. shlyerja e të gjitha taksave të qarkullimit dhe kolaudimit vjetor të mjeteve të transportit në shërbim të administratës.

Realizuar

P01110.Q3.O1.A8. Shërbim Interneti për Institucionin e Bashkisë së Shkodrës & të trashëguara.

Është realizuar prokurimi dhe ofrimi i shërbimit të internetit në të gjithë Bashkinë Shkodër (Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative dhe Lagje). Bashkia Shkodër ka të implementuar një sistem të qendëruar të marrjes së shërbimit të internetit në Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative, Lagje dhe Qendra Komunitare. Zgjidhja e implementuar ofron 99.99% shërbimin në çdo kohë në çdo pikë të tij. Sistemi siguron konfidencialitetin dhe sigurinë e informacionit që transmetohet në linjat e komunikimit. Të gjithë pikat e furnizuara të Bashkisë Shkodër kanë akses në internet 24/7 pa kufizim në komunikim. Ky shërbim ka rritur shpejtësinë në komunikim të të dhënave, ka ulur kostot operative për komunikimin e informacionit, ka garantuar mirëfunksionimin e sistemeve të bazuara në platforma web që Bashkia ka implementuar dhe ka shtrirë në të gjithë njësitë e saj administrative, si: Sistemi i Integruar i Zyrës me Një Ndalesë (SiZIN), Sistemi i Integruar i Taksave dhe Tarifave Vendore (SiTTV), Sistemi i qendëruar kombëtar i shërbimeve të Ndihmës Ekonomike, e- Lejet, Sistemi AFMIS, portali i Transparencës së Buxhetit, sistemi i integruar i menaxhimit të Shërbimeve Sociale dhe Strehimit, faqja zyrtare e internetit www.bashkiashkoder.gov.al, menaxhimi i dokumentacionit dhe punës së përditshme të administratës vendore në rrugë elektronike, transparente dhe në kohë, etj. Ky shërbim është në vijim për 3 vitet e ardhshme.

P01110.Q3.O1.A9. Mirëmbajtje pajisje Informatike

Pasi është bërë rivlerësimi i pajisjeve ekzistuese TIK në Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative të saj, Lagjeve dhe Qendrave Komunitare, ky shërbim është realizuar . Është bërë e mundur mirëmbajtja e disa pajisjeve ekzistuese që kanë pasur nevojë për shërbim.

P01110.Q3.O1.A10. Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)

Pas procesit të vlerësimit të kërkesave të stafit për blerje të pajisjeve TIK dhe sipas standarteve minimale teknike, për të mundësuar pajisje të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në mbështetje të punës së administratës vendore dhe në mbështetje të sistemeve të informacionit të implementuara dhe që do të implementohen në të ardhmen në Bashkinë Shkodër, është realizuar blerja dhe vendosja në funksion e pajisjeve të reja TIK.(Kompjuter,printer,UPS,etj)

P01110.Q3.O1.A11. Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Informacionit të bashkisë Shkodër

Ky shërbim mundëson për informimin e publikut për të ardhurat vjetore të saj, shpenzimet dhe investimet, llogaritjen e taksave dhe tarifave vjetore të qytetarëve dhe bizneseve, si dhe i fton ato të shprehen online për kërkesa apo pakënaqësi të mundshme t'i drejtohen zyrave përkatëse përgjegjëse në Bashki për zgjidhje.

Bashkia Shkodër ka implementuar një sistem informacioni për Shërbimet Sociale. Qëllimi kryesor i implementimit të këtij sistemi është ofrimi i mundësisë për të populluar një bazë të dhënash të saktë me informacione mbi institucionet që ofrojnë shërbime sociale, si dhe mbi përfituesit që janë të regjistruar pranë këtyre institucioneve, në nivel vendor.

Bashkia Shkodër ka arritur ofrimin e shërbimeve administrative elektronike aty ku qytetari dhe biznesi ndodhet, duke mundësuar që qeverisja vendore të shkojë drejt qytetarit në kohë të shkurtër, në mënyrë cilësore dhe transparente. Kjo ka rritur llogaridhënien financiare dhe ka mundësuar pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje. Aktualisht shërbimi ofrohet nga Smart Proceses Sh.P.K sipas kontratës së lidhur. Është bërë realizimi i kësaj procedure.

P01110.Q3.O1.A12. Sistem Informacioni i Integruar për Menaxhimin Financiar të Bashkisë Shkodër dhe Institucioneve e Varësive & te trashëguara

Është nënshkruar kontrata me operatorin ekonomik “*Infosoft Software Developer*” dhe janë kryer disa nga pikat kryesore të saj, si instalimi i sistemit në postet e punës, konfigurimi i planit kontabël apo i artikujve të ndryshëm të magazinës, trajnimet bazë mbi disa nga modulet kryesore të saj. Duke qenë se nuk janë plotësuar specifikimet teknike sipas kërkesës nga Drejtoria e Financës, operatori ekonomik ka kërkuar shtyrjen e afateve për përmbushjen e të gjitha kërkesave të autoritetit kontraktor. Duke qenë se operatori nuk ka realizuar kërkesat sipas kushteve të kontratës, po vlerësohen mundësi të tjera për zgjidhjen e kësaj kontrate.Fondet janë të bllokuara në thesar.

01110.Q3.O1.A14 Blerje vegla pune

Në vijim të përmbushjes së kushteve fizike normale të punës për punonjësit e administratës vendore dhe për arsye të mungesës së veglave të punës për punonjësit e IT si për mirëmbajtje, printera, fotokopje etj ka përfunduar blerja e veglave të punës që do të shërbejë këtyre punonjësve për të përmbushur detyrat e tyre funksionale. Ky aktivitet është realizuar.

P01110.Q3.O1.A15 Rikonstruksion godina ish konvikti Safet Spahia

Ky aktivitet është në proces realizimi i kontratës dhe ndiqet nga Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve publike

Drejtoria Juridike

P01110.Q3.O2.A1. Detyrime dhe kompensime legale & të trashëguara

Nga Drejtoria Juridike për 12- mujin e vitit 2024, janë realizuar veprimtaritë si më poshtë :

1. Janë ndjekur 132 proçese gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit. Nga ky total i çështjeve gjyqësore, 49 janë proçese me efekte financiare.
2. Janë realizuar shpenzimet për pagesë tarifë pulla (njoftimi/tërheqje vendimi/depozitim padie/depozitim ankimi).
3. Janë likuiduar shpenzimet për vendime gjyqësore dhe tituj ekzekutiv/gjoha të institucioneve kompetente.
4. Janë administruar 9 vendime gjyqësore të formës së prerë me efekte financiare.
5. Janë likuiduar 8 vendime gjyqësore të formës së prerë.

Janë zbatuar me rigorozitet dispozitat ligjore në fuqi, sa i takon ndjekjes së të gjitha shkallëve të gjykimit për të gjithë proçeset gjyqësore me efekte financiare.

P01110.Q3.O2.A2.Shlyerja e detyrimeve të prapambetura & te trashëguara

Ky fond është me transfertë sektoriale sjellë nga Ministria për të paguar detyrimet e prapambetura nuk është realizuar për shkak se nuk kemi detyrime që mund të paguajmë me dokumentacion të rregullt financiar dhe ligjor. Janë realizuar pjesërisht detyrimet e prapambetura.

P01110.Q3.O2.A3. Shërbimi për regjistrimin e pronave në pronësi të Bashkisë Shkodër

Ky aktivitet përfshin rregjistrimin e pronave të transferuara me VKM për transferimin në pronësi ose përdorim të pronave të paluajtshme publike , shtetërore, rregjistrimin e e pronave që fitohen nga shpronësimet dhe aplikimi të bëra pranë ASHK për konfirmime statusi Juridik, kartela pasurie+HTR.

Drejtoria e Aseteve dhe Kadastrës Urbane

Gjatë 12 mujorit të vitit 2024 kjo drejtori ka realizuar si më poshtë:

Në total janë bërë 31 aplikime për 167 prona, 8 prona për të cilat është bërë aplikim për shpronësim, 78 prona për të cilat është bërë aplikim për status juridik, kartele pasurie dhe harta treguese, 81 prona të aplikuara për regjistrim pronash sipas VKM .

P01110.Q3.O3.A1.Trajnimi i burimeve njerëzore të Bashkisë së Shkodrës

Reformimi i administratës publike kërkon nëpunës civilë të aftë për të përballuar sfidat gjithnjë në rritje. Kapacitetet njerëzore janë një aset, të cilit duhet t'i kushtosh jo pak vëmendje, jo vetëm për t'i ruajtur, por edhe për t'i zhvilluar dhe për t'i përshtatur me kërkesat e kohës. Të gjithë nëpunësit civilë të cilët emërohen për herë të parë në shërbimin civil i nënshtrohen një periudhë prove që zgjat një vit nga data e aktit të emërimit. Trajnimi i detyrueshëm për nëpunësit civilë në periudhë prove, sipas ligjit 152/2013 "Për Nëpunësin Civil" të ndryshuar është një mundësi shumë e mirë për nëpunësin, i cili emërohet për herë të parë në administratën publike, pasi krijon mjedisin e përshtatshëm për t'u njohur me parimet themelore, mënyrën e organizimit të administratës, kuadrin ligjor, menaxhimin sa më të mirë të burimeve për arritjen e objektivave. Ky trajnim ka për qëllim të integrojë sa më mirë nëpunësin me mjedisin ku ai do të punojë, duke i prezantuar qartë rolin dhe përgjegjësinë që ai ka jo vetëm si mbështetës i reformave, por dhe si promotor i ideve inovative dhe menaxhuese të interesave të qytetarëve.

Më konkretisht, këto njohuri që ofron ky trajnim fokusohen në:

- Parimet kushtetuese si bazë e veprimtarisë së administratës publike për respektimin e të drejtave të njeriut.
- Transparenca dhe efikasiteti në arritjen e objektivave dhe zbatimin e legjislacionit
- Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e nëpunësit të administratës shtetërore
- Sjellja, integriteti dhe lufta kundër korrupsionit

- Menaxhimi me efikasitet dhe burimeve njerëzore dhe financiare
- Procesi i integritetit evropian, detyrat dhe sfidat kryesore.

Gjithashtu ky aktivitet synon që për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë punonjësit të mund të kryejnë trajnime edhe në institucione të tjera trajnuese me iniciativën e tyre, për detyrën që ata kryejnë, me propozimin e përbashkët të eprorit e të drejtuesit të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit dhe me miratimin e titullarit të institucionit.

Për 12 mujorin e vitit 2024 janë realizuar disa trajnime për 146 punonjës me tema si:

Ngritja e kapaciteteve lokal në kuadër të zbatimit të Procedurës së Menaxhimit të Rastit dhe Protokollet e menaxhimit të rasteve nga SOS Fshatrat e Fëmijeve; Standartet e Shkrimit në gjuhën e thjeshtezuar, në vijim të punës për përfshirjen e fëmijeve me aftësi të kufizuara nga Caritas Albania Shqiptar; Protokollet dhe mekanizmat e identifikimit dhe referimit të rasteve për fëmijë dhe të rritur, viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit të rastit nga World Vision; Gruaja. Paqja, Siguria nga koncepti në realitet; Ekstremizmi i dhunshëm. Identifikimi i shenjave të hershme të radikalizimit të dhunshëm nga QendraIMPAKT dhe DE-I.Problematikat dhe menaxhimi i rastit nga NISMA ARSIS. Efektiviteti i Ekipit, Trajnim i vazhdueshëm profesional për auditin e brendshëm, Menaxhimi i rrishtit kibernetik, Cikli i menaxhimit të projektit, sfidat, praktikat e mira të profesionistëve mbështetës të projekteve Menaxhimi i rrishtit, Roli, Analiza dhe Auditimi i Pasqyrave Financiare, Strukturat e Integritetit Evropian, Komunikimi dhe Roli në këtë Proces në Nivel Vendor, Veprimet juridike të së drejtës civile, Kontratat dhe klasifikimi i tyre sipas Kodit Civil, Ekonomia në Bashkimin Evropian, Bazat në statistikë, Statistikat në monitorim, CERV - Programi për Qyterarët, Barazinë, të Drejtat dhe Vlerat, Prokurimi me blerje të vogël, Menaxhimi i palëve të interesuara në zbatimin e projekteve, Performanca e njësisë të vetëqeverisjes vendore, Reforma territoriale, decentralizimi dhe vetëqeverisja vendore, E drejta dhe interesat legjitime të strategjive në politikën e punësimit, Programi Buxhetor Afatmesëm, Marrëdhëniet individuale të punës, të drejtat, detyrimet përparësitë e normave juridike Analiza SWOT, Etika në administratën Publike, Kriteret e veçanta për kualifikimin dhe specifikimet teknike, Llojet e procedurave të prokurimit publik, Bashkitë në procesin e integritetit evropian në Bashkimin Evropian, Disiplina sipas ligjit të shërbimit civil, Prag- Prokurimet sipas Rregullave të BE-së dhe Kushtet e Kontratave, Menaxhimi i fondeve IPA, Raporti i të drejtës Evropiane me të drejtën kombëtare, Marrëveshjet në oferta, Llojet e procedurave të prokurimit publik, Strategjia e re e decentralizimit dhe roli i ministrit të shtetit për vetëqeverisjen vendore, IA dhe Impakti i Ligjit evropian mbi shtetet., Prefekti, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe konfirmimi i ligjshmërisë, Statistika zyrtare tema 68, Paraqitjet dhe sfidat e korrupsionit, Trajnim për komisionet e këshillit bashkiak, Shkeljet e sigurisë për informacionin e klasifikuar, CERV - Programi për Qyterarët, Barazinë, të Drejtat dhe Vlerat, Njohja me aktet juridike evropiane dhe trajnim i të gjithë administratës me temë Gjuha e trupit, marrëveshje mes Bashkisë Shkodër dhe Institutin e Gjuhës së Trupit në kuadër të rëndësisë së madhe që ka gjuha e trupit në komunikimin jo verbal në marrëdhëniet ndërpersonale për punonjësit e administratës si dhe me Publikun.

P01110.Q3.O3.A2. Udhëtime e dieta për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë

Tek ky aktivitet realizohet shërbimi sipas nevojave për udhëtime për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë, i cili është i domosdoshëm në rritjen e standartet të plotësimit të kushteve të punës ndaj administratës si dhe anasjelltas, në rritjen e efikasitetit të administratës për dhënien e kontributit dhe përfaqësimin e duhur të institucionit në takime pune etj. Realizuar rimbursimi i shpenzimeve dhe dietave për administratën vendore në masën financiare që ligji e parashikon.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore

Për 12-mujorin e vitit 2024 ka realizuar veprimtaritë në lidhje me shpenzimet si më poshtë:

P01110.Q3.O4.A1 .Paga per drejtorine e te ardhurave ,pagesa e tarifës për vendosje barre siguruese dhe hipotekore dhe shpenzime korentë dhe kapitale & te trashëguara

Për të ulur vlerën debitorë, që subjektet dhe individët familjarë kanë ndaj Bashkisë Shkodër, bazuar në Ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nga Drejtoria e të Taksave dhe Tarifave vendore vazhdon marrja e masave shtrënguese "urdhër bllokim i llogarive bankare", "urdhër ekzekutim i llogarive bakare" si dhe "vendosje barre hipotekore dhe siguruese" të tatimpaguesit. Vetëm për vitin 2024, për periudhën Janar - Dhjetor 2024 situata paraqitet si më poshtë:

Është bërë 1 njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore për subjekte biznes dhe 121 individë, është bërë 5 njoftim për vendosjen e barrës hipotekore (Bllokim) për subjekte biznes dhe 76 individë, është bërë 1 njoftim për heqjen e barrës hipotekore për subjekte biznes dhe 4 individë, janë bërë 36 njoftime të përgjithshme për vendosjen e barrës siguruese për subjekte biznes dhe 128 individë, janë bërë 5 njoftime për vendosjen e barrës siguruese (Bllokim) për subjekte biznes dhe 76 individë, është bërë 2 njoftim për heqjen e barrës siguruese për subjekte biznes dhe 6 individë, janë bërë 40 njoftime për konfiskim të xhiros ditore 50% për subjekte biznes, janë bllokuar 841 llogari bankare për subjekte biznes dhe 1270 individë, janë lëshuar 285 urdhra zhblokimi për subjekte biznes dhe 368 individë, janë lëshuar 147 urdhra ekzekutim për subjekte biznes dhe 266 individë, dhe janë bërë rreth 84 akt-marrëveshje për subjekte biznes dhe 150 individë.

P01110.Q3.O4.A2. Pagesa e komisionit si agjent tatimor& të trashëguara (Transferim komisioni 2%)

Sipas akt marrëveshjes lidhur mes Bashkisë Shkodër dhe "Ujësjellës Kanalizime" sh.a, Shkodër është realizuar në zbatim të ligjit për transferimin e komisionit për agjentin tatimor, që llogaritet në përqindje të shumës së tatimit që kanë arkëtuar dhe transferuar në buxhetin e Bashkisë Shkodër për llogari të Administratës Tatimore Qendrore. (Drejtorisë Rajonale Tatimore). Synimi është pagesa e tarifës për vendosje barre siguruese dhe hipotekore me anë të zbatimit të masave shtrënguese, respektivisht vendosjes së barrë siguruese dhe/ose barrë hipotekore, ku synohet ulja e borxhit për taksat dhe tarifave vendore, që subjektet dhe individët kanë ndaj Bashkisë Shkodër.

Sipas akt marrëveshjes nr. 1725 prot, datë 01.02.2022 (afati deri me 31.12.2022), akt marrë veshje për shtyerje afati kohor nr.1296 prot . datë 26.01.2023 (afati deri me 31.03.2023), akt marrëveshjes nr. 4603 prot. datë 31.03.2023 (afati nga 01.04.2023 deri me 31.12.2023), Urdhërit nr. 77, datë 24.01.2024, faturës Nr. 333/2023, datë 31.03.2023. Urdhërit nr. 354 date 07.03.2024, dhe Urdhëri nr. 1931 date 31.12.2024, fatures Nr.45355/2024 date 08.02.2024, VKB nr.71, datë 27.12.2022, VKB nr.55 date 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë së Shkodrës", është bërë transferim fondi për pagesë të agjentit tatimor UKSH në vlerën prej 5.198.670 lekë (vlera e tatueshme 4.332.225 lekë dhe TVSH 866.444.8 lekë) për llogari te vitit 2022 dhe 2023.

P01110.Q3.O5.A1. Mirëmbajtje e faqes zyrtare web www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj & te trashëguara

Ky aktivitet realizohet në vazhdimësi. Bashkia Shkodër zotëron faqe zyrtare interneti nën domain-in www.bashkiashkoder.gov.al. Kjo faqe është 24/7 online dhe aktualisht është një faqe e nivelit të 3 në përputhje me rregulloren e AKSHI- t për faqet zyrtare në administratën publike. Në faqe janë të integruar disa module që mundësojnë pjesëmarrjen e qytetarëve dhe demokracinë vendore në kuadër të mirëqeverisjes elektronike vendore. Moduli i Librisë Ligjore i implementuar dhe i integruar në faqe, bën të mundur që Bashkia të ndajë me qytetarët të gjithë projekt- vendimet dhe vendimet e Këshillit të Bashkisë përmes një moduli të menaxhueshëm në web nga Sekretaria e Këshillit të Bashkisë. Moduli e- Pjesëmarrje i implementuar dhe i integruar në faqe, mundëson krijimin e vazhdueshëm të sondazheve me tematika të

ndryshme dhe marrjen e mendimeve nga qytetari, lehtësisht i menaxhueshëm nga punonjësit e Bashkisë. Moduli i SiZIN, i integruar në faqen web, bën të mundur gjurmimin e kërkesave për shërbim të qytetarëve (tregon se në cilin status të aplikimit ndodhen shërbimet) që aplikohen në Zyrën e Integruar me Një Ndalesë në Bashkinë Qendër apo Njësitë Administrative, direkt nga portali zyrtar online. Shkarkimi i formularëve online, informacioni i detajuar i rregjistrimit të kërkesave, raportet e auditimit, raportet financiare, buxheti dhe realizimi i tij, paketa fiskale, transparenca e buxhetit, raportimi online, forumi online, etj. në kuadër të programit të transparencës janë një tjetër mjet i përfshirjes së qytetarit përmes këtij portal web. Mirëmbajtja e faqes zyrtare web www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj këtë vit do të ofrohet nga specialistët IT Bashkia Shkodër.

P01110.Q3.O5.A2. Informimi I qytetarëve përmes mediave vizive për përfitimin e shërbimeve nga Bashkia Shkodër

Bashkia Shkodër është institucioni i parë i qeverisjes vendore në Shqipëri që në respektim të parimit “qytetari në qendër” ka implementuar një model për ofrimin e Shërbimeve Administrative të Integruara të shtrirë tashmë në të gjithë territorin përmes hapjes Zyrate të Integruara me Një Ndalesë (Zi1N) në Bashkinë Qendër, në të gjitha njësitë administrative dhe së fundmi është në proces shtrirja e sistemit në 5 Lagjet e qytetit. Informimi mbi këto shërbime dhe mbi procedurat e përfitimit të tyre vazhdimisht i prezantohet qytetarëve në takime të tematikave të ndryshme, në dëgjesa publike, përmes afishimeve të bëra dhe fushatave informuese me fletëpalosje në të gjitha Zyrat me Një Ndalesë. Njëkohësisht kemi vlerësuar si të domosdoshëm informimin e qytetarëve për këto shërbime dhe mënyrën e përfitimeve të tyre përmes mediave vizive lokale si një mjet tjetër i domosdoshëm komunikimi qytetar- qeverisje vendore. Ky aktivitet nuk është realizuar

Njësia e Auditit

Për Vitin 2024 Njësia e Auditit ka realizuar aktivitetet si më poshtë:

| N r | Subjektet | Niveli vlerësimit të riskut | Llojet e auditimeve | Objektet të pa audituara mbi 2-vjet | Realizimi |
|-----|--|-----------------------------|---------------------------------|-------------------------------------|------------------------------------|
| 1 | Perfunduar 7 subjekte auditimi | I mesem/larte | Përputhshmëri i Kombinuar | ✓ | ✓ |
| 2 | Ne proces realizimi 2 subjekte auditimi | Larte | Kombinuar | ✓ | Ne përgatitjen Projekt raportit |

Njësia e Prokurimit

Gjatë periudhës 01.01.2024 – 31.12.2024 Bashkia Shkodër ka realizuar në total rreth 200 procedura prokurimi nga të cilat 44 procedura të deleguara.

| Lloji i procedurës | Numri |
|-----------------------|-------|
| E hapur, e thjeshtuar | 38 |
| Procedure të hapur | 19 |

| | |
|---|------------|
| Negocim pa botim paraprak | 0 |
| Blerje dinamike | 9 |
| Blerje me vlerë të vogël | 94 |
| Blerje me vlerë nën 100,000 | 12 |
| Totali | 172 |
| Në rolin e organit qëndror blerës | 2 |
| Për llogari të institucioneve të varësisë si organ i deleguar | 44 |

FUNKSIONI 03: RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

Programi 03140: Shërbimet Policore Vendore

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

Policia Bashkiake

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

-Qëllimi i programit të Policisë Bashkiake është:

Shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të Bashkisë, në përputhje me dispozitat ligjore. Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të Bashkisë dhe këshillit bashkiak brenda juridiksionit vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore


-Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 12 mujorin e vitit 2024 kanë qenë:

O1. Policia vendore e trajnuar dhe e kualifikuar për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi.

O2. Rritja e qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Realizimi i buxhetit të planifikuar:

| Programi 03140 | Paga & sigurime | Shpenzime operative | Transferta | Investime | <i>000/leke</i> Totali |
|------------------------|-----------------|---------------------|------------|-----------|---------------------------|
| PBA 2024 | 51,267 | 6,016 | - | 3,000 | 60,283 |
| Plani fillestar 2024 | 59,711 | 6,915 | 18 | 3,082 | 69,726 |
| Plani i rishikuar 2024 | 59,558 | 6,016 | 153 | 3,800 | 69,527 |
| Realizimi viti 2024 | 29,495 | 5,586 | 153 | - | 35,234 |
| % e realizimit | 49.5% | 92.9% | 100.0% | 0.0% | 50.7% |



Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është në total 50.7 %, sipas zërave kryesorë si më poshtë:

Shpenzime korente 53.6%

Shpenzime kapitale 0%



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:

Në 12 mujorin e vitit 2024, janë realizuar 50.7% e shpenzimeve . Një pjesë e mbetur e fondeve janë planifikuar të trashëgohen për vitin 2025.

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: viti 2024

| Kodi i Programit | 3140 | Emertimi i programit: | Shërbimet e Policisë Vendore | | | | | |
|--|--|--------------------------------------|--|--------------------------------------|------------------------------------|---------------------------------------|---|------|
| Qellimi 1 | Shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të bashkisë, në përputhje me dispozitat ligjore. Parandalimin e kundërvajtjeve admini-strative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të bashkise dhe keshillit bashkiak brenda juridiksionit vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore | | | | | | | |
| **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | Kodi i Treguesit te Performances | Emertimi i Treguesit te Performances | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances | |
| Objektivi 1.1 | Policia vendore e trajnuar dhe e kualifikuar për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi. | 1 | Punonjësit e policisë bashkiake gëzojnë statusin sipas ligjit Raporti midis punonjësve me status të oficerit të policisë bashkiake kundrejt numrit total të punonjësve të policisë Bashkiake | 13% | 8% | 8% | 6% | 75% |
| | | 2 | Punonjësit e policisë bashkiake janë të kualifikuar - Numër punonjësish të trajnuar, kundrejt numrit total të punonjësve të policisë Bashkiake | 100% | 87% | 87% | 34% | 39% |
| Objektivi 1.2 | Rritja e qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi | 3 | Shpenzimet buxhetore për shërbimet e policisë bashkiake kundrejt totalit të rasteve të menaxhuara (mije/Lekë të shpenzuara për 1 rast të menaxhuar) | 49 | 98 | 93 | 47 | 51% |
| | | 4 | Numri i rasteve problematikave të menaxhuara | 515 | 616 | 745 | 745 | 100% |
| | | 5 | Numri i akteve të ekzekutuara | 1,006 | 4,000 | 27,685 | 27,685 | 100% |
| | | 6 | Numri i kamerave të vendosura në pika strategjike të qytetit | 81 | 95 | 95 | 81 | 85% |

ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 | | | | | | | | | | | | | | | |
|---------------|--------------------------------|---------------------------|---------------------------|---------------------------------|------------------------------------|------------------------------------|--|--|--|--|---|---------------------------|---------------------------------|-------------------------------------|------------|------------------------------|--------------|--|
| Programi | Policia Bashkiake | Kodi i Programit | 3140 | | | | | | | | | | | | | | | |
| në 000/lekë | | | | I | | | II | | | III | | | IV | | | Luhatjet në Koston për Njësi | | |
| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (viti 2023) | Shpenzi met Faktike (viti 2023) | Kosto për Njësi (sipas vitit 2023) | Sasia (sipas planit të vitit 2024) | Shpenzi met (sipas planit të vitit 2024) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2024) | Sasia (sipas planit të rishikuar vitit 2024) | Shpenzime t (sipas planit të rishikuar vitit 2024) | Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar viti 2024) | Sasia Faktike (viti 2024) | Shpenzime t Faktike (viti 2024) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2024) | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III | |
| 1 | Patrullim per sigurine publike | numër raste të menaxhuara | 515 | 25,166 | 48.9 | 616 | 60,283 | 97.9 | 745 | 69,527 | 93.3 | 745 | 35,234 | 47.3 | -1.6 | -50.6 | -46.0 | |

Për vitin 2024

Në Programin "Shërbimet e Policisë Vendore" në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, janë parashikuar këto aktivitete :

Në mijë lekë

| Produktet | Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi I aktivitetit | Plani fillestar 2024 | Plani I rishikuar 2024 | Realizimi 2024 |
|---|--|-----------------|---|----------------------|------------------------|----------------|
| | | | | Totali | Totali | Totali |
| Patrullim per sigurine publike (Nr.rasteve të menaxhuara nga policia bashkiake) | P03140.Q1.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit efektiv te Policise Bashkiake në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. | Bashkia Shkodër | Realizuar | 51,267 | 59,711 | 29,648 |
| | P03140.Q1.O2.A1 Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake | Bashkia Shkodër | Realizuar | 2,200 | 2,098 | 1,837 |
| | P03140.Q1.O2.A2 Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e policise Bashkiake | Bashkia Shkodër | Realizuar pjeserisht/Nje pjese e mbetur e trashëguar per vitin 2025 | 3,400 | 4,200 | 1,785 |
| | P03140.Q1.O2.A3 Blerje dokumentacioni shtypshkrime në funksion të policise bashkiake | Bashkia Shkodër | Realizuar | 500 | 602 | 601 |
| | P03140.Q1.O2.A4.Kamera sigurie(CCTV) per ambiente publike dhe mirembajtja e tyre. | Bashkia Shkodër | Realizuar pjeserisht/pjesa e mbetur e trashëguar per vitin 2025 | 2,916 | 2,916 | 1,363 |
| 03140 Sherbimet e policisë vendore | | | | 60,283 | 69,527 | 35,234 |
| Të trashëguara | | | | 9,443 | - | - |
| Totali | | | | 69,726 | 69,527 | 35,234 |

P03140.Q1.O1.A1

Vazhdimësia e menaxhimit efektiv te Policise Bashkiake në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Për 12 mujorin e vitit 2024 janë realizuar pagesa për pagat + sigurime shoqërore dhe shëndetësore për punonjës të PoliciSë Bashkiake.

P03140.Q1.O2.A1

Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake & të trashëguara eshte realizuar. Gjate vitit 2024 eshte

realizuar blerja e uniformave te reja per te gjithë punonjesit e Policise Bashkiake me modelin e ri të uniformave të përcaktuar në VKM nr.494/2023,i nryshuar.

P03140.Q1.O2.A2

Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e Policise Bashkiake eshte realizuar pjeserisht. Gjate 12-mujorit te vitit 2024 është realizuar pjesesisht, një pjesë e buxhetit në vlerën që është pasqyruar në relacion për siguracione, taksa , karburant dhe sherbime per mirëmbajtjen e 7 automjeteve që ka në përdorim Policia Bashkiake, pjesa e mbetur do të trashegohet në vitin 2025.

P03140.Q1.O2.A3

Blerje dokumentacioni shtypshkrime në funksion të Policise Bashkiake është realizuar. Gjatë 12-mujorit të vitit 2024 për nevoja pune në funksion të Policise Bashkiake është realizuar blerje e shtypshkrimeve me vlerën që është paraqitur në relacion.

P03140.Q1.O2.A4

Kamerasigurie(CCTV) per ambjente publike dhe mirembajtja e tyre eshte realizuar pjeserisht. Blerja dhe mirëmbajtja e kamerave të sigurisë eshte realizuar pjeserisht gjatë vitit 2024 ku vlerat janë te paqyruara në relacion,pjesa e mbetur do te trashegohet per vitin 2025.

Programi 03280: Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

Ky program përfshin këto institucione dhe konkretisht:

1. Aparatin e Bashkisë,
2. Drejtorine e MZSH.

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

Qëllimi i programit të Emergjencave Civile është:

Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe menaxhimi i tyre, duke siguruar mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nëpërmjet sistemit të mbrojtjes civile.

-Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 12-mujorin e vitit 2024 kanë qënë:

O1. Strukturat për planifikimin, menaxhimin dhe përballimin e emergjencave civile.

Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 55, datë 29.12.2023, për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë së Shkodrës“i ndryshuar, VKB nr 18, datë 29.04.2024 “Për shtesë në buxhetin e vitit 2024, janë miratuar shpenzimet për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme si më poshtë:

- “Shërbime emergjente për riparimin e dëmeve të shkaktuara në infrastrukturë si rezultat i fenomeneve natyrore”. Është realizuar pjesërisht

- “Përballimi i ndihmave për familjet me raste fatkeqësie si dhe ndihmave të menjëhershme. Ky aktivitet është realizuar sipas rasteve të paraqitura gjatë vitit“.

- “Shërbime për mirëmbajtje emergjente të rrugëve të Qytetit dhe Njësisë Administrative, Bashkia Shkodër” “*Ndertim prita malore dhe punime mirembajtjeje perroi I Bardhajve dhe I Pistalles*” Është realizuar.


- “Blerje koncentrat për blegtorinë”. Është realizuar.

O2. Shërbimi përmirësuar Ii MZSH me prioritet parandalimin e ngjarjeve.

Është realizuar pagesa e pagave, energjisë dhe ujit dhe shpenzimeve të tjera..

Realizimi i Buxhetit të planifikuar:

| Programi 03280 | Paga & sigurime | Shpenzime operative | Transferta | Investime | Totali |
|------------------------|-----------------|---------------------|------------|-----------|---------|
| PBA 2024 | 48,281 | 8,097 | 26,794 | 1,000 | 84,172 |
| Plani fillestar 2024 | 62,594 | 19,415 | 61,647 | 7,043 | 150,699 |
| Plani i rishikuar 2024 | 59,715 | 9,418 | 28,197 | 3,312 | 100,642 |
| Realizimi viti 2024 | 53,816 | 7,434 | 1,365 | 1,973 | 64,588 |
| % e realizimit | 90.1% | 78.9% | 4.8% | 59.6% | 64.2% |



Realizimi i shpenzimeve korente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin

është në total 64.2%, sipas zërave kryesorë si më poshtë:

| | |
|--------------------|-------|
| Shpenzime korente | 64.3% |
| Shpenzime kapitale | 59.6% |



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara.

Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH dhe certifikimi për MZSH i të gjitha objekteve në varësi të Bashkisë është në proces gjatë gjithë vitit e përgatitjes së dokumentacionit.

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: viti 2024

| Kodi i Programit | 3280 | Emertimi i programit: | Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile | | | | | |
|----------------------------------|--|--|--|---|---|--|--|------|
| Qellimi 1 | Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe menaxhimi i tyre, duke siguruar mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, nëpërmjet sistemit të mbrojtjes civile. 1. Përafrimi me standartet europiane të organizimit të mbrojtjes civile. 2. Sigurimi I mbrojtjes civile ne te gjithë territorin. 3. Parandalimi. 4. Informim public per reziqet dhe aktivitetet e organeve vendore përgjegjëse për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve në nivel lokal dhe administrimi i strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj | | | | | | | |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | Kodi i Treguesit te Performances/Produktit | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit | |
| Objektivi 1.1 | O1. Strukturat per planifikimin, menaxhimin dhe përballimin e emergjencave civile. | 1 | Numri i familjeve perfituese qe mbareshtojne blegtorine ne zonat e prekura nga permytjet/ndryshimi në përqindje | -50% | 0% | 0% | 0% | |
| | | 2 | Numri i punonjësve sektorit te emergjencave civile | 3 | 3 | 8 | 8 | 100% |
| | | 3 | Numri i familjeve të trajtuara /ndryshimi në përqindje | 0% | 0% | 0% | -41% | |
| | | 4 | Numri i kontrolleve sistematike vjetore për certifikimin për MZSH i objekteve të Bashkisë. /ndryshimi në përqindje | 0% | 38% | 38% | 38% | 100% |
| | | 5 | Numrit të ofruar të pajisjeve dhe kolaudimi i fikësve të zjarrit në institucione /ndryshimi në përqindje | 0% | 0% | 0% | 0% | |
| Objektivi 1.2 | Shërbim i përmirësuar i MZSH me prioritet parandalim in e ngjarjeve. | 6 | Numri i projekteve teknike për masat e MZSH në institucione /ndryshimi në përqindje | 30% | 0% | 0% | 0% | |
| | | 7 | Tregues Qellimi : Numri i stacioneve të shërbimit te MZSH-së | 1 stacion | 1 stacion | 1 stacion | 1 stacion | 100% |
| | | 8 | Tregues Qellimi : Numri i punonjësve të MZSH / banor (1 punonjës për 1500 – 2000 banor) | 0.40 | 0.40 | 0.40 | 0.40 | 100% |
| | | 9 | Zona e mbuluar nga shërbimi i MZSH në % | 29% | 29% | 29% | 29% | 100% |
| | | 10 | Kritja e të ardhurave nga tarifatat për shërbimin ndaj të tretëve / ndryshimi në përqindje | 76% | 8% | 55% | 94% | 171% |
| | | 11 | Tregues Qellimi : Reagim më i shpejtë ndaj njoftimeve për zjarre/ndryshimi në sekonda i daljes nga stacioni | 0% | 0% | 0% | 0% | |

| | | | | | | | | |
|--|--|----|---|-------|-------|-------|-------|------|
| | | 12 | Tregues Qellimi : Efiçienca buxhetore në ofrimin e shërbimit SHMZ: Mbulimi kostove të shërbimit MZSH nga të ardhurat e shërbimit (në %) | 3% | 3% | 3% | 5% | 178% |
| | | 13 | Efiçienca buxhetore në ofrimin e shërbimit MZSH/ lekë/rast të menaxhuar | 96.19 | 83.64 | 94.76 | 88.50 | 93% |
| | | 14 | Numri i thirrjeve nga popullata drejt Shërbimit Zjarrfikës | 860 | 515 | 515 | 515 | |

ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---------------|--|------------------|---------------------------|---------------------------------|-------|------------------------------------|--|---------|--|---|---|-----|---|---------------------------|--------------------------------|--------|-------------------------------------|------------|-------------|--------------|
| Programi | Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile | Kodi i Programit | 3280 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | në 000/lekë | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (viti 2023) | Shpenzi met Faktike (viti 2023) | I | Sasia (sipas planit të vitit 2024) | Shpenzi met (sipas planit të vitit 2024) | II | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2024) | Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2024) | Shpenzi met (sipas planit të rishikuar viti 2024) | III | Kosto per Njësi (sipas planit të rishikuar viti 2024) | Sasia Faktike (viti 2024) | Shpenzimet Faktike (viti 2024) | IV | Kosto për Njësi Faktike (viti 2024) | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III |
| 1 | Nderhyrje Parandaluese dhe Emergjence | nr rastesh | 40 | 14,011 | 350.3 | 40 | 23,788 | 594.7 | 40 | 23,788 | 594.7 | 40 | 462 | 11.6 | -338.7 | -583.2 | -583.2 | | | |
| 2 | Shërbimi I Mbrojtjes Civile | nr punonjes | 0 | 0 | 0.0 | 3 | 3,578 | 1,192.7 | 8 | 5,778 | 722.3 | 8 | 3,737 | 467.1 | 467.1 | -725.5 | -255.1 | | | |
| 3 | Familje te demshperblyera per deme nga zjarri | nr familje | 23 | 1,180 | 51.3 | 37 | 2,951 | 79.8 | 37 | 4,691 | 126.8 | 22 | 1,240 | 56.4 | 5.1 | -23.4 | -70.4 | | | |
| 4 | Raste të menaxhuara për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtim | numer | 458 | 48,709 | 106.4 | 620 | 53,855 | 86.9 | 646 | 66,360 | 102.7 | 646 | 59,149 | 91.6 | -14.8 | 4.7 | -11.2 | | | |

Realizimi i produkteve

Në mijë lekë

| Produktet | Aktivite/Projekte | Institucioni | Statusi i aktivitetit | Plani fillestar 2024 | Plani I rishikuar 2024 | Realizimi 2024 |
|---|---|--|--|----------------------|------------------------|----------------|
| | | | | Totali | Totali | Totali |
| Ndërhyrje Parandaluese dhe Emergjente (numer rastesh) | P03280.Q1.O1.A1. Struktura e mbrojtjes civile dhe organizimi i strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër. Burimet e veta | Bashkia Shkodër | Realizuar | 23,788 | 23,788 | 462 |
| Familje te demshperblyera per fatkeqesi natyrore-Transferte te kushtezuar (numer familje) | P03280.Q1.O1.A2. Struktura e mbrojtjes civile dhe organizimi i strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër. Transfertë të kushtezuar | Bashkia Shkodër | | - | - | - |
| Sherbime te mbrojtjes civile (numer punonjes) | P03280.Q1.O1.A3. Paga per sektorin e ememergjencave te Bashkise | Bashkia Shkodër | Realizuar | 3,578 | 5,778 | 3,737 |
| Familje te demshperblyera per deme nga zjarri (numri i familjeve) | P03280.Q1.O1.A4. Përbalimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie | Bashkia Shkodër | Realizuar | 2,951 | 4,691 | 1,240 |
| Raste të menaxhuara për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (në numër) | P03280.Q1.O1.A5. Plotësimi dhe certifikimi për MZSH i pajisjeve për fije zjarri i të gjithë institucioneve të Bashkisë | Bashkia Shkodër | Realizuar | 1,000 | 3,812 | 1,978 |
| | P03280.Q1.O1.A6. Ndërtim prita malore dhe punime mirëmbajtje përroi i Bardhajve dhe Pistallës - mbikqyrje dhe kolaudim | Bashkia Shkodër | Realizuar, likuidimi do behet në vitin 2025. | - | 334 | - |
| | P03280.Q1.O2.A1. Plotësimi I dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH i të gjitha objekteve të varësi të Bashkisë. | Bashkia Shkodër | Pa realizuar | 1,000 | 1,000 | - |
| | P03280.Q1.O2.A2. Shërbimi I Mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimet | Drejtoria e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimet | Realizuar | 51,855 | 61,214 | 57,171 |
| 03280 Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile | | | | 84,172 | 100,617 | 64,588 |
| Te trashëguara | | | | 66,527 | 25 | - |
| Totali | | | | 150,699 | 100,642 | 64,588 |

Sipas planifikimit për vitin 2024 në Programin “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile” në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përbushjen e objektivave të përcaktuara, situata e aktiviteteve për 12 mujorin 2024 paraqitet si më poshtë:

P03280.Q1.O1.A1. Struktura e mbrojtjes civile dhe organizimi i strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër & të trashëguara. Ky aktivitet është realizuar pjesërisht gjatë vitit.

P03280.Q1.O1.A2. Përbalimi i ndihmave për familjet me raste fatkeqësie. Ky aktivitet është realizuar sipas rasteve të paraqitura gjatë vitit.

| Aktiviteti | Institucion i | Statusi | Plan fillestar 2024 | Plan I rishikuar 2024 | Realizimi |
|---|-----------------|-----------|---------------------|-----------------------|-----------|
| Shpenzime për marrjen e masave parandaluse, lehtësuse dhe rehabilituese përmes blerjes së materialeve dhe shëbimeve të ndryshme | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 15,880 | 15880 |
| Shtetas të ndihmar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqsitë. | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 7,000 | 2,468 |
| Ndërtim prita malore dhe punime mirëmbajtje përroi i Bardhajve dhe Pistallës. | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 25,895 | 21,439 |

P03280.Q1.O1.A3. Ky aktivitet është realizuar.

P03280.Q1.O1.A4.Përbalimi i ndihmave të menjëherëshme për familjet me raste fatkeqësie & të trashëguara. Ky aktivitet është realizuar sipas rasteve të paraqitura gjatë vitit.

P03280.Q1.O1.A5. Plotësimi dhe certifikimi për MZSH i pajisjeve për fikje zjarri i të gjithë institucioneve të Bashkisë, Ky aktivitet është realizuar.

P03280.Q1.O1.A6. Ndërtim prita malore dhe punime mirëmbajtje përroi i Bardhajve dhe Pistallës - mbikqyrje dhe kolaudim, Ky aktivitet është realizuar por likuidimi I fatures te studios mbikqyrese do likuidohet ne 2025.

P03280.Q1.O2.A1. Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH i të gjitha objekteve në varësi të Bashkisë. Ky aktivitet nuk është realizuar.

P03280.Q1.O2.A2. Shërbimi i Mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit. Ky aktivitet është realizuar.

FUNKSIONI 4: ÇËSHTJET EKONOMIKE

Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit ka për qëllim rritjen ekonomike nëpërmje tërheqjes së investitorëve të huaj dhe zhvillimi i NVM-ve. Kjo arrihet nga forcimi i bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor, bizneseve dhe punëkërkuësve, me qëllim promovimin e forcës aktive të punës, promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Në mbështetje të biznesit si institucion, realizojmë një sere aktivitete në mbështetje të sipërmarrësve, përmendim këtu dhe panairë të përvitshme si një mënyrë shumë efektive për të venë përballë njëri-tjetrit të gjithë aktorët e interesuar në proces. Qëllimi është krijimi i një network-u që lidh aktorët e interesuar, shkëmben informacionet me synim zbutjen e papunësisë.

Turizmi, si aktivitet ndërsektoral, është i lidhur me shumë aktivitete ekonomike me ndikim të jashtëzakonshëm në sektorë të ndryshëm, duke ofruar shërbime të lidhura me kohën e lirë dhe me udhëtimet e biznesit. Ai luan një rol të madh në zhvillim, pasi kontribuon në zhvillimin lokal, krijimin e vendeve të punës, zhvillimin e zonave në rënie industriale apo rurale, si dhe në rigjenerimin urban.

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2024 në programin 04130 “Mbështetja për zhvillim ekonomik” ka për qëllim të programit të saj këto si më poshtë:

Qëllim 1: Zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti duke nxitur kohezionin territorial përmes hartimit të planeve dhe programeve zhvillimore duke mbështetur dhe koordinuar strukturat e bashkisë, në realizimin e reformave për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i Integritimit Evropian.

Qëllim 2: Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë

Qëllim 3: Nxitja e zhvillimit të turizmit të zonës dhe rritja e vlerës së territorit të Bashkisë Shkodër, si destinacion turistik, duke forcuar identitetin e saj unik kulturor, social, mjedisor dhe ekonomik.

Qëllim 4: Funksionimi i zyrave vendore turistike përmes koordinimit të aktorëve dhe strukturave përgjegjëse në industrinë turistike; Marketing i vlerave dhe potencialeve të komunitetit.

Funksionet e zhvillimit ku mbështetet programi 04130 janë:

- Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal
- Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë
- Mbështetje për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike
- Publikimi i broshurave informative, krijimit të portaleve me profil ekonomik.
- Dhënia e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi.
- Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi
- Zhvillimi i Turizmit

Objektivat për përmbushjen e ketyre funksionëve për 12-mujorin e vitit 2024 janë:

Q1.O1. Hartimi i Strategjive, Planeve Zhvillimore lokale dhe monitorimi i tyre në bashkëpunim me institucionet e specializuara dhe aktorët e interesuar.

Q1.O2. Programimi dhe zbatimi eficient i financimeve të programeve të BE-së dhe donatoreve të tjerë si dhe forcimi i marrëdhënieve me diasporën.

Q1.O3. Përmiresimi i Klimës së Biznesit përmes panairove, ofrimit të shërbimeve mbështetëse, publikimit të materialeve promovionale si dhe incentivave financiare në mbështetje të biznesit të vogël.

Q2.O1.Sistemimi dhe ngritja e tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë në territorin e Shkodrës

Q3.O1 Promovim i territorit të Bashkisë nëpërmjet prodhimit dhe botimit të materialeve promovionale dhe informative.

Q3.O2 Promovim i territorit të Bashkisë nëpërmjet përmiresimit të infrastruktures turistike

Q3.O3 Organizim dhe pjesëmarrje në panairë lokale, kombëtare dhe ndërkombetare.

Q3. O4 Organizimi i aktiviteteve për promovimin e ofertave dhe produkteve turistike të Bashkisë Shkodër.

Q3. O5 Ngritje e kapaciteteve të bizneseve që operojnë në fushën e turizmit me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit nga ana e tyre.

Q4.O1 Forcimi institucional nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara për zhvillimin e turizmit.

Realizimi i buxhetit të planifikuar


| Programi 04130 | Paga & sigurime | Shpenzime operative | Transferta | Investime | Totali |
|------------------------|-----------------|---------------------|------------|-----------|--------|
| PBA 2024 | 17,021 | 4,500 | 8,600 | 300 | 30,421 |
| Plani fillestar 2024 | 17,021 | 9,842 | 20,332 | 36,923 | 84,118 |
| Plani i rishikuar 2024 | 17,021 | 8,885 | 19,300 | 31,724 | 76,930 |
| Realizimi viti 2024 | 12,934 | 5,348 | 11,333 | 18,296 | 47,911 |
| % e realizimit | 76.0% | 60.2% | 58.7% | 57.7% | 62.3% |



Realizimi i shpenzimeve korente dhe kapitale për këtë program krahasuar me planifikimin është në total 62.3 % sipas zërave më poshtë:

Shpenzimet korrente: 65.5%

Shpenzimet kapitale: 57.7%



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara

Përsa i përket programit 4130 aktivitetet janë në zbatim e sipër. Procedurat për zbatimin e aktiviteteve janë në proces dhe do të përfundojnë sipas parashikimit buxhetor. Përshkrimet e statusit të aktiviteteve janë dhënë në hollësi në përshkrimin e aktiviteteve. Gjithashtu është rishikuar përsëri plani pasi është shtuar në buxhet vlera e investimit për Rikualifikimin e merkatos Rus (Mbulesa e Tregut) me vlerë 30,474 mijë lekë. Nga kjo shumë është realizuar deri me tani vlera 17,633.

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: viti 2024

| Kodi i Programit | 4130 | Emertimi i programit: | Mbështetja për zhvillim ekonomik | | | | | |
|--|--|--|--|--------------------------------------|------------------------------------|---------------------------------------|---|------|
| Qellimi 1 | Zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti duke nxitur kohezionin territorial përmes hartimit të planeve dhe programeve zhvillimore duke mbështetur dhe koordinuar strukturat e bashkisë, në realizimin e reformave për përbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i Integritimit Evropian. | | | | | | | |
| **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | Kodi i Treguesit te Performances/Produktit | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit | |
| <i>Objektivi 1.1</i> | Hartimi i Strategjive, Planeve Zhvillimore lokale dhe monitorimi i tyre ne bashkepunim me institucionet e specializuara dhe aktoret e interesuar. | 1 | Numri i projekteve gjithsej te Dokumentin e Strategjise territoriale te zhvillimit te Bashkise Shkoder | 242 | 198 | 198 | 198 | 100% |
| | | 2 | Numri i projekteve te realizuara me ecuri te ulet zbatimi | 95 | 83 | 92 | 92 | 100% |
| | | 3 | Numri i projekteve te relizuara me ecuri te mesem zbatimi | 87 | 80 | 88 | 88 | 100% |
| | | 4 | Numri i projekteve te relizuara me ecuri te mire zbatimi | 60 | 35 | 18 | 18 | 100% |
| | | 5 | Numri i projekteve te fituara sipas programeve te financuara nga BE dhe organizata te tjera ndërkombëtare Reload | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% |
| <i>Objektivi 1.2</i> | Programimi dhe zbatimi efcient i financimeve te programeve te BE-se dhe donatoreve te tjere si dhe forcimi i marrëdhënieve me diasporën. | 6 | Numri i projekteve të fituara sipas programeve të financuara nga BE dhe organizata të tjera ndërkombëtare | 4 | 3 | 7 | 7 | 100% |
| | | 7 | Numri i projekteve të aplikuara sipas programeve të financuara nga BE dhe organizata të tjera ndërkombëtare | 8 | 6 | 23 | 23 | 100% |
| | | 8 | Numri i aktiviteteve informuese te organizuar | 45 | 45 | 45 | 45 | 100% |
| | | 9 | Numri i personave te informuar | 280 | 240 | 300 | 350 | 117% |
| <i>Objektivi 1.3</i> | Permiresimi i Klimes se Biznesit permes panaireve, ofrimit te sherbimeve mbeshtetese, publikimit te materjaleve promocionale si dhe incentiveve financiare ne mbeshtetje te biznesit te vogel. | 10 | Numri i bizneseve të mbështetura për zhvillim | 135 | 120 | 120 | 120 | 100% |
| | | 11 | Numri i bizneseve të asistuar ne aplikime ne programe dhe skema financiare | 25 | 25 | 25 | 25 | 100% |
| | | 12 | Numri i personave te informuar ne lidhje me diasporën dhe migracionin | 100 | 150 | 150 | 150 | 100% |
| Qellimi 2 | Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë; | | | | | | | |
| | 13 | Numri total i vendeve të shitjes në tregje publike | 230 | 230 | 230 | 230 | 100% | |

| | | | | | | | | |
|----------------------|--|----|---|---------|---------|---------|---------|------|
| Objektivi 2.1 | Sistemimi dhe ngritja e tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë në territorin e Shkodrës. | 14 | Numri i vendeve të shitjes në tregje publike të mirëmbajtura (pasese e shërbimeve utilitare dhe riparim vende shitjeje) | 120 | 120 | 120 | 120 | 100% |
| | | 15 | Numri i tregjeve funksionale me kriteret e lejes përkatëse | 2 | 4 | 4 | 4 | 100% |
| Qellimi 3 | Nxitja e zhvillimit të turizmit të zonës dhe rritja e vlerës së territorit të Bashkisë Shkodër, si destinacion turistik, duke forcuar identitetin e saj unik kulturor, social, mjedisor dhe ekonomik. | | | | | | | |
| Objektivi 3.1 | Promovim i territorit të Bashkisë nëpërmjet prodhimit dhe botimit të materialeve promociionale dhe informative. | 16 | Numri i materialeve promociionale të prodhuara. (harta, guida etj) | 3,000 | 7,000 | 7,000 | 6,200 | 89% |
| Objektivi 3.2 | Organizim dhe pjesëmarrje në panairë lokale, kombëtare dhe ndërkombetare. | 17 | Nr i sipërmarrjeve të promovuara | 45 | 45 | 0 | 0 | |
| Objektivi 3.3 | Organizimi i aktiviteteve për promovimin e ofertave dhe produkteve turistike të Bashkisë Shkodër. | 18 | Numri i aktiviteteve të organizuara nga Drejtoria e Turizmit | 6 | 4 | 4 | 4 | 100% |
| Qellimi 4 | Funksionimi i zyrave vendore turistike përmes koordinimit të aktorëve dhe strukturave përgjegjëse në industrinë turistike; Marketing i vlerave dhe potencialeve të komunitetit. | | | | | | | |
| Objektivi 4.1 | Forcimi institucional nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara për zhvillimin e turizmit. | 19 | Tregues Qellimi : Përmirësimi i shërbimit në sektorin e turizmit. Numri i personave të akomoduar në hotele. Ndryshimi vjetor në numer. | 380,129 | 298,500 | 342,857 | 485,143 | 142% |
| | | 20 | Rritja e të ardhurave të bashkisë nga turizmi : Të ardhurat nga taksa e hoteleve kundrejt totalit të të ardhurave nga taksat vendore | 303,651 | 376,487 | 357,663 | 425,749 | 119% |
| | | 21 | Tregues Qellimi : Përmirësimi i shërbimit të promovimit turizmit - Numri i turistëve që marrin informacion / shërbehen në zyrën e informacionit | 14,000 | 14,000 | 16,000 | 15,350 | 96% |

ANEKSI nr.3 "Raporti përmblendhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 | | | | | | | | | | | | | | |
|---------------|---|--|---------------------------|--------------------------------|------------------------------------|------------------------------------|---|--|--|---|--|---------------------------|--------------------------------|-------------------------------------|------------|-------------|--------------|
| Programi | Mbështetja për zhvillim ekonomik | Kodi i Programit | 4130 | | | | | | | | | | | | | | |
| në 000/lekë | | | | I | II | | | III | | | IV | | | Luhatjet në Koston për Njësi | | | |
| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (viti 2023) | Shpenzimet Faktike (viti 2023) | Kosto për Njësi (sipas vitit 2023) | Sasia (sipas planit të vitit 2024) | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2024) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2024) | Sasia (sipas planit të rishikuar vitit 2024) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar vitit 2024) | Kosto për Njësi (sipas planit të rishikuar vitit 2024) | Sasia Faktike (viti 2024) | Shpenzimet Faktike (viti 2024) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2024) | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III |
| 1 | Plani Strategjik I zhvillimit (procesi i monitorimit dhe rishikimit te strategjise territoriale te zhvillimit te Bashkise Shkoder) | Nr. projektesh | 242 | 0 | 0.0 | 198 | | 0.0 | 198 | | 0.0 | 198 | | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 |
| 2 | Pjesmarrja ne programe dhe projekte nderkombetare | Nr.projektesh dhe personash te informuar | 280 | 1,300 | 4.6 | 240 | 1,700 | 7.1 | 300 | 1,700 | 5.7 | 350 | 1,145 | 3.3 | -1.4 | -3.8 | -2.4 |
| 3 | Mbeshtetje me grante per biznesin e vogel | Nr. I bizneseve te mbeshtetura | 120 | 3,400 | 28.3 | 120 | 4,900 | 40.8 | 120 | 9,800 | 81.7 | 120 | 3,008 | 25.1 | -3.3 | -15.8 | -56.6 |
| 4 | Subjekte te sistemuara ne tregun e ushqimeve | Nr | 120 | 1,000 | 8.3 | 120 | | 0.0 | 120 | 38,159 | 318.0 | 120 | 25,254 | 210.5 | 202.1 | 210.5 | -107.5 |
| 5 | Promovimi I Turizmit | Materiale promocionale | 3,000 | 0 | 0.0 | 7,000 | 6,500 | 0.9 | 7,000 | 9,950 | 1.4 | 6,200 | 5,570 | 0.9 | 0.9 | 0.0 | -0.5 |
| 6 | Sherbimi I stafit te zhvillimit te turizmit | Numri I stafit | 16 | 0 | 0.0 | 13 | 17,321 | 1,332.4 | 13 | 17,321 | 1,332.4 | 13 | 12,934 | 994.9 | 994.9 | -337.5 | -337.5 |

Përshkrimi i aktiviteteve ne 000/leke :

| Produktet | Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi I aktivitetit | Plani fillestar 2024 | Plani I rishikuar 2024 | Realizimi 2024 |
|---|--|-----------------|--------------------------------------|----------------------|------------------------|----------------|
| | | | | Totali | Totali | Totali |
| Plani Strategjik I zhvillimit (procesi i monitorimit dhe rishikimit te strategjise territoriale te zhvillimit te Bashkise Shkoder) | P04130.Q1.O1.A1. Monitorimi dhe Vlerësimi i strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Shkodër | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | - | - |
| | P04130.Q1.O1.A2. Vazhdimi i zbatimit të metodologjisë LOD (ReLoad) si instrument financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve. | Bashkia Shkoder | Parealizuar | - | - | - |
| | P04130.Q1.O2.A1.Bashkëpunimi rajonal dhe koordinimi i ndihmës së huaj | Bashkia Shkodër | Realizuar | 1,000 | 1,000 | 552 |
| | P04130.Q1.O2.A2. Bashkia për BE-në | Bashkia Shkodër | Realizuar | 300 | 300 | 276 |
| | P04130.Q1.O2.A3.Diaspora dhe migracioni | Bashkia Shkodër | Realizuar | 400 | 400 | 317 |
| Mbeshtetje me grante per biznesin e vogel | P04130.Q1.O3.A1. Bashkëpunimi me Zonën e përmirësimit të biznesit ne Shkoder | Bashkia Shkodër | Ne proces. Do te trashegohen ne 2025 | 1,600 | 3,200 | 1,418 |
| | P04130.Q1.O3.A2. Mbeshtetje per bizneset Agro | Bashkia Shkodër | Realizuar | 1,000 | 1,000 | 900 |
| | P04130.Q1.O3.A3.Skeme Granti | Bashkia Shkodër | | 2,300 | - | - |
| | P04130.Q1.O3.A4.Skeme Granti per te rinjt | Bashkia Shkodër | Ne proces. Do te trashegohen ne 2025 | - | 5,600 | 690 |
| TOTALI QELLIMI 1 | | | | 6,600 | 11,500 | 4,153 |
| Subjekte te sistemuara ne tregun e ushqimeve | P04130.Q2.O1.A1. Mirëmbajtje e tregjeve ekzistuese & të trashguara | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 7,685 | 7,621 |
| | P04130.Q2.O1.A2. Tregu i produkteve bujqësore Velipojë | Bashkia Shkodër | | - | - | - |
| | P04130.Q2.O1.A3. Ndërtimi i tregut multifunksional të produkteve agro-ushqimore lokale | Bashkia Shkodër | | - | - | - |
| | P04130.Q2.O1.A5. Rikualifikim i merkatos Rus (Mbulesa e Tregut) & te trashguara | Bashkia Shkodër | Kontrate e lidhur | - | 30,474 | 17,633 |
| TOTALI QELLIMI 2 | | | | - | 38,159 | 25,254 |
| Promovimi I Turizmit | P04130.Q3.O1.A1. Hostim, mirembajtje, perditesim dhe sherbime shtese për web sitin e turizmit. | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | - | - |
| | P04130.Q3.O1.A2.Hostim , mirembajtje , pëditesim dhe shërbime shtese për aplikacionin e turizmit | Bashkia Shkodër | | - | - | - |
| | P04130.Q3.O1.A3. Prodhim, publikim dhe botim I materialeve promocionale & të trashguara | Bashkia Shkodër | Realizuar | 500 | 1,900 | 1,477 |
| | P04130.Q3.O2.A1 Përmirësimi I aksesit dhe mirëmbajtja e shtigjeve | Bashkia Shkodër | Ne Proces likujdimi | 600 | 600 | - |

| | | | | | | |
|---|--|-----------------|--------------------------------------|---------------|---------------|---------------|
| | P04130.Q3.O2.A2 Përmirësimi I infrastruktures dhe shërbimeve në plazhe dhe destinacione të tjera turistike | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 1,500 | 663 |
| | P04130.Q3.O3.A1. Pjesëmarrje në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare për ofertën turistike të Shkodrës | Bashkia Shkodër | Ne proces. Do të trashëgohen në 2025 | 800 | 800 | - |
| | P04130.O1.A3. Përditësim dhe ribotim i guidës turistike të Bashkisë Shkodër të trashëguar | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 300 | 72 |
| | P04130.O1.A4. Ribotim i hartave turistike të Bashkisë Shkodër të trashëguar | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 250 | 222 |
| | P04130.Q3.O3.A2. Iteneraret e shijes/promovimi i Slow food | Bashkia Shkodër | E përealizuar | 1,200 | 1,200 | - |
| | P04130.Q3.O4.A1. Festa e Liqenit | Bashkia Shkodër | Realizuar | 1,000 | 1,000 | 1,000 |
| | P04130.Q3.O4.A2. Valorizimi dhe mbrojtja e trashëgimisë së zonave malore | Bashkia Shkodër | Realizuar | 900 | 900 | 850 |
| | P04130.Q3.O4.A3. Dita e biçikletave | Bashkia Shkodër | Realizuar | 500 | 500 | 416 |
| | P04130.Q3.O4.A4. Lojra Popullore Fest | Bashkia Shkodër | Realizuar | 500 | 500 | 500 |
| | P04130.Q3.O5.A1.Mbështetja e iniciativave të reja në mbështetje të zhvillimit të turizmit | Bashkia Shkodër | Realizuar | 500 | 500 | 370 |
| Shërbimi I stafit të zhvillimit të turizmit | P04130.Q4.O1.A1. Rrjeti i Zyrave të informacionit turistik Qyteti Shkodër, Velipojë, Theth | Bashkia Shkodër | Ne proces. Do të trashëgohen në 2025 | 300 | 300 | - |
| | P04130.Q4.O1.A2. Vazhdimësia e menaxhimit të Drejtorive në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësisë të mbështetjes për zhvillim ekonomik dhe turizëm | Bashkia Shkodër | Realizuar | 17,021 | 17,021 | 12,934 |
| | TOTALI QELLIMI 3+4 | | | 23,821 | 27,271 | 18,504 |
| PROGRAMI 4130 - MBESHTETJA PËR ZHVILLIM EKONOMIK | | | | 30,421 | 76,930 | 47,911 |
| Te trashëguara | | | | 53,697 | - | - |
| Totali | | | | 84,118 | 76,930 | 47,911 |

Qëllimi 1

P04130.Q1.O1.A1. Monitorimi dhe Vlerësimi i strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Shkodër

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor realizohet në fund të çdo viti buxhetor.

Objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor kanë shërbyer si bazë për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2023 - 2025, duke realizuar kështu një lidhje integrale të objektivave dhe planit të veprimit të strategjisë së zhvillimit me projektet e parashikuara në secilin nga programet buxhetore të Bashkisë Shkodër. Mbi bazën e këtij parimi është realizuar kuadri logjik i PBA-së dhe është bërë ndarja e burimeve të disponueshme për secilin program buxhetor. Prandaj monitorimi i ecurisë së zbatimit u bë mbështetur në informacionet për gjendjen e zbatimit dhe të financimit të projekteve të strategjisë deri në fund të vitit 2024.

Për të adresuar 5 objektivat strategjike të planifikuara në këtë plan janë parashikuar 198 projekte. Në përfundim të monitorimit të zbatimit të strategjisë territoriale Shkodër, deri në fund të vitit 2024 raportohen 18 projekte të zbatuara, 88 projekte në proces zbatimi dhe 92 projekte me ecuri të ulët zbatimi. Pjesa më e madhe e projekteve të parashikuara në matricën e projekteve strategjike janë projekte infrastrukture.

Në kuptim të zbatimit të objektivave të strategjisë, objektivat 1, 2 dhe 3 vlerësohen me ecurinë më të mirë të zbatimit, Objektivat 4 dhe 5 vlerësohen ecurinë më të ulët të zbatimit.

P04130.Q1.O1.A2. Vazhdimi i zbatimit të metodologjisë LOD (ReLOad) si instrument financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve.

Bashkia Shkodër ka përmbushur me sukses detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga angazhimi i saj në Programin Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOad). Ky Program është një iniciativë rajonale tre-vjeçare e financuar me fonde të Bashkimit Evropian nga Instrumentet e Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA) dhe zbatohet nga UNDP në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor. Referuar kushteve të Programit ReLOad, Bashkia Shkodër mori përsipër përgjegjësinë e bashkëfinancimit në masën 22% të vlerës së projektit ReLOad dhe angazhimin e organizimit të tre thirrjeve publike (periudhën kohore 2018 – 2020), nga të cilat, dy të parat u financuan nga shuma e alokuar e grantit (fondet e PNUD dhe 22% bashkëfinancimi i bashkisë) dhe thirrja e fundit u financua nga fondet e vetë bashkisë. Të gjitha Thirrjet për projekt propozime realizohen në zbatim të VKB nr. 69, datë 30.10.2017 për “Miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër” si dhe miratimin e metodologjisë LOD për financimin e organizatave të shoqërisë civile”. Gjithashtu, Bashkia Shkodër ka nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit me UNDP Albania në kuadër të RELOAD 2, e cila ka përfunduar me 31 dhjetor të vitit 2024.

P04130.Q1.O2.A1. Bashkëpunimi rajonal dhe koordinimi i ndihmës së huaj

Procesi i integritit evropian përkthehet në negociimin e 33 kapitujve të Acquis së BE dhe kërkon përfshirjen e të gjithë aktorëve të shoqërisë, ku një rol të rëndësishëm luan edhe qeverisja vendore. Pothuajse 50-70% e kuadrit ligjor të BE-së duhet të zbatohet në nivel vendor prandaj acquis-i i BE-së ka një ndikim të rëndësishëm në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët. Duke e konsideruar integritin në BE si perspektivën më të mirë të zhvillimit dhe si një sfidë e përbashkët e vendeve të rajonit, Bashkia Shkodër ka promovuar iniciativën e bashkëpunimit të zgjeruar rajonal, duke lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa qytete në rajon, me lidhje të hershme ndër shekuj dhe me vlera që na bashkojnë në fushën ekonomike, kulturore e njerëzore. Konsolidimi i këtij bashkëpunimi është i rëndësishëm së veçantë jo vetëm për gjenerimin e ideve për të intensifikuar bashkëpunimin rajonal por edhe në terheqjen e fondeve të Bashkimit Evropian, në kuadër të programeve të ndryshme ndërkufitare. Pjesë e kësaj fishe është edhe mbulimi i shpenzimeve për projektet e shpallura fituese në kuadër të programeve të financuara nga BE dhe anëtarësimi në organizata ndërkombëtare. Momentalisht Bashkia Shkodër është në fazën e zbatimit të 7 projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian dhe donatorë të tjerë, si dhe është bërë pagesa vjetore e anëtarësimit në Forumin FAIC. Gjithashtu është bërë anëtarësimi në Rrjetin e Qyteteve Ballkanike B40 Balkan Cities Network.

Me qëllim promovimin e vlerave të solidaritetit dhe bashkëpunimit shoqëror, u realizuan aktivitete me fokus rëndësishëm të solidaritetit njerëzor gjatë periudhës së festave të fundvitit. Aktiviteti angazhoi të rinj, shoqëri civile dhe komunitetet për të kontribuar për një shoqëri më të bashkuar dhe më mbështetëse, veçanërisht për ata që ndodhen në kushte të vështira.

P04130.Q1.O2.A2. Bashkia për BE-në

Programimi dhe zbatimi me efikasitet dhe të gjitha financimeve në kuadër të programeve të BE-së dhe donatorëve të tjerë, është një ndër objektivat e Bashkisë Shkodër. Për këtë qëllim çdo muaj sektori i integritit evropian Shkodër organizon minimalisht 2 aktivitete në muaj sipas tematikave të caktuara dhe sipas ditëve evropiane dhe ndërkombëtare. Këto aktivitete organizohen në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, shkollat 9 vjeçare, të mesme të përgjithshme dhe profesionale, Universitetin e Shkodrës Luigj Gurakuqi, etj. Numri i pjesëmarrësve në këto aktivitete varion nga 20 pjesëmarrës, në rastin e takimeve me fokus grupet deri në 400 pjesëmarrës në rastin e aktiviteteve të mëdha promovuese. Në këtë kuadër, Bashkia Shkodër në partneritet me projektin Bashkitë për në Evropë, financuar nga Bashkimi Evropian, organizuan edicionin e parë të Shkollës Pranverore Evropiane, e cila u zhvillua në Qendren Rinore Atelie, në datat 29 prill – 4 maj 2024, dhe kishte në fokus temën “Roli i të rinjve në procesin e integritit evropian”. Nga kjo shkollë përfituan njohuri 30 të rinj. Njëkohësisht në partneritet me Europe House u organizua Java e Evropës, në sheshin Shirokë, ku tema e kësaj jave i dedikohej mbrojtjes sociale dhe të drejtave të njeriut. Për të vijuar me pas me organizimin e aktiviteteve në kuadër të Javës Evropiane të Mobilitetit, Javës Evropiane të StartUp-eve, Ditët e Solidaritetit Njerëzor, etj.

P04130.Q1.O2.A3. Diaspora dhe migracioni

Me funksionet e shtuara të pushtetit vendor në lidhje me çështjet e migracionit dhe diasporës, Bashkisë Shkodër i lind detyrimi dhe përgjegjësia që nga njëra anë të kontribuojë në ri-integrimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të emigrantëve duke respektuar, mbrojtur dhe përmbushur të drejtat e tyre njerëzore, dhe në të njëjtën kohë të krijojë kushte të favorshme, të cilat i mundësojnë diasporës, përmes kapaciteteve të tyre intelektuale, njerëzore, ekonomike dhe sociale, të pasurojë shoqërinë tonë, për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm në nivel lokal. Këtë vit u realizua një video e cila përcillte një mesazh motivues për diasporën për të investuar, kontribuar dhe marrë pjesë në zhvillimin e territorit të Shkodrës dhe një thirrje për emigrantët që të kthehen dhe të integrohen në shoqërinë shqiptare, përfshirë mundësitë që ofron Bashkia Shkodër. Videoja në përmbajtje kishte disa elementë kyç dhe përzgjedhja e përgatitja e tyre u realizua nga një ekspert i fushës.

P04130.Q1.O3.A1 Bashkëpunimi me Zonën e Përmirësimit të Biznesit në Shkodër.

Bashkia Shkodër në bashkëpunim me AADF (Fondacioni i Zhvillimit Shqiptaro–Amerikan) vazhdon në mënyrë të suksesshme projektin e mbështetjes së përmirësimit të biznesit përgjatë rrugëve “13 Dhjetori”, “28 Nëntori” dhe “Kolë Idromeno”. Në zbatimin e programit të bashkëpunimit me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e klimës së biznesit në zonë, Shoqata e bizneseve vazhdon të ofrojë asistencë teknike dhe të zhvillojë një sërë aktiviteteve kulturore, argëtuese, disa prej të cilave edhe në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër. Njëkohësisht ofrohet konsulencë profesionale për bizneset e zonës me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e klimës së biznesit. Nga ana tjetër, është përmirësuar ndjeshëm cilësia e shërbimeve të ofruara nga bizneset në këtë zonë. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është mbështetja e biznesit të vogël për t’u konsoliduar, nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të zonës së përmirësimit të biznesit, për ta kthyer atë në një vend tërheqës për vizitorin.

P04130.Q1.O3.A2. Mbështetje për bizneset Agro

Bashkisë Shkodër paraqet potenciale të shumta të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të cilat duhen ruajtur dhe promovuar. Qyteti, zona fushore dhe malore e Bashkisë Shkodër janë dalluar për prodhimet artizanale si punimet prej thupre, bakri, argjendi e druri, qëndisimat, qilimat, etj. Gjithashtu e gjithë zona është karakterizuar nga prodhimet bujqësore dhe blegtorale si një nga sektorët që i lidh të gjitha njesitë

administrative. Fermerët e njësive administrative tashmë kanë filluar të zhvillojnë edhe sektorin agroturistik, mirëpo është parë e nevojshme të mbështeten nëpërmjet rritjes së kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit të sipërmarrësve të rinj mbi mënyrën e përpunimit, tregtimit, promovimit me anën e përfshirjes së tyre në rrjete të reja tregtare. Në këtë kuadër u realizua aktiviteti “Agro Fest” i cili u zhvillua në Rragam, njësia administrative Gur i Zi me qëllim promovimin e produkteve vendore të sipërmarrjeve të reja dhe atyre egzistuese për rritjen social-ekonomike të gjithë territorit dhe përmirësimin e jetës së komunitetit. Në “Agro Fest” u zhvilluan aktivitete të ndryshme me fokus marketimin e brandimin e produkteve lokale si: panair i produkteve lokale me pjesëmarrjen e fermerëve, agrobizneseve dhe prodhuesve të zonës; takim informues për sigurinë ushqimore, marketimin e produkteve dhe mundësive të financimit për fermerët, agrobizneset, bizneset eko, etj.; program artistik me artistët e rinj të zonës, të cilët sollën artin, kulturën dhe traditën e vecantë të zones; tur me guidë për në ishullin e Shurdhahut, etj.

P04130.Q1.O3.A3. Skemë granti për të rinjtë

Bashkia Shkodër ka shpallur Thirrjen Skemë granti për të rinjtë. Qëllimi i kësaj thirrje është krijimi i mundësive të reja ekonomike për sipërmarrësit aspirantë dhe bizneset ekzistuese, bazuar në një skemë granti, e cila mbështet zhvillimin e iniciativave ekonomike lokale, duke ruajtur një qasje miqësore ndaj mjedisit. Skema e grantit ka mbështur të rinjtë e moshës 18 - 30 vjeç, banues në Bashkinë Shkodër, të cilët kanë një ide apo kanë një biznes ekzistues të vogël ose të mesëm dhe kërkojnë të shndërrohen në biznese eko-inovative, për një projekt propozim me afat nga 6 - 9 muaj. Publikimi i thirrjes është bërë me datë 31.10.2024 në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër dhe në rrjetet sociale dhe thirrja është mbyllur me datë 10.12.2024. Gjatë periudhës së hapur të thirrjes, Bashkia Shkodër ka ofruar asistencë teknike për të rinjtë e interesuar të aplikojnë për skemën e grantit, duke angazhuar ekspertë të jashtëm, si këshillim individual, asistencë trajnimi, mentorim, etj.

Gjithashtu është organizuar një takim informues në Rektoratin e Universitetit “Luigj Gurakuqi” dhe në disa fakultete të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, një ditë e hapur pranë Qendrës Rinore Atelie dhe në Gur të Zi. Në përfundim të thirrjes aplikuan 25 të rinj nga të cilët 6 aplikime u shpallën fituese. Zbatimi i kontratave do të bëhet përgjatë vitit 2025.

Qëllimi 2

P04160.Q2.O1.A1. Mirëmbajtje e tregjeve ekzistuese

Bashkia ofron një program për mirëmbajtjen e tregjeve ekzistuese, i cili synon të përmirësojë infrastrukturën dhe shërbimet në këto hapësira. Ky program përfshin aktivitete si pastrimi, riparimi i ambienteve, përmirësimi i aksesit dhe krijimi i kushteve më të mira për tregtarët dhe konsumatorët, riparime në infrastrukture të tezgave, banakeve, lysterje, mirëmbajtje në banjo publike, elektricitet, uje, riparime në ambjentet e magazinimit të mallit. Qëllimi është të sigurohet një ambient i pastër dhe tërheqës, i cili nxit aktivitetin ekonomik dhe mbështet zhvillimin e komunitetit lokal. Përmes këtij programi, bashkia angazhohet të përmirësojë cilësinë e shërbimeve, duke kontribuar në rritjen e besimit të qytetarëve dhe rritjen e frekuentimit të tregjeve. Gjithashtu në këtë program përfshihen konsultime me tregtarët dhe banorët për të siguruar që nevojat e tyre të merren parasysh në procesin e përmirësimit.

Konkretisht këtë vit me buxhetin e programit 04130 janë likujduar çdo muaj detyrimet e energjisë elektrike sipas parashikimit. Megjithatë me anë të projektit të fituar nga AZHBR për ndërtim tregu të ri është realizuar një investim konkret në këtë zonë.

Bashkia Shkodër me Projektin: “Rikualifikim i Merkatës Rus (Mbulesa e Tregut Shkodër)”, është përzgjedhur për financim në kuadër të thirrjes për propozime të shpallur nga Agjencia e Zhvillimit

Bujqësor Rural (AZHBR). Ndërhyrja e propozuar me projektin **Rikualifikim i Merkatës Rus (Mbulesa e Tregut Shkodër)** do të ridimensionojë zonën për ta kthyer atë në një mjedis të përshtatshëm, i cili do të ofrojë hapësira të nevojshme për tregtim. Realizimi i mbulesës së tregut së bashku me banakët e rinj për tregtarët ka përmirësuar kushtet e tregtimit duke e bërë me atraktive frekuentimin e këtij tregu nga të gjithë banorët por edhe vizitorët e shumtë si një atraksion i produktit lokal. Mbulesa ka ndihmuar tregtarët duke ju krijuar kushte të favorshme dhe mbrojtur produktet dhe tregtarët e klientët nga reshjet dhe nga dielli i verës. Përmes këtij projekti u propozua përmirësimi i kushteve të tregtimit në merkaton Rus, duke ndërtuar 128 banakë të rinj dhe një mbulesë që krijon kushte të përshtatshme për mbarëvajtjen e funksionimit të tregut pa u ndikuar nga kushtet atmosferike. Për këtë arsye u propozua krijimi i një mbulesë me strukturë metalike e cila është shtrirë sipas një planimetrie të rregullt prej 1500 m². Gjithashtu u ndërtuan 128 banakë të rinj duke rritur kështu edhe kapacitetin e këtij tregu.

Bashkia Shkodër me Projektin: “Rikualifikim i godinës së Merkatës Rus” është përzgjedhur për financim në kuadër të zbatimit të aktit normativ nr. 5 datë 19.12.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, të udhëzimit të Ministrit të financave nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” të ndryshuar, sipas shkresës së Ministrisë së Financave nr. 17526/3 Prot. dt. 23.12.2024, “Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.5, datë 19.12.2024”. Ky projekt parashikon **Rikualifikimin e godinës së Merkatës Rus** duke ridimensionuar zonën për ta kthyer atë në një mjedis të përshtatshëm por edhe atraktiv, i cili do të ofrojë hapësira të nevojshme për tregtim të produkteve blegtorale, do të përmirësojë kushtet e tregtimit duke e bërë me atraktiv frekuentimin e këtij tregu nga të gjithë banorët, por edhe vizitorët e shumtë si një atraksion i produktit lokal.

Me VKB nr. 74 datë 19.12.2023 Për dhënien në përdorim pa kundërshtim të pasurisë me Nr 3/1034, Zonë kadastrale 8593 “Tregu Rus”, në favor të shoqërisë aksionere “Bio Strajca”, administrimi i këtij tregu i ka kaluar Sh.a. Bio Strajca me qëllim vazhdimin e ofrimit të shërbimit dhe të menaxhimit të tregut për gjenerimin e të ardhura për mirëmbajtjen e tij në vitet në vijim si dhe mundësinë e krijimit të hapsirave të tjera tregtare në qytet.

Qellimi 3

P04130.Q3.O1.A1. Hostim, mirembajtje, perditesim dhe sherbime shtese për web-sitin e turizmit. Një ndër instrumentët më të rëndësishëm të marketingut territorial, është promovimi online. Promovimi online ofron avantazhe të shumta dhe është lehtësisht i arritshëm nga çdo pikë e globit, mund të përditësohet shpejt dhe nuk ka kosto të madhe. Mundësia unike që ka ëeb-i për të bashkuar shumë elemente në një dokument multimedia, kanë rritur përdorimin në një shkallë të lartë kundrejt mediave të tjera tradicionale, duke e kthyer atë në një media globale. Bashkia Shkodër ka një ëeb-site zyrtar që i dedikohet turizmit. Ky portal përmban materiale promocionale dhe të gjithë informacionin e nevojshëm për vizitorët që dëshirojnë të vijnë në Shkodër. Gjatë vitit 2023, me përfundimin e kontratës së hostimit të ëeb-sitit, është parë e nevojshme rishikimi dhe rindërtimi i një ëeb-site të ri kushtuar turizmit. Në kuadër të projektit “Tourism4Albania” është parashikuar realizimi dhe vënia në funksion të ëeb-sitit të ri dhe për këtë arsye nuk është parashikuar fond për këtë zë buxheti. Aktiviteti është realizuar dhe ëeb-site është në funksion të përdoruesve: www.bashkiashkoder.gov.al

P04130.Q3.O1.A2. Hostim, mirembajtje, perditesim dhe sherbime shtese per aplikacionin e turizmit

Për të promovuar territorin e Bashkisë Shkodër si destinacion turistik dhe përmirësuar cilësinë e shërbimit për turistët, krijimi i një aplikacioni për smartphone, me informacionet dhe orientimet e nevojshme drejt nevojave të vizitorëve, është i domosdoshëm. Ofrimi i informacionit online përmes rrjeteve socialeve, faqes së ëeb-it, aksesit për shkarkimin falas të gjithë materialeve promocionale të territorit përmes aplikacionit do të ketë një impakt pozitiv në rritjen e numrit të vizitorëve dhe do ndikojë

në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Bashkia Shkoder ka parashikuar krijimin e nje aplikacioni dedikuar turizmit. Duke qenë se fondi në dispozicion për këtë zë buxheti nuk është i mjaftueshëm për rimodelimin dhe pasurimin me module shtesë, janë duke u vlerësuar mundësitë e financimit përmes bashkëpunimeve me donatorë potencialë në vitet në vazhdim.

P04130.Q3.O1.A3. Prodhimi dhe publikim i materialeve promociionale

Zhvillimi i turizmit në territorin e Bashkisë Shkodër ka ardhur gjithnjë e në rritje. Duke parë fluksin në rritje të turistëve dhe me qëllim rritjen e kohëzgjatjes së qëndrimit në territorin tonë, Drejtoria e Turizmit çdo vit ka realizuar botime të ndryshme dhe ka prodhuar materiale promociionale (guidën turistike, hartën turistike të territorit të Bashkisë; harta të destinacioneve specifike- Shkodër; Theth dhe Velipojë; itinerare të ndryshme turistike, kalendarin e aktiviteteve kulturore dhe artistike; materiale të ndryshme promociionale si dosje, stilolapsa, çanta, çakmakë etj. Të gjitha materialet promociionale janë vënë në dispozicion të zyrave të informacionit turistik të Bashkisë, falas. Ky zë buxheti është realizuar.

P04130.Q3.O2.A1 Përmirësimi i aksesit dhe mirëmbajtja e shtigjeve

Territori i bashkisë Shkodër është ndër zonat më të pasura me burime natyrore, ku përfshihen edhe destinacionet më të frekuentura për ata që takon turizmit natyror dhe atij malor. Këto zona turistike frekuentohen nga turistë kryesisht të huaj, të apasionuar pas ecjes në natyrë, alpinizmit, sporteve të aventurës por edhe për interesimin ndaj mënyrës autentike të jetesës së banorëve të zonës. Brenda zonave turistike ka mjaft pika tërheqëse me interes për vizitorët, të cilat vizitohen duke ecur në këmbë në shtigje që njihen nga guidat turistike të zonës. Këto shtigje kanë nevojë që të paisen me sinjalistikë të përshtatshme pasi ka një numër të madh vizitorësh të cilët vijnë në mënyrë të paorganizuar. Të gjitha facilitetet, përfshirë zonat rekreative dhe shtigjet për ecje, kanë nevojë për mirëmbajtje të rregullt për të zvogëluar dëmin e shkaktuar me kalimin e kohës dhe nga përdorimi. Mirëmbajtja e duhur është themelore për të garantuar sigurinë e vizitorëve, lehtësi në kalim, dhe për të inkurajuar përdorimin e itinerarit të caktuar. Gjatë vitit 2024 ishte parashikur një zë buxheti për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e dy shtigjeve: “Shtegu I rinisë” dhe “Shtegu Shirokë Qendër- Maja e Golishit- Fshati I Paqes” në malin e Traboshit. Ky zë buxheti është tenderuar dhe operatori fitues për realizimin e këtij aktiviteti ka përfunduar punimet. Ky aktivitet është realizuar dhe është në proces likuidimi.

P04130.Q3.O2.A2 Përmirësimi i infrastruktures dhe shërbimeve në plazhe dhe destinacione të tjera turistike

Zona bregdetare e Velipojës është një zonë tepër tërheqëse në drejtim të turizmit dhe shumë e frekuentuar nga vizitorë vendas dhe të huaj sidomos gjatë periudhës së verës.

Industria e turizmit bazuar në potencialet e mëdha që ofron, është në rritje të vazhdueshme duke sjellë dhe domosdoshmërinë në përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve dhe sistemimit të hapësirave publike, për të menaxhuar fluksin sidomos gjatë sezoneve dhe përmirësuar aksesin në këtë zonë turistike.

Drejtoria e Turizmit gjatë 2024 ka planifikuar dhe realizuar ndërhyrjen për veprim në disa plazhe publike të plazhit të Velipojës dhe konkretisht:

Vendosja e pasarelave prej druri me gjerësi 1.35 m le listela druri pishe

Vendosja e shkallareve dhe rampeve me listela druri dhe profile celiku të galvanizuara.

P04130.Q3.O3.A1. Pjesëmarrje në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare për ofertën turistike të Shkodrës

Për të promovuar ofertën turistike të territorit, Bashkia Shkodër ka planifikuar pjesëmarrjen në panairë kombëtare/ ndërkombëtare. Gjatë vitit 2024, është menduar që fondi për këtë zë buxheti, të trashëgohet

në 2025 dhe Bashkia Shkodër të marrë pjesë në panairë ndërkombëtare të një rëndësie të vecantë sic është panairi I turizmit në Berlin dhe në Bari- Itali.

P04130.O3.A3. Përditësim dhe ribotim i guidës turistike të Bashkisë Shkodër të trashëguar

Ky aktivitetet me ze buxheti i rishikuar, është realizuar. Është bërë botimi i guides me informacionet e rifreskuara

P04130.O3.A4. Ribotim i hartave turistike të Bashkisë Shkodër të trashëguar

| Mbledhje dhe transport i mbetjeve ne zonat urbane | P05100.Q1.O2.A1. Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit | Ndermarrja e Sherbimeve Publike | E perfunduar | 3,477 | 3,477 | 3,320 |
| | P05100.Q1.O2.A2. Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat urbane | Ndermarrja e Sherbimeve Publike | E perfunduar | 103,000 | 106,984 | 42,493 |
| Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve | P05100.Q1.O3.A1.Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve | Ndermarrja e Sherbimeve Publike | E perfunduar | 80,097 | 80,097 | 69,059 |
| | P05100.Q1.O3.A1.Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve & të trashëguara | Bashkia Shkodër | E perfunduar | - | 13,116 | 3,600 |
| Mbledhje dhe transport i mbetjeve ne zonat rurale | P05100.Q1.O4.A1-A2. Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale | Ndermarrja e Sherbimeve Publike | E perfunduar | 53,051 | 53,051 | 52,051 |
| Pastrimi i rrugeve dhe parqeve | P05100.Q1.O5.A1. Pastrimi i rrugëve dhe i parqeve | Ndermarrja e Sherbimeve Publike | E perfunduar | 45,000 | 45,000 | 12,726 |
| | P05100.Q1.O5.A1. Pastrimi i rrugëve dhe i parqeve & të trashëguara | Bashkia Shkodër | E perfunduar | - | 19,741 | 13,789 |
| TOTALI QELLIM 1 | | | | 299,043 | 338,984 | 212,704 |
| Promovimi i mbrojtjes së mjedisit | P05100.Q2.O1.A1. Zbatimi i objektivave mjedisore të Planit te Përgjithshëm Vendor, Bashkia Shkodër. | Bashkia Shkodër | Zbatuar detyre funksionale | - | - | - |
| | P05100.Q2.O1.A2. Aktivitete ne bashkepunim me shoqata mjedisore, arsimin parauniversitar , SHC etj per promovimin dhe mbrojtjen e mjedisit | Bashkia Shkodër | realizuar pjeserisht | - | - | - |
| | P05100.Q1.O1.A3. Shpenzime paga te personelit per Vazhdimësia e menaxhimit të Drejtorise në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi per menaxhimin e mjedisit | Bashkia Shkodër | realizuar | 5,055 | 5,655 | 4,908 |

| | | | | | | |
|-----------------------------------|---|-----------------|--------------|----------------|----------------|----------------|
| | P0100.Q2.O1.A4. Hartimi/Miratimi Planit vendor i veprimit për energji dhe klime të Bashkia Shkoder (MECAP) | Bashkia Shkodër | realizuar | - | - | - |
| | P05100.Q2.O1.A5.Auditim Energjistik dhe simulim i sistemeve eficiente të energjisë në objektet publike, pronë e Bashkisë Shkoder. | Bashkia Shkodër | realizuar | - | - | - |
| | P005100.Q2.O1.A6.Projekti i Bashkive të Zgjuara të Energjisë (PBZHE) & te trasheguara | Bashkia Shkodër | realizuar | - | 3,928 | 1,085 |
| | P005100.Q2.O1.A7Harta Strategjike e Zhurmave/ Zbatim i Planit te veprimit mbi zhurmat në Bashkinë Shkodër | Bashkia Shkodër | pa realizuar | 200 | 200 | - |
| | P005100.Q2.O1.A8. / Rishikimi I Planit Lokal te Mbrojtjes se Biodiversitetit. | Bashkia Shkodër | realizuar | 200 | 200 | - |
| | TOTALI QELLIMI 2 | | | 5,455 | 9,983 | 5,993 |
| 05100 MENAXHIMI I MBETJEVE | | | | 304,498 | 348,967 | 218,697 |
| Te trasheguara | | | | 83,814 | - | - |
| Totali | | | | 388,312 | 348,967 | 218,697 |
| Llogari jashte Thesari | | | | | | |
| Promovimi i mbrojtjes së mjedisit | P005100.Q2.O1.A6.Projekti i Bashkive të Zgjuara të Energjisë (PBZHE) & te trasheguara LLOG JASHTE THESARI | Bashkia Shkodër | realizuar | 0 | 64,662 | 44,518 |

P05100.Q1.O1.A1 Shërbimi i Stafit të menaxhimit të mbetjeve dhe pastrimit. Ky aktivitet është realizuar.

P05100.Q1.O2.A1: Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit. Ky aktivitet është realizuar. Shpenzime për sigurimin e automjeteve është realizuar. Blerje karburanti është realizuar.

P05100.Q1.O2.A2 Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat urbane. Ky aktivitet është realizuar.

P05100.Q1.O3.A1 Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve. Ky aktivitet është realizuar.

P05100.Q1.O4.A1-A2 Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale. Ky aktivitet është realizuar.

P05100.Q1.O5.A1 Pastrimi i rrugëve dhe i parqeve. Ky aktivitet është realizuar. Blerje kazanësh është realizuar. Ndërtim xhepa kazanesh është në proces.

P05100.Q2.O1.A5.Auditim Energjetik dhe simulim i sistemeve eficiente të energjisë në objektet publike, pronë e Bashkisë Shkoder Në kuadër të Ligjit nr 124/2015 “Për eficensën e energjisë” si edhe akteve nënligjore në zbatim të tij, parashikojmë hartimin e projektit për një objekt pronë e Bashkisë Shkodër. Aktualisht është realizuar auditimi energjetik i 10 objekteve publike të cilat do të përfitojnë investim në bashkëpunim me Agjensinë për Eficiencë Energjie.

P005100.Q2.O1.A6 .Projekti i Bashkive të Zgjuara të Energjisë (PBZHE) Në kuadër të projektit Bashki të Zgjuara Energjie, projekt në bashkëpunim me SECO, MIE dhe Bashkisë Shkodër. Kontrata e investimit është lidhur në muajin shtator 2023 dhe aktualisht po vazhdon realizimi i investimit i cili ka një afat 8 muajor të zbatimit të tij Investimi po ecen sipas parashikimeve , grafikeve të punimeve dhe marreveshjes së lidhur ndërmjet Bashkisë Shkodër si edhe donatoreve SECO dhe Ministria e Infrastruktura dhe Energjise.Aktualisht Investimi ka përfunduar dhe jemi në fazën e kolaudimit dhe likuidimit të situacionit përfundimtar.

P005100.Q2.O1.A7 Harta Strategjike e Zhurmave/ Zbatim i Planit të veprimit mbi zhurmat në Bashkinë Shkodër. Me Vendim të Këshillit të Bashkisë Shkodër nr 22 datë 18.04.2019 është miratuar Plani Lokal i Veprimit për Zhurmën në mjedis, pjesë integrale e të cilit ishte edhe Plani i Veprimit.. Dispozitat e reja ligjore që shoqeruan Ligjin nr 9774/2005 “ Për zhurmat” i ndryshuar, parashikoi ndryshime të reja të cilat sjellin edhe aktivitete dhe detyrime të reja.

P005100.Q2.O1.A8. / Rishikimi I Planit Lokal të Mbrojtjes së Biodiversitetit.

Gjate 12 muajorit puna e nisur për vlerësimin e planit aktual të biodiversitetit dhe masat e marra në kuadër të këtij plani kanë përfunduar dhe jemi në fazën e realizimit të Draft Planit të rishikuar.

P05100.Q2.O1.A1 Zbatimi i objektivave mjedisore të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Shkodër.

Deklarata Mjedisore e PPV parashikon zbatimin e 18 masave të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e Mjedisit në kuadër të projekteve për VNM. Për vitin 2024 janë parashikuar zbatimi i 6 masave. Ky produkt është detyrë funksionale dhe zbatohet në gjithë vitin.

P05100.Q2.O1.A2. Aktivitete në bashkëpunim me shoqata mjedisore, arsimin parauniversitar, SHC etj për promovimin dhe mbrojtjen e mjedisit. Në kuadër të dëgjësive publike mbi ndërgjegjësimin e publikut për efektet e projekteve që zbatohen dhe ndikimet mjedisore që ata kanë. Si detyrim ligjor për pjesëmarrje në dëgjesa publike, referuar kërkesave të subjekteve dhe në bashkëpunim me Agjensinë Rajonale të Mjedisit.

P05100.Q1.O1.A3. Shpenzime paga të personelit për Vazhdimësinë e menaxhimit të Drejtorisë në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi për menaxhimin e mjedisit.

P05100.Q2.O1.A4. Hartimi/Miratimi Planit vendor i veprimit për energji dhe klimë të Bashkia Shkodër (MECAP) është Realizuar dhe Miratuar në keshillin e bashkisë “Plani Lokal i veprimit për Energji dhe Klimë” me vendim nr 34dt 31.05.2024. Realizimi i këtij plani ishte një sfidë për të gjithë stafin e bashkisë Shkodër për vetë rëndësinë e tij.

FUNKSIONI 06: STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT

Programi 06140: Urbanistika

Strategji të unifikuara për zhvillimin e integruar të territorit në funksion të krijimit të një rajoni shumë qendërsh përmes krijimit e zhvillimit të infrastrukturës publike, administrative, sociale dhe kulturore.

I. Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2024 ka fokusuar përpjekjet e saj në një funksion zhvillimi

Objektivat për secilin funksion janë:

O1. Hartimi, mbështetja dhe monitorimi i proceseve planifikuese në Bashkinë Shkodër, me qëllim sigurimin e kornizës së përgjithshme të zhvillimit të territorit dhe promovimit të tij.

O2. Realizimi dhe Monitorimi i Sistemit të Adresave si mjet për përmirësimin e shërbimeve dhe identitetit të qytetarit.

II. Rezultatet e programit 06140: Planifikimi Urban Vendor në 000/ lekë

| Programi 06140 | Paga+ sigurime | Shpenzime operative | Transferta | Investime | Totali |
|------------------------|----------------|---------------------|------------|-----------|---------|
| PBA 2024 | 58,253 | - | - | - | 58,253 |
| Plani fillestar 2024 | 58,253 | - | - | 61,000 | 119,253 |
| Plani i rishikuar 2024 | 58,203 | 5,000 | 50 | 61,000 | 124,253 |
| Realizimi viti 2024 | 38,280 | 1,767 | 50 | - | 40,097 |
| % e realizimit | 65.8% | 35.3% | 100.0% | 0.0% | 32.3% |



Realizimi i shpenzimeve për paga, shpenzime operative, transferime dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është 32.3%, sipas zërave kryesorë si më poshtë:

| | |
|--------------------|-------|
| Shpenzime korente | 63.4% |
| Shpenzime kapitale | 0.00% |



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:

Aktivitetet janë në proces realizimi dhe do të mbarten për 2025.

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: viti 2024

| Kodi i Programit | 6140 | Emertimi i programit: | Planifikimi Urban Vendor | | | | | |
|---------------------------|--|---|---|--------------------------------------|------------------------------------|---------------------------------------|---|------|
| Qellimi 1 | Strategji të unifikuara për zhvillimin e integruar të territorit në funksion të krijimit të një rajoni shumëqendërsh përmes krijimit e zhvillimit të infrastrukturës publike, administrative, sociale dhe kulturore. | | | | | | | |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | Kodi i Treguesit te Performances/Produktit | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit | |
| <i>Objektivi 1.1</i> | Hartimi, mbështetja dhe monitorimi i proceseve planifikuese në Bashkinë Shkodër, me qëllim sigurimin e kornizës së përgjithshme të zhvillimit të territorit dhe promovimit të tij. | 1 | Numri i punonjesve Inspektoriati i mbrojtjes territorit | 0 | 16 | 16 | 16 | 100% |
| | | 2 | Tregues Qellimi ; Bashkia përdor instrumentat planifikimit sipas parashikimeve ligjore :Instrumentat të përdorur nga bashkia: - PPV periudha 2015 - 2030 | 1 | 1 | 1 | 1 | 100% |
| | | 3 | Tregues Qellimi ; Bashkia përdor instrumentat planifikimit sipas parashikimeve ligjore : Plani detajuar për njësi të ndryshme | 9 | 7 | 7 | 7 | 100% |
| | | 4 | Bashkia akordon leje zhvillimi mbi bazën e planeve të detajuara vendore: Numri lejeve të miratuara | 56 | 65 | 32 | 32 | 100% |
| | | 5 | Efiçienca e programit të planifikimit urban vendor: Raporti i të ardhurave nga lejet e zhvillimit të miratuara kundrejt totalit të të ardhurave të bashkisë (në %). | 6% | 16% | 16% | 14% | 89% |

ANEKSI nr.3 "Raporti përmblledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 | | | | | | | | | | | | | | | |
|---------------|--|-----------------------------------|---------------------------|--------------------------------|------------------------------------|------------------------------------|---|--|---|--|---|---------------------------|--------------------------------|-------------------------------------|------------|-------------|--------------|--|
| Programi | Planifikimi Urban Vendor | Kodi i Programit | 6140 | | | | | | | | | | | | | | | |
| | në 000/lekë | | | | | I | | II | | III | | IV | Luhatjet në Koston për Njësi | | | | | |
| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (viti 2023) | Shpenzimet Faktike (viti 2023) | Kosto për Njësi (sipas vitit 2023) | Sasia (sipas planit të vitit 2024) | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2024) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2024) | Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2024) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2024) | Kosto per Njësi (sipas planit të rishikuar viti 2024) | Sasia Faktike (viti 2024) | Shpenzimet Faktike (viti 2024) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2024) | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III | |
| 1 | Inspektime te zhvilluara per mbrojtjen e territorit | numer punonjesish | | | | 16 | 17,086 | 1,067.9 | 16 | 17,086 | 1,067.9 | 16 | 14,957 | 934.8 | 934.8 | -133.1 | -133.1 | |
| 2 | Projkte zhvillimit urban te hartuara dhe monitoruara | numri i planeve te detajuara(PDV) | 1 | 0 | 0.0 | 7 | 41,167 | 5,881.0 | 7 | 107,167 | | 7 | 25,140 | 3,591.4 | 3,591.4 | 2,289.6 | 3,591.4 | |

III. Realizimi i produkteve për Vitin 2024

Gjatë vitit 2024 po punohet për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër

Për vitin 2024 në Programin “Planifikimi Urban Vendor” në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara janë parashikuar aktivitetet në mijë lekë si më poshtë:

| Produktet | Aktivite/Projekte | Institucioni | Statusi i aktivitetit | Plani fillestar 2024 | Plani I rishikuar 2024 | Realizimi 2024 |
|---|--|-----------------|------------------------------|----------------------|------------------------|----------------|
| | | | | Totali | Totali | Totali |
| Inspektime të zhvilluara për mbrojtjen e territorit (numër punonjesh) | P06140.Q1.O1.A1 - Paga dhe sigurime Inspektoriati i mbrojtjes territorit | Bashkia Shkodër | Realizuar | 17,086 | 17,086 | 14,957 |
| Projekte zhvillimit urban të hartuara dhe monitoruara (numër PDV) | P06140.Q1.O1.A2 - Paga dhe sigurime Drejtoria e Planifikimit dhe koordinimit të investimeve dhe Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të territorit | | Realizuar | 41,167 | 41,167 | 23,373 |
| | P06140.Q1.O1.A3 Përgatitja e PDV për zonat e parashikuara në PPV. | | | - | - | - |
| | P06140.Q1.O1.A3 Hartimi i studimeve të fizibilitetit, planeve zhvillimore, masterplane, projekt - ide teknike dhe projekteve teknike të ndryshme të detajuara & të trashëguara | | Lidhur kontrata | - | 60,000 | - |
| | P06140.Q1.O1.A4 Publikimi i Planeve të Detajuara Vendore nëpërmjet publikimit elektronik dhe mjeteve tradicionale të informimit | | | - | - | - |
| | P06140.Q1.O1.A5 Miratimi i lejeve të zhvillimit/ndërtimit | | | - | - | - |
| | P06140.Q1.O1.A6 Tarifa/Taksa për aplikime apo shërbime në lidhje me projekte të Bashkisë Shkodër | | | - | 5,000 | 1,767 |
| | P06140.Q1.O2.A1. Rivlerësimi, realizimi dhe monitorimi i Sistemit të Adresave Bashkia Shkodër & të trashëguara | | Ne vijim, do mbartet në 2025 | - | 1,000 | - |
| 06140 Planifikimi Urban Vendor | | | | 58,253 | 124,253 | 40,097 |
| Te trashëguar | | | | 61,000 | - | - |
| Totali | | | | 119,253 | 124,253 | 40,097 |

Programi 06260 : Zhvillimi i komunitetit

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

1. Aparatin e Bashkisë
2. Ndërmarrja e shërbimeve dhe punëve publike

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit

-Qëllimet e programit të Zhvillimit të komunitetit janë:

I.Garantimi për të gjithë qytetarët e saj shërbime publike cilësore në të gjithë territorin e saj pamvarësisht vendodhjes së tyre.

II. Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve publike, modernizimi i tyre nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë.

III. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike si dhe garantimi i shërbimit të varrimit; Garantimi për të gjithë qytetarët e saj shërbime publike cilësore në të gjithë territorin e saj pavarësisht vendodhjes së tyre.

IV.Permirësimi i cilësisë së mirëmbajtjes dhe riorganizimi i lulishteve, zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbërta dhe gjelbërimit rrugor, objekteve publike të mirëmbajtura

V. Garantimi i shërbimeve publike cilësore për përmirësimin e jetesës së qytetarëve dhe përmirësimi i ndriçimit të mjediseve publike.

VI. Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve publike, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë si dhe zgjerimit të zonës së shërbimit.

-Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre qëllimeve për 12 mujorin e vitit 2024 kanë qenë:

O1. Përmbushja e nevojës për kryerjen e shërbimeve ditore të ruajtjes, pastrimit, mirëmbajtjes dhe të tjera për objektet dhe hapësirat publike.

- Është realizuar shpërblimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësoretë administratës vendore në mbështetje të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparencë
- Është realizuar mirëmbajtja e të gjithë objekteve në qytet dhe në Nj.A
- Është realizuar mirëmbajtje e ambjenteve publike në Nj.A

O2. Shërbim cilësor me standarteve dhe sipas normativave të rregullores së Mirëmbajtjes së Varrezave. Zgjerim i territorit të Varrezave për vazhdimësinë e këtij shërbimi .

- Është realizuar gjatë vitit shërbimi i mirëmbajtjes të varrezave publike dhe dëshmorëve, Zbatim i Kontratës ka objektiv kryesor shërbimin cilësor dhe me standarteve shtetërore të mirëmbajtjes të varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit.

O1. Përmirësimi i cilësisë së mirëmbajtjes dhe riorganizimi i lulishteve, zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbërta dhe gjelbërimit rrugor, objektet publike të mirëmbajtura në të gjithë Bashkinë.

- Gjatë vitit 2024 është realizuar përmirësimi i cilësisë së mirëmbajtjes të gjelbërimit rrugor dhe lulishteve të qytetit. Shërbimi realizohet për mirëmbajtjen e 121 791 m² sipërfaqe të gjelbër ku përfshihen 74 lulishte ndër të cilat 96 796 m² në qytet dhe 25 000 m² lulishte në Velipojë, si dhe në gjelbërimit rrugor me 6980 rrënjë pemësh në të gjithë qytetin.
- Shërbimet kryhen sipas grafikëve të përcaktuar në funksion të tipologjive dhe elementet atraktiv të këtyre sipërfaqeve në zërat e: mirëmbajtjes së sipërfaqes së barit, drurëve dekorativë, shkurreve, sipërfaqeve ujore, stolave, pastrim i rrugëve të brendshme etj.

- Është realizuar vendosja e 190 koshave të vegjël në lulishtetë ndryshme të qytetit, në trotuare si dhe në rrugën Shkodër- Shirokë.

O1. Përmirësimi i menaxhimit të shërbimit të ndriçimit

- Nëpërmjet shërbimit të mirëmbajtjes, rehabilitimit është realizuar puna për rehabilitimin rrjetit elektrik ekzistues
- Mirëmbajtja e gjithë rrjeti i ndriçimit publik në rrugë kryesore, dytësore në të gjithë Bashkinë:
 - Mirëmbajtje e 6,836 ndriçuesve të zakonshëm;
 - Mirëmbajtje e 338 ndriçueve dekorativ.
- Realizimi i pagesës për konsumin e pritshëm të energjisë elektrike për të gjitha kontratat në qytet dhe njësitë administrative;
- Gjatë vitit 2024 Bashkia Shkodër nëpërmjet projektit SEMP (Bashki te Zgjuara Energjie) ka përfunduar zbatimin e projektit për instalimin e ndriçuesve me efikasitet energjie të teknologjisë LED. Ky projekt do të krijojë mundësinë e ndriçimit më të mirë të rrugëve me një kosto më të ulët. Projekti parashikon zëvendësimin e rreth 500 ndriçuesve të teknologjisë së vjetër SAP SON me fuqi 250W me ndriçues LED me fuqi 80W

Është realizuar zbatimi i projekteve për ndriçimin e rrugëve kryesore të qytetit me ndriçues LED ku është ndërhur në të gjithë infrastrukturën për sistemin e ndriçimit rrugor.

Rrugët që janë pjesë e projektit janë të listuara si më poshtë:

1. Rruga Villson & Sheshi 2 Prilli
2. Rruga Studenti dhe Sheshi Demokracia
3. Rruga Bulevardi Zogu i Parë dhe Sheshi Parrucë
4. Rruga Marin Beçikemi
5. Rruga Edith Durham
6. Rruga Bulevardi Mehmet Pashë Plaku
7. Rruga Daut Boriçi
8. Rruga Gjuhadol
9. Rruga Bujar Bishanaku
10. Rruga Bulevardi Skënderbeu
11. Rruga Kolë Heqimi

Realizimi i punimeve ka përfunduar. Në proces mbyllja e kontratës dhe likuidimit.

- Gjatë vitit 2024, Bashkia Shkodër, si fituese e projektit “Ndriçim i rrugëve plazh Velipojë”, të financuar nga FSHZH (Fondi Shqiptar i Zhvillimit) arriti të implementojë ndriçimin në 8 rrugë të plazhit Velipojë, me një sasi totale prej 209 ndriçuesish LED të teknologjisë së fundit. Ky projekt do të vazhdojë edhe përgjatë vitit 2025 me implementimin e rrugëve të tjera.
- Investim me fonde të veta dhe punëtori të Ndërmarrjes së Shërbimeve dhe Punëve Publike, për instalimin e 150 ndriçuesve të rinj të shpërndara në të gjitha njësitë administrative, rrugë të reja të ndriçuara si Shtoj i Vjeter, Berdice e Madhe, Berdice e Mesme, Fshati i Paqes Shirokë, Dragoc, Fshat i Ri, Boks, Drisht, Sheldi, Rrenc, Vukatane, Juban, Gur i Zi, Vejukej dhe Gorice.

Realizimi i Buxhetit të planifikuar:

| Programi 06260 | Paga &sigurime | Shpenzime operative | Transferta | Investime | 000/leke |
|----------------------|-------------------|------------------------|------------|-----------|----------|
| | | | | | Totali |
| PBA 2024 | | | | | |
| | 57,353 | 230,501 | - | 20,000 | 307,854 |
| Plani fillestar 2024 | 66,276 | 252,224 | 40 | 29,891 | 348,431 |

| | | | | | |
|------------------------|--------|---------|-------|--------|---------|
| Plani i rishikuar 2024 | 57,294 | 256,043 | 59 | 31,201 | 344,597 |
| Realizimi viti 2024 | 43,048 | 208,021 | 50 | 17,897 | 269,016 |
| % e realizimit | 75.1% | 81.2% | 84.7% | 57.4% | 78.1% |



Realizimi i shpenzimeve për paga, shpenzime operative, transferime dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planin e rishikuar është 78.1% sipas zërave kryesorë si më poshtë:

| | |
|--------------------|--------|
| Shpenzime korente | 80.1% |
| Shpenzime kapitale | 57.36% |



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:

Rikonstruksion ambiente magazine dhe te jashtme, në proces zbatimi.

Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve ujore, për nenaktivitetin “Marrje me qera makineri dhe sinjalistike për pastrimin e liqenit” sepse nuk është përfunduar procedura e tenderimit.

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: viti 2024

| Kodi i Programit | 6260 | Emertimi i programit: | Shërbimet publike vendore | | | | | |
|--|---|---|---|---|---|---|--|--|
| Qellimi 1 | Garantimin e shërbimeve publike cilësore për përmirësimin jetesës së qytetarëve dhe përmirësimin e ndricimit të mjediseve publike. II.Rritja e efijencës dhe efektivitetit të shërbimeve publike, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë si dhe zgjerimit të zonës së shërbimit. | | | | | | | |
| **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | | Kodi i Treguesit te Performances/Produktit | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit |
| <i>Objektivi 1.1</i> | Përbushja e nevojës për kryerjen e shërbimeve ditore të ruajtjes, pastrimit, mirëmbajtjes dhe të tjera për objektet dhe hapësirat publike. | 1 | Rritja e efijencës buxhetore në ofrimin e shërbimeve operative të gjelberimit dhe varrezave - ndryshimi ne % kundrejt vitit paraardhes | 11% | -4% | -1% | -16% | |
| <i>Objektivi 1.2</i> | Shërbim cilësor me standarteve dhe sipas normativave të rregullores së Mirëmbajtjes së Varrezave. Zgjerim i territorit të Varrezave për vazhdimësinë e këtij shërbimi . | 2 | Përmirësimi i shërbimit të varrezave - Zgjerimi i sipërfaqes së mirembajtjes për garantimin e shërbimit funeral ne qytet - ndryshimi ne % kundrejt vitit paraardhes | 14% | 4% | 4% | 4% | 100% |
| | | 3 | Kapaciteti i varrezave publike për 1000 banorë | 773 | 805 | 801 | 801 | 100% |
| Qellimi 2 | Përmirësimi i cilesise se mirembajtjes dhe riorganizimi i lulishteve , zgjerimi i siperfaqeve te gjelberta dhe gjelberimit rrugor, objekteve publike te mirembajtura | | | | | | | |
| | Përmirësimi i cilesise se mirembajtjes dhe riorganizimi i lulishteve , zgjerimi i siperfaqeve te gjelberta dhe gjelberimit rrugor, objekteve publike te mirembajtura | 4 | Tregues Qellimi : Përmirësimi i shërbimeve publike vendore - Raporti i sipërfaqes së gjelbëruar kundrejt sipërfaqes totale të bashkisë (në %) | 83% | 91% | 91% | 91% | 100% |
| | | 5 | Tregues Qellimi - Eficiencia e shërbimit / mbulimi koston e shërbimit nga tarifa - Raporti të ardhurave nga tarifa kundrejt shpenzimeve totale për shërbimin (Raporti në %) | 58% | 63% | 60% | 77% | 128% |
| | | 6 | Përmirësimi i menaxhimit të tarifave të shërbimit të gjelberimit - Raporti shuma totale e arketuar për shërbimin kundrejt shumës së faturuar nga klientët (Raporti në %) | 100% | 100% | 100% | 100% | 100% |
| | | 7 | Lekë të ardhura nga tarifa e gjelberimit kundrejt siperfaqes se mirembajtuar (në mije leke/sip mirembajtur ne m2) | 0.21 | 0.22 | 0.22 | 0.22 | 100% |
| | | 8 | Rrënjë pemë të mbjella kundrejt totalit të pemëve për të cilat kujdeset - ndryshimi vjetor ne numer | 1,000 | 499 | 899 | 899 | 100% |

| Qellimi 3 | Garantimin e shërbimeve publike cilësore për përmirësimin jetesës së qytetarëve dhe përmirësimin e ndricimit të mjediseve publike. II.Rritja e efijencës dhe efektivitetit të shërbimeve publike, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë si dhe zgjerimit të zonës së shërbimit. | | | | | | | |
|---------------|---|----|---|-------|------|------|------|------|
| Objektivi 3.1 | Përmirësimi i menaxhimit të shërbimit të ndriçimit | 9 | Tregues Qellimi : Rritja e mbulimit të territorit me ndriçim publik: - Sipërfaqja e shtuar e rrugëve dhe e shesheve të ndriçuara; - Sipërfaqe e hapësirave publike e mbuluar me ndriçim – raporti sipërfaqe e mbuluar me ndriçim kundrejt totalit të sipërfaqes publike të bashkisë (në%) | 66% | 66% | 68% | 68% | 100% |
| | | 10 | Tregues Qellimi : Përmirësimi i efijencës së buxhetit të bashkisë për shërbimin e ndriçimit publik -Shpenzime operative totale kundrejt sipërfaqes totale të ndriçuar - (Mijë Lekë të shpenzuara për m2 katror hapësirë publike të ndriçuar) | 10% | 18% | 19% | 15% | 79% |
| | | 11 | Tregues Qellimi : Përmirësimi i mbulimit të kostove nga tarifa e shërbimit ; Mbulimi shërbimit të ndricimit publik nga tarifa e shërbimit- Lekë ardhura nga tarifat për ndriçimin e hapësirave publike kundrejt totalit të shpenzimeve të bashkisë për mbulimin me ndriçim (në %) | 34% | 24% | 22% | 23% | 105% |
| | | 12 | Përmirësimi i mbulimit të kostove nga tarifa e shërbimit ; Mbulimi shërbimit të ndricimit publik nga tarifa e shërbimit- Lekë ardhura nga tarifat për ndriçimin e hapësirave publike kundrejt totalit të shpenzimeve të bashkisë për mbulimin e pageses se konsumit te EE per ndriçimin rrugor (në %) | 50% | 57% | 50% | 50% | 100% |
| | | 13 | Përmirësimi i menaxhimit të tarifave të shërbimit të ndricimit: Raporti shuma totale e arketuar për shërbimin kundrejt shumës së faturuar nga klientët (Raporti në %) | 90% | 100% | 100% | 100% | 100% |
| | | 14 | Zgjerimi i rrjetit të shërbimit të ndricimit publik në Njësitë Administrative të Bashkisë - ndryshimi në % kundrejt vitit paraardhës | -100% | 100% | 100% | 100% | 100% |

ANEKSI nr.3 "Raporti përmblidhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 | | | | | | | | | | | | | | | |
|---------------|---|------------------------------|---------------------------|--------------------------------|------------------------------------|------------------------------------|---|--|---|--|---|---------------------------|--------------------------------|-------------------------------------|------------|------------------------------|--------------|--|
| Programi | Shërbimet publike vendore | Kodi i Programit | 6260 | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | në 000/lekë | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | I | | | II | | | III | | | IV | | | Luhatjet në Koston për Njësi | | |
| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (viti 2023) | Shpenzimet Faktike (viti 2023) | Kosto për Njësi (sipas vitit 2023) | Sasia (sipas planit të vitit 2024) | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2024) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2024) | Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2024) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2024) | Kosto per Njësi (sipas planit të rishikuar viti 2024) | Sasia Faktike (viti 2024) | Shpenzimet Faktike (viti 2024) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2024) | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III | |
| 1 | Sherbimi i stafit te ndermarrjeve publike te gjelberimit, varrezave | Numri i punonjesve | 11 | 7,967 | 724.3 | 2 | 4,938 | 2,469.0 | 2 | 4,938 | 2,469.0 | 2 | 3,767 | 1,883.5 | 1,159.2 | - | 585.5 | |
| 2 | Mirembajtja e siperfaqes se varrezave | Sip. varrezash e mirembajtur | 90,180 | 20,853 | 0.2 | 93,836 | 16,632 | 0.2 | 93,836 | 16,632 | 0.2 | 93,836 | 16,322 | 0.2 | -0.1 | 0.0 | 0.0 | |
| 3 | Siperfaqe e gjelber e mirembajtur | Sip. e gjelber e mirembajtur | 111,631 | 40,948 | 0.4 | 121,741 | 41,735 | 0.3 | 121,741 | 43,525 | 0.4 | 121,741 | 34,753 | 0.3 | -0.1 | -0.1 | -0.1 | |
| 4 | Objekte publike te mirembajtura | Nr. I banoreve | 116,593 | 765 | 0.0 | 116,593 | 765 | 0.0 | 117,117 | 10,765 | 0.1 | 117,117 | 765 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | -0.1 | |
| 5 | Sherbimi i stafit te mirembajtjes se ndricimit publik | numër | 12 | 5,050 | 420.8 | 26 | 85,884 | 3,303.2 | 26 | 87,094 | 3,349.8 | 25 | 68,545 | 2,741.8 | 2,321.0 | - | 561.4 | |
| 6 | Rrjeti i ndricimit rrugor publik urban i mirembajtur | linja te reja ndricimi | 2,300 | 112,721 | 49.0 | 2,500 | 118,600 | 47.4 | 900 | 118,600 | 131.8 | 900 | 101,206 | 112.5 | 63.4 | 65.0 | -19.3 | |
| 7 | Rrjeti i ndricimit rrugor publik rural i mirembajtur | linja te reja ndricimi | 0 | 23,983 | | 6,200 | 39,300 | 6.3 | 9,600 | 61,871 | 6.4 | 9,600 | 43,658 | 4.5 | 4.5 | -1.8 | -1.9 | |

Për vitin 2024 në Programin "Zhvillimi i komunitetit" në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përbushjen e objektivave të përcaktuara, janë parashikuar aktivitetet më poshtë.

-Aktivitetet janë analizuar si më poshtë:

| Produktet | Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi I aktivitetit | Plani fillestar 2024 | Plani I rishikuar 2024 | Realizimi 2024 |
|--|--|---------------------------------|-----------------------|----------------------|------------------------|----------------|
| | | | | Totali | Totali | Totali |
| Sherbimi i stafit te ndermarrjeve publike te gjelberimit, varrezave, | P06260.Q1.O1.A1. Paga dhe sigurime te stafit - Gjelbrim Varreza | Ndermarrja e Sherbimeve Publike | E përfunduar | 2,458 | 2,458 | 1,287 |
| | P06260.Q1.O1.A2 Shpenzime për pagat, sigurime shoqërore | Bashkia Shkodër | E përfunduar | 2,480 | 2,480 | 2,480 |
| Mirembajtja e siperfaqes se varrezave | P06260.Q1.O2.A1. Mirëmbajtje e varrezave publike dhe varrezave të dëshmorëve | Ndermarrja e Sherbimeve Publike | E përfunduar | 16,632 | 16,632 | 16,322 |
| Siperfaqe e gjelber e mirembajtur | P06260.Q2.O1.A1. Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta | Ndermarrja e Sherbimeve Publike | E përfunduar | 41,735 | 43,525 | 34,753 |
| Objekte publike te mirëmbajtura | P06260.Q2.O1.A2. Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve ujore | Ndermarrja e Sherbimeve Publike | E përfunduar | 765 | 10,765 | 765 |
| TOTALI QELLIMI 1 & 2 | | | | 64,070 | 75,860 | 55,607 |
| Sherbimi i stafit te mirembajtjes se ndriçimit publik (Numri i punonjesve) | P06260.Q3.O1.A1: Shërbim I stafit të mirëmbajtjes së ndriçimit publik dhe dekorit | Ndermarrja e Sherbimeve Publike | E përfunduar | 52,468 | 52,468 | 39,331 |
| | P06260.Q3. O1.A2 Dekorimi i mjediseve publike | | E përfunduar | 5,000 | 8,000 | 7,470 |
| | P06260.Q3.O1.A3 Mbeshtetje per infrastrukturën dhe shërbimet bazë të NSHPP | | E përfunduar | 23,050 | 22,660 | 17,888 |
| | P06260.Q3.O1.A4 Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e NSHPP | | E përfunduar | 5,366 | 3,966 | 3,856 |
| Rrjeti i ndriçimit rrugor publik urban i mirembajtur | P06260.Q3.O1.A5: Sherbimi i Sistemit të Ndriçimit Publik të Qytetit | | E përfunduar | 118,600 | 118,600 | 101,206 |
| Rrjeti i ndriçimit rrugor publik rural i mirembajtur | P06260.Q3.O1.A6: Sherbimi i Sistemit të Ndriçimit Publik te Njësive Administrative | | E përfunduar | 39,300 | 39,300 | 30,654 |
| | P06260.Q3.O1.A6: Sherbimi i Sistemit të Ndriçimit Publik te Njësive Administrative& te trashëguara | Bashkia Shkoder | E përfunduar | - | 12,371 | 12,031 |

| | | | | | | |
|--|---|---------------------------------------|--|----------------|----------------|----------------|
| | P06260.Q3.O1.A7 Rikonstruksion ambiente magazine dhe te jashtme | Ndermarrja e Sherbimeve Publike | Në proces zbatimimi për vitin 2025 | - | 9,200 | 18 |
| | P06260.Q3.O1.A8 Tualete publike, pika turistike | Ndermarrja e Sherbimeve Publike | E përfunduar | - | 1,000 | 955 |
| | TOTALI QELLIMI 3 | | | 243,784 | 267,565 | 213,409 |
| | 06260 - Sherbime publike vendore | | | 307,854 | 343,425 | 269,016 |
| | Te trasheguara | | | 40,577 | 1,172 | - |
| | Totali | | | 348,431 | 344,597 | 269,016 |

P06260.Q1.O1.A1. Paga dhe sigurime te stafit - Gjelbrim Varreza. Ky aktivitet është realizuar.

P06260.Q1.O1.A2 Shpenzime për pagat, sigurime shoqërore. Ky aktivitet është realizuar.

P06260.Q1.O2.A1 Mirëmbajtje e varrezave publike dhe varrezave të dëshmorëve. Ky aktivitet është realizuar.

P06260. Q2. O1.A1 Shërbimi i Mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta. Ky aktivitet është realizuar.

P06260.Q3.O1.A1 Shërbim i stafit të mirëmbajtjes së ndriçimit publik dhe dekorit. Ky aktivitet është realizuar.

P06260.Q3.O1.A2 Dekorimi i mjediseve publike. Ky aktivitet është realizuar si më poshtë:

-Blerje aksesorë dekori për festat e fundvitit

Është realizuar blerja e aksesorëve shtesë, të cilët së bashku me aksesorët gjëndje në magazinë të blera gjatë viteve të mëparshme dhe që mirëmbahen e riparohen nga punonjësit e Ndërmarrjes së Shërbimeve dhe Punëve Publike vendosen në sheshe e rrugë kryesore të Bashkisë. Pjesa tjetër e dekorit është realizuar me aksesorë të blerë në vitet e kaluara, të cilët ruhen e mirëmbahen nga punonjësit e sektorit të dekorit . Me këto aksesorë për festat e fundvitit është realizuar një dekor I përmirësuar i akseseve kryesore të rrugëve shesheve, godinave të qytetit, konkretisht sheshet Parrucë, Nënë Tereza, Rus i madh, rrugët 13 Dhjetori, 28 Nëntori, Kolë Idromeno, rruga Studenti, Bulevardi Skënderbeg, Gjuhador, bulevardi Mehmet Pashë Plaku, sheshi Isa Boletini si dhe godina e Bashkisë e sheshi i saj.

-Blerje materiale të ndryshme për dekorin:

Është realizuar blerja e materialeve të domosdoshme për riparimet e mundshme dhe montimin e aksesorëve të dekorit. Në zërat kryesorë të materialeve përfshihen:

Kordon ndriçues dekorative (Ø 12 mm).

Tel përcjelles energjie elektrike me dimension 2x1.5 mm.

Lidhëse kabllosh plastike.

Flamurë kombëtar për dekorin e institucioneve administrative në të gjithë territorin si dhe në sheshe dhe rrugë kryesore.

P06260.Q3.O1.A3 Mbeshtetje per infrastrukturën dhe shërbimet bazë të NSHPP. Blerje materiale për pastrim ambienti është realizuar, Shërbimi Interneti është realizuar, Blerje Kancelarie është realizuar.

P06260.Q3.O1.A4 Mbeshtetje dhe ofrim i shërbimit të transportit per funksionimin e NSHPP është realizuar P06260.Q3.O1.A3/A.1 Blerje Kancelarie e realizuar.

P06260.Q3.O1.A3/A.3 Blerje materiale për pastrim ambienti e realizuar,

P06260.Q3.O1.A3/A.4 Blerje pajisje zyre është realizuar

P06260.Q3.O1.A3/A.8 Blerje fikse zjarri e realizuar, Shpenzime për sigurimin e automjeteve e realizuar.

P06260.Q3.O1.A3/A.12 Shërbime të tjera (larje automjete, tarife parking etj) është realizuar.

P06260.Q3.O1.A3/A.14 Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) është realizuar.

P06260.Q3.O1.A5 Sherbimi i Sistemit të Ndrëçimit Publik të Qytetit. Pagesa e konsumit të ndrëçimit publik (ekzistues+zgjerim) sipas faturimit OSHEE Bashkia Shkodër (qytet) të realizuara.

P06260.Q3.O1.A6 Sherbimi i Sistemit të Ndrëçimit Publik te Njësi Administrative. Pagesa e konsumit të ndrëçimit publik (ekzistues+zgjerim) sipas faturimit OSHEE Bashkia Shkodër (nj.a) të realizuara.

P06260.Q3.O1.A7 Rikonstruksion ambiente magazine dhe te jashtme, në proçes zbatimi.

Programi 06370: Furnizimi me ujë

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

1. Aparatin e Bashkisë
2. Ndërmarrja e shërbimeve dhe punëve publike

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit

Qëllimet e programit të Menaxhimit të ujërave të zeza dhe Prodhimit dhe shpërndarjes së ujit të pijshëm dhe mbledhjes së ujërave të përdorura janë:

1. Sigurimi i funksionimit normal të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të bardha (shiut) në qytet dhe grykëderdhjet kryesore për të evituar problematikat e ndryshme.

-Objektivi i programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 12 mujorin e vitit 2024 ka qenë:

O1. Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të shiut në të gjithë zonat urbane të Nj.A të bashkisë. Ky shërbim realizohet nga Ujësjiellës Kanalizime Shkodër, sh.a:

- 96,266 numri i popullsisë me shërbime sanitare (KUB)
- Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të bardha i qytetit të Shkodrës (për mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut) funksionon i ndarë nga rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza;
- Gjatësia e përgjithshme e sistemit të kanalizimeve të KUB për qytetin është rreth 54 km. Rreth 37 km përbëhen nga tubacione të mbyllura dhe pjesa tjetër janë kanale të hapura;
- Sistemi kryesor i drenazhimit mbulon rreth 70% të zonave formale të qytetit, ndërsa në zonat informale zë një mbulim shumë më të ulët.
- Gjatë vitit 2024 është kryer mirëmbajtje e vazhdueshme dhe e qëndrueshme e rrjetit KUB qytet:
 - Pastrim kuneta Bulevardi Zogu i I-rë.
 - Pastrim kuneta Bulevardi Bujar Bishanaku.
 - Pastrim zhblllokim kolektori Unaza madhe lindore
 - Pastrim zhblllokim kolektori Unaza madhe Perëndimore
 - Pastrim zhblllokim kolektori Unaza vogël lindore
 - Pastrim zhblllokim kolektori Unaza vogël Perëndimore
 - Pastrim zhblllokim kolektori Rus-Xhabije
 - Pastrim zhblllokim kolektori Dugajt e reja – Stom Golem
 - Pastrim zhblllokim kolektori Ura Kirasit-Kiras
 - Pastrim kanali Tepe
 - Pastrim kanali Velipojë Plazh

Përveç kanaleve të mëdha kulluese, gjithashtu ka vazhduar puna rutinë në pastrimin e kunetave dhe kanaleve në rrugica të lagjeve të ndryshme të qytetit.

Është realizuar riparimi dhe vendosje gradelash dhe pusetash të dëmtuara në rrugë të ndryshme të qytetit.

- Është realizuar riparimi i pusetave në Unazën e qytetit
- Riparim linja e KUB, rruga “Marin Barleti”, “Lek Dukagjini“, “Arra e madhe“
- Zëvendësimin e gradelave dhe riparim pusetash të dëmtuara në të gjithë qytetin.

Realizimi i Buxhetit të planifikuara:

| Programi 06370 | 000/leke | | |
|------------------------|------------|-----------|--------|
| | Transferta | Investime | Totali |
| PBA 2024 | 15,000 | - | 15,000 |
| Plani fillestar 2024 | 30,000 | 10,272 | 40,272 |
| Plani i rishikuar 2024 | 15,000 | - | 15,000 |
| Realizimi viti 2024 | 15,000 | - | 15,000 |
| % e realizimit | 100.0% | 0.0% | 100.0% |

Realizimi i shpenzimeve korrente për këtë program, duke e krahasuar me planin e rishikuar është 100%.



Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: viti 2024

| Kodi i Programit | 6370 | Emertimi i programit: | Furnizimi me ujë dhe Kanalizime | | | | | |
|----------------------------------|---|--|---|---|---|--|--|------|
| Qellimi 1 | Garantimin e shërbimeve publike cilësore për përmirësimin jetesës së qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit. II.Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve publike, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë si dhe zgjerimit të zonës së shërbimit. III.Rritja e transparencës në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, duke siguruar pjesëmarrjen e publikut në procesin e planifikimit dhe të monitorimit për ta orientuar atë sipas nevojave të tyre . IV.Mbledhja dhe largimi i ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara; | | | | | | | |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | Kodi i Treguesit te Performances/Produktit | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit | |
| Objektivi 1.1 | O1. Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të shiut në të gjithë zonat urbane të Nj.A të bashkisë. | 1 | Të ardhurat e realizuara (në mijë lekë) nga tarifa e shërbimit të kanalizimeve | 48,113 | 99,070 | 59,549 | 54,014 | 91% |
| | | 2 | Të ardhurat e planifikuara (në mijë lekë) nga tarifa e shërbimit të kanalizimeve | 60,830 | 99,070 | 59,549 | 54,014 | 91% |
| | | 3 | Buxheti për shërbimin e menaxhimit të ujërave të zeza dhe kanalizimeve ne total i ndare : | 105,873 | 95,112 | 175,965 | 171,310 | 97% |
| | | 4 | Shpenzime operative kanalizime (në mijë lekë) | 52,674 | 63,725 | 144,578 | 144,578 | 100% |
| | | 5 | Shpenzime operative Impiantet e përpunimit (ne mijë lekë) | 53,199 | 31,387 | 31,387 | 26,732 | 85% |
| | | 6 | Sasia e ujit te shkarkuar ne sistemin e përpunimit të ujërave të ndoture m3 | 267,500 | 450,000 | 300,000 | 299,740 | 100% |
| | | 7 | Popullsia që mbulohet nga shërbimi i trajtimit të ujërave të zeza/ndotura | 51,200 | 51,200 | 51,200 | 51,200 | 100% |
| | | 8 | Popullsia me shërbime sanitare / kanalizimeve të ujërave të përdorura (zeza dhe bardha) | 96,727 | 100,137 | 109,869 | 109,869 | 100% |
| | | 9 | Popullsia në zonën e shërbimit | 213,217 | 210,182 | 214,270 | 214,270 | 100% |
| | | 10 | Buxheti për shërbimin e menaxhimit të kanalizimeve të ujërave të shiut | - | 15,000 | 15,000 | 15,000 | 100% |

ANEKSI nr.3 "Raporti përmblidhës i realizimit të treguesve të performancës/produnkteve të programit"

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 | | | | | | | | | | | | | Luhatjet në Koston për Njësi | | | | | |
|---------------|---|------------------------------------|---------------------------|--------------------------------|-----|------------------------------------|------------------------------------|---|---------|--|---|--|--------|---|---------------------------|--------------------------------|-----|-------------------------------------|------------|-------------|--------------|
| Programi | Furnizimi me ujë dhe kanalizime | Kodi i Programit | 6370 | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| në 000/lekë | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (viti 2023) | Shpenzimet Faktike (viti 2023) | I | Kosto për Njësi (sipas vitit 2023) | Sasia (sipas planit të vitit 2024) | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2024) | II | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2024) | Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2024) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2024) | III | Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar viti 2024) | Sasia Faktike (viti 2024) | Shpenzimet Faktike (viti 2024) | IV | Kosto për Njësi Faktike (viti 2024) | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III |
| 1 | Menaxhimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të shiut (KUB) | numër popullsie mbuluar me shërbim | 96,727 | 0 | 0.0 | 100,137 | 15,000 | 0.1 | 109,869 | 15,000 | 0.1 | 109,869 | 15,000 | 0.1 | 0.1 | 0.0 | 0.0 | | | | |

Për vitin 2024 në Programin “Furnizimi me ujë” në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, është parashikuar 1 aktivitet.

P06370.Q1.O1.A1. Menaxhimi i sistemit të ujërave të bardha (KUB). Ky aktivitet është realizuar.

| Produktet | Aktivite/Projekte | Institucioni | Statusi I aktivitetit | Plani fillestar 2024 | Plani I rishikuar 2024 | Realizimi 2024 |
|---|--|---------------------------------|-----------------------|----------------------|------------------------|----------------|
| | | | | Totali | Totali | Totali |
| Menaxhimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të shiut (KUB) (numër popullsisë me shërbime sanitare) | P06370.Q1.O1.A1. Menaxhimi i sistemit të ujërave të bardha (KUB) | Bashkia Shkodër | | 15,000 | - | - |
| | P06370.Q1.O1.A1. Menaxhimi i sistemit të ujërave të bardha (KUB) | Ndermarrja e Shërbimeve Publike | E përfunduar | - | 15,000 | 15,000 |
| Totali 6370 Furnizimi me uje dhe kanalizime | | | | 15,000 | 15,000 | 15,000 |
| Të trashëguara | | | | 25,272 | - | - |
| Totali | | | | 40,272 | 15,000 | 15,000 |

Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik është drejtori e krijuar për herë të parë në Bashkinë e Shkodrës në fillim të vitit 2016 dhe ristrukturuar në mars të vitit 2024 si Drejtoria e Përgjithshme Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik.

Vizioni i kësaj drejtorie është “Shërbime Sociale multisektoriale, të qëndrueshme dhe të standartizuara pranë komunitetit, në mbështetje dhe fuqizim të familjes si qeliza bazë e shoqërisë”.

Shërbimet me bazë komunitare, të cilat filluan të krijohen gjatë vitit 2016 janë të parat struktura operative në territorin e Bashkisë së Shkodrës. Qendrat Komunitare “Për Familjen” janë njësitë bazë të ngritura dhe që mbulojnë me shërbime sociale çdo lagje të qytetit dhe njësitë administrative. Aktualisht janë të ngritura dhe në funksion 13 qendra komunitare; 6 në zonën urbane dhe nga një në Njësitë Administrative të Gurit të Zi, të Dajçit, Velipojës, Postribës, Rrethinave dhe Shalës. Në këto qendra ofrohet informim, këshillim, orientim, mbrojtje e fëmijëve, shërbime për fëmijët dhe familjen, fuqizim ekonomik, programe prindërimi, fuqizim komuniteti, ri-integrim në shkollë dhe mbështetje familjare për nevojat arsimore të fëmijëve, etj.

Gjatë punës sonë përveç qendrave komunitare “Për Familjen” që ofrojnë shërbime sociale bazë në një territor të përcaktuar kemi arritur të ndërtojmë qendra që ofrojnë shërbime të specializuara për grupe dhe individë në nevojë të tilla si: qendra komunitare Multifunkionale në shërbim të fëmijëve dhe familjeve në situatë rruge; qendra Rinore Atelie, në shërbim të të rinjve; qendra komunitare “Për Familjen” nr. 6 me apartamente sociale për jetimët dhe familjet me njëkryefamiljar dhe fëmijë; qendra multifunkionale Ngjyrat, ku ofrohen disa shërbime si: kopsht dhe çerdhe, qendër shëndetësore për komunitetin e lagjes Nr.1, qendra multifunkionale Xixëllonjat me hapësira për qendër komunitare “Për Familjen”, qendër shëndetësore për lagjen, kopsht&çerdhe dhe zyrë administrative të bashkisë Shkodër, hapësira për të rinj, hapësira për të moshuar.

Në fushën e strehimit social, në zbatim të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar, gjatë vitit 2024, Bashkia Shkodër ka zbatuar disa nga programet e strehimit social, që kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet në nevojë për strehim. Në përmbushje të detyrimeve ligjore, Bashkia Shkodër ka përgatitur dhe miratuar në Këshill Bashkiak një paketë vendimesh, të cilat rregullojnë veprimtarinë e strukturës përgjegjëse dhe Komisionit të Strehimit pranë Bashkisë gjatë zbatimit të programeve të strehimit social. Gjatë këtij viti janë zbatuar disa programe të strehimit social (banesa sociale me qira pranë ish konviktit të pyjores, Subvencionimi i interesave të kredisë dhe subvencionimi i qirasë në tregun e lirë) për të cilat janë miratuar me vendim të këshillit bashkiak përfituesit. Gjithashtu janë zbatuar disa projekte që kanë si synim përmirësimin e kushteve të banimit për individë dhe familje në nevojë siç janë: Godinat sociale për komunitetin rom, Rikonstruksioni i godinës së ish konviktit të shkollës veterinare.

Bashkia Shkodër ka krijuar dhe vënë në funksion të plotë Qendrën Harmonia, e cila ofron shërbime të specializuara për spektrin e autizmit. Përgjatë kësaj periudhe kanë marrë shërbim rreth 20 fëmijë të diagnostikuar me spektrin e autizmit.

Duke u mbështetur në shërbimet e ekzistuese, eksperiencën e krijuar dhe nevojat sociale në komunitet, Bashkia e Shkodrës synon të mbështesë zhvillimin e integruar dhe të vazhdueshëm të mirëqenies sociale të familjes si qeliza bazë e komunitetit tonë të shtrirë në të gjithë territorin. Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave

Në ushtrim të detyrave funksionale në zbatim të ligjit 139 “Për vë tëqeverisjen vendore”, Ligjin 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve”, ligjit 9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar dhe aktet nënligjore përkatëse, Ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin Social”, i ndryshuar.

FUNKSIONI 7 : SHENDETESIA

Programi 07220 “ Shërbimet e kujdesit parësor ”

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik.

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit.

Qëllimi i programit të “Shërbimet e kujdesit parësor”.

Q1. Projektimi, përmirësimi i kushteve të qendrave shëndetësore parësore në territor dhe mirëadministrimi i infrastrukturës së ndërtuar.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre funksioneve për 12-mujorin e vitit 2024 kanë qenë:

O1. Mirëmbajtja e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

O2 Përmirësimi i shëndetit, cilësisë së jetës së komunitetit përmes zhvillimit të aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, edukimin e promocionin shëndetësor, parandalimin e sëmundjeve dhe shërbimet e tjera shëndetësore në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetësor.

O3. Përmirësimi i infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Me qëllim përmirësimin e shëndetit, cilësisë së jetës së komunitetit përgjatë të gjithë vitit organizohen aktiviteteve të edukimit e promocionit shëndetësor, si dhe merren masa për projektimin, përmirësimin e kushteve të qendrave shëndetësore parësore në territor dhe mirëadministrimin e infrastrukturës së ndërtuar.

Realizimi i Buxhetit të planifikuar

Programi: Shërbimet e kujdesit parësor.

| Programi | Shpenzime operative | 000/leke | |
|------------------------|---------------------|----------|--|
| 07220 | | Totali | |
| PBA 2024 | 2,000 | 2,000 | |
| Plani fillestar 2024 | 4,351 | 4,351 | |
| Plani i rishikuar 2024 | 4,000 | 4,000 | |
| Realizimi viti 2024 | - | - | |
| % e realizimit | 0.0% | 0.0% | |

Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është në total 0%, sipas zërave kryesorë më poshtë:

| | |
|--|-----------|
| Shpenzimet korrente (paga+sigurime shoqërore, shpenzime operative, transferime) | 0% |
| Shpenzimet kapitale | 0% |

Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara.

Proçedura e prokurimit është përfunduar, është lidh kontrata dhe është në fazë zbatimi.

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: viti 2024

| Kodi i Programit | 7220 | Emërtimi i programit: | Shërbimet e kujdesit parësor | | | | | |
|---------------------------|--|---|---|--------------------------------------|------------------------------------|---------------------------------------|---|------|
| Qellimi | Projektimi, përmirësimi i kushteve të qendrave shëndetësore parësore në territor dhe mirëadministrimi i infrastrukturës së ndërtuar. | | | | | | | |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | Kodi i Treguesit te Performances/Produktit | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit | |
| Objektivi 1.1 | Mirëmbajtja e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. | 1 | Nr. i qendrave shëndetësore funksionale. | 14 | 14 | 14 | 100% | |
| | | 2 | Nr. i qendrave shëndetësore të mirëmbajtura | 3 | 2 | 2 | 0% | |
| | | 3 | Numri i personave të shërbyer që marrin shërbim në këto qendra shëndetësore | 181,628 | 181,628 | 181,628 | 181,628 | 100% |
| Objektivi 1.2 | Përmirësimi i shëndetit, cilësisë së jetës së komunitetit përmes zhvillimit të aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, edukimin e promovimin shëndetësor, parandalimin e sëmundjeve dhe shërbimet e tjera shëndetësore në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetësor. | 4 | Nr. I Temave të zhvilluara. | 12 | 20 | 20 | 17 | 85% |
| | | 5 | Nr. i aktiviteteve informuese dhe promovuese për shëndetin. | 35 | 60 | 60 | 61 | 102% |
| | | 6 | Nr. i pjesëmarrësve në takime e aktivitete. | 602 | 1200 | 1200 | 1062 | 89% |
| | | 7 | Nr. i pjesëmarrësve në takime e aktivitete vajza/gra. | 414 | 800 | 800 | 639 | 80% |
| Objektivi 1.3 | OPërmirësimi i infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. | 8 | Nr. i qendrave shëndetësore të ndërtuara(të reja) dhe të rikonstruuaruara; | 1 | 0 | 0 | 0 | |

ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 | | | | | | | | | | | | | | | |
|---------------|---|----------------------|---------------------------|--------------------------------|------------------------------------|------------------------------------|---|--|---|--|---|---------------------------|--------------------------------|-------------------------------------|------------|-------------------------------------|--------------|--|
| Programi | Shërbimet e kujdesit parësor | Kodi i Programit | 7220 | | | | | | | | | | | | | | | |
| | në 000/lekë | | | | I | | | II | | | III | | | IV | | Luhatjet në Koston për Njësi | | |
| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (viti 2023) | Shpenzimet Faktike (viti 2023) | Kosto për Njësi (sipas vitit 2023) | Sasia (sipas planit të vitit 2024) | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2024) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2024) | Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2024) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2024) | Kosto per Njësi (sipas planit të rishikuar viti 2024) | Sasia Faktike (viti 2024) | Shpenzimet Faktike (viti 2024) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2024) | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III | |
| 1 | Qendra shëndetësore të mirëmbajtura | Numri i qendrave | 3 | 2,649 | 883.0 | 2 | 2,000 | 1,000.0 | 2 | 4,000 | 2,000.0 | | 0 | | | | | |
| 2 | Promovim dhe edukim për mbrojtjen e shëndetit | Numri I aktiviteteve | 35 | | 0.0 | 60 | 0 | 0.0 | 60 | 0 | | 61 | 0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | |
| 3 | Qendra shëndetësore të rikonstruara | Numri i qendrave | 1 | 0 | 0.0 | 0 | 0 | | 0 | 0 | | | 0 | | | | | |

Për vitin 2024 në Programin “Shërbimet e kujdesit parësor”, në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përbushjes së objektivave të përcaktuara, janë parashikuar 3 aktivitete.

| Produktet | Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi I aktivitetit | Plani fillestar 2024 | Plani I rishikuar 2024 | Realizimi i 2024 |
|--|--|--|--|----------------------|------------------------|------------------|
| | | | | Totali | Totali | Totali |
| Qendra shëndetësore të mirëmbajtura (në numër) | P07220.Q1.O1.A1 Përmirësimi i infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor | Drejt e përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike | E përcaktuar | 2,000 | 4,000 | - |
| Promovim dhe edukim për mbrojtjen e shëndetit (nr. aktiviteteve) | P07220.Q1.O2.A1 Informimi dhe promovimi për një komunitet më të shëndetshëm | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | - | - |
| Qendra shëndetësore të rikonstruara (në numër) | P07220.Q1.O3.A1 Rikonstruksioni I ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor | Bashkia Shkodër | Parashikuar për t'u zbatuar në kuadër të thirrjeve nga donatorët | - | - | - |
| 07220 Shërbimet e kujdesit parësor | | | | 2,000 | 4,000 | - |
| Te trashëguara | | | | 2,351 | - | - |
| Totali | | | | 4,351 | 4,000 | - |

P07220.Q1.O1.A1 Përmirësimi i infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor & të trashëguara.

Drejtorja e Përgjithshme Sociale dhe Rinisë pranë Bashkisë së Shkodrës, ndër detyrat funksionale ka përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat në nevojë, pjesë e së cilës është vlerësimi i kushteve infrastrukturore të qendrave shëndetësore, rristurimi i tyre, planifikimi dhe projektimi i ndërhyrjeve, me synim që të krijohen kushtet e përshtatshme për komunitetin për marrjen e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor. Bashkia e Shkodrës tashmë ka krijuar një database të qendrave shëndetësore parësore të gatshme, me të dhënat aktuale dhe nevojat për ndërhyrje. Pjesë e këtij database, i cili është në përditësim të vazhdueshëm, është projektimi dhe përmirësimi i kushteve të qendrave shëndetësore në territor. Janë organizuar disa takime me stafin e NJVKSH për të përcaktuar nevojat e territorit. Është punuar për hartimin e preventivave përkatës, është realizuar procedura e prokurimit, lidhur kontrata dhe aktualisht kanë filluar punimet. Aktualisht në bashkinë e Shkodrës janë 14 qendra shëndetësore funksionale, në të cilat marrin shërbim shëndetësor rreth 181,628 individë.

P07220.Q1.O2.A1 Informimi dhe promovimi për një komunitet më të shëndetshëm.

Shërbimi i shëndetit publik pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik ka organizuar një sërë takimesh informuese me synim përmirësimin e shëndetit dhe cilësisë së jetesës së komunitetit. Këto takime janë organizuar pranë qendrave komunitare “Për Familjen” dhe gjithashtu në shkollat 9 vjeçare dhe të mesme të bashkisë së Shkodrës. Temat e referuara janë në përputhje me kalendarin kombëtar të promovimit shëndetësor të miratuar nga Instituti i Shëndetit Publik dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Organizimi dhe zhvillimi i këtyre aktiviteteve është realizuar në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetësor dhe atij arsimor me moton “Së bashku për shëndetin tuaj”. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar tema të shëndetit, të cilat janë prezantuar në takime të organizuara në

qendrat komunitare “Për Familjen”, në qendrën rinore “Atelie”, në shkolla, në zonën urbane dhe në njësitë administrative Dajç, Gur i Zi, Postrinë, Ana e Malit, Rrethina dhe Bërdicë.

P07220.Q1.O3.A1 Rikonstruksioni i ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor

Drejtorja e Përgjithshme Sociale dhe Rinisë pranë Bashkisë së Shkodrës, ndër detyrat funksionale ka përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat në nevojë, pjesë e së cilës është vlerësimi i kushteve infrastrukturore të qendrave shëndetësore, ristrukturimi i tyre, planifikimi dhe projektimi i ndërhyrjeve, me synim që të krijohen kushtet e përshtatshme për komunitetin për marrjen e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor. Rikonstruksioni i ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor është parashikuar për t'u zbatuar në kuadër të thirrjeve nga donatorët.

FUNKSIONI8: ARGËTIMI, KULTURA DHE FEJA

Programi 08130: Sport dhe argëtim

Ky program përfshin institucionin:

- 1- Aparati i Bashkisë
- 2- Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

Qëllimi i programit Sport dhe argëtim është:

Ofrimi i shërbimeve specifike në lidhje me:

- I. Informimin dhe këshillimin për rininë për shërbimet lokale, edukim, për formim profesional, etj.
- II. Vlerësimin e nevojës për mbështetje të rinjve;
- III. Bashkëfinancim të aktiviteteve rinore;
- IV. Bashkërendim me sektorin e shërbimeve sociale, shëndetësore e të sportit për nxitjen e aktiviteteve më të rinj.

Pjesë e programit për rininë dhe sportet janë organizimi i përvitshëm i aktiviteteve sportive dhe zhvillimi i sportit në komunitet. Këto aktivitete zhvillojnë traditën ku të rinjtë dhe të rejtat e Shkodrës, shoqatat e klubit sportive nga vendi ose nga rajoni të garojnë në mes tyre.

Bashkia Shkoder, në zbatim të Ligjit 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar, mbështet zhvillimin e tij nëpërmjet projekteve sportive që shoqatat sportive kanë paraqitur e janë perzgjedhur nga bashkia për të përfaqësuar Vllazninë në kompeticionet sportive kombëtare dhe nderkombëtare.

Jane 15 disiplina sportive që mbështeten nëpërmjet 24 ekipeve sportive dhe 454 sportiste të përfshira në këto ekipe që kontribuojnë në zhvillimin e sportit në bashkinë tonë.


Objektivat e programit buxhetor për përbushjen e këtyre funksioneve për 12 mujorin e vitit 2024 kanë qenë :

O1. Të promovojmë dhe të nxisim pjesëmarrjen aktive të rinjve në aktivitete sportive dhe sociale, si aktorë thelbësorë në zhvillimin e territorit.

O2. Manaxhimi dhe mirëadministrimi i strukturave sportive dhe krijimi i infrastrukturës së pershtatshme dhe cilësore për të gjithë sportet.


Realizimi i buxhetit te planifikuar:

| Programi 08130 | Paga& sigurime | Shpenzime operative | Transferta | Investime | 000/leke Totali |
|------------------------|----------------|---------------------|------------|-----------|--------------------|
| PBA 2024 | 25,894 | 37,154 | 44,400 | 15,763 | 123,211 |
| Plani fillestar 2024 | 32,377 | 45,575 | 44,995 | 49,368 | 172,315 |
| Plani i rishikuar 2024 | 31,060 | 56,151 | 47,427 | 41,288 | 175,926 |
| Realizimi viti 2024 | 23,851 | 33,333 | 46,508 | 8,711 | 112,403 |
| % e realizimit | 76.8% | 59.4% | 98.1% | 21.1% | 63.9% |



Përqindja e realizimit të shpenzimeve totale është 63.9% e ndarë:

| | |
|--------------------|-------|
| Shpenzime korente | 77% |
| Shpenzime kapitale | 21.1% |



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:

Përsa i përket mbështetjes së financimit të zhvillimit të sportit në Bashkinë Shkodër, nëpërmjet mbështetjes së projekteve sportive të shoqatave të ndryshme sportive që funksionojnë në këtë bashki, janë ndeshur vështirësi në drejtim të kapaciteteve të këtyre shoqatave për të ndjekur konkretisht si nga ana sportive ashtu edhe financiare të projekteve të tyre. Kapacitetet e tyre kanë filluar të ndërtohen dhe duhet punë në drejtim të konsolidimit të tyre.

Mbështetja jonë si bashki ka qenë mjaft me vlerë, gjë që shprehet dhe në takimet tona të përbashkëta, por kërkohet më shumë trajnim për rritjen e kapaciteteve të tyre si shoqata.

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: viti 2024

| Kodi i Programit | 8130 | Emërtimi i programit: | Sport dhe Argetim | | | | | |
|---------------------------|--|---|--|--------------------------------------|------------------------------------|---------------------------------------|---|------|
| Qellimi 1 | Krijimi i infrastrukturës mbështetëse dhe bazës materiale për zhvillimin e proceseve stërvitore për të gjitha ekipet zinxhire të klubit shumësportësh “Vllaznia”. Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete sportive dhe zhvillimin e sportit në komunitet synojmë organizimin e përvitshëm të programit “Jeto me sportin”. | | | | | | | |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | Kodi i Treguesit te Performances/Produktit | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit | |
| Objektivi 1.1 | Të promovojmë dhe të nxisim pjesëmarrjen aktive të të rinjve në aktivitete sportive dhe sociale, si aktorë thelbësorë në zhvillimin e territorit. | 1 | Nr. Pjesëmarrësish në aktivitete sportive | 700 | 700 | 750 | 750 | 100% |
| | | 2 | Nr. Publikime sportive | 4 | 4 | 0 | 0 | |
| | | 3 | Struktura për veprimtari sportive | 3 | 3 | 3 | 3 | 100% |
| | | 4 | Administrimi dhe Mirëmbajtje e objekteve/terreneve sportive në pronësi të Bashkisë Shkodër në 000/lekë | - | 23,930 | 27,974 | 16,293 | 58% |
| | | 5 | Nr i ekipeve | 24 | 24 | 23 | 23 | 100% |
| | | 6 | Nr i të rinjve që merren me sportve në ekipet kombetare dhe nderkombetare | 454 | 454 | 500 | 500 | 100% |
| | | 7 | Nr i disiplinave sportive të mbështetura | 14 | 14 | 15 | 15 | 100% |
| Objektivi 1.2 | Menaxhimi dhe mirëadministrimi i strukturave sportive dhe krijimi i infrastrukturës së pershtatshme dhe cilësore për të gjithë sportet. | 8 | Buxheti për mbështetjen e ekipeve sportive në 000/leke | 0 | 50,700 | 44,000 | 43,505 | 99% |
| | | 9 | Numri i punonjësve drejtoria e sportit | 3 | 8 | 6 | 6 | 100% |

ANEKSI nr.3 "Raporti përmblledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 | | | | | | | | | | | | | | |
|---------------|---|---|---------------------------|--------------------------------|------------------------------------|------------------------------------|---|--|---|--|---|---------------------------|--------------------------------|-------------------------------------|-------------------------------------|-------------|--------------|
| Programi | Sport dhe argëtim | Kodi i Programit | 8130 | | | | | | | | | | | | | | |
| | në 000/lekë | | | | I | | | II | | | III | | | IV | Luhatjet në Koston për Njësi | | |
| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (viti 2023) | Shpenzimet Faktike (viti 2023) | Kosto për Njësi (sipas vitit 2023) | Sasia (sipas planit të vitit 2024) | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2024) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2024) | Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2024) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2024) | Kosto per Njësi (sipas planit të rishikuar viti 2024) | Sasia Faktike (viti 2024) | Shpenzimet Faktike (viti 2024) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2024) | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III |
| 1 | Sherbimi I stafit te Sportit dhe Argetimit(000) lekë | Numri I stafit te paguar | 37 | 19,755 | 533.9 | 31 | 25,894 | 835.3 | 29 | 32,785 | 1,130.5 | 29 | 25,362 | 874.6 | 340.6 | 39.3 | -256.0 |
| 2 | Disiplina te ndryshme sportive te mbeshetura (000) lekë | numri i strukturave në funksion të sportit. | 14 | 37,764 | 2,697.4 | 14 | 81,554 | 5,825.3 | 15 | 94,353 | 6,290.2 | 15 | 78,116 | 5,207.7 | 2,510.3 | -617.6 | -1,082.5 |
| 3 | Objekte sportive te ndertuara dhe te rikonstruktuar | Numri I objeteve te rikonstruktuar | 0 | 17,320 | 0.0 | 1 | 15,763 | 15,763 | 3 | 48,788 | 16,262.7 | 3 | 8,711 | 2,903.7 | 2,903.7 | -12,859.3 | -13,359.0 |

Realizimi i produkteve për periudhën 12-mujore 2024:

Në programin Rinia e Sportet, për periudhën 12 mujore 2024, eventet sportive dhe rinore në funksion të veprimitarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

| Produktet | Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi I aktivitetit | Plani fillestar 2024 | Plani I rishikuar 2024 | Realizimi 2024 |
|---|--|--|----------------------------|----------------------|------------------------|----------------|
| | | | | Totali | Totali | Totali |
| Sherbimi i stafit te Sportit dhe Argetimit (numri i stafit) | P08130.Q1.O1.A1. Paga dhe sigurime shoqerore per stafin administrates per aktivite sportive & te trasheguara | Bashkia Shkodër | Realizuar | 8,632 | 15,523 | 13,619 |
| | P08130.Q1.O1.A2. Paga dhe sigurime shoqerore per stafin permirembajtje te terreneve sportive | Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike | Listëpagesa të llogaritura | 17,262 | 17,262 | 11,957 |
| Disiplinat e ndryshme te sportive të mbeshтетura (numri i disiplinave te mbeshтетura) | P08130.Q1.O1.A3. Aktivite rinore dhe sportive & te trasheguara | Bashkia Shkodër | Realizuar | 1,357 | 2,372 | 2,038 |
| | P08130.Q1.O1.A4. Festivali i Shahut Cesk Jubani | Bashkia Shkodër | Realizuar | 60 | 60 | 60 |
| | P08130.Q1.O1.A5 Kupa Agim Tafili | Bashkia Shkodër | Realizuar | 420 | 360 | 344 |
| | P08130.Q1.O1.A6 Memorial Vllaznia Boks | Bashkia Shkodër | Realizuar | 400 | 400 | 394 |
| | P08130.Q1.O1.A7 Beach Volley | Bashkia Shkodër | Realizuar | 977 | 857 | 802 |
| | P08130.Q1.O1.A8 Triathlon | Bashkia Shkodër | Realizuar | 600 | 600 | 440 |
| | P08130.Q1.O1.A9 3x3Shkodra | Bashkia Shkodër | Realizuar | 1,410 | 1,210 | 1,068 |
| | P08130.Q1.O1.A10 Beach Soccer | Bashkia Shkodër | Realizuar | 900 | 780 | 744 |
| | P08130.Q1.O1.A11 Shkodra Indoor Tennis & te trasheguara | Bashkia Shkodër | Realizuar | 600 | 653 | 636 |
| | P08130.Q1.O1.A12. Shpenzime per mirembajtjen e funksionimin e terreneve sportive. | Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike | Realizuar pjesërisht | 23,930 | 27,974 | 16,293 |
| | P08130.Q1.O1.A12. Shpenzime per mirembajtjen e funksionimin e terreneve sportive te trasheguara | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 5,953 | 5,414 |
| | P08130.Q1.O1.A13 . Mbeshтетje per ekipet sportive Vllaznia. | Bashkia Shkodër | Pa Realizuar | 44,400 | 400 | - |
| | P08130.Q1.O1.A14 Shpërblim për rezultatet në arenën kombetare dhe ndërkombëtare për sportistët e trajnerët që përfaqësojnë ekipet e Shkodrës | Bashkia Shkodër | Realizuar pjesërisht | 6,500 | 6,500 | 4,420 |

| | | | | | | |
|--|--|-----------------|----------------------|---|-------|-------|
| | P08130.Q1.O1.A15 Shkodra Qyteti Evropian I Sportit 2025 | Bashkia Shkodër | Realizuar pjesërisht | - | 2,234 | 1,958 |
| | P08130.Q1.O1.A15. Mbështetje e ekipit të basketbollit femra te rritura & te reja | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 4,000 | 4,000 |
| | P08130.Q1.O1.A16. Mbështetje e ekipit të Basketbollit meshkuj të rritur dhe te rinj | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 6,000 | 6,000 |
| | P08130.Q1.O1.A17. Mbështetje e ekipit të voleibollit femra te rritura & te reja | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 4,200 | 4,200 |
| | P08130.Q1.O1.A18. Mbështetje e ekipit të voleibollit meshkuj te rritur & te rinj | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 6,000 | 5,522 |
| | P08130.Q1.O1.A19. Mbështetje e ekipit të atletikes | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 5,500 | 5,500 |
| | P08130.Q1.O1.A20. Mbështetje e ekipit të boksit femra | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 1,000 | 997 |
| | P08130.Q1.O1.A21. Mbështetje e ekipit të boksit meshkuj | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 4,700 | 4,700 |
| | P08130.Q1.O1.A22. Mbështetje e ekipit të ciklizmit | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 2,350 | 2,350 |
| | P08130.Q1.O1.A23. Mbështetje e ekipit të gjimnastikes | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 800 | 800 |
| | P08130.Q1.O1.A24. Mbështetje e ekipit të mundjes | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 800 | 795 |
| | P08130.Q1.O1.A25. Mbështetje e ekipit të notit | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 650 | 650 |
| | P08130.Q1.O1.A26. Mbështetje e ekipit të peshengritjes | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 800 | 792 |
| | P08130.Q1.O1.A27. Mbështetje e ekipit të ping pongut | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 650 | 650 |
| | P08130.Q1.O1.A28. Mbështetje e ekipit të shahut | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 650 | 650 |
| | P08130.Q1.O1.A29. Mbështetje e ekipit të xhudos | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 2,200 | 2,200 |
| | P08130.Q1.O1.A30. Mbështetje e ekipit të taekwondo | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 900 | 900 |
| | P08130.Q1.O1.A31. Mbështetje e ekipit të futsal | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 800 | 800 |
| | P08130.Q1.O1.A32. Mbështetje e ekipit të futbollit te femrave | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 2,000 | 2,000 |
| Objekte sportive te ndertuara dhe te rikonstruktura | P08130.Q1.O2.A1. Studim për ngritjen e një kompleksi olimpik & te trasheguara | Bashkia Shkodër | Pa realizuar | - | 3,000 | - |

| | | | | | |
|--|--|-----------------------------|----------------|----------------|----------------|
| P08130.Q1.O2.A2 Bashkëfinancim për projekte sportive | Bashkia Shkodër | Pa realizuar | 15,763 | - | - |
| P08130.Q1.O2.A3 Ndertim I ambienteve sportive shkolla "Deshmoret e Prishtine" (Jeto me sportin) | Bashkia Shkodër | Në proces. Mbartet për 2025 | - | 6,058 | 142 |
| P08130.Q1.O2.A4 Ndertim I ambienteve sportive shkolla "Preng Jakova" (Jeto me sportin) | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 2,502 | 2,399 |
| P08130.Q1.O2.A5 Ndertim I ambienteve sportive shkolla "Adem Haxhija" (Jeto me sportin) | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 6,372 | 6,170 |
| P08130.Q1.O2.A6 Fusha te pambuluara sportive, shkolla "Xheladin Fishta" | Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike | Kontrate e lidhur | - | 5,145 | - |
| P08130.Q1.O2.A7. Furnizim, vendosje dhe blerje materiale Pallati I Sportit | Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike | Kontrate e lidhur | - | 7,500 | - |
| P08130.Q1.O2.A8.Salle sportive -TE TRASHEGUARA | Bashkia Shkodër | Pa realizuar | - | 13,869 | - |
| P08130.Q1.O2.A9 Ndertim ambiente sportive -TE TRASHEGUARA | Bashkia Shkodër | Pa realizuar | - | 4,342 | - |
| 08130 Sport dhe argetim | | | 123,211 | 175,926 | 112,403 |
| Te trasheguara | | | 49,104 | - | - |
| Totali | | | 172,315 | 175,926 | 112,403 |

Përshkrimi i aktiviteteve:

P08130.Q1.O1.A1. Paga dhe sigurime shoqerore per stafin administrates per aktivitete sportive & te trasheguara

Janë realizuar pagat dhe sigurimet per stafin e drejtorise te sportit.

P08130.Q1.O1.A2. Paga dhe sigurime shoqerore per stafin permirembajtje te terreneve sportive

Jane realizuar pagat dhe sigurimet per stafin e drejtorise te pergjithshme te mirembajtjes te objekteve sportive.

P08130.Q1.O1.A3. Aktivitete rinore dhe sportive

Në kuadër të promovimit të sportit të atletikës dhe te percjelljes së vlerave të cilat ky sport mbart, kete vit u organizua për të herë të dytë Kupa e Ikonave në Atletikë ‘Gëzim Mema - Vildan Tufi’

Aktiviteti u zhvillua në stadiumin ‘Loro Boriçi’ në datën 20 Prill 2024, nga Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Shoqatën Sportive ‘Atletikë Vllaznia’ shoqatë e cila përfaqëson zyrtarisht ekipin e Vllaznisë në sportin e atletikës në aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe Federatën Shqiptare të Atletikës.

Kupa e Ikonave në Atletikë ‘Gëzim Mema - Vildan Tufi’ ishte miting i hapur për të gjithë, dhe morën pjesë rreth 50 sportistë dhe sportiste, të rinj dhe të reja. Pjesëmarrësit ishin edhe nga qytetet e tjera të

Shqipërisë si Korça, Durrësi, Tirana por edhe nga Kosova. U zhvilluan gara vrapimi dhe kërcimi në disiplinat 100m, 200m, 400m, 4x100m, 4x400m, kërcim se gjati, kërcim së gjati 3-hapësh, kërcim së larti, të gjitha disiplinat ishin në 2 kategori për meshkuj dhe femra.

Aktiviteti ishte i regjistruar në IAAF (Federata Ndërkombëtare e Atletikës) dhe sportistët në varësi të rezultateve, patën mundësi të fitojnë pike olimpike për rënditjen e tyre zyrtare.

Kupa e Ikonave në Atletikë ‘Gëzim Mema - Vildan Tufi’ u gjykua nga arbitrat zyrtar të FSHA (Federata Shqiptare e Atletikës) të specializuar për vrapime dhe kërcime.

Gjithashtu aktiviteti u përshendet nga përfaqësues të FSHA dhe personalitete të atletikës Shqiptare dhe Kosovare.

Në përfundim të aktivitetit u shpallën dhe fituesit dhe 2 sportistët më të mirë të aktivitetit të cilt ishin Franko Burraj dhe Erisa Rrasa të ekipit të Villaznisë.

Në kuadër të promovimit të sportit të atletikës kete vit u organizua për të herë të parë Speed Masters Athlritic (Kampionati Botëror për Veteranë).

Ky kampionat e mori iniciativën nga AMA Albanian Masters Athletes dhe u bë pjesë e aktiviteteve të mbeshetura nga EMA European Masters Athletes dhe u konceptua si një kampionat i hapur për të gjithë atletet nga të gjitha vendet e botes që përfaqësojnë Atletet Master duke u bërë Kampionati i Parë Botëror i këtij lloji. Keto dite Shkodra u vu në epiqendër të botes sportive të Atletëve Master. U bë një publicitet i jashtëzakonshëm për kete aktivitet. Faqet zyrtare të internetit të EMA European Masters Athletics <https://european-masters-athletics.org/>, Faqja zyrtare e Aktivitetit <https://speed-masters-athletics.com/> Rrjetet sociale etj.

Mbas përfundimit të regjistrimeve në datën 5 Maj 2024 ishin regjistruar rreth 520 atlete. Rreth 400 atlete kanë marrë pjesë nga 26 vende të ndryshme të botes. Nga data 5 Maj deri 20 Maj 2024 u përpunuan të dhënat dhe u bë gati infrastruktura e organizimit të aktivitetit.

Cilesia e zhvillimit të këtij kampionati ishte e standarteve Europiane. U krijuan Accreditation room, Call room, Ëarming area, Medal distribution area.

U vendosën shenimet e duhura në stadium që orientonin atletet (Dhomat e zhveshjes, Tualetet, Call room, Accreditation room, Ëarming Area etj)

Në vijim të aktiviteteve sportive rinore, Drejtoria e Sportit, në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Aeronautikës, organizoi edicionin e parë të garës të fluturimeve të lira ‘Shkodra Open’ më 06 dhjetor 2024. Ky aktivitet risi për qytetin e Shkodrës, tërhoqi 20 pjesëmarrës nga Shqipëria dhe rajoni. Konkurrentët ishin të moshave të ndryshme, nga 18 deri në 65 vjeç, që përfaqësonin Shqipërinë dhe Kosovën.

Gara e cila u zhvillua nën aprovimin dhe miratimin e Federatës Shqiptare të Aeronautikës duke qënë pjesë e kalendarit vjetor të garës së precizionit nën emrin “Shkodra Open 2024”, ishte mandatore për parashutistët dhe ekipet që të marrin pjesë.

Programi u realizua me sukses në datat 06 Dhjetor – 08 Dhjetor 2024, detajuar si më poshtë vijon:

1. Hapja e regjistrimeve
2. Regjistrimi në terren
3. Ceremonia hapëse
4. Briefing i përgjithshëm i sigurisë
5. Gara
6. Ceremonia mbyllëse

Gara e precizionit duke qënë një garë që zhvillohet në ambient të hapur, në Melgushë, Shkodër nëpërmjet një veje (parashutë), ky event i cili ishte i ndjeshëm ndaj kushteve atmosferike, moti rezultoi

i qëndrueshëm dhe në favor të eventit “Shkodra Open 2024”, duke realizuar 8 (tetë) raunde të plota, e cila përmbushi kriterin e plotë për këtë kompeticion të precizionit

Në vijim të aktiviteteve sportive rinore, Drejtorja e Sportit, në bashkëpunim me familjen Bakalli, organizoi edicionin e gjashtë të garës MTB XC ‘Trofeu Gilman Bakalli 2024’ më 27 tetor 2024. Ky aktivitet, tashmë i kthyer në traditë për qytetin e Shkodrës, tërhoqi 51 pjesëmarrës nga Shqipëria dhe rajoni. Konkurrentët ishin të moshave të ndryshme, nga 18 deri në 65 vjeç, që përfaqësonin Shqipërinë, Kosovën, Malin e Zi, Austrinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Gara ishte konceptuar për tre kategori të ndryshme: femra, meshkuj dhe veteranë (mix), dhe për çdo kategori u ndanë çmime simbolike për tre vendet e para. Këtë vit, itinerari filloi nga Ura e Mesit në Njësinë Administrative Postribë dhe përfundoi në fshatin Kuç në Njësinë Administrative Gur i Zi. Distanca totale e garës ishte 35 kilometra, me një disnivel ngjitje prej 465 metrash dhe zbritje prej 509 metrash.

P08130.Q1.O1.A4 : Festivali i shahut “Çesk Jubani”:

Në kuadër të promovimit të sportit të shahut dhe te percjelljes së vlerave të cilat ky sport mbart, kete vit u organizua për të 6-tin vit rradhazi **Festivali i Shahut “Çesk Jubani”**.

Aktiviteti u zhvillua në hollin e Bashkisë Shkodër në datat 1, 2 dhe 3 Mars 2024, në bashkëpunim me Qendrën Lulebora.

Festivali i Shahut “Çesk Jubani” ishte i hapur për të gjithë, dhe morën pjesë 50 lojtarë dhe lojtare, të rinj dhe të reja, veteran, amatorë dhe dashamirës të këtij sporti të cilët për 3 ditë u ndeshën për të zënë një vend mes më të mirëve. Pjesëmarrësit ishin edhe nga qytetet e tjera të Shqipërisë si Lezha, Durrësi, Tirana por edhe nga Ulqini e Tuzi.

Aktiviteti ishte i regjistruar në FIDE (Federata Internacionale e Shahut) dhe lojtarët në varësi të rezultateve, patën mundësi të fitojnë pikë për rënditjen e tyre në zyrtare. Si sistem loje u aplikua sistemi Bitz dhe Rapid (20 min + 5sec) dhe metodologjia e ndeshjeve ishte zyrtari Zviceran.

Festivali i Shahut “Çesk Jubani” u gjykua nga arbitri zyrtar profesioniste i FSHSH (Federata Shqiptare e Shahut) zj. Kismete Sykaj, gjithashtu u përshendet nga përfaqësuesit e Federatës Shqiptare të Shahut. Në përfundim të aktivitetit u shpallën dhe fituesit si mëposhtë:

Disiplina Rapid: Vende të para për meshkuj dhe femra - Sotir Pasko dhe Federika Deda

Disiplina Blitz: Vende të para për meshkuj dhe femra - Riza Bregu dhe Noemi Marku

P08130.Q1.O1.A5 Kupa "Agim Tafili"

Bashkia Shkodër në programin e saj ka parashikuar për vitin 2024 Aktivitetin Ndërkombëtar në Çiklizëm. Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Çiklizmit, organizoi për të dytin vit rradhazi turneun ‘Agim Tafili’ në datat 16 dhe 18 prill 2024. Morën pjesë 40 çiklistë në kategori dhe nga klube të ndryshme si Vllaznia, Tirana, Partizani, Teuta, Burreli, Elbasani, Besa, Apollonia, Flamurtari dhe Skenderbeu.

Fituesit e aktivitetit u shpallën si më poshte:

Date 16 Prill 2024

Etapa 1 me Itenerar Mamurras – Lezhe – Berdice – Torovice – Balldren – Shkoder me gjatesi 125 km e fituesit ishin per grupmoshen Junior Ankel Limaja i Ekipit Studenti ndersa per grupmoshen U23/Elite Blerton Nuhaj i Ekipit Kastrioti Ferizaj.

Ne date 17 Prill 2024

Etapa 2 me Itenerar Shkoder – Rraboshte – Fishte – Vau i Dejes 2 xhiro Cirkuit Finish Shkoder me gjatesi 135 km u fitua nga sportistet per grupmoshen Junior Ankel Limaja ndersa per kategorine U23/Elite u fitua nga Sportisti Henri Hysa i Ekipit Teuta.

Date 18 Prill 2024

Etapa e 3 me Itenerar Shkoder – Rrapsh starja – Shkoder me gjatesi 105 km u fitua nga sportistet per kategorine Junior Ankel Limaja i Ekipi Studenti ndersa per kategorine U23/Elite nga Sportisti i Tiranes Dzimitry Prudnikau

P08130.Q1.O1.A6. Memorial “Vllaznia”,boks

Bashkia Shkodër në kuadër të aktiviteteve vjetore si cdo vit ka organizuar turneun ndërkombëtar “Memorial Vllaznia 2024” në datat 7-9 Prill për disiplinën e boksit. Me datën 7 ishte mbërritja dhe akomodimi i pjesëmarrësve dhe në datën 8 ishte fillimi i aktivitetit. Ky aktivitet u zhvillua në nderim të boksierëve të cilët ngritën emrin e Vllaznisë në majat e boksit Shqiptar përgjatë viteve e sot nuk jetojnë më. Liman Kulla, Shyqyri Halili, Fadil Efovia, Ymer Gruda, Dervish Efovia, Ndoc Gjoni, Nazmi Halili, Kolec Ashiku, Lem Kosova, Shpresim Bregu, Kujtim Demi, Ramiz Halili e Fadil Zhega ishin figura të shquara të boksit shkodran. Shtetet si Bullgaria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi e Shqipëria ishin pjesëmarrëse në aktivitetin 3 ditor. Interesi ishte i lartë nga sportdashësit shkodran, por kishte edhe spektatorë të huaj nga vendet pjesëmarrëse.

Boksierët garuan në 6 pesha të ndryshme 57 kg, 63.5 kg, 71 kg, 80 kg, 86 kg dhe 92+ kg, ku dhe fituesit përkatës u shpallën:

Javier Diaz 57 kg (Bullgari) Edin Alkovic 63.5 kg (Mali i Zi) Rilind Murici 71 kg (Kosovë) Arjon Kajoshi 80 kg (Shqiperi) Milorad Puric 86 kg (Mali i Zi) Gelian Rajku 92+ kg (Shqiperi)

Gjithashtu u shpallën edhe boksierët më të mirë të turneut ku boksieri më teknik u shpall Javier Diaz i ekipit të Bullgarise dhe boksieri më i mirë Gelian Rajku i ekipit të Shqipërisë. Ndërsa Ekipi më i mirë i aktivitetit u shpall ekipi i Shqipërisë.

P08130.Q1.O1.A7. Beach Volley

Bashkia Shkodër me qëllim pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitete sportive dhe promovimin e territorit për sportin, ka planifikuar për vitin 2024 Shkodra Beach Volej në kuadër të aktiviteteve rinore verore.

Ky aktivitet u organizuar për të statin vit radhazi në Njesinë Administrative Velipojë në datat 26-27-28 korrik. Këtë vit moren pjesë 40 sportiste profesioniste, amator dhe sportiste elitare nga klube tendryshme të Shqipërisë si Vllaznia, Tirana, Partizani, Studenti por edhe nga Kosova e Mali i Zi

Në kategorinë e femrave u regjistruan 7 ekipe, ndërsa në kategorinë e meshkujve 14 ekipe.

Aktiviteti u gjykua nga gjyqtarë profesioniste të licencuar nga FSHV. Diten e parë të aktivitetit u zhilluan 10 ndeshje në dy fusha pasdite dhe kishte rreth 100 spektatore, ndërsa ditën e dytë dhe të tretë u zhvilluan 35 ndeshje të tjera. Në total numërohen 45 ndeshje meshkujsh dhe femrash dhe interesi i pushuesve ishte me i lartë duke numëruar kështu rreth 1200 spektatore. Në ditën e fundit u zhvillan finalët dhe ndeshja për vend të tretë ku nga këto fitues dolën:

Kategoria Femra

Deborah Keci - Xhudjena Kruti - Vendi i 1; Lyre Pireva - Melirona Avdullahu - Vendi i 2;

Andjela Josic - Katarina Simovski - Vendi i 3

Kategoria Meshkuj:

Ensar Zecic - Aleksandar Marojevic - Vendi i 1; Bledi Metani - Osman Qepa - Vendi i 2;

Ermal Maliqi - Ledion Martiro - Vendi i 3

P08130.Q1.O1.A8. Triathlon

Operatori mori përsipër realizimin e “Triathlon” dhe siguroi pjesëmarrjen e 100 sportistëve të kualifikuar. Subjekti printoi dy banera në përmasat 5 m*0.8 m, dhe i instaloi në buletin e aktiviteteve në Piacë (muri i Jubaneve) dhe një në Shirokë. Baneri ishte material rezistent ndaj agjentëve atmosferikë, i printuar në të dyja anët me ngjyra full color dhe kishte në përmbajtje njoftimin për aktivitetin dhe logot e organizatorëve.

U printuan 10 postera A2, në letër të paktën 100 g/m², full color sipas dizenjës të treguar nga i deleguari i Shoqatës. U printuan 100 numra të renditur nga numri një në 100, në letër me ngjyrë të bardhë dhe numrat me ngjyrë blu. Letra të paktën 300 gr/m², me shkëlqim, numrat të zënë të paktën 60% të

sipërfaqes. Operatori solli 100 bluza të masave S, M, L dhe XL, material pambuk me ngjyrë të bardhë të printuara me logon e aktivitetit. Operatori solli 100 çanta bezeje, të përmasave të paktën 35*35 cm, të printuara me logon e aktivitetit. U siguroa e gjithë infrastruktura e nevojshme për zhvillimin e garave. Operatori mori përsipër instalimin e dy bovave pluskuese me volum jo më të vogël se 60l në largësi 375 m nga bregu i liqenit në fund të korsisë së notit. Operatori mori përsipër instalimin një litari kufizues me gjatësi 500 m që do shërbejë si korsi noti për garuesit. Litari ishte material najloni me trashësi 20 mm, në të cilin janë instaluar tapa pluskuese çdo 5m. Operatori siguroi 6 kupa 25 cm të larta, me bazë drejtkëndore, të personalizuar dhe të realizuara në pirografi me mbishkrim për secilin fitues, me material metalik dhe bazën material druri. Subjekti ofroi 100 medalje metalike dhe lidhëse me material najlon, medaljet ishin të gdhendura në të dyja anët me logon e aktivitetit dhe datën e zhvillimit. Gjithashtu u vendosën në ujë 30 flamuj me ngjyra të ndryshme. Subjekti solli 100 kapuçë për notarët në material latex, të printuar me logon e aktivitetit në njërin anë dhe me numrat rendor nga njëshi në njëqind e njëzet në anën tjetër.

U siguroa shërbimi I fonisë dhe DJ gjatë gjithë kohës që u zhvillua aktiviteti. Shërbim zëri, Fonia me fuqi 3000 WAT line array, mikser për live 2 kanalesh, mikrofona statike 2 copë, mikrofona valore 1 copë dhe 4 bokse.

GPS për garuesit ishte në formën e lidhëses e cila u vendos në kyçin e këmbës (kavilje) me njëjtitëse të butë dhe me numër përkatës për garuesin. Qendra në të cilën resetohej çipi ishte e vendosshme në tokë, në formë drejtkëndore me material gome për mos të dëmtuar sportistët që kalojnë përsipër

P08130.Q1.O1.A9. 3x3Shkodra

Bashkia Shkodër më qëllim pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitete sportive dhe promovimin e territorit përmes sportit, ka planifikuar për vitin 2024 Shkodra 3x3Shkodra.

Ky aktivitet u organizuar për të dytin vit rradhazi në sheshin qëndror të Shirokës në datat 9-10-11 Gusht. Këtë vit morën pjesë 26 ekipe kombëtare dhe nga rajoni. Pjesëmarrja ishte e gjërë me ekipe nga Tirana, Durrësi, Elbasani, Mali i Zi, Kosova dhe Serbia.

Aktiviteti u gjykua nga gjyqtarë profesionistë të licencuar nga FSHB.

Ditën e parë të aktivitetit u zhvilluan 13 ndeshje dhe kishte rreth 100 spektatorë, ndërsa ditën e dytë dhe të tretë u zhvilluan 18 ndeshje të tjera dhe seritë e finaleve.

Në total numërohen 31 ndeshje dhe interesi i qytetarëve ishte shumë i lartë duke afruar shumë spektatorë dhe kalimtarë të rastit. Në ditën e fundit u zhvilluan finalet dhe ndeshjet për vend të tretë dhe të katërt ku nga kto fitues dolën Dangerous Meridian nga Mali i Zi:Marko Koljevic, Aleksandar Bogojevic, Bogdan Cebalovic, Aleksandar Bulatovic; Vend i dyte ekipi Grafomatex nga Mali i Zi: Matija Ilic, Lazar Bailovic, Vladimir Marljukic, Filip Dragojevic

P08130.Q1.O1.A10. Beach Soccer

Bashkia Shkodër më qëllim pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitete sportive dhe promovimin e territorit përmes sportit, ka planifikuar për vitin 2024 Beach Soccer në kuadër të aktiviteteve rinore verore.

Ky aktivitet u organizuar në Njësinë Administrative Velipojë në datat 23-24-25 korrik. Këtë vit morën pjesë 80 sportistë profesionistë, amator dhe sportistë elitari nga klube të ndryshme të qytetit të Shkodrës.

Aktiviteti u gjykua nga gjyqtarë profesionistë të licencuar nga FSHF.

Ditën e parë të aktivitetit u zhvilluan 4 ndeshje pasdite dhe kishte rreth 100 spektatorë, ndërsa ditën e dytë dhe të tretë u zhvilluan 3 ndeshje të tjera.

Në total numërohen 7 ndeshje meshkujsh dhe interesi i pushuesve ishte më i lartë duke numëruar kështu rreth 1200 spektatorë. Në ditën e fundit u zhvilluan finalet ku nga kto fitues doli ekipi Velipoja.

P08130.Q1.O1.A11. Shkodra Indoor Tennis

Në datat 6-8 Dhjetor 2024 ne Adriatic Tennis Park u organizua turneu Shkodra Indoor Tennis Pjesëmarrja ishte e larte ku ne total numerohen 50 tenistë pjesëmarrës. Pjesë e kalendarit zyrtar të garave të Federatës

Shqiptare të Tenisit dhe u gjykua nga gjyqtarë profesionistë të licesuar nga FSHT. Turneu është mbajtur për 3 kategori, 30+, 45+ dhe 55+. Kanë marrë pjesë 50 lojtar, përveç nga Shqipëria kanë marrë pjesë edhe nga Maqedonia e Veriut dhe Malit të Zi.

Lista e lojtarëve pjesëmarrës: 1 Arjan Bakalli 2 Genc Cakciri 3 Mario Çurçija 4 Mirsad Curri 5 Florian Dabulla 6 Redi Dabulla 7 Erarber Dervishi 8 Ermal Dragusha 9 Besmir Grishi 10 Visar GRuda 11 Loris Hanxhari 12 Dhimiter Jani 13 Sokol Jubica 14 Albi Karabashi 15 Vasillaq Kristo 16 Mildon Kumaraku 17 Serkiz Lumanaj 18 Gentian Mani 19 Gert Meta 20 Mervis Mici 21 Armend Milla 22 Ardit Paçrami 23 Valon Rexhepi 24 Arian Shanaj 25 Genajd Shypheja 26 Senad Tafa 27 Xhemal Fici 28 Rabin Velo 29 Gentian Tola 30 Atila Uligaj 31 Enkela Mezini 32 Elonia Gjata 33 Angela Karamano 34 Anisa Metalla 35 Sokol Agoviku 36 Ardit Bani 37 Denis Bashli 38 Rubin Bektashi 39 Tedi Beni 40 Andi Bilali 41 Elton Doma 42 Doruk Gurkan 43 Alban Hasani 44 Kliti Hoti 45 Redi Sata 46 Orges Xhelili 47 Agron Deari 48 Gezim Galiqi 49 Dritan Kruja 50 Paulin Ndoja
FITUESIT E TURNEUT Men's Singles 30+ Kampion: Genajd Shhypeja Finalist: Gert Meta Men's Singles 45+ Kampion: Tedi Beni Finalist: Elton Doma Men's Singles 55+ Kampion: Agron Deari Finalist: Paulin Ndoja

P08130.Q1.O1.A12. Shpenzime per mirembajtjen e funksionimin e terreneve sportive.

Jane realizuar pagesat per sherbimin e rojeve dhe sherbimet utilitare si uje, energji elektrike për stadiumin “Loro Borici”, pallatin e sportit “Qazim Dervishi” dhe fushen sportive “Reshit Rusi”.

Bashkia Shkoder, ne zbatim te ligjit per sportin, mbeshtet zhvillimin e tij nepermjet projekteve sportive qe shoqatat sportive kane paraqitur e jane perzgjedhur nga bashkia per te perfaqesuar Vllaznine ne kompeticionet sportive kombetare dhe nderkobetare.

Jane 14 disiplina sportive qe mbeshteten nepermjet 24 ekipeve sportive dhe 454 sportiste te perfshire ne keto ekipe qe kontribuojne ne zhvillimin e sportit ne bashkine tone

P08130.Q1.O1.A13 . Mbështetje per ekipet sportive Vllaznia perealizuar.

08130.Q1.O1.A14 Shpërblim për rezultatet në arenën kombetare dhe ndërkombëtare për sportistët e trajnerët që përfaqësojnë ekipet e Shkodrës

Me datat 16-17 mars 2024 u zhvillua Kampionati Kombetar nga Federata Shqiptare e Notit ne ambientet e pishines Stela. Ne kete aktivitet moren pjese 8 ekipe nga Shqiperia. Ekipi Shkodra Not perfaqesues zyrtare te Vllaznise u perfaqesua nga keto sportiste: Viki Tafrruku, Adriel Marku, Albi Bilali, Alkeo Isufi, Dean Vajushi, Matia Jubani, Era Gogaj, Kolë Rupa.

Notarja Viki Tafrruku ka arritur te shpallet Kampione Kombetare me te rriturit per stilin 50m shpine me trajner Kole Shiroka

Ekipi Vllaznia Taekwondo ka marre pjese me date 14 Prill 2024 ne Kampionatin Kombetar zhvilluar ne Tirane. Ky ekip ka arritur te shpalle Kampione Kombetare Enisa Shabaj pesha -53 kg, Irsa Osmanagiq pesha -67 kg, Nejla Uruci pesha +73 kg bashke me trajneren e tyre Neriman Puka.

Ne zbatim te Ligi 79/2017 “Per Sportin” i ndryshuar, VKM nr. 687 "Per kriteret, mënyren e sperblimit dhe perfitimin e trajtimit per pergatitjen sportive te sportisteve, qe perfitone statusin e nivelit te larte" i ndryshuar, keto sportiste perfitojne shperblimin si sportiste te nivelit te larte

P08130.Q1.O1.A15 Shkodra Qyteti Evropian I Sportit 2025

Në datat 23-28 Gusht 2024 delegacioni i ACES Europe ka vizituar qytetin e Shkodrës për të vlerësuar kandidaturën e Bashkisë Shkodër si Qyteti Evropian i Sportit 2025. Në këto data Bashkia Shkodër ka realizuar ardhjen dhe akomodimin e të delegacionit i cili ka vizituar impiantet sportive në kuadër të kandidaturës të titullit ‘Shkodra Qyteti Evropian i Sportit 2025’.

P08130.Q1.O1.A15 Mbështetje e ekipit të basketbollit femra të rritura.

Ekipi i të rriturve për femra i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë.

Arritjet ne kete 12 mujor jane:

1. Ekipi te rritura (Senior) – Vend i katërt në Kampionat Kombetar.

P08130.Q1.O1.A15 Mbështetje e ekipit të basketbollit femra të reja

Ekipi i basketbollit të të rinjve për femra “Vllaznia” përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajner.

Arritjet ne kete 12 mujor jane:

1-Ekipi te reja – Vend i dyte

P08130.Q1.O1.A16 Mbështetje të Ekipi i basketbollit meshkuj të rritur

Ekipi i Bashketbollit i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë.

Arritjet ne kete 12 mujor jane:

1. Ekipi te rritur (Senior) – Vend i dyte.

P08130.Q1.O1.A16 Mbështetje e ekipit të basketbollit meshkuj të rinj.

Ekipi i basketbollit të të rinjve i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajner.

Arritjet ne kete 12 mujor jane:

1. Ekipi te rinj – Vend i trete.

P08130.Q1.O1.A17 Mbështetje e ekipit të volejbollit femra të rritura.

Ekipi i volejbollit të të rriturve për femra përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë.

Arritjet ne kete 12 mujor jane:

1. Ekipi te rritura (Senior) – Vend i 4-rt Kampionat Kombetar.

P08130.Q1.O1.A17 Mbështetje e ekipit të Volejbollit femra të reja.

Ekipi i të rejave i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajner.

Arritjet ne kete 12 mujor jane:

1. Ekipi te reja – Finale te Kampionatit Kombetar,

P08130.Q1.O1.A18 Mbështetje e ekipit të volejbollit meshkuj të rritur.

Ekipi i të rritur i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë.

Arritjet ne kete 12 mujor jane:

1. Ekipi te rritur (Senior) – Vend i 4-rt Kampionat Kombetar.

P08130.Q1.O1.A18 Mbështetje e ekipit të Volejboll meshkuj të rinj.

Ekipi i të rinjve i volejbollit të meshkujve Vllaznia përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajner.

Arritjet ne kete 12 mujor jane:

1. Ekipi te rinj –Kampion Kombetar

P08130.Q1.O1.A19 Mbështetje e ekipit të Atletikës.

Ekipi i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 14 sportistë dhe 3 trajnerë.

Arritjet ne kete 12 mujor jane:

Kampion Kombetar dhe te Kupes se Shqiperise,.

P08130.Q1.O1.A20. Mbështetje e ekipit të boksit femra

Ekipi i bokist të femrave përbëhet nga 1 trajner dhe 2 sportiste.

Arritjet ne kete 12 mujor jane:

Kampion Kombetar

P08130.Q1.O1.A21 Mbështetje e ekipit të Boksit.

Ekipi i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 20 sportistë dhe 2 trajnerë.

Arritjet ne kete 12 mujor jane:

1. Kampion Kombetar

P08130.Q1.O1.A22 Mbështetje e ekipit të Çiklizëm.

Ekipi i ciklizmit të të rriturve të Vllaznise përbëhet nga 8 sportistë dhe 1 trajner.

Arritjet ne kete 12 mujor jane:

1.Ekipi te rritur (Senior) - Vend i 1-re Flavio Venomi (Kupa Agim Tafili)

Vend i 2-te Bruno Kola (Kupa Agim Tafili)

P08130.Q1.O1.A23 Mbështetje e ekipit të Gjymnastikës

Ekipi përbëhet nga 10 sportistë dhe 1 trajner.

Arritjet ne kete 12 mujor jane:

1. Stervitje dhe pregatitje per kompeticionet e kombetare.

P08130.Q1.O1.A24. Mbështetje e ekipit të mundjes

Ekipi përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajner.

Arritjet ne kete 12 mujor jane:

1. Vend i 3 ne kampionat kombëtar.

P08130.Q1.O1.A25 Mbështetje e ekipit të Notit

Ekipi përbëhet nga 7 sportistë dhe 1 trajner.

Arritjet ne kete 12 mujor jane:

2. Stervitje dhe pregatitje per kompeticionet e veres.

P08130.Q1.O1.A26. Mbështetje e ekipit të peshengritjes

Arritjet ne kete 12 mujor jane:

1. Vend i 3 ne kampionat kombëtar për të rinj.

P08130.Q1.O1.A27 Mbështetje e ekipit te Ping-pong:

Ekipi përbëhet nga 7 sportistë dhe 1 trajner.

Arritjet ne kete 12 mujor jane:

1. Stervitje dhe pregatitje per kompeticionet sipas kalendarit sportiv.

P08130.Q1.O1.A28 Mbështetje e ekipit te Shahut:

Ekipi përbëhet nga 10 sportistë dhe 1 trajner.

Arritjet ne kete 12 mujor jane:

1. Stervitje dhe pregatitje per kompeticionet sipas kalendarit sportiv.

P08130.Q1.O1.A29 Mbështetje e ekipit të Xhudos

Ekipi përbëhet nga 30 të rinj dhe të rritur dhe 1 trajner.

Arritjet ne kete 12 mujor jane:

1. Kampion Kombetar.

P08130.Q1.O1.A30 Mbështetje e ekipit të taekëondo

Ekipi përbëhet nga 30 të rinj dhe të rritur dhe 1 trajner.

Arritjet ne kete 12 mujor jane:

1. Kampion Kombetar me moshat

P08130.Q1.O1.A31 Mbështetje e ekipit të futsal

Ekipi përbëhet nga 13 të rinj dhe të rritur dhe 1 trajner.

Arritjet ne kete 12 mujor jane:

1. Vend i 2 ne kampionat kombëtar

P08130.Q1.O1.A32 Mbështetje e ekipit të futbollit të femrave

Ekipi përbëhet nga 22 të reja dhe të rritur dhe 1 trajner.

Arritjet ne kete 12 mujor jane:

1. Kampion Kombetar.

**P08130.Q1.O2.A1. Studim për ngritjen e një kompleksi olimpik & te trashguara Pa Realizuar
Bashkia Shkodër**

P08130.Q1.O2.A2 Bashkëfinancim për projekte sportiv është shpërndare në tre fishet realizuar nga Bashkia Shkodër:

P08130.Q1.O2.A3 Ndertim I ambienteve sportive shkolla " Deshmoret e Prishtine" (Jeto me sportin) Në proces, mbartet për vitin 2025.

P08130.Q1.O2.A4 Ndertim I ambienteve sportive shkolla "Preng Jakova " (Jeto me sportin) realizuar

P08130.Q1.O2.A5 Ndertim I ambienteve sportive shkolla " Adem Haxhija" (Jeto me sportin) realizuar

P08130.Q1.O2.A6 Fusha te pambuluara sportive, shkolla "Xheladin Fishta" Kontrate e lidhur Do të realizohet nga Drejtoria e pergjithshme e mirembajtjes te objekteve .

P08130.Q1.O2.A7. Furnizim, vendosje dhe blerje materiale Pallati I Sportit Kontrate e lidhur Do të realizohet nga Drejtoria e pergjithshme e mirembajtjes te objekteve .

P08130.Q1.O2.A8 Salle sportive -TE TRASHEGUARA Bashkia Shkodër pa realizuar .

P08130.Q1.O2.A9 Ndertim ambiente sportive -TE TRASHEGUARA pa realizuar.

Transferta e kushtëzuar:

| Aktiviteti | Institucioni | Statusi | Plan fillestar 2024 | Plan I rishikuar 2024 | Realizimi |
|---|-----------------|-----------|---------------------|-----------------------|-----------|
| P08130.Q1.O2.A3 Ndertim I ambienteve sportive shkolla " Deshmoret e Prishtine" (Jeto me sportin) | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 14,534 | 14,534 |
| P08130.Q1.O2.A4 Ndertim I ambienteve sportive shkolla "Preng Jakova " (Jeto me sportin) | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 8,737 | 8,737 |
| P08130.Q1.O2.A5 Ndertim I ambienteve sportive shkolla " Adem Haxhija" (Jeto me sportin) | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 19,983 | 19,983 |

Aktivitetet e transfertës së kushtëzuar janë realizuar.

Programi 08220: Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

- 1- Administrata e Bashkise
- 2- Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

Qëllimi i programit Shërbimet kulturore është:

- Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.
- Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar dhe lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.
- Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i bibliotekave dhe ambienteve për lexim me qëllimin e edukimit të përgjithshëm të qytetarëve.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre funksioneve për vitin 2024 kanë qenë:

O1: Vlerat e trashëgimisë kulturore të ruajtura dhe të promovuara si dhe institucione menaxhuese të mirëadministruara.

O2: Institucionet kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës të fuqizuara.


O3: Jetë kulturore të gjallëruar nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve artistike dhe kulturore përgjatë gjithë vitit.

O4: Shërbime cilësore pranë Bibliotekës “Marin Barleti” për promovimin dhe nxitjen e leximit si instrument edukimi.

O4: Fondi i bibliotekës “Marin Barleti” i mirëadministruar dhe i pasuruar.

Realizimi i buxhetit të planifikuar:

| Programi 08220 | Paga & sigurime | Shpenzime operative | Transferta | Investime | Totali |
|------------------------|-----------------|---------------------|------------|-----------|---------|
| PBA 2024 | 60,848 | 62,866 | 22,500 | 3,290 | 149,504 |
| Plani fillestar 2024 | 75,204 | 73,368 | 23,781 | 5,015 | 177,368 |
| Plani i rishikuar 2024 | 67,751 | 79,459 | 26,871 | 28,897 | 202,978 |
| Realizimi viti 2024 | 53,300 | 65,508 | 25,998 | 5,950 | 150,756 |
| % e realizimit | 78.7% | 82.4% | 96.8% | 20.6% | 74.3% |



Përqindja e realizimit të shpenzimeve është 74.3% e ndarë:

| | |
|--------------------|-------|
| Shpenzime korente | 83.2% |
| Shpenzime kapitale | 20.6% |



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:

Shumica e procedurave janë realizuar me sukses. Një ndër faktorët shumë pengues në realizimin e shpenzimeve operative dhe atyre të investimeve janë procedurat e prokurimit, zgjatja shumë në kohë deri në përfundimin dhe nënshkrimin e kontratave përkatëse.

Pjesa e porealizuar e shpenzimeve të mirembajtjes nga DPMOP nuk kanë përfunduar për efekt kohe të pamjaftueshme për procedure prokurimi, por janë në proces.

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: viti 2024

| Kodi i Programit | 8220 | Emertimi i programit: | Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore | | | | | |
|--|--|--|---|----------------------------------|--------------------------------------|------------------------------------|---------------------------------------|---|
| Qellimi 1 | Menaxhimi dhe administrimi i institucioneve kulturoro- artistike, asetëve të trashëgimisë kulturore, duke risjellur në vëmendjen e vizitorëve vlerat dhe pasuritë që disponohen, ndër më të pasurat në vendin tonë si në sektorit arkeologjik, etnografik, historik, te fotografise, muzikës, teatrit etj. Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të zonave të ndryshme të territorit të Bashkisë së Shkodrës. Zbulimin dhe zhvillimin e talenteve në fushën e artit, sportit, si dhe edukimi dhe përcimi i vlerave kulturore dhe sportive do te jete nje nga politikat e programit. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve. Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar dhe lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve. | | | | | | | |
| **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | | Kodi i Treguesit te Performances/Produktit | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit |
| Objektivi 1.1 | Ruajtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe mirëadministrimi e fuqizimi i institucioneve menaxhuese. | 1 | Nr. i shfaqjeve kulturore; artistike për trashëgiminë kulturore, të mbështetura me fondet e bashkisë | 17 | 17 | 17 | 17 | 100% |
| | | 2 | Numri i aktiviteteve rreth informimit dhe promovimit te trashëgimise kulturore ne komunitet. - Muzeu Oso Kuka | 7 | 7 | 7 | 8 | 114% |
| | | 3 | Nr. i aktiviteteve per promovimin e vlerave te Muzeut te Deshmise dhe Kujteses. | 8 | 8 | 8 | 5 | 63% |
| Objektivi 1.2 | Ruajtja, mirëadministrimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekës Marin Barleti | 4 | Nr. i fondit të librave të pasuruar | 1101 | 1200 | 1200 | 1574 | 131% |
| | | 5 | Numri i anëtareve të regjistruar në Bibliotekë | 1515 | 2000 | 2000 | 1900 | 95% |
| | | 6 | Nr. i shkrimtarëve të ftuar në takimet tematike letrare | 8 | 8 | 35 | 35 | 100% |
| | | 7 | Nr. i të rinjve pjesmarres në takimet tematike letrare | 420 | 420 | 950 | 1500 | 158% |
| Objektivi 1.3 | Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës, Përmiresimi i mjediseve për zhvillimin e aktiviteteve artistike, rikonstuksione të ambjenteve ndihmëse në institucionet e ndryshme të kulturës. | 11 | Numri i shfaqjeve te bandes | 16 | 16 | 16 | 13 | 81% |
| | | 12 | Numri i aktiviteteve kulturore | 136 | 132 | 147 | 147 | 100% |
| | | 13 | Nr i ekspozitave te perbashketa, personale, dhe numri i workshopeve | 8 | 8 | 8 | 8 | 100% |
| | | 14 | Takime publike për promovimin e trashëgimisë kulturore dhe promovimin e artistëve të rinj. | 8 | 8 | 8 | 7 | 88% |

ANEKSI nr.3 "Raporti përmblidhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 | | | | | | | | | | | | | | |
|---------------|---|---|---------------------------|---------------------------------|------------------------------------|------------------------------------|--|--|--|--|--|---------------------------|---------------------------------|-------------------------------------|------------------------------|-------------|--------------|
| Programi | Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore | Kodi i Programit | 8220 | | | | | | | | | | | | | | |
| | në 000/lekë | | | | I | | | II | | | III | | | IV | Luhatjet në Koston për Njësi | | |
| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (viti 2023) | Shpenzi met Faktike (viti 2023) | Kosto për Njësi (sipas vitit 2023) | Sasia (sipas planit të vitit 2024) | Shpenzi met (sipas planit të vitit 2024) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2024) | Sasia (sipas planit të rishikuar vitit 2024) | Shpenzi met (sipas planit të rishikuar vitit 2024) | Kosto per Njësi (sipas planit të rishikuar vitit 2024) | Sasia Faktike (viti 2024) | Shpenzi met Faktike (viti 2024) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2024) | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III |
| 1 | Sherbimi I stafit te trashëgimise kulturore muzeve dhe bibliotekave. | Nr i punonjesve te trashëgimise kulturore | 31 | 23,420 | 755.5 | 31 | 20,609 | 664.8 | 31 | 25,713 | 829.5 | 31 | 23,230 | 749.4 | -6.1 | 84.5 | -80.1 |
| 2 | Objekte te trashëgimise kulturore te mirembajtura. | Nr I objekteve te trashëgimise kulturore | 3 | | 0.0 | 3 | 4,460 | 1,486.7 | 3 | 7,076 | 2,358.7 | 3 | 2,038 | 679.3 | 679.3 | -807.3 | -1,679.3 |
| 3 | Promovimi i trashëgimise kulturore | Nr I aktiviteteteve te muzeve | 47 | 951 | 20.2 | 47 | 2,312 | 49.2 | 47 | 4,624 | 98.4 | 45 | 3,651 | 81.1 | 60.9 | 31.9 | -17.2 |
| 4 | Funksionimi i bibliotekes. | Nr I librave te rinj | 1,100 | 1,147 | 1.0 | 1,200 | 1,200 | 1.0 | 1,200 | 1,215 | 1.0 | 1,574 | 996 | 0.6 | -0.4 | -0.4 | -0.4 |
| 5 | Sherbimet e stafit te Artit e Kultures. | nr I punonjesve te artit e kultures | 46 | 37,327 | 811.5 | 46 | 40,239 | 874.8 | 46 | 47,609 | 1,035.0 | 46 | 34,963 | 760.1 | -51.4 | -114.7 | -274.9 |
| 6 | Objekte te veprimtarise kulturore dhe artistike te mirembajtura dhe funksionale | Nr I objekteve te veprimtarise kulturore | 2 | 36,717 | 18,358.5 | 2 | 71,384 | 35,692.0 | 2 | 80,320 | 40,160.0 | 2 | 72,986 | 36,493.0 | 18,134.5 | 801.0 | -3,667.0 |
| 7 | Shfaqje Teatri | nr I shfaqjeve nga Teatri | 155 | 8,860 | 57.2 | 160 | 8,800 | 55.0 | 160 | 35,921 | 224.5 | 160 | 12,709 | 79.4 | 22.3 | 24.4 | -145.1 |
| 8 | Shfaqje kinemaje | nr I kinemave | 1 | 0 | 0.0 | 1 | 500 | 500.0 | 1 | 500 | 500.0 | 1 | 183 | 183.0 | 183.0 | -317.0 | -317.0 |

Realizimi i produkteve për periudhën 12 mujore 2024:

Për vitin 2024, në programin Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore, në funksion të veprimtarisë kryesore dhe për permbushjen e objektivave të caktuara, janë parashikuar aktivitetet si më poshtë:

| Produktet | Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi I aktiviteti | Plani fillestar 2024 | Plani I rishikuar 2024 | Realizimi 2024 |
|---|--|--|----------------------|----------------------|------------------------|----------------|
| | | | | Totali | Totali | Totali |
| Sherbimet e stafit të trashëgimise kulturore, muzeve, bibliotekave. (Nr i punonjesve të trashëgimise kulturore) | P08220.Q1.O1.A1 Administrimi dhe menaxhimi i Degës ekonomike të kulturës (Muze+biblioteka+galeria +Adm DEK) | DEK | Realizuar | 2,513 | 7,450 | 7,450 |
| | P08220.Q1.O1.A2 Administrimi dhe menaxhimi i Degës ekonomike të kulturës (Muze+biblioteka+galeria) | Bashkia Shkodër | Realizuar | 18,096 | 18,263 | 15,780 |
| Objekte të trashëgimise kulturore të mirembajtura. (Nr I objekteve të trashëgimise kulturore) | P08220.Q1.O1.A3 Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve të trashëgimise kulturore | Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike | Realizuar | 3,440 | 4,090 | 1,416 |
| | P08220.Q1.O1.A4 Shpenzime për funksionimin e objekteve të trashëgimise kulturore | Bashkia Shkodër | Realizuar | 1,020 | 1,136 | 622 |
| Promovimi i trashëgimise kulturore (Nr I aktiviteteteve të muzeve) | P08220.Q1.O1 .A5 "Aktivitete protokollare | Bashkia Shkodër | Realizuar | 92 | 92 | 62 |
| | P08220.Q1.O1 .A6 Realizimi I aktiviteteteve të trashëgimise kulturore. | Bashkia Shkodër | Realizuar | 490 | 1,710 | 1,503 |
| | P08220.Q1.O1.A7 Mbështetje për funksionimin dhe shëbimin në vazhdimësi të muzeut historik. | Bashkia Shkodër | Realizuar | 1,250 | 1,342 | 606 |
| | P08220.Q1.O1 .A8 Shpenzime promocionale të aktiviteve kulturore | Bashkia Shkodër | Realizuar | 480 | 480 | 480 |
| Funksionimi i bibliotekes. (Nr I librave të rinj) | P08220.Q1.O2.A1 Zhvillimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekës | Bashkia Shkodër | Realizuar | 1,200 | 1,215 | 996 |
| Sherbimet e stafit të Artit dhe Kultures. (nr I punonjesve të artit e kultures) | P08220.Q1.O3.A1 Paga dhe sigurime të personelit të Teatrit "Migjeni" | Teatri Migjeni | Realizuar | 3,128 | 8,113 | 8,112 |
| | P08220.Q1.O3.A2 Paga dhe sigurime të personelit të Teatrit "Migjeni" dhe Kinemaja | Bashkia Shkodër | Realizuar | 26,325 | 28,081 | 18,859 |
| | P08220.Q1.O3.A3 Paga dhe sigurime të personelit të drejtorise se kultures. | Bashkia Shkoder | Realizuar | 5,495 | 5,495 | 4,508 |

| | | | | | | |
|--|--|---|-----------------|-----------|--------|--------|
| | P08220.Q1.O3.A4 Paga dhe sigurime te personelit te Qendres Kulturore "Pjeter Gaci" | DEK | Realizuar | 584 | 584 | 584 |
| | P08220.Q1.O3.A5 Paga dhe sigurime te personelit te Qendres Kulturore "Pjeter Gaci" | Bashkia Shkoder | Realizuar | 4,707 | 5,336 | 2,900 |
| Objekte te veprimtarise kulturore dhe artistike te mirembajtura dhe funksionale (Nr I objekteve te veprimtarise kulturore) | P08220.Q1.O3.A6 Shpenzime per mirembajtjen e plote te Teatrit Migjeni | Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike | Realizuar | 2,141 | 2,141 | 777 |
| | P08220.Q1.O3.A7 Shpenzime per mirefunksionimitt e plote te Teatrit Migjeni | Bashkia | Realizuar | 2,780 | 2,780 | 1,358 |
| | P08220.Q1.O3.A8 Shpenzime per mirembajtjen dhe sigurimin e funksionimitt e plote te Qendres Kulturore "P.Gaci" dhe Qendra Atelie | Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike | Realizuar | 685 | 685 | 100 |
| | P08220.Q1.O3.A9 Shpenzime sigurimin e funksionimitt e plote te Qendres Kulturore "P.Gaci" dhe Qendra Atelie | Bashkia Shkodër | Realizuar | 1,865 | 1,865 | 741 |
| | P10430.Q1.O3.A10. Qendra Rinore "Atelie" | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | - | - |
| | P08220.Q1.O3.A11 Orkestra Frymore Honorare vjetore | Bashkia Shkodër | Realizuar | 7,139 | 7,139 | 7,042 |
| | P08220.Q1.O3.A12 Aktivitete te realizuara nga Qendra Kulturore "Pjeter Gaci" | Bashkia Shkodër | Realizuar | 2,924 | 2,924 | 2,446 |
| | P08220.Q1.O3.A13 "Honorare " Grupi i Valleve" | Bashkia Shkodër | Realizuar | 960 | 960 | 960 |
| | P08220.Q1.O3.A14 Festivali i Këngës "Luleborë". | Bashkia Shkodër | Realizuar | 4,530 | 4,530 | 4,290 |
| | P08220.Q1.O3.A15 Realizimi i aktiviteteve te organizuara nga Drejtoria e Kultures | Bashkia Shkodër | Realizuar | 17,500 | 25,180 | 24,938 |
| | P08220.Q1.O3.A16 Ndërmendje | Bashkia Shkodër | Realizuar | 2,000 | 2,000 | 2,000 |
| | P08220.Q1.O3.A17 Karnavalet | Bashkia Shkodër | Realizuar | 3,000 | 1,480 | 1,480 |
| | P08220.Q1.O3.A18 Festivali Mbarekombetar i Humorit ne Shkoder | Bashkia Shkodër | Realizuar | 4,000 | 4,000 | 3,959 |
| | Shfaqje kulturore (nr I shfaqjeve nga Teatri) ose Numri I shfaqjeve kulturore | P08220.Q1.O3.A19 Realizim I aktiviteteve te Teatrit Migjeni | Bashkia Shkoder | Realizuar | 8,800 | 9,171 |
| Objekte te veprimtarise kulturore dhe artistike te | P08220.Q1.O3.A20 Realizimi I aktiviteteve t e Galerise se Arteve | Bashkia Shkoder | Realizuar | 1,380 | 1,380 | 1,024 |

| | | | | | | |
|---|---|--|----------------------|--------|--------|--------|
| mirembajtura dhe funksionale (Nr I objekteve te veprimtarise kulturore) | P08220.Q1.O3.A21 Orkestra Simfonike | Bashkia Shkodër | Realizuar | 13,300 | 13,300 | 13,300 |
| | P08220.Q1.O3.A22 Aktivitete ne partneritet me te trete | Bashkia Shkodër | Realizuar | 4,800 | 2,920 | 2,920 |
| | P08220.Q1.O3.A23 Honorare Këshilli Arstistik I Bashkisë Shkodër & të trashguara | Bashkia Shkodër | Realizuar | 200 | 232 | 212 |
| | P08220.Q1.O3.A24 Sherbime fonie,skene dhe ndricimi per aktivitetet e kultures | Bashkia Shkodër | Realizuar | 2,180 | 4,680 | 3,315 |
| Shfaqje kinemaje.(numer i shfaqjeve | P08220.Q1.O3.A25 Shpenzime per mirembajtjen e funksionimin e kinemase publike. | Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike | Realizuar pjeserisht | 500 | 500 | 183 |
| Shfaqje kulturore (nr I shfaqjeve nga Teatri) ose Numri I shfaqjeve kulturore | P08220.Q1.O3.A26 Blerje paisje fonie, ndricimi dhe materiale skenike per Teater Migjeni | Bashkia Shkoder | Realizuar | - | 6,000 | 5,941 |
| | P08220.Q1.O3.A27 Instalimi I sistemit te ngrohjes dhe ftohjes Teatri Migjeni | DPMOP | - | - | - | - |
| | P08220.Q1.O3.A27 Instalimi I sistemit te kondicinimit Teatri Migjeni | Bashkia Shkoder | Ne proces prokurimi | - | 20,000 | - |
| | P08220.Q1.O3.A37 Cmimi "Pjeter Gaci" te trashguara | Bashkia Shkoder | Pa Realizuar | - | 292 | - |
| Promovimi i vlerave të trashëgimise kulturore (numër i aktiviteve të muzeve) | P08220.Q1.O1 .A1 "Java e Pavarësisë dhe e Çlirimit" Ekspozitë me karakter historik dhe artistik te trashguara | DEK | Realizuar | - | 1,000 | 1,000 |
| Objekte te veprimtarise kulturore dhe artistike te mirembajtura dhe funksionale(numer i shfaqjeve) | P08220.Q1.O3.A37 Aktivitete artistike kulturore ne mbeshtetje te grupeve rinore artistike te trashguara | Bashkia Shkoder | Pa Realizuar | - | 350 | - |
| | P08220.Q1.O3.A44 "Shkodra qyteti i festave" te trashguara | Bashkia Shkoder | Pa Realizuar | - | 1,500 | - |
| Shfaqje kulturore (nr I shfaqjeve nga Teatri) ose Numri I shfaqjeve kulturore | P08220.Q1.O3.A23 Pjesë Teatrorë 2 & te trashguara | Teatri Migjeni | Realizuar | - | 458 | 458 |
| Objekte te veprimtarise kulturore dhe artistike te mirembajtura dhe funksionale(numer i shfaqjeve) | P08220.Q1.O2.A3 Periodiku Gegnia te trashguara | DEK | Realizuar | - | 110 | 110 |
| | P08220.Q1.O3.A2 Administrimi dhe Menaxhimi i Qendres Kulturore "Pjeter Gaci" & te trashguara | DEK | Realizuar | - | 672 | 672 |
| Aktivitete kulturore artistike përgjatë gjithë vitit në | P08220.Q1.O3.A3 Orkestra Frymore | DEK | Realizuar | - | 82 | 82 |

| | | | | | | |
|---|---|-----|-----------|----------------|----------------|----------------|
| Bashkinë Shkodër (numri i aktiviteteve kulturore) | Honorare vjetore te trashguara | | | | | |
| | P08220.Q1.O3.A7 "Honorare " Grupi i Valleve" te trashguara | DEK | Realizuar | - | 52 | 52 |
| | P08220.Q1.O3.A8 Festivali i Këngës Qytetare "Luleborë"te trashguara | DEK | Realizuar | - | 618 | 618 |
| | P08220.Q1.O3.A11 Festival burimor te trashguara | DEK | Realizuar | - | 30 | 30 |
| | P08220.Q1.O3.A30 Ekspozita "Salloni i vjeshtës "te trashguara | DEK | Realizuar | - | 13 | 13 |
| | P08220.Q1.O3.A35 Orkestra Simfonike te trashguara | DEK | Realizuar | - | 115 | 115 |
| | P08220.Q1.O3.A36 Takim nderkombetar I bandave frymore te trashguara | DEK | Realizuar | - | 432 | 432 |
| 8220 Trashëgimia kulturore, monumentet, kopshtet zoologjike e botanike dhe bibliotekat | | | | 149,504 | 202,978 | 150,756 |
| Te trashguara | | | | 27,864 | - | - |
| Totali | | | | 177,368 | 202,978 | 150,756 |

Përshkrimi i aktiviteteve:

P08220.Q1.O1.A1 Administrimi dhe menaxhimi i Degës ekonomike të kulturës

Janë realizuar pagesat për pagat e personelit dhe pagesat e sigurimeve shoqërore për periudhen Janar-Shkurt 2024 .Jane paguar pagat për 35 punonjës nga Dega Ekonomike e Kultures deri ne shkrirjen e institucionit per Muzeun Historik , Biblioteken , Galerine e Artve e dhe Sektorin e Finances.

P08220.Q1.O1.A2 Administrimi dhe menaxhimi i Degës ekonomike të kulturës

Janë realizuar pagesat për pagat e personelit dhe pagesat e sigurimeve shoqërore për periudhen Mars-Dhjetor 2024. Jane paguar pagat nga Bashkia Shkoder per Muzeun Historik dhe Biblioteken , Galerine e Artve.

P08220.Q1.O1.A3 Shpenzime për mirëmbajtjen e Objekteve të trashëgimisë kulturore

Janë realizuar pagesat për shërbime nga të tretë nga Drejtoria e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike per Materiale pastrimi /sanitare, Shërbim nga të tretë (Energji, ujë, postë),Shërbim Interneti , Siguracion ndërtese , Rimbushje Fikse Zjarri.

P08220.Q1.O1.A4 Shpenzime per funksionimin e objekteve te trashëgimise kulturore

Jane realizuar procedurat per blerjen e Paisjeve TIK dhe Materiale Kancelarie ,shpenzimet jane realizuar nga Bashkia Shkoder .

P08220.Q1.O1 .A5 "Aktivitete protokollare" Aktivitete me rastin e 2 Prillit

Aktivitete me rastin e 2 Prillit - "2 Prilli" është ngjarje e cila shënoi një ndër revoltat më të mëdha në vend duke i dhënë fund komunizmit në Shqipëri. Në kuadër të ditës përkujtimore të "2 Prillit" në sheshin që mban edhe emrin e kësaj revolte, u organizua ceremonia e vendosjes së kurorave në ndërim të dëshmorëve të demkoracisë. Shoqëroi homazhet Orkestra Frymore e Bashkisë Shkodër.

"5 Maj" Dita e Dëshmorëve është dita që përkujtohen të rënët e Shqipërisë. Kjo datë është shumë e rëndësishme për shqiptarët, pasi në këtë datë kujtohen dhe nderohen trimat që luftuan për Shqipërinë e lirë. Në kuadër të ditës përkujtimore të "5 Maj" u organizua ceremonia e vendosjes së kurorave tek Varrezat e Dëshmorëve në shenjë ndërimi . Shoqëroi homazhet Orkestra Frymore e Bashkisë Shkodër. Lëvizja e Postribës – Aktivitetet përkujtimor ku përkujtohet kryengrita e parë antikomuniste shqiptare e vitit 1946. Bashkia Shkodër kishte organizuar ceremonine e vendosjes së kurorave në ndërim të dëshmorëve ku shoqëroi orkestra frymore e qytetit.

28-29 Nëntor , Dita e Pavarësisë dhe e Çlirimit, Bashkia Shkodër realizoi ceremonialin e ngritjes së flamurit dhe vendosjen e kurorave tek vorrezat e dëshmorëve.

P08220.Q1.O1.A6 "Realizimi i aktiviteteve te institucioneve te trashegimise kulturore"

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Muzeve, Bashkia Shkodër në bashkëpunim me institucionet e kulturës dhe partnere të tretë , me datat 17 dhe 18 maj kanë zhvilluar një serë aktivitete për qytetarët. Muzeu "Oso Kuka" me datën 17 Maj organizoi ëorkshop dhe ekspozitë mbi xhubletën e titulluar "Dijebërja e xhubletë". Ekspozimi i xhubletës dhe i aksesorëve te saj u shpjegua nga dijebërësja znj File Kola si dhe argjendari Diomen Borici. Aktiviteti vazhdoi me nje kolazh këngësh shkodrane përgatitur nga nxënësit e shkollës "Prenkë Jakova" nën kujdesin e Prof Prek Mrishaj dhe Prof Lukë Mllugja.

Edhe poezia ishte pjesë e kësaj dite, me pjesëmarrjen e aktorëve Merita Smaja dhe Vladimir Doda të cilët përformuan për publikun, të shoqëruar në piano nga maestro Markelian Kapidani.

Muzeu i Dëshmisë dhe Kujtesës me datë 17 Maj organizoi ëorkshop: "Komunizmi përmes dokumentave arkivore". Nxënësit pjesëmarrës patën mundësi të njihen me metodologjinë e kërkimit në arkiva, nëpërmjet botimeve ndihmëse të realizuara nga IDMC-Instituti për Demokraci, Media & Kulturë. Ata prezantuan dhe disa punime të tyre kërkimore të realizuara nën orientimin e mësueses së tyre dhe stafit të muzeut. Instalacion artistik "Zërat e Kujtesës" , me dëshmi të personave që kanë vuajtur nga sistemi, u risollën të lexuara nga aktorët e teatrit Migjeni dhe jovetëm.

Galeria e Arteve: Me datë 17 maj u hap ekspozita "Penelata e Arkitekteve" tek salla e vogel e Galerisë. Me pjesëmarrjen e arkitektëve Maksim Mitrojorgji, Valentin Voshtina, Zef Çuni, Pirro Stefa dhe Olasi

Plasa, sollën në galeri anën romantike të artistave por edhe peisazhe urbane nga Shkodra e viteve 60-80.

Teatri "Migjeni" Me datë 17 maj organizoi ekspozitë me dokumenta, materiale të arkivës të premierës së parë të teatrit të vitit 1950 dhe shfaqjes së parë të Estradës së vitit 1958 si dhe rekuizitën e shfaqjeve ndër vite, duke përfshirë garderobën, posterat e shfaqjeve etj.

Biblioteka "Marin Barleti". Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Muzeve, pranë Fondit të Fëmijëve u zhvilloi aktiviteti me titull: "Detektivët e Bibliotekës". Në këtë aktivitet morën pjesë fëmijë të moshës 10-11 vjeç. Ata eksploruan disa nga librat që janë pjesë e Fondit të Fëmijëve dhe më pas plotësuan pyetjet e parapërgatitura në lidhje me librat që ata kanë eksploruar. Pyetjet ishin nga më të larmishmet dhe më interesantet, në mënyrë që fëmijët të mësojnë të jenë të vëmendshëm ndaj detajeve si "Detektive" të vërtetë.

Në Kalanë "Rozafa" me datë 17 Maj, DRKT organizoi: Facepainting në bashkëpunim me shoqatën "Shpresë për botën"; "Kalaja e mrekullive" që përfshiu punime të fëmijëve me pjesëmarrjen e kopshtit "Bep Tusha" Skica arkitekturore me motive arkitekturore të kalasë nga shkolla e Mesme Artistike "Prenkë Jakova" Ekspozitë fotografike me aspekte të trashëgimisë kulturore e historike, Shkodër-Krajë. Bisedë me arkeologun, me pjesënarrjen e arkeologut z.Zamir Tafilica.

Gatime tradicionale nga shkolla e Mesme Profesionale "Hamdi Bushati".

Biblioteka "Marin Barleti" 18 Maj

Me datë 18 Maj në oborrin e brendshëm të Biblioteka Publike "Marin Barleti", hapur pas më shumë se 50 vitesh, u organizua aktiviteti për "Muzat". Një aktivitet dedikuar totalisht figurë së gruas, nëpërmjet poezisë dhe pikturës. Koncerti Vokal-Instrumental i organizuar nga Biblioteka Publike "Marin Barleti", në bashkëpunim me Qendrën Kulturore "Pjetër Gaci" dhe koncertmaestron Gjon Shllaku, shënoi përmbylljen e aktiviteve të Bibliotekës në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Muzeve. Repertori me këngë të autorëve shkodranë u paraqit për publikun në ambientet e bibliotekës nga vokalistët Blerta Cina, Leonora Luca, Arjola Zadrima, Laorjan Ejlli dhe artistë të tjerë të rinj. Po ashtu krijimtaria e autorëve shkodranë u përcoll edhe nga dy instrumentistët, violinistja Erbi Piranaj dhe pianistja Isla Syknaj.

"Mapping shoë" në orën 21:00 u shfaqën tek Prefektura e Shkodrës, Teatri "Migjeni" dhe Muzeu "Marubi" të cila u shoqërua edhe me muzikë, me grupe të ftuara të cilët bënë shfaqjen e mapping në fasadat e ndërtesave muzeale dhe dj që luanin muzikë ishin një rigjallërim dhe një festim ndryshe i kësaj dite nën drejtimin artistik të maestro Lorenc Radovanit.

Gjithashtu Të ftuarit në aktivitete për fëmijë ishin shkrimtarja e njohur për fëmijët dhe animatorja Rudina Çupi, si dhe shkrimtari i mirënjohur i qytetit tonë, Xhahid Bushati.

Autorja Rudina Çupi, në aktivitetet e saj me fëmijë të grupmoshave të ndryshme, bashkëbisedoi me ta duke i paraqitur veprat e saj që u dedikohen fëmijëve. Ajo zhvilloi më fëmijët e pranishëm lojërë gjuhësore dhe veprimtari pasleximi. Autorja Çupi promovoi librin "Festa e Abetares" si dhe lexoi duke

demonstruar për fëmijët librin "Dordolëngu" i cili flet për ushqyerjen e shëndetshme dhe librin "Është... çëfësht", për mbrojtjen e mjedisit.

Biblioteka info shtesë:

Biblioteka "Marin Barleti" Gjate vitit ka realizuar mbi 45 prezantim libri. takime me autorë te afirmuat dhe te rinj., 15 Aktivitete dedikur librit per femije me perfshirjen e shkollave 9 vjeqare dhe te mesme dhe 5 ekspozita .

- 1 3 maj Takim me shkrimtaren për fëmijë Rudina Çupin
 - 2 4 maj Takimi "Mes miqsh" Klubi i librit për të rinj
 - 3 10 maj Takim me shkrimtarin Dritan Sulçebe
 - 4 12 maj Takimi "Mes miqsh" Klubi i librit për të rinj
 - 5 17 maj Takim me shkrimtarin Xhahid Bushati, promovim i librit me poezi të Ndue Pal Shllaku
 - 6 17 maj Takim me studiuesen Viola Isufaj
 - 7 17 maj Detektivet e vegjël
 - 8 17 maj Muzat
 - 9 17 maj Ekspozitë me dorëshkrime të vjetra
 - 10 18 maj Koncert Vokalo-Instrumental
 - 11 18 maj Takimi "Mes miqsh" Klubi i librit për të rinj
 - 12 21 maj Takim i Klubi të librit "Gjergj Vlasi" me shkrimtarin Ridvan Dibra
 - 13 28 maj Klubi i librit për fëmijë
 - 14 31 maj Udhëtim në letërsinë e Xhahid Bushatit
 - 15 1 qershor Ekspozitë "Unë i dua ngjyrat"
 - 16 7 qershor Takim me shkrimtarin Ardian Vehbiu
 - 17 28 qershor Takim me Drejtorin e Qendrës për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Kulturës së Pakicave
- Gzim Hajdinaga
- 18 10 korrik Ceremonia e dhurimit të fondit së Koliqi
 - 19 17 korrik "Mbramje poetike" Klevisa Bardeli
 - 20 23 korrik Hapja e ambientit të ri dedikuar fëmijëve
 - 21 23 korrik Punëtori me fëmijët e vegjël "Origami, arti i palosjes"
 - 22 26 korrik Ekspozitë "Ngjyrat e Jozefinës"

Info Shtesë:

Muzeu Histori, banesa Oso Kuka, gjate vitit ka realizuar 40 aktivitete si: takime letrare, ekspozita ne promovim te trashegimise kulturore, aktivitete ne perkujtim te figurave te shquara te historise te shqiperise dhe shkodes, koncerte te realizuara ne bashkepunim, promovime libri nga autore te afirmuar dhe te rinj.

Vendi i Deshmise dhe Kujtese, duke qënë një vend shumë specifik në konceptin e tij , aktivitete që zhvillohen janë të natyrës historike për të kalurën komuniste.

Jane realizuar 3 takime “cikël bisedash me të rinjtë mbi të kaluarën komuniste” në bashkëpunim me shkollat e mesme të qytetit.

Ekspozite fotografike në perkujtim të figurave kulturore të qytetit të cilët u perndojnë ashpër nga sistemi komunist.

P08220.Q1.O1.A7 Mbështetje për funksionimin në vazhdimësi të Muzeut Historik

Jane realizuar nga Bashkia Shkoder pagesat për Prodhim dhe shtypje biletash, Blerje fotoskaner VDK dhe Blerje kompiutera dhe pajisje tjera TIK.

P08220.Q1.O1.A8 Shpenzime promovionale për aktivitetet e kultures

Eshtë planifikuar dhe është realizuar procedura e shpenzimeve promovionale gjatë gjithë vitit. Muzeu Historik ,Biblioteka “Marin Barleti” ,Qendra Kulturore Pjeter Gaci ,. Galeria e Arteve Shkoder dhe Drejtoria e Kultures kanë përdorur këtë shërbim për mbështetjen e të gjitha aktiviteteve të organizuara nga ato.

P08220.Q1.O2.A1 Zhvillimi dhe pasurimi i fondit të Bibliotekës

Detyra kryesore e çdo biblioteke është zhvillimi dhe pasurimi i koleksioneve, përmes zgjedhjes së materialeve të shtypura dhe jo të shtypura që shërbejnë për plotësimin e nevojave për edukim dhe çlodhje të komunitetit. Në administrimin dhe ruajtjen e fondeve të librave, roli i rëndësishëm nuk kanë vetëm lokalet ku vendosen librat, por edhe raftet. Me blerjen e librave , lind nevoja e sigurimit të vendit ku do të vendosen këto libra. Prandaj janë blerë 328 tituj librash, 993 cope libra dhe 8 tituj revista dhe gazeta 1,438 cope për këtë fond.

P08220.Q1.O3.A1 Paga dhe sigurime të personelit të Teatrit “Migjeni”

Janë realizuar pagesat për pagat e personelit dhe pagesat e sigurimeve shoqërore si dhe shpenzime për periudhën Janar-Shkurt 2024 .Jane paguar pagat për punonjës nga Teatrit deri në shkëmbimin e institucionit.

P08220.Q1.O3.A2 Paga dhe sigurime të personelit të Teatrit “Migjeni” dhe Kinemaja

Janë realizuar pagesat për pagat e personelit dhe pagesat e sigurimeve shoqërore si dhe shpenzime për periudhën Mars - Dhjetor 2024 .Jane paguar pagat për punonjës nga Bashkia Shkoder .

P08220.Q1.O3.A3 Paga dhe sigurime të personelit të drejtorisë së kultures.

Janë realizuar pagesat për pagat e personelit dhe pagesat e sigurimeve shoqërore për periudhen Janar-Dhjetor 2024 për administratën e kulturës .

P08220.Q1.O3.A4 Paga dhe sigurime të personelit të Qendrës Kulturore "Pjeter Gaci"

Janë realizuar pagesat për pagat e personelit dhe pagesat e sigurimeve shoqërore për periudhën Janar-Shkurt 2024 .Jane paguar pagat për 4 punonjës nga Dega Ekonomike e Kulturës deri në shkrirjen e institucionit për Qendrën Kulturore "Pjeter Gaci".

P08220.Q1.O3.A5 Paga dhe sigurime të personelit të Qendrës Kulturore "Pjeter Gaci"

Janë realizuar pagesat për pagat e personelit dhe pagesat e sigurimeve shoqërore për periudhën Mars-Dhjetor 2024 .Jane paguar pagat nga Bashkia Shkoder për për Qendrën Kulturore "Pjeter Gaci".

P08220.Q1.O3.A6 Shpenzime për mirëmbajtjen e plote të Teatrit Migjeni

Janë realizuar pagesat për shërbime nga të tretë për Teatrin "Migjeni".Eshtë realizuar shpenzimi për Sigurim ndërtese, Energji elektrike ,Ujë ,Internet dhe Furnizim me materiale higjene nga Drejtoria e përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike.

P08220.Q1.O3.A7 Shpenzime për mirëfunksionimit të plote të Teatrit Migjeni

Janë realizuar pagesat për prodhim dhe shtypje biletash ,Shpenzime për pritje, përcjellje , Udhëtimet , Printime dhe publikime , kancelari nga Bashkia Shkoder për Teatrin "Migjeni".

P08220.Q1.O3.A8 Shpenzime për mirëmbajtjen dhe sigurimin e funksionimit të plote të Qendrës Kulturore "P.Gaci" dhe Qendra Atelie

Janë realizuar pagesat për shërbime nga të trete si: Ujë , Energji elektrike, Materiale pastrimi/sanitare dhe Sigurim ndërtese nga Drejtoria e përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike për Qendrën Kulturore "P.Gaci" dhe Qendra Atelie.

P08220.Q1.O3.A9 Shpenzime për mirëmbajtjen dhe sigurimin e funksionimit të plote të Qendrës Kulturore "P.Gaci" dhe Qendra Atelie

Janë realizuar pagesat për materiale kancelarie, Shpenzime transporti dhe udhëtimi , blerje bileta ,dhe shpenzime pritje përcjellje. nga Bashkia Shkoder për aktivitetet kulturore të Qendrës Kulturore "P.Gaci" dhe Qendra Atelie.

P08220.Q1.O3.A11 Orkestra Frymore Honorare vjetore

Formacioni i Orkestrës Frymore është një nga vlerat e veçanta artistike unike që ka qyteti ynë. Janë mbështetur me honorare për 11 muaj të vitit ky formacion që përbëhet prej 40 muzikantëve.

P08220.Q1.O3.A12 “Realizimi i Aktiviteteve te Qendres kulturore “Pjeter Gaci”

Cmimi ‘Pjeter Gaci’- Për 4 ditë me radhë Shkodra mirëpriti mbi 210 pjesmarrës , talente të rinj , interpretues të muzikës klasike.Konkurentët pjesmarrës vijnë nga treva të ndryshme te Shqipërisë , Kosovës , Malit të Zi , surprizë ishte dhe ardhja e konkurrenteve nga Gjermania dhe Italia.Ky aktivitet ishte i hapur për interpretues me aftësi solistike nga mosha 7 deri ne 23 vjeç , të ndara ne kategori sipas grupmoshave ne specialitet:Piano, Fizarmonike, Harqe, Kitarë, Instrumente të drunjta, te tunxhit dhe Kanto

Këtë vit konkursi u gjykua nga 3 Juri me profesionistë të fushës:

Juria: Piano/Fizarmonikë e përbërë nga :Nikola Vuckovic, Etleva Kolnikaj Amir Xhakovic,

Juria: Harqe/Kitarë e përbërë nga Bujar Sykja, Anton Kaftalli, Gjulian Bytyqi,

Juria: Instrumenteve te Drunjta dhe Tunxhit dhe të Kantos e përbërë nga :Sokol Saraqi, trompist. Rita Ranko, Fatbardh Gashi.U realizuan rreth 45 orë audicione për 3 ditë .

Audicionet u mbajten në 3 ambjente artistike dhe u ndoqën nga rreth 400 artdashes ,dhe në naten finale rreth 350 artdashes.

Çmimi i parë: Marla Hoxha , kategoria C violinë nga Tirana

Çmimi i dytë : (Lis Mustafa, , kategoria D kitarrë nga Prizreni)

Çmimi i tretë: (Albana Bajraktari , kategoria D kanto Tiranë)

Çmimi i tretë (Rron Rustemi, , kategoria F saksofon nga Gjilani)

Çmimi i publikut (Irem Krasniqi , kategoria D piano nga Prizreni)

Ahengu Shkodran_ Me date 30 shtator 2024 u organizua aktiviteti tradicional “Ahengu Shkodran”. Ky aktivitet organizohet nga Bashkia Shkodër, Qendra Kulturore “Pjetër Gaci” në bashkëpunim me Teatrin Migjeni dhe Muzeun Historik, banesa “Oso Kuka”.

Në këtë edicion ju kushtua një vëmendje e veçantë dy figurave të ahengut shkodran me kontribute të mëdha në këtë fushë si bartes,krijues dhe reformatorë të kësaj gjinie. Kolë Gurashi dhe Seit Hoxha, gjithashtu krijimtarisë së Paulin Palit, Ramadan Sokolit ,Tish Daija etj. Këtë edicion u sollën dy këngë për herë të parë dhe të pa dëgjuara më parë si : Bora po shkrin, me autor tekst nga Ndre Mjeda, po ashtu dhe kënga e Tish Daisë “Vinte çika prej pazarit”.

Takimi Ndërkombëtar i Bandave Frymore në edicionin e katërt të tij, solli një atmosfere festive në qytetin e artit dhe kulturës.Në tre sheshe të ndryshme të qytetit, disa nga orkestrat pjesëmarrëse, kanë performuar për kënaqësinë e qytetarëve shkodranë marshe dhe pjesë muzikore shumë të njohura shqiptare dhe të huaja. Shkodra, Durrësi dhe Salento e Italisë, kanë përcjellë muzikë në rrugët e Shkodrës në ditën e pare të eventit dy ditor.

Parada e bandave filloj njëkohësisht nga secili shesh si: Sheshi Nënë Tereza, Sheshi tek “Isa Boletini” dhe Sheshi para Bashkisë Shkodër duke performuar rrugës marshe te ndryshme, pershkruan pedonalen “Kolë Idromeno” dhe “Gjuhadol”, duke krijuar atmosferë të jashtëzakonshme tek kalimtarët dhe turistët.

Datë 6 tetor 2024 , ora 19:00 - koncerti final u realizua tek Teatri Migjeni.

P08220.Q1.O3.A13 Honorare Grupi i Valleve

Grupi i Valleve përbëhet prej 12 personash, të cilët janë mbështetur me honorare për 10 muaj të vitit.

P08220.Q1.O3.A14 .Festivali I Këngës “Luleborë”

Bashkia Shkodër, Qendra Kulturore “Pjetër Gaci” në bashkëpunim me Teatrin “Migjeni” organizuan për të nëntin vit, Festivalin e Këngës “Luleborë”, në datat 1 dhe 2 Nëntor 2024.

Drejtor Artistik i këtij viti ishin Shpëtim Saraçi dhe Markelian Kapidani të cilët janë marrë me çdo detaj artistik të festivalit. Jetmir Barbullushi si dirigjent, duke drejtuar me profesionalizëm dhe shumë korrektesë të gjitha krijimet e reja që u paraqitën në festival.

Me një orkestër të përbërë prej 36 artistë instrumentistë, u arrit të realizohen me sukses 15 krijimet e reja, të cilat u shfaqën live në skenën e Teatrin “Migjeni”.

Skenari i festivalit u puna nga Ermira Alija, e cila me shumë seriozitet dhe përgjegjësi, prezantoi me së miri çdo komponent të këtij festivali si dhe për çdo mesazh promovuese në mbështetje të vlerave artistike të dhëna gjatë netëve live të festivalit.

Moderatore e festivalit - Suela Demiri.

Pjesmarrja e publikut ishte shume e lartë, rreth 900 spektatore në sallë në të dyja netët.

Media partner i këtij aktiviteti ishte Televizioni Publik Shqiptar.

Në natën finale të festivalit, përshendeti publikun me performancë artistike pjestari i jurisë Frederik Ndoci i cili interpretoi një kolazhi që u bazua mbi tre këngë të Pjetër Gjinit, kolazh i cili u punua dhe orkestrua nga Markelian Kapidani.

Juria e edicionit të IX “Luleborë” në fund vendosi:

Çmimi i parë – “Nuk lulzon pa Zot”, kompozuar nga Ana Bushgjokaj, teksti Ana Bushgjokaj, këndoi Ana Bushgjokaj.

Çmimi i dytë – “Me Mujtë”, kompozuar nga Florent Boshnjaku, teksti Arjola Zadrime, këndoi Ermal Demiri

Çmimi i tretë - “Të ngjashëm”, kompozuar nga Roland Guli, teksti Meri Guli, këndoi Ea Zoga.

P08220.Q1.O3.A15 Realizimi i aktiviteteve te organizuara nga drejtorja e kultures

“KONCERTET E VERËS” kanë filluar më herët së asnjë vit dhe me 27 Prill u organizua aktiviteti “Sëing Marathon” duke filluar festën në rrugën Gjuhadol dhe më pas në Teatrin “Migjeni” me një seri aktiviteteve kulturore, dhe festive. Ky aktivitet, i cili prej tre vitesh bëhet i mundur nga një grup dashamirësish të muzikës jazz, I cili sjellë në qytetin e Shkodrës atmosferën e një aktiviteti gjithëpërfshirës me cilësi të lartë artistike, duke sjellë në skenë muzikantë kombëtar dhe ndërkombëtar. Në datën 14 Qershor 2024 u mbajt koncerti i parë, në Funzone me pjesëmarrjen e artistët Besmir Topcia, Irian Taraboshi, Arseldi Muça dhe Niki Mjeda shoqëruar me tastierë nga instrumentisti Rezart Cacani. Repertori i zgjedhur, rreth 20 këngë, Shqiptare dhe të huaja .

Me datë 15 Qershor 2024 u mbajt koncerti i dytë i “Koncerteve të verës” në Funzone , të ftuar në këtë koncert ishin Martina Serreqi, Leonora Lucaj, Ylber Tahiri, Blerta Cina, të shoqëruar nga instrumentistët Rudolf Çeklijaj dhe Mark Ujka . Repertori i zgjedhur për të performuar në këtë koncert me shumë i muzikes shqiptare dhe asaj qytetare shkodrane.

Me datë 22 Qershor 2024 Nata e tretë e quajtur RETRO me muzike të viteve 50, me të ftuar si: Viki Haxhi, Bruna Sata, Ademir Fresku, Selma Bekteshi nën shoqërimin e instrumentistëve si : Gëzim Mesi, Daniel Prendi, Mark Ujka dhe Anton Guri. Repertori i përzgjedhur ishte i larmishëm, ku u kënduan rryma të ndryshme si Rock, Pop, Rock and Roll muzike Latine etj. Moderatore e aktivitetit ishte artistja Fiona Rushit, e cila përveç moderimit krijoi dhe performancë madhështore me flakë.

Me datë 24 Qershor 2024 Koncerti i katërt i koncerteve të verës kishte të ftuar Glerdit Turmetaj, Ana Bushgjokaj, Ea Zoga, të shoqëruar nga instrumentistët Ersad Hotaj, Kristian Gajtani, Repertori i përzgjedhur nga grupi muzikor ishte i larmishëm.

Me datë 28 Qershor 2024 Në datën e pestë të koncerteve të verës kishte të ftuar Lidia Gjyshja, Sevina Kurti, Rigersa Loka, nën shoqërimin e instrumentistëve Mark Ujka, Gjergj Marku dhe Florian Martini, me orkestrimet e Artjon Qamili.

4 korrik 2024 Vëllezërit Korçarë, Stefi dhe Endri Prifti - Ideja e këtyre koncerteve është gjithëpërfshirës dhe në përpjekje për t’u zgjeruar përtej lokalizmit të një qyteti dhe t’u përshtatet shijeve muzikore, moshave të audiencave të ndryshme. Vëllezërit Korçarë kënduan këngët më të mira të repertorit të tyre, këngë qytetare të disa zonave, si edhe disa prej hiteve ndërkombëtare më të pëlqyera për të gjithë të pranishmit. Atmosfera ishte e zjarrtë, edhe për shkak të specifikës së muzikës së vëllezërve korçarë.

7 korrik Sardi Strugaj - Ashtu siç është përshkruar ky projekt që në fillim të konceptimit të tij, një nga qëllimet kryesore kanë qenë jo vetëm diversifikimi i publikut, por edhe promovimi i artistëve më të rinj, si në rastin konkret Sardi Strugaj. Sardi është autor dhe producent i njohur, por deri përpara pak kohësh ka qenë i përkushtuar të ishte artisti i hiteve radiofonike. Tashmë publiku po lidh emrin, zërin, fytyrën me këngët e dëgjua dikur në radio, duke e shndërruar atë sot, në një prej artistëve më të dashur të momentit.

Mbrëmja e 7 korrikut mblodhi shumë spektatorë, veçanërisht mosha të reja.

8 korrik Redon Makashi - Mbrëmja e 8 korrikut sollti në skenën e vendosur në Fun Zone, kantautorin e dashur për publikun, Redon Makashi. Ndonëse me një repertor më të lehtë dhe nostalgjik, ky koncert sollti tek publiku një moment qetësie, reflektimi dhe meditimi. Redon Makashi nuk është artisti i masivitetit, por është populist i qëtërheq një publik, që janë të orientuar në shijet e tyre nga poezitëe bukura, meloditë me harmoni dhe orkestracione të bukura, të cilat transmetojnë emocione edhe nga vetë interpretimi i artistit Makashi.

11 korrik Elton Deda - Mbrëmja e 11 korrikut ishte e destinuar për tifozët e muzikës rock, me një prej përfaqësuesve më të mirë që ka ky zhanër në Shqipëri, Elton Deda.

Deda sëbashku me bandin e tij prezantuan repertorin nga hitet më të njohura botërore dhe shqiptare, duke sjellë një atmosferë dhe energji elektrizuese, duke kënduar sëbashku në kor, me publikun që zgjodhi ta kalojë mbrëmjen në shesh.

12 korrik Altin Goci - Mbrëmja e 12 korrikut ngjiti në skenë një nga pionerët e muzikës moderne të viteve '90-të, Altin Goci, bashkëthemelues i një prej grupeve më me ndikimin të muzikës moderne shqiptare "Ritfolk" Goci dhe bandi i tij prezantuan albumin e ri të artistit, të promovuar në një koncert live, nëntorin e kaluar në Tiranë, si edhe hite të grupit ndër vite.

13 korrik Marsela Çibukaj - E shtuna e 13 korrikut, duke rastisur edhe fundjavë mbledhi në skenën e ndërtuar nga Bashkia e Shkodrës për Koncertet e Verës, jo vetëm qytetarë të Shkodrës, por edhe turistë të huaj, të cilët gjendeshin në qytet gjatë kësaj fundjave. Performanca e Marsela Çibukajt, e cila i kishte munguar qytetit prej disa kohësh, u mirëprit dhe u duartrokoi nga publiku. Ajo prezantoi para tij këngë të reja nga albumi i ri, i sapopublikuar, hite ndër vite, si edhe këngë të njohura të repertorit botëror.

23 korrik - "Maratona Këngë Moj" është një event multikulturor, i cili zhvillohet në formën e një turneu artistik në qytetet e ndryshme të Shqipërisë. Ky event u zhvillua në mbrëmjen e datës 23 Korrik 2024. Koncerti filloi rreth orës 21.00 dhe vazhdoi deri në orën 23.30. Konceptuar si një shesh i madh argëtimi me një skenë gjigande Maratona priti një numër të madh spektatorësh, të cilët kënduan e vallzuan nën ritmin e këngëve së bashku me artistët më të mirë të muzikës shqiptare. Në të performuan artistët më të suksesshëm të muzikës duke filluar nga Bujar Qamili, Valbona Mema, Eranda Libohova, Irma Libohova, Mukades Canga, Erik Lloshi, Sidrit Bejleri, Mateus Frroku, Egzona Ademi & Band etj, pa harruar emrat më të spikatur të muzikës shkodrane dhe këngëtarë të rinj të muzikës

24 korrik Vesa Luma - Përfundimi i Kampionatit European të Futbollit, solli prioritet edhe në skenën e Velipojës, ku u organizuan gjithashtu një sërë aktivitetesh. Këngëtarja e dashur nga Kosova, Vesa Luma, sëbashku me bandin e saj, mbajtën koncert përpara spektatorëve, vendas dhe të huaj, duke sjellë një atmosferë festive nëpërmjet hiteve më të dashura të këngëtares ndër vite, por edhe këngë të njohura qytetare të trevave të ndryshme.

26 korrik Bledar Sejko dhe Einar Nelku - Mbrëmja e 26 korrikut iu rezervua nostalgjikëve të muzikës dhe një publiku pak më të madh në moshë, nëpërmjet bandit lider në promovimin e muzikës blues në Shqipëri, Bledar Sejko dhe Einar Nelku Band. Një mbrëmje shumë e veçantë që u mirëprit dhe u duartrokoi nga publiku që kishte mbushur plot e përplot të gjithë hapësirën rreth e qark skenës. Duke qenë një grup me repertor të rrallë që nuk e ndeshim shpesh, ky grup ishte një nga surprizat e Koncerteve të Verës, për mënyrën së si u prit nga publiku.

2 gusht Fanfara - Një tjetër natë e veçantë, nga Fanfara Tirana, një grup i përbërë nga muzikantë të cilët janë nominuar dy herë për Independent Music Award. Grupi luajti muzikë me bite ballkanike, të ndërthurur me atë shqiptare, një histori suksesi edhe në skenat europiane. Gjatë kësaj performace u përdorën edhe mjaft elemente orkestracionesh si rege, dub apo edhe jazz.

3 gusht Blitz Rock dhe Urban Band - Mbrëmja e 3 gushtit iu rezervua dy grupeve të reja në moshe, si Blitz Rock nga Shkodra dhe Urban Band nga Tirana, të cilët luajtën repertor të rockut të viteve 70,80 e

deri në muzikën alternative të ditëve tona. Ky kombinim I moshes se re ,me repertorin e tyre gold, beri bashke audience e te gjitha moshave

8 gusht Era Rusi - Këngëtarja e njohur për publikun, Era Rusi, u ngjit në skenën e Velipojës mbrëmjen e 8 gushtit, sëbashku me bandin e saj. Era Rusi këndoi në kor me publikun që prej hiteve të saj si “Telat e zemrës”, e deri tek muzikë e të gjitha trevave shqiptare, në respekt të pushuesve të Velipojës nga e gjithë Shqipëria.

8 gusht Verë dhe Portokalle- spektakli veror humoristik dhe argëtues me qëllim aktivizimin e jetës artistike dhe kulturore të qytetit të Shkodrës. Trupa e Portokallisë organizoi këtë spektakël në qytetin e Shkodrës me date 08.08.2024.Spektakli zgjati rreth 2 orë filloi në 20.45 deri në orën 22.45 dhe kishte në përbërjen e tij 22 performanca nga të cilët 5 këngë dhe 17 numra humori.

9 gusht 3 Musketierët- Mbrëmja e 9 gushtit iu rezervua grupi, 3Musketierët.Pas interpretimeve të tyre si solistë, skena e Shkodrës bashkoi figurat emblematike të muzikës blues dhe rock të viteve 90 në Shqipëri, Aleksandër Gjoka, Elton Deda, Redon Makashi. Repertori i tyre tashmë është në memorien e çdo spektatori, pavarësisht moshës, ndaj dhe mbrëmja e 9 gushtit në kuadër të Koncerteve të Verës 2024, ishte nga më të paharrueshmet.

16 gusht Eranda Libohova - Artistja e dy kohëve, para dhe pas viteve '90-të, Eranda Libohova, u prit midis qindra duatrokitjesh në skenën e Velipojës, nga plot vendas dhe turistë që u gjendën aty për pushimet e tyre verore, nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e të huaj. Për këtë arsye, artistja me përvojë përshtati repertorin e koncertit, duke “shëtitur” nëpërmjet muzikës në cdo trevë shqipfolëse.

22 gusht - Mbrëmja e 22 gushtit, ngjiti në skenën e qytetit të Shkodrës, një prej bijve të saj, Ervin Bushatin, artistin bashkëkohor që spikati në fillim të viteve '90-të me tendenca e rryma të reja, për të kaluar dalëngadalë e me kalimin e viteve, më muzikën e bukur popullore e qytetare, jo vetëm të Shkodrës. Artisti shkodran u mirëprit, si në shtëpinë e tij, për t’ja lënë vendin një cifi artistësh në skenë e në jetën reale, Venera Lumani e Lind Islami, më afër një audience më të re në moshë, të cilët mbushën sheshin në skenën përpara Bashkisë.

23 gusht Anxhela Peristeri - Koncertet e Verës, Shkodër 2024 u mbyllën me artisten e njohur të muzikës pop në Shqipëri, Anxhela Peristeri. Pas dy recitaleve të suksesshme në Tiranë, Anxhela Peristeri dhe formacioni i saj, u ngjitën në skenën e ndërtuar në sheshin përpara Bashkisë së Shkodrës, duke interpretuar hitet më të mira të krijimtarisë së saj ndër vite, por edhe këngë të njohura shqiptare nga fondi i artë i muzikës popullore apo asaj të lehtë.

DITA E LULEVE “6 MAJ” - “Dita e Luleve - 6 Maj”, e titulluar “Lule je, lule frymon” nga subjekti, u konceptua mbi tema të ndryshme: “Panairi i luleve” – I vendosur në sheshin para Bashkisë Shkodër, panairi i luleve u hap në orën 10:00-20:00 të datës 6 maj. Në këtë organizim u ftuan subjekte dhe qytetarë të ndryshëm që merren me kultivimin e luleve . Rreth 22 biznese lokale lulësh morën pjesë në panair, të cilëve iu mundësuan 20 stenda të vendosura përgjatë rrugës “13 Dhjetori”.“Parada e luleve” – Kjo temë ishte e dedikuar për fëmijët. Subjekti, në koordinim me Drejtorinë e Kulturës dhe Drejtorinë e Arsimit, bashkëpunoi në mënyrë të suksesshme me Zyren Vendore Arsimore Shkodër, duke

angazhuar fëmijët e sistemit parashkollor dhe shkollor parauniversitar. Gjithashtu, pjesë e këtij bashkëpunimi u bënë edhe subjekte arsimore private të qytetit tonë. Parada e grupeve të ndryshme të fëmijëve, të cilët të veshur në përshtatje me tematikën e ditës, performuan gjatë gjithë ditës tek sheshi para Bashkisë Shkodër. “Ekspozita e luleve” – Data 6 Maj filloi me ekspoziten personale të piktores Greta Tahiraga. Ekspozita kishte tematike lulen dhe u hap në hollin e Bashkisë Shkodër, nga ora 11:00-19:00 . Ekspozita tërhoqi vemendjen e shumë qytetarëve të cilët ndalun për të shijuar veprat e artit të piktores Greta Tahiraga. “Festivali i Luleve” - Një hapsirë e veçantë iu dedikua tërësisht shkollave 9-vjeçare të cilët sollën në skenën performaca vallëzimesh me ritme shqipëtare dhe moderne. Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit, bashkëpunoi në mënyrë të suksesshme me Zyrën Vendore Arsimore, Shkodër, duke angazhuar fëmijët e sistemit parashkollor dhe shkollor parauniversitar në këtë aktivitet. Nuk mungoi kënga në këtë aktivitet, pasi në skenë kënduan edhe disa pjesëmarrës të “Bilbilat e vegjël të Shkodrës këndojnë”.

Koncert Premiere Orkestra Simfonike – “Shkodra nën Tingujt e Muzikës së Filmit Shqiptar”.Me pjesëmarrjen e Orkestrës Simfonike të Shkodrës, Korit Polifonik “Prenkë Jakova”, Koncert Premiere Orkestra Simfonike u realizua me datë 6 Maj në teatrin Migjeni. Kjo premierë kishte të ftuar personalitete të artit skenik shqiptar si : Pirro Milkani, Ndiçim Xhepa, gjithashtu kompozitorë të shquar të muzikës së filmi : Thoma Simaku, Robert Radoja dhe Alban Laro. Në program ishin të përfshirë kolonat zanore të filmave si: Mëngjese Luftë, Lulëkuqet mbi Mure, Apasionata, Çifti i Lumtur etj.

KONCERT NDERKOMBETAR – Koncert Nderkombetar” i konceptuar si mbremje Gala ‘Rame Lahaj and Friends’, vjen si bashkëpunim me Orkestrën Simfonike të Bashkisë Shkodër dhe me pjesëmarrjen e Alessandro Safina dhe Adhurim Grezda të udhëhequr nga dirigjimi i maestro Elda Laro. Kjo mbremje Gala e zhvilluar në sheshin e Shirokës përmes emrave të njohur të skenës nderkombetare si tenori i njohur Rame Lahaj e miqtë dhe repertorit të perzgjedhur të muzikës operistike dhe muzikës së perzgjedhur shqiptare dhe asaj shkodrane në vecanti krijoi një atmosferë të vecantë duke promovuar njëkohësisht vlerat historike, kulturore dhe artistike të qytetit. Repertori i muzikës shqiptare i perzgjedhur me shumë kujdes përmes përpunimeve të rafinuara me qëllim që të ruajë dhe promovojë identitetin kombëtar i ndërthurur me repertorin operistik që pati një vend të rëndësishëm në këtë mbremje Gala.

FESTA E TRASHËGIMISE KULTURORE - Festa e Trashëgimisë Kulturore”, e titulluar “Za Fest” nga subjekti, i cili u zhvillua në tre ditë të ndryshme, në datat 18-19-20 Korrik 2024 në Shkodër.

Data 18.07.2024 - Nata e parë e aktivitetit ZaFest u zhvillua tek Muzeu Historik, Banesa “Oso Kuka”, një natë e dedikuar këngëve të gjakovës me ndërthurje të këngës shkodrane , e cila erdhi nën interpretimin e grupit Don’t Listen To Your Neighbors. Nuk munguan bisedat në ZaFest, ku i ftuar ishte Dom Gjergj Meta . Në këtë bisedë të hapur u prek një ndër çështjet më të ndjeshme sociale siç është emigrimi i të rinjve nga Shqipëria. Natën e parë të ZaFest e mbylli filmi i regjizorit Gentian Koçi “A cup of coffee and në shoes on”.Film “A cup of coffee and në shoes on” frymëzohet në një rast real ku 2 vëllezër të shurdhër vuajnë nga një sëmundje degjenerative që përfundimisht do t'i lërë të verbër.

Data 19.07.2024 - Nata e dytë e aktivitetit Za Fest u zhvillua në Kalanë e Rozafës. Ne skenën e Za Fest u ngjiten artistë të rinj dhe të afirmuar kombëtar si :Elsa Rraqin,Reperi BimBimma dhe Ylli Limani I cili elektizoi gjithë publikun me këngët e tij hit. I ftuar I kësaj nate ishte dhe Çun Lajçi, i cili interpretoi pjesë nga rapsodi shqiptar. Aktiviteti filloi në orën 21:00 dhe zgjati deri në orët e para të mëngjesit. Skena ishte e përmasave të mëdha dhe e ndërtuar në stil të veçantë, ndërkohë përreth mureve të kalasë u projektuan me ndriçim dhe figura artistike. Pjesmarrja e publikut ishte e mirë.

Data 20. 07.2024 - Nata finale e aktivitetit Za Fest u zhvillua në Kalanë e Rozafës. Të ftuar në natën përmblyese të ZAFest : Makari Trio nga Sicilia me muzikën e tyre ngazëlluese, Vlashent Sata , Grupi Ritfolk të cilët interpretuan hite të grupit ndër vite po ashtu edhe pjesë nga albumi i ri duke e finalizuar këtë edicion me pjestarin e grupit të famshëm Gipsy King- Pablo Reyes, ku të gjithë nostalgjikët e këtij grupi patën mundesi të shijonin ritmet e muzikës latine. Aktiviteti filloi në orën 21:00 dhe zgjati deri në orët e para të mëngjesit. Pjesmarrja e publikut ishte e mirë.

LIGHT FESTIVAL SHKODRA - “Light Festival Shkodra”, u zhvilluan në datat 17 dhe 18 Gusht 2024 në Shirokë. Data 17.08.2024 - Nata e parë e aktivitetit “Shndrite zemren n’Shirokë” startoi në orën 20:00 me ekspozimin e produkteve artizanale të zonës së Shirokes dhe jovetem , promovimin e produkteve “Made in Albania” me një larmishmëri gjeografike nga e gjithë Shqipëria dhe trevat shqipëfolëse duke i dhënë mundesi qytetarëve dhe turistëve të degustonin këto produkte. Koncerti filloi në orën 21:00, I shoqëruar nga një video promovuese e vlerave gjeografike, turistike dhe kulturore të Shirokës dhe Shkodrës.Klea Chutra ishte këngëtarja e parë e kësaj nate, vajza dibrane e dashuruar me këngët shkodrane, e cila performoi për publikun disa këngë traditë të shkodrës por edhe hite të muzikës pop. Sfidë në lartësi – performancë akrobacie në 30 m lartësi nga Fiona Rushiti. Akrobatja e lartësive të mëdha këtë herë ka sfiduar veten në Shirokë, duke dhuruar momente drithëruese për publikun. Muzikë Jazz- Kompozitori Markelian Kapidani dhe perkusionisti Jetmir Mesi u ngjiten në skenën e “Shndrite zemren n’Shirokë” dhe performuan materiale muzikore afro/kubane të arranzhuara për duo pianoforte dhe perkusione latine. Këngëtarja e mirënjohur Eneda Tarifa iu bashkua duo-s dhe përfomoi dy materiale muzikore standart jazz. Sfida e Artit në flakë – Grupi artisteve të reja performuan numëra artistik me zjarrin. Niki Zaimi, djali I talentuar, fitues I cmimit të dytë në x factor Albania, u ngjit në skemë në grupin e tij, luajti disa pjesë të jashtezakonshme të muzikës rock të viteve 70 dhe 80 por edhe pjesë të muzikës shqiptare. Zëri i tij I fuqishëm elektrizoi gjithë pjesëmarrësit.Blerina Sindi Sheshi, pjesë e Ansambllit Kombëtar, solli në liqenin e shkodrës pjesë nga baleti “Liqeni I Mjellmave” .Ndërkohë që mbi liqenin dhe qiellin e Shirokës fluturonin fenerët e ndezur nga pjesëmarrësit, duke krijuar kështu një atmosferë magjike, e gjitha u shoqërua nga performanca e artistes Eneda Tarifa, e cila këndoi disa nga hitet e saja. Data 18.08.2024

Dita e dytë e aktivitetit u zhvillua po në Shirokë. Aktiviteti filloi në orën 10:00 me hapjen e panairit. Rreth 40 artistë, artizanë, piktorë, zejtarë e grupe artistike sollën në Shirokë ngjyrat plot kolorite të produkteve inovative artizanale shqiptare, ekspozita të mjeshtërisë artizanale, vitrina evoluese kreative, ekzibicione artizanale të performancave dhe proceseve artizanale duke e rikthyer në orgjinën e tij, duke

promovuar fort traditat artizanale shkodrane, duke i dhënë shtysë zhvillimit dhe mundësimin të punësimit të brezit të ri në këtë sektor.

FESTIVAL JAZZ-I - "Festival Jazz-it" projekt i titulluar "Shkodra Universal Sounds" i ndarë në tre objektiva nga subjekti fitues si : "Shkodra Jazz Festival" "Shkodra Sounds" dhe "Rrok Academy" , u zhvillua në datat 12 gusht – 1 shtator 2024.

-"Rrok Academy" është shkolla e parë e këtij lloji në Shqipëri, e cila ka të bëjë me kurse të avancuara për muzikantë, dhe ka si synim edukimin e brezave të rinj me muzikën elitare, përmes leksioneve intensive të drejtuara nga profesionistë të fushës. "Rrok Academy" Junior e drejtuar nga Brixhilda Martini., ku morën pjesë 15 studente nga qyteti i Shkodrës, Lezhës, Tiranës, Durrësit dhe Italia. Dega e Fizarmonikës e cila u drejtua nga Bardh Jakova, zhvilloi leksione me temën "Mbi studimin e teknikave klasike dhe ballkanike", në ambjentet e Qendrës Rinore "Atelie" nga data 12 gusht deri me datën 24 gusht 2024. Në degën e Fizarmonikës morën pjesë 8 student të cilët ishin nga Shqipëria, Romania, Mali i Zi dhe Kosova.

"Rrok Academy Jazz" në ambjentet e Qendrës Rinore "Atelie" nën drejtimin e Markelian Kapidanit . Leksionet që u zhvilluan në degën e Jazz-it ishin me temën "Mbi idiomën muzikore të jazz-it", morën pjesë 16 studentë nga Shqipëria, Kosova, Rumania, Italia. Në bazë të kalendarit të koncerteve të artistëve pjesëmarrës në "Shkodra Jazz Festival", u mbajtën orë speciale në "Rrok Academy Jazz" ku leksionet e trombës nga Gabriel Oscar Rosati; leksionet e bass-it nga Flavio Piantoni. "Rrok Academy Klasike" filloi në ambjentet Galerisë së Arteve Shkodër , nën drejtimin e Paçalin Pavacit. . Leksionet që u zhvilluan në degën klasike ishin me temën "Mbi studimin e teknikës orkestrale dhe muzikës së dhomës", morën pjesë 10 studente nga Shqipëria, Kosova dhe Italia . Dega Neë Technology – Multimedia filloi, në ambjentet e Qendrës Rinore "Atelie" nën drejtimin Fatjon Çelikut. Kursi e degës neë technology – multimedia ishte me temë "Formim mbi kritikën e artit dhe përvetësim i teknikave të fotografisë e video-artit". Në degën Neë Technology – Multimedia morën pjesë 6 studentë.

Data 24 gusht 2024

Pas 14 ditësh intensive masterclass-i dhe provash, studentët e "Rrok Academy Accordion" nën drejtimin e Maestro Bardh Jakova. Tingujt magjik të 8 fizarmonikave performuan një repertor nga pjesë të huaja si : Vals Brillant , Tico- Tico , Suite Bullgare, Libertango dhe pjesë nga repertori shqiptarë si : Valle Tiranse, Baresha , Pranvera filloi me ardhe etj. Koncert filloi në orën 20:30 dhe zgjati për rreth 1 orë e 30 minuta, në oborrin e Muzeut Historik, banesa "Oso Kuka". Në fund të performancës artistike studentët u pajisen me çertifikata pjesëmarrje.

Datë 25 gusht 2024

Muzeut Historik, banesa "Oso Kuka" u "pushtua" nga tinguj e harqeve të klases "Rrok Academy Junior" dhe "Rrok Academy Classic" . "Rrok Academy Junior" me artistët me të rinj të akademisë, të cilët pas dy javësh prova dhe masterclase performuan për publikun. Repertori i koncertit ishte zgjedhura me kujdes nga profesoresha Brixhilda Martini, me pjesë klasike por dhe shume argëtuese. Në fund të performancës artistike studentët e "Rrok Academy" Junior , u pajisen me çertifikata pjesëmarrje. "Rrok

Academy Classic” pas 14 ditësh intensive masterclass-i dhe provash studentët performuan muzike dhome për rreth 1 orë e 30 minuta, me një program të përzgjedhur elitare të muzikës klasike.

Datë 29 gusht 2024

“Jare Jazz – Prej Shkodret dej n’Gjakovë” ishte koncerti i datës 29 gusht 2024 rezultat i bashkëpunimit mes dy muzikantëve të jashtëzakonshëm I muzikës Jazz dhe asaj tradicionale si : Markelian Kapidani dhe Artan Bakija. Ky koncert bashkoi tinguj të traditës "Aheng" me "voicings" dhe atmosfera Jazz. Tentativë konkrete e cila dëshmon forcën ripërtëritëse që buron nga kjo muzikë, rreth së cilës mund të bëhet Jazz me tingëllime shqiptare. Impresioni i publikut u dallua qartë, veçanërisht në aspektin artistik, ku artistët u duartrokitën gjatë. Koncerti filloi në orën 20:30 tek Muzeu Historik, Banesa “Oso Kuka”.

Datë 30 gusht 2024

Francesco Bearzatti “Tinissima 4tet”

Saksofonistin Francesco Bearzatti një nga talentet më të njohura të muzikës jazz, ishte pjesë e edicionit të XV të Shkodra Jazz Festival, I cili performoi me datë 30 Gusht 2024, në orën 20:00, para sheshit të Bashkisë Shkodër. Francesco Bearzatti interpretoi së bashku me kuartetin e tij Tinissima 4ET, ku morën pjesë Giovanni Falzone në trompë, Danilo Gallo në kitarë bas, dhe Zeno De Rossi në bateri. Performanca e tyre ishte një homazh për muzikën jazz si një formë arti që mbart në vetvete çlirim, rezistencën ndaj padrejtësisë, romancën dhe aventurën.

Datë 31 gusht 2024

Mars Trio është grupi i cili ka zhvilluar një identitet stilistik të veçantë, duke kombinuar harmoninë e jazz-it me ritmet e kërcimit dhe ndikime të ndryshme nga sfondet e tyre muzikore të larmishme. Muzika e tyre përfshin elemente të elektronikës, soul-it dhe muzikës botërore, duke krijuar një përvojë unike për dëgjuesit. Vokalistja Marina Arsene, saksofonisti Paolo Profeti dhe kitaristi Lucas Contreras janë artistë me përvojë të gjerë në skenën ndërkombëtare të jazz-it, duke sjellë në Shkodër një koncert shumë të veçantë . Ky koncert ishte një mundësi për të shijuar jazz-in e gjallë dhe inovativ.

Elina Duni & Rob Luft Band - Elina Duni, vokalistja e njohur shqiptare me famë ndërkombëtare dhe kitaristi britanik Rob Luft prezantuan repertorin e tyre unik që përzier tingujt tradicionalë shqiptarë dhe kosovarë me jazz-in bashkëkohor. Në këtë koncert të veçantë, Duni dhe Luft u shoqëruan nga dy muzikantë të talentuar: Kiril Tufekcievski në kontrabas dhe Viktor Filipovski në bateri, duke krijuar një ansambël që përfaqëson një ndërthurje të shkëlqyer të muzikës folk dhe jazz.

Datë 1 shtator 2024

Studentet e kursit jazz patën mundësinë dhe fatin të luajnë në JamSession me artistët të ftuar në “Shkodra Jazz Festival”. Klasa e frymës, të shoqëruar nga trombetisti me famë ndërkombëtare Gabriel Oscar Rosati, klasa e bass-it me Flavio Piantoni, nën shoqërimin e kompozitorit Markelian Kapidani, dhuruan për publikun një spektakël të vërtetë Jazz.

Shkodra N’festë: E kthyer tashmë në traditë, si çdo fundvit, edhe këtë vit u realizua projekti kulturor “Shkodra n’fest”, aktivitet i cili synon të kthejë qytetin në një atmosferë festive, në kuadër të festave të dhjetorit.

Gjate gjithë muajit dhjetor u realizun rreth 25 koncerte, me artiste lokal dhe kombëtar te cilet mbushen plot sheshin para bashkisë Shkoder.

Të ftuar : Three dots, Alban Skenderaj, Juliana Pasha & Band, Capital T, Dafina Zeqiri , Frederik Ndoci, Eugent Bushpepa, Mateus Frroku, Olimpia Smajlaj, Bruna Sata, Bujar Qamili, Rosela Gjylbegu, Justina Alija, kori i qendres kulturore të fëmijëve “Kujtim Alija”. Laorjan Ejlli, Savjana Vjerdha, Mukades Çanga, Rezarta Smaja.

U realizua koncerti i Krishtlindjes nga mjeshtri Zef Çoba, i cili krijoi një atmosferë magjike në vigljet e kësaj nate.

Per ta mbyllur viti, Bashkia Shkoder kishte të ftuar special Eugent Bushpepën i cili ndezi dhe elektrizoi gjithë qytetën në natën e ndërrimit të viteve.

P08220.Q1.O3.A16 - Ndërmëndje

Me date 29 dhjetor 2024, teatri Migjeni- Koncerti Gala me pjesëmarrjen e orkestrës simfonike, me të ftuar artistë ndërkombëtar dhe kombëtar.

Performanca LIVE e Orkestrës Simfonike të qytetit me vepra madhore koncertore si dhe pjesëmarrja e formacioni Big band , i dhanë vlera dhe momente të spikatura artistike kësaj mbrëmje Galá.

Nën dirigjimin e mjeshtrit Jetmir Barbullushi , Orkestra Simfonike e Shkodrës performoi kryevepra botërore dhe ato të artit shqiptar duke i dhuruar publikut një natë magjike.

Këtë vit “Ndërmëndje” përveç pjesëve klasike, solli edhe pjesë të repertori modern shqiptar dhe të huaj, moment i cili krijoi shumë atmosferë festive në sallën e Teatrit Migjeni me duartrokitje pa fund.

Në skenën e Teatrit Migjeni u ngjiten artistë të rinj dhe të arfirmuar si:

Josif Gjipali – Tenor

Ardita Meni – Soprano

Frederik Ndoci – Këngëtar

Klodiana Brahimi – Soprano

Laorjan Ejlli – Tenor

Blerta Cina – Soprano

Savjana Vjerdha – Kengetare

Ademir Fresku – Këngëtar

Markelian Kapidani – Kompozitor/ pianist

Kejdi Barbullushi – Kitarrë

Kori i Qendrës Kulturore “Kujtim Alija”

Kori Polifonik “Prenkë Jakova”: nën dirigjimin e Gjon Shllaku

Aktiviteti “Ndërmëndje” zgjati 1 orë e 30 dhe pati një impakt të jashtëzakonshëm tek publiku në sallë.

Drejtor Artisti i ‘Ndërmëndje’ 2024 - Gjon Shllaku

Dirigjent i Orkestës Simfonike - Jetmir Barbullushi

Drejtues Organizativ – Agron Grami, Dritan Mlika

Konsulent Artistik – Ergys Pirani

Koordinator – Fation Tanazi

Skenariste – Rozafa Shpuza

Skenograf- Divni Gushta

Modetore: Erlinda Kavaja.

P08220.Q1.O3.A17 Karnavalet

“**Rrugët e Shkodrës n’Karnaval**” Karnavalet e Shkodrës janë një traditë e hershme që zhvillohen në Shkodër gjatë muajit shkurt dhe këtë vit organizimi kishte përfaqësi edhe nga qytetet e Korçës dhe Tuzit duke marrë përmasa gjithëpërfshirëse.

Qëllimi i aktivitetit ishte që të krijohej një atmosferë e cila ndërthur traditën e kulturën e zonave të ndryshme që u bënë bashkë në tre ditë festë: 23, 24, 25 shkurt. Përpos kësaj, promovimi i kulinarisë dhe përfshirja tek programi artistik, parada, e shkollave 9 vjeçare dhe të mesme nga rrethinat plotësuan panoramën me të gjithë elementët.

Këtë vit nën drejtimin artistik të Zef Cobës dhe Sonela Piranit, aktiviteti nisi me festën e fëmijëve datë 23 shkurt ku u angazhuan 32 shkolla 9 vjeçare, ata e nisën festën me parada nga shkollat e tyre drejt sheshit para Bashkisë për ta vazhduar festën në Teatrin “Migjeni” me performanca të përgatitura nga vetë nxënësit dhe me të ftuar special si grupi I kërcimit të koreografit Aldo Nikaj.

Njejtë edhe për datën 24 shkurt e cila në ndryshim nisi me paradën e gjimnazeve. Ata performuan gjithashtu në Teatrin “Migjeni” dhe performancat e tyre u pasuan me artistë të ftuar si grupi muzikor “Brios”, Arlinda Sinani, apo grupi I kërcimit I drejtuar nga Muhamir Saiti. Dy ditë të mbushura me performanca në kujdesin e skenarit të Evis Muriqit.

Nga këto grupe u përzgjedhën më të mirët nga një juri e ngritur për vlerësimin e tyre e përbërë nga Amila Gjyrezi, Gjon Stefa, Drande Xhai, Rafael Hoxhaj dhe Elhaid Alija që morën pjesë tek Karvani i datës 25 shkurt. Një karvan I udhëhequr nga Banda frymore e qytetit dhe I pasuar nga makinat e artistëve, në drejtimin e Gjon Stefa dhe interpretuesit që performonin muzikë dhe bejta të shkruara nga Besnik Cinari dhe Qazim Çelaj, si: Edmond Halilaj, Drande Xhai, Markerit Hila, Jozef Marashi, Erikllita Hoxha, Anuncja Camaj, Gac Kodrina, Isuf Coku, Fritz Selmani, Aleksander Prenga.

Pas paradës festa vijoi me koncertin para Bashkisë, ku aktorët, orkestra e Teatrit “Migjeni” dhe këngëtarët si, Rezarta Smaja, Ademir Fresku, Savjan Vjerdha, Martina Serreqi, Laorjan Ejlli, Ketlin Pjalmi dhanë spektakël për publikun. Pas koncertit të gjithë bashkë ju drejtuan sheshit “Nënë Tereza” për të djegur dordolecin e realizuar nga artisti Orgito Qose .

Festa vazhdonte me datë 23 dhe 24 pasdite me puntoritë e ndryshme në ndërtimin e maskave me skenografinë e Majlinda Zeqo dhe kujdesin e Venice Art, kllounata të drejtuara nga Rafael Hoxhaj dhe facepainting, gjithashtu darkave me light shoë të përgatitur enkas për fasadën e Bashkisë dhe me një

koncert brënda ambienteve të Bashkisë me të ftuar këngëtarët më në zë si Frederik Ndoci, Let's Killua dhe performuese akrobate dhe fire shoë me regjinë e Fiona Rushiti.

Gjithashtu një grup artistësh I përbërë nga aktorë dhe muzikantë të kryesuar nga Adori Dhima të veshur me kostume Veneciane ndricuan rrugët e qytetit duke performuar.

P08220.Q1.O3.A18 Festivali mbarëkombëtar i humorit në Shkodër ”

11 – 15 Dhjetor 2024 Teatri “Migjeni” realizoi me sukses per 5 net rradhazi Festivalin Mbarëkombëtar të Humorit. Ky festival ishte një urë lidhëse midis artistëve dhe publikut të trevave shqipfolëse, duke përfshirë Shqipërinë, Kosovën, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe komunitete të tjera shqiptare.

Festivali ishte konceptuar në një format dinamik, duke përfshirë ëorkshop-e, diskutime tematike dhe shfaqje të shumëllojshme skenike çdo mbrëmje. Kjo kombinim ka ndihmuar jo vetëm në argëtimin e publikut, por edhe në zhvillimin teorik dhe praktik të humorit si formë arti.

Aktivitetet kryesore; Punëtoritë tematike (Workshops): Të mbajtura nga personalitete të njohura të skenës dhe letrave shqiptare si Bujar Kapexhiu, Haxhi Rama, Zija Vukaj dhe Filip Çakuli.

Shfaqje Skenike: Përfshirje e 50 artistëve nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut.

Risi: Prezantimi i filmave të shkurtër humoristikë, duke sjellë një frymë të re dhe moderne në Festival.

Aktorët që morën pjesë në edicionin e parë të “Festivali Mbarëkombëtar i Humorit në Shkodër ” ishin : Agron Llakaj, Xhevahir Zeneli , Behar Mera, parodistët e vlorës: Afrim Agalliu, Agron Amo, Muharrem Hoxha, Sevdai Radogoshi, Sejfulla Myftari (Cekja) dhe Rexhep Ustaj.

Stand-up comedy : Asim Sopi Memishi, Avni Shkodra, Kushtrim Qerimi, Valina Muçolli, Marin Orhanasi, Edi Oga, Akil Varfi, Tan Brahimi, Gent Hazizi dhe Besnik Mustafaj.

Aktorët e mirënjohur të estradës së Shkodrës : Zyliha Miloti, Besnik Çinari, Drande Xhaj dhe Edmond Halili.

Aktorët e rinjve: Fritz Selmani, Aleksandër Prenga, Nikolin Ferketa, Evis Muriqi, Amelia Krosaj, dhe Lusi Bregu,

Gjatë këtyre 5 netëve morën pjese këngëtarët: Mukades Çanga, Laorjan Ejlli, Orjeta Kelaj, Savjana Vjerdha dhe Rrezarta Smaja, të shoqëruar nga orkestra e teatrit “Migjeni”.

Festivali u moderua nga Savjana Verdha dhe Ketlin Pjalmi.

P08220.Q1.O3.A19 Realizim I aktiviteve te Teatrit Migjeni

Teatër Kukullash “Mbretëresha e Borës”

Teatri “Migjeni” prej disa vitesh ka si prioritet rikthimin e traditës së shfaqjeve për fëmijë dhe teatrin e kukullave, si mënyra më e mirë e afrimit të fëmijëve me teatrin.

Teatri “Migjeni” vitin 2024 e ka hapur me një shfaqje dedikuar spektatorit me të mirë, fëmijëve.

Me regji të Merita Smajës, me datën 10.02.2024 është shfaqur premierë “Mbretëresha e Borës” e përshtatur nga Shegushe Bebeti dhe me një skenografi me projeksion që vjen për herë të parë në skenën e Teatrit “Migjeni” përgatitur nga Divni Gushta.

“Mbretëresha e borës” krijoi në ato ditë dimri me diell një atmosferë magjike për fëmijët, të cilët e ndoqën me prindërit e tyre këtë shfaqje. Kjo pjesë ishte plot vlera argëtuese, artistike dhe shumë edukuese, për fëmijët. Fëmijët po e ndejnë më shumë rëndësinë e skenës, po e prekin skenën, në botën digitale, ku kompjuteri ka një vend të rëndësishëm dhe i zë një pjesë të mirë të kohës.

“Mbretëresha e Borës”, u interpretua nga Drande Xhaj, Merita Smaja, Astrit Fani, Fritz Selmani dhe Gjovalin Kolaj, e cila u shfaq 12 herë dhe u ndoq prej rreth 3200 fëmijëve.

“Festival Teatri me shkollat e mesme”

Shkollat e mesme gjatë këtyre viteve janë përfshirë në disa iniciativa teatrore, siç është edhe projekti “Festival teatri me shkollat e mesme”. Në këtë aktivitet u përfshinë disa nga gjimnazet publike dhe jopublike të territorit të Bashkisë Shkodër të cilët nën përkujdesjen e aktorëve të teatrit “Migjeni” gërshetuan interpretimet e veprave të ndryshme.

Pas shumë javësh prova, nxënësit e nëntë shkollave pjesëmarrëse, u ngjiten në skenën e Teatrit Migjeni dhe interpretuan pjesët e përgatitura.

Me datë 11 Mars 2024 në skenën e Teatrit Migjeni u ngjit shkolla e mesme “Jordan Misja” me pjesën “Parathania e Parathanies”, me regji nga Jozef Shiroka;

Me datë 12 Mars 2024 në skenën e Teatrit Migjeni u ngjit shkolla e mesme “28 Nëntori” me komedinë “Pallati 176”, me regji nga Fritz Selmani;

Me datë 13 Mars 2024 në skenën e Teatrit Migjeni u ngjit shkolla e mesme “Hamdi Bushati” me pjesën “Sokaku i të marrve” me regji nga Vladimir Doda;

Me datë 14 Mars 2024 në skenën e Teatrit Migjeni u ngjit shkolla e mesme “Adem Haxhija” – Postribë, me pjesën “Ariu”, me regji nga Simon Shkreli;

Me datë 15 Mars 2024 në skenën e Teatrit Migjeni u ngjit shkolla e mesme “At Pjetër Meshkalla” me komedinë “14 vjeç dhëndërr”, me regji nga Aleksandër Prenga;

Me datë 16 Mars 2024 në skenën e Teatrit Migjeni u ngjit shkolla e mesme “At Gjon Karma” - Gur i Zi, me pjesën “E djegur për së gjalli”, me regji nga Nikolin Ferketa;

Me datë 17 Mars 2024 në skenën e Teatrit Migjeni u ngjit shkolla e mesme “Shejnaze Juka” me pjesën “Noemi”, me regji nga Gerti Palali;

Me datë 18 Mars 2024 në skenën e Teatrit Migjeni u ngjit shkolla e mesme “Prenkë Jakova” me pjesën “Njohja në internet”, me regji nga Raimonda Marku;

Me datë 19 Mars 2024 në skenën e Teatrit Migjeni u ngjit shkolla e mesme “Oso Kuka” me pjesën “Fëmijët e rrugës”, me regji nga Merita Smaja.

Juria e “Festival Teatri me shkollat e mesme” ishte e përbërë nga : Arian Çuliq (Kryetar) , Drande Xhaj, Zija Vukaj, Krist Lleshi dhe Akil Varfi, të cilët vlerësuan me këto çmime këtë edicion:

“Shfaqja më e mirë” - Shkollat “Shejnaze Juka dhe Jordan Misja”.

Aktori më i mirë (Dramë) - Arenc Radaj, nxënës i shkollës “Adem Haxhija” , Postrisë.

Aktorja më e mirë (Dramë)- Elisavet Alija, nxënëse e shkollës “Shejnaze Juka”.

Aktori më i mirë (Komedi)- Jozef Marashi, nxënës i shkollës “Atë Pjetër Meshkalla”.

Aktorja më e mirë (Komedi)- Hulja Efovija, nxënëse e shkollës “28 Nëntori”.

Aktori më i mirë (Joprotagonist)- Adrian Paloka, nxënës i shkollës “Atë Pjetër Meshkalla”.

Aktorja më e mirë (Joprotagoniste)- Amelja Krosaj, nxënëse e shkollës “28 Nëntori”.

Mirënjohje për shkollën debutuese “Atë Pjetër Meshkalla”.

Festival Teatri me shkollat e mesme mbushi skenën ku interpretuan 113 nxënës dhe sallën e Teatrit Migjeni me plot 3000 nxënës në nëntë netë.

Kthimi në traditë i një aktiviteti të tillë krijon mundësinë e rritjes profesionale të brezit të ri dhe afrimin e tij me artin skenik. Tematika e interpretimit do të bazohet në shkrimtarët më të mirë të letërsisë shqiptare dhe të huaj.

“Shfaqja që shkon keq” një komedi e shkruar nga Henry Leëis, Jonatan Sayer, u vu në skenë nga Fritz Selmani dhe Gerti Palali. Me pjesëmarrjen e aktorëve të rinj të projektit “Festival Teatri me shkollat e mesme” si: Arenci Radaj, Evis Muriqi, Jozef Marashi, Orgen Osja, Hulja Efovija, Adrian Paloka, Amelja Krosaj shfaqja dhuroi plot situata komike duke mbushur sallën e teatrit për disa ditë me rradhë. Kjo shfaqje vertetoi talentin dhe pasionin e të rinjve për teatrin.

Komedia “Krimi është vetëmi imi”, i Autorëve francez George Berr dhe Louis Verneil, erdhi në një variant të përshtatur nga regjisorja Driada Dervishi Jani dhe u vu në skenën e Teatrit Migjeni në datat 11-13-14-15 Shtator 2024.

Përgatitjet për këtë projekt teatror filluan që herët, me prova gjatë muajve qershor, korrik, gusht 2024 me të gjithë trupën e aktorëve pjesëmarrës.

Komedia “Krimi është vetëmi imi” bëri sëbashku aktorët e Teatrit Migjeni si: Pjerin Vlashi, Merita Smaja, Jozef Shiroka, Fritz Selmani, Nikolin Ferketa me aktorët e mirnjohur të skenës shqiptare si: Olta Daku, Neritan Liçaj, Romir Zalla, Rudina Dembacaj, Linda Jarani, me pjesëmarrjen e aktorit të mrekullueshëm Besnik Çinari, të cilët i dhuruan publikut shkodranë një shfaqje komedi të një niveli të lartë artistik. Mjeshtri Zef Çoba kompozoi pjesët muzikore të kësaj shfaqje, të cilat u luajtën nga orkestra e Teatrit Migjeni. Salla e Teatrit Migjeni për tre net rradhazi ishte e mbushur plot, duke i dhuruar aktorëve në skenë duartrokitje pafund.

Kjo shfaqje mori pjesë në festivalin Mbarëkombëtarë të Komedisë “KOKO Fest”, ku dha shfaqjet e veta duke përfaqësuar Teatrin “Migjeni”, i cili u zhvillua në Korçë.

Komedia “Krimi është vetëmi imi” on tour u zhvillua në Tiranë për 3 net rresht në sallën e Universitetit të Arteve në datat 12 dhe 13 tetor 2024.

Ndërsa në datat 6 dhe 7 nëntor 2024 komedia u shfaq në Teatrin “Aleksandër Moisiu”.

Në vitin 9.10 . 2024 shfaqja “Vizita” mori pjesë në Festivalin Ndërkombëtar të Teatrove MESS,Sarajevë, në edicionin e tij të 64-t, një festival i kategorisë A. Festivalin Ndërkombëtar të Teatrove MESS është më i vjetër i teatrit në Ballkan dhe një nga më të mëdhenjtë në Evropën

Juglindore. Shfaqja "Vizita" e regjisorit Davide Iodice është shpallur fitues i Çmimi i medias "Oslobodjenje". Trupa e Teatrit Migjeni është e para trupë teatrore në Shqipëri që merr pjesë në një festival të përmasave të tilla ndërkombëtare e cila vlerësohet me një çmim kaq të rëndësishëm, një moment historik për Teatrin Migjeni dhe qytetin e Shkodrës.

Trupa fituese ishin aktoret: Rita Gjeka Kacarosi, Pjerin Vlashi, Jozef Shiroka, Fritz Selmani, Julinda Emiri, Nikolin Ferketa, Aleksander Prenga, Vladimir Doda, Merita Smaja, Raimonda Marku.

Opera per tre grosh - Shfaqja "Opera për tre grosh" e Bertolt Brecht, me regji nga Kuniaki Ida, u realizua me sukses në Teatrin "Migjeni", Shkodër.

Një aspekt kyç i kësaj shfaqjeje ishte bashkëpunimi mes aktorëve nga Kosova dhe Shqipëria, të cilët punuan së bashku me trupën e Teatrit Migjeni. Në skenë morën pjesë gjithsej 14 aktorë.

Skenografia e dizajnuar nga Divni Gushta krijoi një atmosferë ekspresive dhe groteske, duke e bërë skenën një pjesë integrale të veprës.

Kostumet, të krijuara nga Ilirjane Basha, reflektonin stilin e kohës moderne dhe plotësonin idenë ekspresive të Brecht-it. Grimi grotesk, nën kujdesin e Albert Shirokës, shtoi një dimension të veçantë vizual në transformimin e aktorëve.

Ndriçimi i Arben Meshnunit ndihmoi në krijimin e zhvendosjeve ambientale dhe emocionale, ndërsa muzika e përpunuar nga Markelian Kapidani theksoi dramatin e situatave skenike. Koreografitë i shtuan një energji të veçantë lëvizjeve dhe performancës së aktorëve.

Shfaqja u ndoq nga personalitete të shquara si ambasadorja japoneze dhe ambasadori gjerman, si dhe ish-ambasadori japonez. Publiku reagoi pozitivisht në të gjitha netët e shfaqjes, duke përjetuar thellësisht mesazhet sociale dhe artistike të veprës. Duartrokitjet e gjata në fund ishin një dëshmi e suksesit të kësaj pune të përbashkët.

Aktorët që morën pjesë: Refael Hoxhaj, Bujar Hoxhaj, Merita Smajaj, Zana Berisha, Pjerin Vlashi, Jozef Shiroka, Vladimir Doda, Nikolin Ferketa, Fritz Selmani, Aleksander Prenga, Vlora Dervishi.

Aktorët e rinj: Denisa Luanaj, Evis Muriqi dhe Vitmir Alikokej.

Musical Matilda - Për herë të parë në skenën e Teatrit Migjeni u realizua një Musical, risi e cila mbushi sallën e teatrit me publikun kryesor, fëmijët.

Shfaqja teatrale muzikore "Matilda", frymëzuar nga kryevepra e Roald Dahl, përqendrohet tek Matilda Ęormëood, një vajzë pesëvjeçare e cila me dhuntinë e telekinezës, e cila i pëlqen të lexojë, kapërcen pengesat e shkaktuara nga familja dhe shkolla e saj dhe ndihmon mësuesin e saj të rimarrë jetën e saj. E risjellur nga një trupë e talentuar aktorësh të vegjël së bashku me aktorët profesionistë, personazhet e musical Matilda do të mbeten gjatë në mendje.

Me koreografinë e Kozeta Bakiut, skenografinë e Divni Gushtës dhe regjinë e Gerti Palalit, shfaqja solli një spektakël emocionues për fëmijët dhe të rriturit.

Pjesë e këtij projekti ishte dhe pjesëmarrja e fëmijëve të qendrës kulturore të fëmijëve “Kujtim Alija”, të cilët iu bashkuan projektit përmes interpretimit të disa pjesëve muzikore.

P08220.Q1.O3.A20 Realizimi I aktiviteteve t e Galerise se Arteve

Takimet publike “Biseda publike mbi artin, ëorkshop me artiste të rinj dhe studentë

Me date 16- Mars2024, sipas traditës tashmë të krijuar në Galerinë e Arteve Shkodër zunë vend Takimet publike të radhës me të ftuarit artistin Z.Jon Kraja(emri i artit) ID Gjon Kraja dhe Prof. Asc.Dr . Ardian Isufi të lëndës së Grafikës në Universitetin e Arteve Tiranë.

Ky takim u shqua për nga fryma e diskutimit pas hyrjes që ju bë prezantimit të ekspozitës “SPECTACOLUM” duke e hedhur diskutimin kryesisht me karakter filozofik dhe estetik në drejtim të publikut I cili u përfshi në çështje sensitive që diskutonte roli I artistit, kuratorit dhe impakti I veprës në hapsirën publike.

Ky aktivitet si qëllim ka çdo herë edhe kësaj radhe krijimin e mundesive pjesmarrëseve të mësojnë dhe t’ a zhvillojne debatin mbi tema të caktuara me synim implementimin e standarteve që rrjedhin nga debate për në hapsirën ku jetohet e krijohet. Ky diskutim u ndoq nga student, letra, professor, artiste, mediave. etj

Diskutimi në vetevete shtronte nevojën e shpeshimit të këtyre takimeve në të ardhmen.

Ky panel u shoqërua nga një vëmendje e gjërë e medias lokale.

Personazh i Ftuar -Galeria e Arteve 7 shtator - Ekspozitë personale e një personaliteti si Besim Tula

Programet e edukimit artistik ne partneritet me individe dhe shoqata kulturore – Galeria e Arteve

25-26 tetor - Wokshope nga artiste me pjesemrren e studenteve te artit pamor. Në përfundim të ëorkshopit u realizua ekspozite nga studentet.

Konkursin “Salloni I Vjeshtës” Edicioni i 18-te, titulluar “Vjeshta, stina e dashurisë dhe krijimtarisë.”

U realizua me 26 nentor me pjesemarrjen e 75 artisteve dhe u kurua nga Dr.Mikel Temo.

P08220.Q1.O3.A21 Orkestra Simfonike

Orkestra Simfonike e Qytetit të Shkodrës e perbere prej 52 personash, janë mbështetur me honorare për 10 muajt të vitit.

Ky formacion realizoi aktivitetet të rëndësishme si : Koncert Premiere “Shkodra nën Tingujt e Muzikës së Filmit Shqiptar, Koncert “Ramë Lahaj and Friends” dhe Ndërmëndje.

P08220.Q1.O3.A22 Aktivitete ne partneritet me te trete

Bashkia Shkoder ka planifikuar aktivitete “Ne mbeshtetje të grupeve rinore” me ane te te cilit, synon promovimin e artit si gjithëpërfshirës si veprimtari sociale dhe integruese ne sherbim te rritjes të nje brezi të ri të shëndetshëm.

“Pranvere me këngë”, koncert i cili u vleresua me një impakt pozitiv tek qytetarët, u zhvillua ne datat 12 dhe 13 prill 2024 ne Teatrin Migjeni. Nën udhëheqjen e Maestro Ilir Zoga, ky koncert shfaqti para

publikut një repertor të larmishëm ku u përfshin këngë shqipëtare por edhe të huaja nën interpretimin e artistëve të afirmur dhe të rinj të qytetit. Me pjesëmarrjen e artitëve si: Leonora Çuliqi, Glerdit Turmetaj, Ademir Fresku, Niki Mjeda, Bruna Sata, Ylber Tahiri, Arsen Muça, Irian Taraboshi, Blerta Cina, Martina Serreqi, Ana Bushgjokaj, Ea Zoga, Ester Qendro, Selma Bekteshi, Sevina Kurti, Rigersa Loka, Viki Haxhi, Rodolf Çeklijaj, Anton Guri, Gjergj Marku, koncerti zgjati për 2 ore duke mbushurr plot sallen e Teatrit Migjeni në të dyja netet.

Moderator të koncertit “Pranvere me Kenge” ishin : Ketlin Pjalmi dhe Fritz Selmani.

“**Sanfest**”- Data 1 qershor 2024 - Aktiviteti filloj paraditen e datës 1 qershor, ku ishin organizuar lojra për fëmijë, aktivitete ujore dhe aktivitete sportive në rërë, të cilët krijuan një atmosferë të jashtëzakonshme në plazhin e Rrjollit, Velipojë.

Koncerti i natës së parë solli në skenën e SANFEST 2 banda të cilët përformuan live si : Peter Pan Quartet dhe Alban Ninami si dhe katër dj të ndryshëm: Amor del rey, Lab Sadiku, All Shadoës dhe Secret 47. Koncerti zgjati deri në orët e para të mëngjesit.

Data 2 qershor 2024 -Koncerti i natës së dytë kishte të ftuar dy grupe të tjera: Dren Abazi Band dhe Ron Gjura Band. Pas performancesë së dy grupeve festa vazhdoi me dj: Hektor Jubani, Amer Doux, Bani D, Chriss V dhe Mr Cool duke e zgjatur festën deri në lindjen e diellit.

Skenografia u mundësua nga kompania Piano Event. Ku ishte vendosur ndriçimi i skenës dhe Ledëall ku u shfaqen pamje nga Shkodra mbi promovimin e turizmit si dhe partneret mbështetës.

“**Festivale të Artit Audiovizual**”- u zhvillua në datat 5 deri me 9 Qershor 2024 në pika të ndryshme të qyteti . “Festivale të Artit Audiovizual” e titulluar “Ekran i Artit” nga subjekti, u konceptua mbi temën Solitude and Multitude. “Ekran i Artit” synoi ruajtjen e fokusit mbi spektatorin e vëmendeshëm ndaj filmit dhe video artit por duke e pasuruar festivalin me kontribute të tjera që e çojnë dialogun me qytetin në një stad të ri përfshirjeje edhe që e bëjnë atë tërheqës për një publik mbarëkombëtar e ndërkombëtar.

Objekti parësor i këtij edicioni ishte rikthimi i vëmendjes ndaj Kinemasë së qytetit dhe riaktivizimi i saj me realizimin e një programacioni të pasur me filma, njëkohësisht duke mbajtur dialogun me hapësira alternative si Galeria e Arteve, Art House, VDK , Qendra Rinore Arka, Kalaja Rozafa dhe Auditori Françeskan. Në ditët e edicionit të sivjetshëm të festivalit Ekran i Artit, Shkodra mikpritit artistë e personalitete të artit, kulturës dhe mendimit intelektual shqiptar e ndërkombëtar.

P08220.Q1.O3.A23 Honorare Këshilli Arstistik I Bashkisë Shkodër.

Jane kryer pagesat për antaret e keshillit artistik të Bashkisë Shkodër për 6 mbledhjet e realizuara në 12 muajt të vitit 2024.

P08220.Q1.O3.A24 Sherbime fonie, skene dhe ndricimi për aktivitetet e kultures

Është kryer procedura e prokurimit, është lidhur kontrata dhe është zbatuar gjatë vitit.

P08220.Q1.O3.A25 Shpenzime per mirembajtjen e funksionimin e kinemase publikeeshte realizuar mirembajtja dhe sherbime operative nga Drejtoria e Pergjithshme e mMirembajes se Objekteve Publike..

P08220.Q1.O3.A26 Blerje paisje fonie, ndricimi dhe materiale skenike per Teater Migjeni eshte realizuar .

P08220.Q1.O3.A27-28 Instalimi I sistemit te ngrohjes dhe ftohjes Teatri Migjeni do te realizohet ne vazhimesi .

P08220.Q1.O3.A29 Cmimi "Pjeter Gaci" te trasheguara,

P08220.Q1.O1 .A1 "Java e Pavarësisë dhe e Çlirimit" Ekspozitë me karakter historik dhe artistik te trasheguara ,eshte realizuar videoja promovuese e publikuar ne websitin e bashkise.

P08220.Q1.O3.A37 Aktivitete artistike kulturore ne mbeshtetje te grupeve rinore artistike te trasheguara,

P08220.Q1.O3.A44 "Shkodra qyteti i festave" te trasheguara,

P08220.Q1.O3.A23 Pjesë Teatrore 2 & te trasheguara ,

P08220.Q1.O2.A3 Periodiku Gegnia te trasheguara,

P08220.Q1.O3.A2 Administrimi dhe Menaxhimi i Qendres Kulturore "Pjeter Gaci" & te trasheguara,

P 08220.Q1.O3.A3 Orkestra Frymore Honorare vjetore te trasheguara,

P08220.Q1.O3.A7 “Honorare ” Grupi i Valleve” te trasheguar,

P08220.Q1.O3.A8 Festivali i Këngës Qytetare “Luleborë”te trasheguara,

P08220.Q1.O3.A11 Festival burimor te trasheguara,

P08220.Q1.O3.A30 Ekspozita “Salloni i vjeshtës ”te trasheguara,

P08220.Q1.O3.A35 Orkestra Simfonike te trasheguara ,

P08220.Q1.O3.A36 Takim nderkombetar I bandave frymore te trasheguara , jane projekte te trasheguara nga viti 2023 nga ish institucionet Teatri Migjeni dhe D.E.Kultures te likujduara gjate vitit 2024.

FUNKSIONI 9: ARSIMI

Programi 09120 : Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor.

Arsimi parauniversitar:

Qëllimi i programit të Planifikimit, Menaxhimit dhe Administrimit është:

I. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar;

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre funksioneve për vitin 2024 janë:


1.1. Sigurimi i mjediseve dhe objekteve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor në sistemin parauniversitar dhe parashkollor

1.2. Organizimi i aktiviteteve dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre aktiviteteve.

1.3. Krijimi i ambienteve dhe mjediseve të sistemit arsimor bazë dhe parashkollor, të sigurtë konform standarteve ligjore.

Realizimi i Buxhetit të planifikuar:


| Programi 09120 | Paga & sigurime | Shpenzime operative | Transferta | Investime | Totali |
|------------------------|-----------------|---------------------|------------|-----------|---------|
| PBA 2024 | 309,971 | 108,957 | - | 55,259 | 474,187 |
| Plani fillestar 2024 | 379,615 | 123,014 | 140 | 70,249 | 573,018 |
| Plani i rishikuar 2024 | 357,204 | 132,787 | 10,784 | 136,894 | 637,669 |
| Realizimi viti 2024 | 272,651 | 67,233 | 10,784 | 6,539 | 357,207 |
| % e realizimit | 76.3% | 50.6% | 100.0% | 4.8% | 56.0% |



Realizimi i shpenzimeve në total është 56% e ndarë si më poshtë:

| | |
|--------------------|-------|
| Shpenzime korente | 70.0% |
| Shpenzime kapitale | 4.8% |

Realizimi i shpenzimeve sipas zërave



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:

Për shkak të kohës së fillimit të aktivitetit të saj dhe kryerjes së disa procedurave që mundësojnë fillimin e aktivitetit, DPMOP është në proces të projektimit të investimeve të planifikuara në buxhet. Pjesa tjetër, është në proces prokurimi.

Shërbimi i sistemit të sigurisë në objekte ka kontratë deri me 11.01.2025. Ndërkohë është likuiduar nga obligimet e vitit të kaluar.

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: viti 2024

| Kodi i Programit | 9120 | Emertimi i programit: | Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor. | | | | | |
|--|---|---|---|--------------------------------------|------------------------------------|---------------------------------------|--|------|
| Qellimi 1 | Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar; | | | | | | | |
| **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhës | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/Produkti | |
| Objektivi 1.1 | Sigurimi i mjediseve dhe objekteve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor në sistemin parauniversitar dhe parashkollor. | 1 | Numri I kopshteve | 55 | 55 | 55 | 51 | 93% |
| | | 2 | Numri I femijeve qe frekuentojne kopshtet | 1725 | 1725 | 2000 | 1712 | 86% |
| | | 3 | Nr punonjeshish staf mbështetës në arsimin baze | 1310 | 1310 | 1174 | 1174 | |
| | | 4 | Numri i shkollave ne arsimin 9-vjecar; qytet/fshat | 67 | 67 | 75 | 75 | 100% |
| | | 5 | Nr i shkollave qe ngrohen me dru zjarri | 52 | 64 | 50 | 50 | 100% |
| | | 6 | Nr i shkollave qe ngrohen me kaldaja dhe naftë | 3 | 3 | 9 | 9 | 100% |
| | | 7 | Nr i shkollave qe ngrohen me gaz | 12 | 0 | 6 | 6 | 100% |
| | | 8 | Nr I shkollave me sherbim sigurije | 50 | 50 | 26 | 26 | 100% |
| Objektivi 1.2 | O2. Organizimin e aktiviteteve dhe promovimin e identitetit kombetare e local,si dhe administrimin e objekteve qe lidhen me ushtrimin e ketyre aktiviteteve | 9 | Numri I nxenesve pjesemarres ne aktivitete kulturore ,sportive dhe argetuese per femije total | 14000 | 14000 | 14000 | 6130 | 44% |
| | | 10 | Numri I nxenesve pjesemarres ne aktivitete kulturore ,sportive dhe argetuese per femije vajza | 8460 | 8460 | 5960 | 4585 | 77% |
| Objektivi 1.3 | O3. Krijimi i ambjenteve dhe mjediseve te sistemit arsimor baze dhe parashkollor., te sigurte konform standarteve ligjore. | 11 | Nr I shkollave qe do te nderhyhet nj. Admin. | 10 | 6 | 20 | 20 | 100% |
| | | 12 | Nr I shkollave qe do te nderhyhet Qytet | 8 | 5 | 20 | 20 | 100% |
| | | 13 | Nr shkollave qe do rikonstruktohen | 4 | 2 | 2 | 1 | 50% |

ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 | | | | | | | | | | | | | | |
|---------------|--|------------------------------------|---------------------------|---------------------------------|------------------------------------|------------------------------------|--|--|---|--|---|---------------------------|--------------------------------|-------------------------------------|------------------------------|-------------|--------------|
| Programi | Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor. | Kodi i Programit | 9120 | | | | | | | | | | | | | | |
| | në 000/lekë | | | | I | | | II | | | III | | | IV | Luhatjet në Koston për Njësi | | |
| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (viti 2023) | Shpenzi met Faktike (viti 2023) | Kosto për Njësi (sipas vitit 2023) | Sasia (sipas planit të vitit 2024) | Shpenzi met (sipas planit të vitit 2024) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2024) | Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2024) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2024) | Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar viti 2024) | Sasia Faktike (viti 2024) | Shpenzimet Faktike (viti 2024) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2024) | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III |
| 1 | Sherbimet mbeshtetese te stafit te Arsimit Bazë. | Nr I stafit | 345 | 257,798 | 747.2 | 363 | 304,136 | 837.8 | 363 | 363,018 | 1,000.0 | 363 | 279,250 | 769.3 | 22.0 | -68.6 | -230.8 |
| 2 | Objekte te arsimit baze te mirembajtura dhe funksionale | nr i objekteve | 67 | 31,051 | 463.4 | 67 | 74,445 | 1,111.1 | 75 | 97,410 | 1,298.8 | 75 | 45,676 | 609.0 | 145.6 | -502.1 | -689.8 |
| 3 | Femije qe ndjekin kopshtin. | Nr I femijve | 1,725 | 25,691 | 14.9 | 1,725 | 28,145 | 16.3 | 2,000 | 28,145 | 14.1 | 1,712 | 13,130 | 7.7 | -7.2 | -8.6 | -6.4 |
| 4 | Femije qe frekuentojne qendrat kulturore te femijve. | nr I femijve ne qendrat kulturore | 14,000 | 7,818 | 0.6 | 14,000 | 14,602 | 1.0 | 14,000 | 14,602 | 1.0 | 6,130 | 12,933 | 2.1 | 1.6 | 1.1 | 1.1 |
| 5 | Objekte te arsimit baze dhe parashkollor te rikonstruktuar a | nr I objekteve te rikonstruktuar a | 4 | 41,129 | 10,282.3 | 2 | 52,859 | 26,429.5 | 2 | 134,494 | 67,247.0 | 1 | 6,218 | 6,218.0 | -4,064.3 | -20,211.5 | -61,029.0 |

Realizimi i produkteve 12- mujori i Vitit 2024:

Për 12- mujorin e vitit 2024 janë planifikuar dhe realizuar produktet e mëposhtme:

| Produktet | Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi I aktivitetit | Plani fillestar 2024 | Plani I rishikuar 2024 | Realizimi 2024 |
|---|--|--|----------------------------|----------------------|------------------------|----------------|
| | | | | Totali | Totali | Totali |
| Sherbimet mbeshtetese te stafit te Arsimit Bazë. | P09120.Q1.O1 .A1. Mbështetja për punonjësit e arsimit bazë& të trashëguara | Arsimi | Realizuar | 11,334 | 27,346 | 27,346 |
| | Shpenzime per sherbimi I sigurise ne objekte te trashëguara | Arsimi | Realizuar | - | 636 | 636 |
| | P09120.Q1.O1 .A2. Mbështetja e personelit edukator dhe të shërbimit të sistemit parashkollor (paga/sigurime shoqerore) & te trashëguara | Kopshtet | Realizuar | 15,910 | 39,838 | 39,839 |
| | Furnizim me EE dhe ujë për arsimin parashkollor - TE TRASHEGUARA | Kopshtet | Realizuar | - | 229 | 229 |
| | P09120.Q1.O1 .A3. Mbështetja e personelit edukator dhe të shërbimit të sistemit parashkollor (paga/sigurime shoqerore) | Bashkia Shkoder | Realizuar | 141,985 | 152,723 | 111,097 |
| | P09120.Q1.O1 .A4. Mbështetja e personelit mbeshtetese për arsimin bazë. (paga/sigurime shoqerore) dhe stafi I drejtorise | Bashkia Shkoder | Realizuar | 9,226 | 16,565 | 13,070 |
Aktiviteti ka përfunduar, janë kthyer fondet e mbetura dhe gjithashtu nga fondi tepriçë kemi hyrë me projektvendim në këshillin bashkiak për ndryshim destinacioni për mirëmbajtjen e qendrave shëndetësore parësore pas konfirmimit të donatorit.

- Trasferatat e Kushtezura

| Përshkrimi | Buxheti fillestar 000/lekë | Buxheti i korigjuar 000/lekë | Realizimi 12- mujori 000/lekë |
|--|---------------------------------------|---|--|
| P09120.Q1.O1.A13. Fëmijë me aftësi të vecanta që përfitojnë shërbim arsimor cilësor - (Transferate të kushtezuar) | 2,881 | 8,151 | 2,250 |
| P09120.Q1.O1.A14. Paisje mobilimi arsimit baze | 4,418 | 2,628 | 2,628 |
| P09230.Q1.O1.A11 Nxenes që regjistrohet dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë në inst arsimore (Transferate të kushtezuar) | 1,186 | 1,186 | 1,110 |
| P09240.Q2.O1.A24 Nxenes që regjistrohet dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë në inst arsimore (transferate të kushtezuar) | - | 15,495 | 14,916 |
| P09230.Q1.O2.A3 Shkolla e hapur "Kol Idromeno" | | 35,000 | 14,027 |
| P09230.Q1.O2.A4 Paisje mobilimi shkolla Edith Durham dhe Shejnaze Juka | | 8,091 | 8,091 |
| P09240.Q2.O1.A25 Trajtimi ushqimor për konviktet dhe pagese kuotave financiare -bursa (transferate të kushtezuar) | 480 | 480 | 473 |
| Totali | 8,965 | 71,031 | 43,495 |

P09120.Q1.O1.A13.Fëmijë me aftësi të vecanta që përfitojnë shërbim arsimor cilësor - (Transferate të kushtezuar)

Eshtë realizuar blerje artikuj ushqimorë për shkollën speciale 3 Dhjetori

P09230.Q1.O1.A11 Nxenes që regjistrohet dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë në inst arsimore (Transferate të kushtezuar) Eshtë realizuar, kanë përfituar bursa 18 nxenes nga shkollat e mesme të përgjithshme

P09240.Q2.O1.A24 Nxenes që regjistrohet dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë në inst arsimore (transferate të kushtezuar) Eshtë realizuar, kanë përfituar bursa 266 nxenes nga shkollat e mesme profesionale.

P09240.Q2.O1.A25 Trajtimi ushqimor për konviktet dhe pagese kuotave financiare -bursa (transferate të kushtezuar)

Eshtë realizuar, kanë përfituar burse ushqimorë 8 nxenes të konviktit

FUNKSIONI 10 : MBROJTJA SOCIALE

Programi 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”

Ky program përfshin 2 drejtori dhe konkretisht:

1. Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik;
2. Drejtorinë e Ndhmës Ekonomike.

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit.

Qëllimi i I i programit të “**Kujdesi social për familjet dhe fëmijët**”.

Q1 Planifikimi, informimi dhe zhvillimi i shërbimeve sociale multisektoriale dhe të qendrueshme duke u harmonizuar me interesat dhe nevojat e komunitetit. Gjithashtu synojmë mbulimin sa më të plotë të territorit, të Bashkisë Shkodër, duke promovuar gjithëpërfshirjen, pjesëmarrjen, krijimin e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar, gjinisë, origjinës, minoritetit etj.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për vitin 2024 janë:

O1. Mbulim sa më të plotë të territorit me shërbime sociale dhe zhvillimi i aktiviteteve edukuese dhe promovuese në nivel vendor që lidhen me shërbimet e kujdesit shoqëror në bashkërendim dhe harmonizim me strategjitë dhe politikat kombëtare.

Qëllimi i II i programit të “**Kujdesi social për familjet dhe fëmijët**”.

Q2. Administrimi, rregullimi dhe zhvillimi i shërbimeve të sistemit parashkollor për mirërritjen e fëmijëve 0-3 vjeç.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për vitin 2024 janë:

O1. Krijimi, zgjerimi dhe zhvillimi i shërbimeve për fëmijët e moshës 0-3 vjeç.

Qëllimi i III i programit të “**Kujdesi social për familjet dhe fëmijët**”.

Q3. Identifikimi i individëve dhe familjeve në nevojë të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike. Informimi dhe orientimi i qytetarëve për aplikim në skemën e ndihmës ekonomike dhe shërbimet shoqërore ekzistuese nën juridiksionin e bashkisë/njesisë administrative, në territorin e së cilës është banor individ.

Q3/1 Informimi i individëve për kriteret, procedurat dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë për përfitimin e aftësisë së kufizuar. Zhvillimin e aftësive dhe mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore për personat me aftësi të kufizuar.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për vitin 2024 janë:

O1. Programimi dhe menaxhimi i përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit për ndihmën ekonomike dhe PAK, duke respektuar parimet bazë mbi të cilat funksionon skema e ndihmës ekonomike dhe pagesa e personave me aftësi të kufizuar

Qëllimi i IV i programit të **“Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”**.

Q4/1 Krijimi, ndërtimi dhe administrimi i qendrave komunitare për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.

Q4/2. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi me ministrinë përgjegjëse për mirëqënien sociale, donatorët, shoqërinë civile, për krijimin e fondeve për financimin e shërbimeve sociale sipas mënyrës së përcaktuar me ligj

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për vitin 2024 janë:

O1. Ndërtimi dhe administrimi i qendrave që ofrojnë shërbime sociale me orientim promovimin dhe zhvillimin e këtyre shërbimeve.


O2. Krijimi i fondit të dedikuar për financimin e shërbimeve sociale në bashkërendim Bashki - Ministri - Donatorë / Shoqëri Civile.

Në kuadër të mbulimit sa më të plotë të territorit me shërbime sociale duke siguruar gjithëpërfshirjen, pjesëmarrjen, krijimin e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimin për shkak të aftësive të kufizuara, gjinisë, origjinës, minoritetit etj., Drejtoria e Shërbimeve Sociale, ka planifikuar dhe zbaton një sërë aktivitete të shpërndara përgjatë të gjithë vitit.

Realizimi i Buxhetit të planifikuar


Programi: **“Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”**.

| Programi 10430 | Paga & sigurime | Shpenzime operative | Transferta | Investime | 000/leke |
|------------------------|--------------------|------------------------|------------|-----------|----------|
| | | | | | Totali |
| PBA 2024 | 94,970 | 20,116 | 38,583 | 422 | 154,091 |
| Plani fillestar 2024 | 116,502 | 28,733 | 42,213 | 19,876 | 207,324 |
| Plani i rishikuar 2024 | 104,435 | 27,596 | 48,230 | 16,402 | 196,663 |
| Realizimi viti 2024 | 86,786 | 11,402 | 44,233 | 12,016 | 154,437 |
| % e realizimit | 83.1% | 41.3% | 91.7% | 73.3% | 78.5% |



Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është në total 78.5%, sipas zërave kryesorë më poshtë:

| | |
|--|--------------|
| Shpenzimet korrente (paga+sigurime shoqërore, shpenzime operative, transferime) | 79% |
| Shpenzimet kapitale | 73.3% |



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara.

Fondet e planifikuara janë realizuar në masën 78.53%. Disa proçedura prokurimi janë mbartur për t'u realizuar për vitin 2025.

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit
Periudha e Raportimit: viti 2024

| | | | | | | | |
|--|---|---|--|---|---|--|--|
| Kodi i Programit | 10430 | Emertimi i programit: | Kujdesi social për familjet dhe fëmijët | | | | |
| Qellimi 1 | Planifikimi, informimi dhe zhvillimi i shërbimeve sociale multisektoriale dhe të qendrueshme duke u harmonizuar me interesat dhe nevojat e komunitetit. Gjithashtu synojmë mbulimin sa më të plotë të territorit, të Bashkisë Shkodër, duke promovuar gjithëpërfshirjen, pjesëmarrjen, krijimin e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar, gjinisë, origjinës, minoritetit etj. | | | | | | |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | Kodi i Treguesit te Performances/Produktit | Emërtimi i Treguesit të Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit |
| Objektivi 1.1 Mbulim sa më të plotë të territorit me shërbime sociale dhe zhvillimi i aktiviteteve edukuese dhe promovuese në nivel vendor që lidhen me shërbimet e kujdesit shoqëror në bashkërendim dhe harmonizim me strategjitë dhe politikat kombëtare. | 1 | Numri i punonjësve që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror | 21 | 15 | 15 | 15 | 100% |
| | 2 | Numri i fëmijëve të trajtuar në situatë rruge | 69 | 50 | 50 | 44 | 88% |
| | 3 | Numri i familjeve në situatë rruge të mbështetura; | 30 | 20 | 50 | 50 | 100% |
| | 4 | Nr. i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje të përfshirë në programet e përfshirjes sociale | 151 | 70 | 190 | 192 | 101% |
| | 5 | Nr i takimeve të organizuara të Grupit Teknik Ndërsektorial (GTN) | 24 | 30 | 20 | 12 | 60% |
| | 6 | Nr. i aktiviteteve ndërgjegjësuese për promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe parandalimin e formave të keqtrajtimit ndaj të miturve. | 7 | 10 | 10 | 10 | 100% |
| | 7 | Nr. i aktiviteteve ndërgjegjësuese të organizuara në kuadër të ditës së familjes. | 7 | 7 | 13 | 13 | 100% |
| | 8 | Numri i pjesëmarrësve në aktivitetet e organizuara në kuadër të ditës së familjes | 320 | 350 | 350 | 326 | 93% |
| | 9 | Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuese në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori. | 4 | 3 | 3 | 3 | 100% |
| | 10 | Numri i fëmijëve pjesëmarrës | 235 | 200 | 200 | 190 | 95% |
| | 11 | Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuese për "1 Qershorin" | 3 | 5 | 2 | 1 | 50% |
| | 12 | Numri i fëmijëve pjesëmarrës. | 230 | 250 | 250 | 250 | 100% |
| | 13 | Numri i studentëve që zhvillojnë praktikën mësimore në Bashki | 29 | 12 | 25 | 26 | 104% |
| | 14 | Qëndrueshmëria dhe vazhdimësia e tryezave konsultative : Nr. i takimeve periodike të tryezës konsultative. | 15 | 12 | 12 | 13 | 108% |
| | 15 | Nr i organizatave pjesëmarrëse në tryezat konsultative | 21 | 25 | 25 | 20 | 80% |
| | 16 | Nr. i personave që do të marrin shërbime pranë Qendrës Komunitare për Rom dhe Egjiptian | 450 | 500 | 500 | 420 | 84% |
| | 17 | Nr. I fëmijëve jetimë përfitues | 8 | 8 | 8 | 8 | 100% |

| | | | | | | | | |
|----------------------|---|----|---|------|------|------|------|------|
| | | 18 | Nr. i familjeve përfituese nga bashkepunimi me Shpresa per boten | 264 | 200 | 200 | 147 | 74% |
| | | 19 | Numri i fëmijëve të trajtuar në qendra rezidenciale publike | 86 | 80 | 80 | 58 | 73% |
| | | 20 | Numri I fëmijëve në nevojë për mbrojtje të mbështetur nga NJMF | 3 | 5 | 12 | 13 | 108% |
| | | 21 | Numri I fëmijëve dhe familjeve përfituese | 20 | 65 | 50 | 17 | 34% |
| | | 22 | Numri i familjeve përfituese | 60 | 45 | 45 | 17 | 38% |
| | | | | | | | | |
| Qellimi 2 | Administrimi, rregullimi dhe zhvillimi i shërbimeve të sistemit parashkollor për mirërritjen e fëmijëve 0-3 vjeç. | | | | | | | |
| Objektivi 2.1 | O1.Krijimi, zgjerimi dhe zhvillimi i shërbimeve për fëmijët e moshës 0-3 vjeç. | 23 | Numri i çerdheve funksionale | 7 | 7 | 7 | 7 | 100% |
| | | 24 | Numri i fëmijëve përfitues të shërbimit në çerdhe | 260 | 310 | 250 | 250 | 100% |
| | | 25 | Nr. i fëmijëve vajza që frekuentojnë çerdhet. | 120 | 150 | 137 | 137 | 100% |
| | | 26 | Numri i stafit për fëmijë | 68 | 53 | 53 | 53 | 100% |
| | | 27 | Nr I femijeve te perjashtuar nga tarifa e çerdheve | 0 | 28 | 28 | 5 | 18% |
| Qellimi 3 | Q3.Identifikimi i individëve dhe familjeve në nevojë të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike. Informimi dhe orientimi i qytetarëve për aplikim në skemën e ndihmës ekonomike dhe shërbimet shoqërore ekzistuese nën juridiksionin e bashkisë/njësisë administrative, në territorin e së cilës është banor individi. Q3/1 Informimi I individëve për kriteret, procedurat dhe dokumentacionin qe duhet te plotesojne për përfitimin e aftësisë së kufizuar. Zhvillimin e aftësive dhe mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore për personat me aftësi të kufizuar . | | | | | | | |
| Objektivi 3.1 | O1. Programimi dhe menaxhimi i përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit për ndihmën ekonomike dhe PAK, duke respektuar parimet bazë mbi te cilat funksionon skema e ndihmës ekonomike dhe pagesa e personave me aftësi të kufizuar | 28 | Numri I Stafit të drejtorisë se ND dhe PAK | | 18 | 17 | 17 | 100% |
| Qellimi 4 | Q4/1 Krijimi, ndërtimi dhe administrimi i qendrave komunitare për ofrimin e shërbimeve sociale vendore. Q4/2. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, donatorët, shoqërinë civile, për krijimin e fondeve për financimin e shërbimeve sociale sipas mënyrës së përcaktuar me ligj | | | | | | | |
| Objektivi 4.1 | Ndërtimi dhe administrimi i qendrave që ofrojnë shërbime sociale me orientim promovimin dhe zhvillimin e këtyre shërbimeve. | 29 | Nr. i qendrave sociale komunitare funksionale; | 13 | 13 | 13 | 13 | 100% |
| | | 30 | Numri I përfituesve të shërbimeve në qendrat komunitare "Për Familjen". | 5342 | 6600 | 6600 | 5982 | 91% |
| | | 31 | Nr. i fëmijëve dhe familjeve që marrin shërbim në qendrën e specializuar për diagnostimin e hershëm të fëmijëve me autizëm. | 21 | 25 | 25 | 27 | 108% |
| Objektivi 4.2 | Krijimi i fondit të dedikuar për financimin e shërbimeve sociale në bashkërendim Bashki - Ministri - Donatorë / Shoqëri Civile. | 32 | Përmirësimi i mbështetjes për personat me aftësi të kufizuar në qendrat rezidenciale: Nr. i shtëpive familje funksionale dhe në shërbim të PAK. | 8 | 8 | 8 | 8 | 100% |
| | | 33 | Përmirësimi i mbështetjes për personat me aftësi të kufizuar në qendrat rezidenciale: Numri i përfituesve Opera Madonnina del Grapa + Projekti Shpresa- ne numer | 80 | 77 | 83 | 83 | 100% |

| | | | | | | |
|----|--|-----|-----|-----|-----|------|
| 34 | Përmirësimi i mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara në qendrat rezidenciale: i) Eficienca buxhetore për mbështetjen e personave PAK: Shpenzimet totale në qendrat e shërbimeve PAK kundrejt numrit total të personave të akomoduar në këto qendra; | 461 | 496 | 503 | 456 | 91% |
| 35 | Nr. i aktiviteteve ndërgjegjësuere në kuadër të ditës ndërkombëtare të PAN. | 7 | 7 | 5 | 5 | 100% |
| 36 | Nr. i fëmijëve në nevojë që marrin pjesë dhe performojnë në aktivitetin artistiko-kulturor. | 0 | 30 | 30 | 0 | 0% |
| 37 | Nr. i fëmijëve në nevojë që marrin pjesë dhe performojnë në aktivitetin artistiko-kulturor. | 32 | 25 | 33 | 33 | 100% |
| 38 | Nr. i jetimëve të mbështetur me rastin e festave të fundit të vitit; | 42 | 50 | 50 | 39 | 78% |
| 39 | Numri i rasteve të identifikuara / të referuara të dhunës në familje | 64 | 80 | 140 | 140 | 100% |
| 40 | Nr i përfituesve nga funksionimi i sistemit të referimit | 285 | 180 | 420 | 420 | 100% |
| 41 | Nr i takimeve të organizuara të ekipit Teknik i Ndërdisciplinor (ETN) | 9 | 10 | 10 | 9 | 90% |
| 42 | Nr. i aktiviteteve ndërgjegjësuere për dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore. | 18 | 35 | 50 | 50 | 100% |
| 43 | Numri I femijeve qe ndjekin klasat passhkollore | 10 | 15 | 15 | 16 | 107% |
| 44 | Numri I viktimave të dhunës me bazë gjinore te mbeshtetura | 50 | 200 | 200 | 93 | 47% |
| 45 | Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuere në kuadër të 8 Marsit. | 16 | 17 | 14 | 14 | 100% |
| 46 | Nr i pjesëmarrësve në aktivitete 8 Marsi | 270 | 250 | 375 | 375 | 100% |
| 47 | Nr i pjesëmarrësve vajza/gra në aktivitete | 189 | 200 | 365 | 365 | 100% |
| 48 | Nr. partneriteteve me shoqërinë civile, organizatat jofitimprurëse, | 5 | 5 | 5 | 5 | 100% |
| 49 | Rritja e nr. Të personave të shërbyer në vit / Të moshuar të trajtuar në vit në qendrat e shërbimeve sociale. | 75 | 50 | 60 | 60 | 100% |
| 50 | Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuere, | 7 | 3 | 3 | 3 | 100% |
| 51 | Nr përfituesish Të moshuar të trajtuar në vit në qendrat 1.3.4 | 50 | 250 | 250 | 143 | 57% |
| 52 | Nr përfituesish të projektit | 0 | 44 | 44 | 43 | 98% |
| 53 | Nr I të rinjve që perfitojne shërbime mbështetëse të shëndetit mendor | | 80 | 100 | 100 | 100% |

ANEKSI nr.3 "Raporti përmblledhës i realizimit të treguesve të performancës/produtive të programit"

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 | | | | | | | | | | | | | | |
|---------------|--|----------------------------|---------------------------|--------------------------------|------------------------------------|------------------------------------|---|--|--|---|--|---------------------------|--------------------------------|-------------------------------------|------------|-------------|--------------|
| Programi | Kujdesi social për familjet dhe fëmijët | Kodi i Programit | 10430 | | | | | | | | | | | | | | |
| | në 000/lekë | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (viti 2023) | Shpenzimet Faktike (viti 2023) | Kosto për Njësi (sipas vitit 2023) | Sasia (sipas planit të vitit 2024) | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2024) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2024) | Sasia (sipas planit të rishikuar vitit 2024) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar vitit 2024) | Kosto per Njësi (sipas planit të rishikuar vitit 2024) | Sasia Faktike (viti 2024) | Shpenzimet Faktike (viti 2024) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2024) | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III |
| 1 | Shërbimi i stafit të Kujdesit për fëmijët dhe Familjet | Nr I Stafit | 21 | 15,150 | 721.4 | 15 | 18,482 | 1,232.1 | 15 | 27,683 | 1,845.5 | 15 | 21,028 | 1,401.8 | 680.4 | 169.7 | -443.7 |
| 2 | Fëmijë që përfitojnë nga shërbimi social burimet e veta | Nr. I femijeve | | | | 158 | 8,131 | 51.5 | 150 | 8,231 | 54.9 | 96 | 4,222 | 44.0 | 44.0 | -7.5 | -10.9 |
| 3 | Fëmijë që frekuentojnë çerdhet | nr. I femijeve | 260 | 54,228 | 208.6 | 310 | 57,453 | 185.3 | 250 | 77,904 | 311.6 | 250 | 62,838 | 251.4 | 42.8 | 66.0 | -60.3 |
| 4 | Familje dhe individë në nevojë që përfitojnë nga skema e NE dhe PAK | Nr. I familjeve/individëve | | | | 18 | 19,447 | 1,080.4 | 17 | 20,925 | 1,230.9 | 17 | 18,981 | 1,116.5 | 1,116.5 | 36.1 | -114.4 |
| 5 | Objekte të shërbimit të kujdesit social për familje dhe fëmijë të mirëmbajtura | Nr. I objekteve | 13 | 2,830 | 217.7 | 13 | 2,700 | 207.7 | 13 | 2,885 | 221.9 | 13 | 836 | 64.3 | -153.4 | -143.4 | -157.6 |
| 6 | Shërbimi i stafit të Kujdesit Social | Nr. i stafit | | | | 4 | 6,673 | 1,668.3 | 6 | 7,843 | 1,307.2 | 6 | 3,913 | 652.2 | 652.2 | -1,016.0 | -654.9 |
| 7 | Persona që përfitojnë Kujdesin Social | Nr. I personave perfitues | | | | 751 | 41,205 | 54.9 | 2,050 | 50,257 | 24.5 | 1,795 | 42,620 | 23.7 | 23.7 | -31.1 | -0.8 |

Për vitin 2024 në Programin “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”, në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përbushjes së objektivave të përcaktuara, janë parashikuar këto aktivitete.

| Produktet | Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi I aktivitetit | Plani fillestar 2024 | Plani I rishikuar 2024 | Realizimi 2024 |
|--|--|-----------------|--------------------------------|----------------------|------------------------|----------------|
| | | | | Totali | Totali | Totali |
| Shërbimi i stafit të Kujdesit për fëmijët dhe Familjet (nr. I stafit) | P10430.Q1.O1.A1 Paga dhe sigurime per ofrimin I shërbimeve të kujdesit shoqëror për familjet dhe fëmijët (Qendra komunitare) | Bashkia Shkodër | Realizuar | 9,589 | 15,807 | 12,396 |
| | P10430.Q1.O1.A2 Vazhdimësia e menaxhimit të Drejtorise në funksion të përbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive te shërbimit per administrimin e Kujdesit social per femije dhe familjet | Bashkia Shkodër | Realizuar | 8,318 | 11,118 | 8,013 |
| | P10430.Q1.O1.A3 Masat për Identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge & të trashëguara | Bashkia Shkodër | Realizuar | 225 | 325 | 290 |
| | P10430.Q1.O1.A4. Koordinimi i punës për parandalimin, identifikimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik apo nevojë për mbrojtje (Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve) | Bashkia Shkodër | Realizuar pa efekte financiare | 100 | 100 | - |
| | P10430.Q1.O1.A5. Dita ndërkombëtare për familjen – 15 maj | Bashkia Shkodër | Realizuar | 50 | 50 | 49 |
| | P10430.Q1.O1.A6. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori. | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | - | - |
| | P10430.Q1.O1.A7. Dita ndërkombëtare e fëmijëve, "1 Qershori" | Bashkia Shkodër | Realizuar | 100 | 100 | 98 |
| | P10430.Q1.O1.A8. Partneriteti me departamentin e psikologji-punës sociale | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | - | - |
| | P10430.Q1.O1.A9. Tryeza konsultative me organizatat që veprojnë në sektorin social në Bashkinë e Shkodrës; | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | - | - |
| | P10430.Q1.O1.A10 Fuqizimi socio – ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian & të trashëguara | Bashkia Shkodër | Realizuar | 100 | 183 | 182 |
| Fëmijë që përfitojnë nga shërbimi social (nr. I femijeve) burimet e veta | P10430.Q1.O1.A11. Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror-Burimet e veta | Bashkia Shkodër | Realizuar | 7,931 | 7,931 | 4,148 |
| | P10430.Q1.O1.A12. Bashkëpunimi me Fondacionin “Shpresë për botën”, për përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe familjet në nevojë. | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | - | - |

| | | | | | | |
|--|---|--|---|--------|--------|--------|
| | P10430.Q1.O1.A13 Fuqizim dhe shtrirje e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve | Bashkia Shkodër | Realizuar pa efekte financiare | 200 | 200 | - |
| | P10430.Q1.O1.A14. Shërbime alternative për fëmijët dhe familjen & të trashëguara | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 100 | 74 |
| Fëmijë që frekuentojnë çerdhet (nr. I femijeve) | P10430.Q2.O1.A1. Mbështetja e personelit te cerdheve (paga/sigurime shoqerore) | Drejtoria e Cerdheve dhe Kopshteve | Realizuar per muajin Janar, Shkurt dhe Mars | 4,780 | 11,860 | 11,860 |
| | Furnizim me EE dhe ujë për çerdhet - Të trashëguara | Drejtoria e Cerdheve dhe Kopshteve | Realizuar per muajin Janar, 2024 | - | 155 | 155 |
| | P10430.Q2.O1.A2 Mbështetja e personelit te cerdheve (paga/sigurime shoqerore) | Bashkia Shkodër | Realizuar | 39,910 | 36,764 | 33,628 |
| | P10430.Q2.O1.A3. Materiale mbështetëse për Cerdhet. (kancelari,). | Bashkia Shkodër | Realizuar | 135 | 135 | 79 |
| | P10430.Q2.O1.A4 Furnizim me ushqime për Cerdhet në Bashkinë e Shkodrës | Bashkia Shkodër | Realizuar | 7,000 | 7,683 | 2,649 |
| | P10430.Q2.O1.A5. Materiale mbështetëse për mirembajtje per Cerdhet. | Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike | Pjeserisht Realizuar | 4,506 | 4,506 | 1,715 |
| | P10430.Q2.O1.A6. Subvencionimi për mbështetjen e shërbimit pa pagesë në çerdhe për fëmijët e familjeve në nevojë dhe fëmijët me aftësi të kufizuar | Bashkia Shkodër | Realizuar | 1,122 | 1,122 | 1,122 |
| | P10430.Q2.O1.A7. Rikonstruksioni i çerdhes “Manush Alimani”.& të trashëguara | DPMOP | realizuar kolaudimi | - | 4,076 | 27 |
| | P10430.Q2.O1.A7. Rikonstruksioni i çerdhes “Manush Alimani”.& të trashëguara | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 11,603 | 11,601 |
| Familje dhe individe në nevojë që përfitojnë nga skema e NE (nr. I famijleve/indi videve) | P10430.Q3.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit të Drejtorise në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të shërbimit për administrimin e drejtorisë së ndihmës ekonomike dhe të paaftësise | Bashkia Shkodër | Realizuar | 19,447 | 20,925 | 18,981 |
| Objekte të shërbimit të kujdesit social për familje dhe fëmijë të mirëmbajtura (nr. I objekteve) | P10430.Q4.O1.A1. Ngritja, vendosja në funksion dhe konsolidimi i Qendrave Komunitare “Për Familjen” | Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike | Realizuar pjeserisht | 2,700 | 2,500 | 501 |
| | P10430.Q4.O1.A1. Ngritja, vendosja në funksion dhe konsolidimi i Qendrave Komunitare “Për Familjen” & të trashëguara | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 385 | 335 |
| Shërbimi I stafit të Kujdesit | P10430.Q4.O1.A2. Blerje Kancelari për Qendrat Komunitare “Për Familjen” | Bashkia Shkodër | Realizuar | 250 | 250 | 240 |

| | | | | | | |
|---|--|--|----------------------|--------|--------|--------|
| Social (nr. I stafit) | P10430.Q4.O1.A3. Ngritja, vendosja në funksion dhe konsolidimi i Qendrave Komunitare Mutifunkionale & të trashëguara | Bashkia Shkodër | Realizuar | 6,423 | 6,506 | 3,430 |
| | P10430.Q4.O1.A4 Shpenzime për mirembajtjen dhe sigurimin e funksionimit të plote të Qendres Rinore Atelier | Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes së Objekteve Publike | Realizuar pjesërisht | - | 1,025 | 234 |
| | P10430.Q4.O1.A5. Shpenzime për sigurimin e funksionimit të plote të qendres rinore | Bashkia Shkodër | Realizuar pjesërisht | - | 62 | 10 |
| Persona që përfitojnë Kujdesin Social (nr. I personave përfitues) | P10430.Q4.O2. A1. Shtëpi Familje për persona me aftësi të kufizuar nga Opera Madonnina del Grappa & të trashëguara | Bashkia Shkodër | Realizuar | 17,210 | 18,317 | 16,827 |
| | P10430.Q4.O2.A2. Projekti “Shpresa” për personat e braktisur dhe me aftësi të kufizuar & të trashëguara | Bashkia Shkodër | Realizuar | 20,973 | 23,441 | 20,981 |
| | P10430.Q4.O2.A3. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar, më 3 Dhjetor & të trashëguara | Bashkia Shkodër | Realizuar | 235 | 265 | 231 |
| | P10430.Q4.O2. A4. “Asnjë Fëmijë Jashtë” | Bashkia Shkodër | E përcaktuar | 271 | 271 | - |
| | P10430.Q4.O2. A5. Mbështetja e trupës muzikore të Personave me Aftësi të kufizuar” & të trashëguara | Bashkia Shkodër | Realizuar | 369 | 449 | 367 |
| | P10430.Q4.O2. A6. Shpërblim për jetimet me rastin e festave të fundvitit | Bashkia Shkodër | Realizuar | 400 | 418 | 371 |
| | P10430.Q4.O2. A7. Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje. | Bashkia Shkodër | Realizuar | 150 | 150 | 142 |
| | P10430.Q4.O2. A8. Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore & të trashëguara | Bashkia Shkodër | Realizuar | 100 | 250 | 195 |
| | P10430.Q4.O2. A9. TVESA@SH- Konsolidimi i sistemeve për fuqizimin e viktimave në Shqipëri @Shkodër LLOG JASHTE THESARI | Bashkia Shkodër | Realizuar | 12 | 215 | 3 |
| | P10430.Q4.O2. A10. Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi | Bashkia Shkodër | Realizuar | 100 | 100 | 80 |
| | P10430.Q4.O2. A11. Kujdesi social ndaj moshës së tretë | Bashkia Shkodër | Realizuar | 50 | 50 | 48 |
| | P10430.Q4.O2. A12. “Fuqizimi dhe zhvillimi i shërbimeve ditore për moshën e tretë” | Bashkia Shkodër | Realizuar | 1,035 | 1,683 | 1,272 |
| | P10430.Q4.O2. A13. Punësim dhe mësim për përfshirje sociale LLOGARI JASHTE THESARI | Bashkia Shkodër | Realizuar | 300 | 300 | 57 |

| | | | | | | | |
|---|---|-----------------|-----------|-------|----------------|----------------|----------------|
| | P10430.Q4.O2. A14.HOLD ON - Nxitje e aksesit ne mbeshtetjen e shendetit mendor per te rinjet financiar ne kuader te programit Erasmus+ LLOG JASHTE THESARI | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 870 | 53 | |
| | P10430.Q4.O2. A15 " Fuqizim I komunitetit permes ofrimit te sherbimeve ditore te alternuara per femijet dhe familjen" | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 2,378 | 1,160 | |
| | P10430.Q4.O2. A16 Realizimi I aktiviteve per rinine | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 1,000 | 735 | |
| | P10430.Q4.O2. A17. "Vizë studimore nga eksperte nga Italia per ndarjen e modeleve ne lidhje me te moshuarit me nevoja te vecanta" - Blerje bileta avioni per transportin ajror. | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 100 | 98 | |
| 10430 Kujdesi social per familjet dhe femijet | | | | | 154,091 | 195,728 | 154,437 |
| Te trasheguara | | | | | 53,233 | 935 | - |
| Totali | | | | | 207,324 | 196,663 | 154,437 |
| LLOGARI JASHTE THESARI | | | | | | | |
| Persona që përfitojnë Kujdesin Social (nr. I personave perfitues) | P10430.Q4.O2. A9. TVESA@SH- Konsolidimi i sistemeve për fuqizimin e viktimave në Shqipëri @Shkodër LLOG JASHTE THESARI | Bashkia Shkodër | Realizuar | 2,479 | 3,667 | 1,403 | |
| | P10430.Q4.O2. A13. Punësim dhe mësim për përfshirje sociale LLOGARI JASHTE THESARI | Bashkia Shkodër | Realizuar | 6,272 | 3,113 | 1,425 | |
| | P10430.Q4.O2. A14.HOLD ON - Nxitje e aksesit ne mbeshtetjen e shendetit mendor per te rinjet financiar ne kuader te programit Erasmus+ LLOG JASHTE THESARI | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 1,146 | 872 | |

| Aktivite/Projekte (me transfertë të kushtëzuar) | Buxheti fillestar 000/Lekë | Buxheti i rishikuar 000/Lekë | Realizimi 12 mujor i vitit 2024 000/Lekë |
|---|----------------------------|------------------------------|--|
| P10430.Q1.O1.A11. Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror me transfertë të kushtëzuar | 4,159 | 4,159 | 4,022 |
| P10430.Q3.O1.A2 Ndhimja ekonomike me transfertë të kushtëzuar | 175,000 | 199,124 | 197,426 |
| P10430.Q3.O1.A3 Pagesë PAK dhe Invaliditeti me transfertë të kushtëzuar | 810,000 | 803,209 | 803,209 |
| Pagese per perfituesit e Vendimit te Gjykates Administrative Shkalla e Pare Shkoder | - | 3,656 | 3,655 |
| Totali | 989,159 | 1,010,148 | 1,008,312 |

P10430.Q1.O1.A1 Paga dhe sigurime për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror për familjet dhe fëmijët (Qendra komunitare).

Është realizuar sigurimi i mbështetjes së funksionimit të punonjësve të qendrave komunitare “Për Familjen” në kohë të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli u bazua tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar.

P10430.Q1.O1.A2 Vazhdimësia e menaxhimit të Drejtorisë në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të shërbimit për administrimin e Kujdesit social për fëmijë dhe familjet.

Është realizuar sigurimi i mbështetjes së funksionimit të punonjësve të qendrave komunitare “Për Familjen” në kohë të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli u bazua tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar.

P10430.Q1.O1.A3 Masat për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge & të trashëguara.

Në kuadrin e nënshkrimit të Marrëveshjes Bashkëpunimit midis MMSR, MAS dhe MPB “Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge dhe Planit Kombëtar të Veprimit “Ndihmë për Familjet dhe Fëmijët në situatë rruge”, është hartuar dhe vazhdon të zbatohet Plani lokal i veprimit, ku bashkia (NJMF), ka përgjegjësinë kryesore për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve dhe koordinimin e punës ndërmjet institucioneve përgjegjëse, brenda territorit të qytetit. Vazhdojnë të funksionojnë skuadrat e terrenit me përfaqësues të Bashkisë Shkodër, stafi i qendrave komunitare, përfaqësues të Policisë të cilët janë trajnuar, kanë qenë dhe janë prezent në territor sipas një kalendari të paracaktuar. Në zbatim të ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Bashkia Shkodër po koordinon Mbledhjet e Grupit Teknik Ndërsektorial me përfaqësues nga të gjitha institucionet publike vendore dhe organizatat partnere ku janë diskutuar rastet për çdo familje të fëmijëve në situatë rruge. Gjithashtu janë hartuar plane individuale ndërhyrjeje për fëmijët në situatë rruge me qëllim mbështetjen dhe përmirësimin e situatës së këtyre fëmijëve dhe familjeve të tyre. Nr. i fëmijëve të identifikuar në situatë rruge si dhe të mbështetur është 32. Për secilën familje të identifikuar janë ofruar ndihma në veshmbathje, ushqime, asistencë ligjore, ndërmjetësim për punësim, ndihmë ekonomike, rregjistrim i fëmijëve në shkollë dhe kopshte, monitorim për frekuentimin dhe ecurinë e fëmijëve në shkollë sipas vlerësimeve dhe planeve individuale të ndërhyrjes. Në ditën ndërkombëtare të fëmijëve në situatë rruge, me datë 12 prill, u zhvilluan aktivitete ndërgjegjësuese, në Qendrën Komunitare Multifunksionale “Për familjen”, të cilat kishin si qëllim rritjen e ndërgjegjesimit ndaj fenomenit të shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve duke përfshirë dhe fëmijët në situatë rruge. Gjithashtu me datë 8 prill, Dita ndërkombëtare e Romëve, u zhvilluan aktivitete ndërgjegjësuese në Qendrën Komunitare Multifunksionale “Për familjen” dhe në shkolla të ndryshme të qytetit për të promovuar kulturën e traditat rome dhe njëkohësisht për të promovuar integrimin dhe përfshirjen e tyre sociale.

Me datën 12 qershor u zhvillua një aktivitet ndërgjegjësuës në pedonalen e qytetit ku u shpërndanë edhe fletëpalosje. Gjithashtu edhe me datën 30 korrik dita ndërkombëtare kundër fenomenit të trafikimit u shfrytëzua si një ditë sensibilizuese për të rritur ndërgjegjësimin dhe informimin për fëmijët në situatë rruge, si një kontigent potencial i mundshëm për trafikim. Gjatë kësaj periudhe janë shtuar skuadrat e terrenit me qëllim identifikim e fëmijëve në situatë rruge në pikat me “hot spot” të qytetit. Me qëllim uljen e numrit të fëmijëve në situatë rruge janë realizuar tryeza me Drejtorinë Vendore të Policisë ku janë përcaktuar nevojat dhe problematikat që janë hasur gjatë monitorimit të terrenit.

P10430.Q1.O1.A4. Koordinimi i punës për parandalimin, identifikimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik apo nevojë për mbrojtje (Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve)

Njësiti e qeverisjes vendore kanë autoritetin për ngritjen në nivel bashkie dhe në nivel njësie administrative stuktura të posaçme për mbrojtjen e fëmijëve sipas Ligjit Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”. Në bashkinë Shkodër vazhdon të jetë funksionale njësia e mbrojtjes së fëmijëve si një njësi e posaçme brenda strukturës së drejtorisë së shërbimeve sociale dhe ka për detyrë parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje. Për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, drejtori i strukturës përgjegjëse ose punonjësi i njësisë së mbrojtjes së fëmijëve mbledh grupin teknik ndërsektorial, të cilët janë aktorët përgjegjës për zbatimin e masave të mbrojtjes së fëmijës si dhe për zbatimin e planit individual të mbrojtjes për ndjekjen dhe menaxhimin e rastit.

Gjatë vitit 2024 janë organizuar mbledhje të grupit teknik ndërsektorial me qëllim trajtimin, menaxhimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje si dhe janë marrë masa mbrojtëse për fëmijët në nevojë për mbrojtje, duke vendosur fëmijën pranë një strukture të përkujdesjes alternative. Në zbatim të Ligjit Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” neni 59 pika 4 punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes së vendimit për masën përkatëse të mbrojtjes nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, depoziton në gjykatën kompetente kërkesën për vlefshmërinë e masës emergjente të mbrojtjes ose të masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative, e cila përmban edhe kërkesën për vendosjen e fëmijës në kujdestari. Gjykata shqyrton dhe vendos, brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës përkatëse nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, për vlefshmërinë e masës së mbrojtjes duke shqyrtuar edhe ankimet përkatëse të paraqitura nga palët. Kur gjykata vendos dhënien e masës së mbrojtjes, atëherë ajo vazhdon gjykimin edhe për shqyrtimin e kërkesës për vendosjen e fëmijës në kujdestari, sipas legjislacionit në fuqi. Me qëllim marrjen e vendimit të gjykatës për caktimin e kujdestarisë ligjore të të miturit në nevojë për mbrojtje, kërkohet mendimi i një eksperti psikolog i paanshëm sipas listës të vënë në dispozicion nga ana e Gjykatës që të realizojë vlerësimin lidhur me kujdestarinë ligjore të të fëmijës në nevojë për mbrojtje. Caktimi i shpenzimeve për ekspertët në gjykatë bazohet në Udhëzim nr 4 datë 12.12.2012 “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesat e ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”.

P10430.Q1.O1.A5. Dita ndërkombëtare për familjen – 15 maj.

Në Ditën Ndërkombëtare të Familjes në gjithë botën organizohen aktivitete në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, që kanë në fokus familjen, duke e përqëndruar vëmendjen tek proceset shoqërore, ekonomike dhe demografike që prekin familjet. Gjithashtu fokusi i kësaj dite është promovimi i vlerave të familjes, nxitja e barazisë midis grave dhe burrave në familje, mbrojtja e familjes si njësi bazë e shoqërisë dhe mundësia për të ndihmuar familjet për të përmbushur përgjegjësinë e tyre për komunitetin ku bëjnë pjesë. Në territorin e bashkisë së Shkodrës, ekziston një numër i madh familjesh në vështirësi të theksuara sociale e ekonomike. Situata në të cilën ndodhen këto familje vjen si shkak i ndikimit të një sërë faktorësh si: niveli i ulët arsimor, kulturor, ekonomik, etj. Si pasojë të faktorëve të lartpërmendur, këto familje shpesh herë kanë mungesë informacioni, nuk marrin interesim për shërbimet sociale që ofrohen në territor dhe jetojnë në kushte ekstreme varfërie. Duke qenë se Bashkia e Shkodrës që nga viti 2016, arriti ngritjen dhe vënien në funksion të qendrave komunitare të quajtura “Për Familjen”, duke parë familjen si qeliza bazë për zhvillimin e komunitetit, sivjet në kuadër të ditës ndërkombëtare për familjen janë planifikuar një javë me aktivitete nën moton “Punojmë së bashku në forcimin e familjes”. Janë organizuar disa aktivitete sensibilizuese, informuese, të shpërndara në

Qendrat Komunitare “Për Familjen”, shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie etj., si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative.

P10430.Q1.O1.A6. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori.

20 Nëntori “Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve” synon të promovojë mirëqenien e fëmijëve, të parandalojë çdo formë dhune apo abuzimi ndaj fëmijëve. Janë realizuar disa aktivitete ndërgjegjësuese që kanë qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtat e fëmijëve. Fëmijët janë një target grup që shumë lehtë mund të jenë pre e keqtrajtimit dhe dhunës e për këtë është e nevojshme që të informohen në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të tyre.

P10430.Q1.O1.A7. Dita ndërkombëtare e fëmijëve, "1 Qershor"

Një Qershor është dita ndërkombëtare e fëmijëve. Këtë ditë fëmijët e të gjitha moshave kërkojnë që të jenë të lumtur e të festojnë me familjen, me prindërit, me vëmendjen dhe përkujdesjen e nevojshme për realizimin e dëshirave të tyre. Kjo ditë përveç se është një ditë festive, është një ditë sensibilizimi për promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve. Bashkia e Shkodrës ka organizuar aktivitete festive dhe ndërgjegjësuese që lidhet me mirëqenien e fëmijëve, njohjen dhe respektimin e të drejtave në familje, shkollë, shoqëri dhe në të gjitha shërbimet që ofrohen për fëmijët. Transmetojmë mesazhe sensibilizuese për fëmijët që janë e ardhmja e shoqërisë sonë.

P10430.Q1.O1.A8. Partneriteti me departamentin e psikologji-punës sociale

Në universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në degët e psikologjisë, punës sociale, fizioterapisë dhe infermierisë, çdo vit regjistrohen rreth 50 studentë në secilën degë. Në vitin e tretë të studimeve bachelor, gjatë gjithë vitit akademik, studentët zhvillojnë lëndën e “Praktikumit”. Një lëndë e tillë është me shumë rëndësi për përfitimin e njohurive praktike në fushat përkatëse. Gjithashtu pas përfundimit të studimeve në ciklin bachelor, ka shumë rëndësi praktika e njohurive të marra gjatë viteve të studimit. Bashkia e Shkodrës ka arritur një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, ku pjesë e kësaj marrëveshje ka qenë bashkëpunimi për ofrimin e një praktike sa më profesionale dhe të vlefshme për zhvillimin akademik e profesional të studentëve. 12 studentë; 7 të nivelit bachelor dhe 5 të nivelit master kanë zhvilluar praktikën profesionale pranë shërbimeve sociale dhe kanë kontribuar në aktivitetet e planifikuara pranë qendrave komunitare “Për Familjen”. Një eksperiencë e tillë ka rezultuar shumë pozitive për të dyja palët. Nëpërmjet institucionalizimit të këtij bashkëpunimi, studentët ofrojnë njohuritë e tyre në shërbim dhe në përputhje me nevojat e komunitetit, duke filluar kështu të fitojnë aftësitë bazë të profesionit të tyre.

P10430.Q1.O1.A9. Tryeza konsultative me organizatat që veprojnë në sektorin social në Bashkinë e Shkodrës;

Në qytetin e Shkodrës, ndodhen e funksionojnë një sërë organizatash të shoqërisë civile që ofrojnë shërbim në mbështetje të grupeve sociale në nevojë; fëmijëve, të rinjve, grave e burrave, personave me aftësi ndryshe, komunitetit rom dhe egjiptian, moshës së tretë, etj. Viti 2016 ishte një vit i rëndësishëm i fillimit të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionalizimit të partneritetit me to. Gjatë këtyre viteve është konsoliduar aktiviteti i tryezave konsultative dhe zhvillimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile. Me synim koordinimin e aktiviteteve dhe shërbimeve në territorin e Bashkisë së Shkodrës, janë planifikuar dhe organizuar tryeza konsultative me shoqërinë civile. Gjatë kësaj periudhe

tryezat konsultative janë organizuar për planifikimin e aktiviteteteve në kuadër të zbatimit të kartës evropiane për barazinë gjinore, 8 marsit, 8-12 prillit dhe në zbatim të projekteve të reja që po zbatohen në Bashkinë e Shkodrës nga organizatat partnere. Tashmë ka një proces të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të konsultimit përmes takimeve ku qëllimi i këtyre tryezave ka qenë ndërhyrja e integruar në ofrimin e shërbimeve, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe mbulimi i territorit me shërbime.

P10430.Q1.O1.A10 Fuqizimi socio – ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian & të trashëguara

Ka vazhduar edhe gjatë vitit 2024 ofrimi i shërbimeve sociale, integruese dhe mbështetëse pranë Qendrës Komunitare Multifunkionale “Për Familjen” për komunitetin rom dhe egjiptian.

Qendra Komunitare Multifunkionale “Për Familjen” për komunitetin rom dhe egjiptian është vënë në funksion të plotë që nga muaji tetor i vitit 2018 dhe ofron shërbime specifike për këtë komunitet siç janë:

- Regjistrimi civil dhe mbështetje në nevojat administrative.
- Arsimimi dhe promovimi i dialogut.
- Kujdesi shëndetësor
- Strehimi dhe integrimi
- Punësimi.
- Mbrojtja sociale.
- Gjithëpërfshirje dhe Integrim

Qendra Multifunkionale bashkëpunon që prej vitit 2018 me Fondacionin “Shpresë për Botën”, Food bank për ofrimin e shërbimeve integruese për këtë komunitet.

Gjithashtu Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Fondacionin OSFA po implementojnë në këtë qendër edhe projektin “Punësim dhe mësim për përfshirjen sociale” me financim të Bashkimit European, i cili ka në fokus komunitetin rom/egjiptjan. Nga ky projekt përfitojnë shërbime mbështetëse integruese bursë 30 fëmijë dhe familjet e tyre janë të përfshirë në programet e punësimit.

Numri total i përfituesve të shërbimeve në Qendrën Multifunkionale është 180 përfitues, nga të cilat 130 i përkasin komunitetit rom dhe 50 komunitetit egjiptian.

Fëmijët që përfitojnë shërbime gjatë frekuentimit ditor të qendrës Multifunkionale janë 50 fëmijë të rregjistruar si përfitues ditor nga të cilët 40 janë nga shkollat 9 vjecare “Isuf Tabaku”, “Liria” dhe “Mati Logoreci” si dhe 10 fëmijë nga kopshtet brenda brenda këtyre Shkollave.

Fëmijë që frekuentojnë qendrën Multifunkionale mbështeten me:

- Transport në shkollë-kopsht-qendër dhe anasjelltas (kostot mbulohen nga Fondacioni “Shprese per Boten”).
- Vakt ushqimor në qendër (dreka, kostoja mbulohet nga FoodBank).
- Klasa passhkollore dhe përgaditore.
- Organizimi dhe festimi i ditëlindjes për çdo fëmijë.
- Lojra dhe aktivitete psiko-sociale çdo ditë.
- Mjete shkollore për përdorim të përditshëm.
- Rroba/këpucë dhe nevoja të tjera të përditshme.
- Çanta dhe materiale shkollore çdo fillim vit shkollor.
- Pako ushqimore për çdo familje të fëmijëve që frekuentojnë rregullisht kopsht/shkollë gjatë muajt.

Në dispozicion të fëmijëve të komunitetit rom gjatë vitit 2024 janë dy mjete transporti të cilët shoqërojnë fëmijët nga vendqëndrimet rome me itinerar:

- Mjeti 1 (K/Dubai, Bahcallek – shkolla 9 vjecare “Isuf Tabaku” / Kopshti “Mjelmat” – qkmf - k/Dubai)
- Mjeti 2 (Shkolla Pashko Vasa dhe Mati Logoreci - Qkmf – Banesat Sociale, Godinat Rome (nga muaj tetor 2024 e në vazhdim)
- Kostot e transportit dhe pagesa për shoferat mbulohen nga Fondacioni “Shpresë për Botën”.

Përvec itinerarit të përditshëm transporti është në dispozicion edhe për aktivitetet që zhvillohen me fëmijët dhe familjet rome jashtë qendrës Multifunkionale.

Higjena është elementi i rëndësishëm që lehtëson integrimin e fëmijëve rom, duke marrë në konsideratë faktin se shpesh është shkak për qëndrime diskriminuese. Për këtë pranë qendrës komunitare multifunkionale janë në funksion dushe, makina larëse për fëmijët që frekuentojnë këtë qendër. Për këtë qëllim pranë qendrës Multifunkionale janë realizuar vazhdimisht aktivitete për kujdesin e higjenes si: larja e dhëmbëve, duarve etj.

Ka vazhduar rregullisht edhe gjatë vitit 2024 koordinimi ndërinstitucional për identifikimin e fëmijëve që rrezikojnë të braktisin shkollën ose e kanë braktisur atë duke përfshirë takime në institucione dhe vizita në terren (kampet rome) të grupit të edukimit që përfshijnë drejtorë të institucioneve arsimore, përfaqësues të Zyrës Vendore Arsimore Shkodër, mësues kujdestar, psikolog, punonjës social, njësinë e mbrojtjes së fëmijëve, staf të qendrës multifunkionale dhe staf nga organizatat.

Bashkia Shkodër në zbatim të Planit Vendor të Veprimit për fëmijët në situatë rruge ka aktive skuadrat e terrenit të përbërë ngë punonjës social të qendrave komunitare, të cilët kanë vazhduar intensivisht punën për identifikimin dhe referimin e rasteve të fëmijëve në situatë rruge, të cilët shfrytëzohen për lypje. Sipas një kalendari të hartuar, janë aktive në terren në çdo ditë të javës punonjës, të cilët monitorojnë terrenin në shtatë ditë të javës në zonat: Urës Bunës, pika Doganore e Muriqanit si edhe monitorimi i terrenit në qytet.

Në mbështetje të skuadrave të terrenit gjatë gjithë verës kanë qënë edhe Policia e Shtetit, Policia Bashkiake si dhe Specialistët e Policimit në Komunitet.

Janë identifikuar 33 raste të fëmijëve në situatë rruge.

Në kuadër të planit të përbashkët të masave për identifikimin, referimin dhe vlerësimin e fëmijëve në situatë rruge, në bashkëpunim me strukturat e policisë janë shoqëruar në komisarjat 6 raste nga komuniteti rom të cilët po ushtronin lypësi në kushte dhe zona ku rrezikohet siguria dhe mirëqenia e të miturve si dhe duke u bërë burim aksidenti për shkak të qëndrimit tyre (3 nëna me fëmijë të mitur dhe 4 raste të rritur).

Gjithashtu janë paralajmëruar edhe dy raste të identifikuar në zonën e Muriqanit.

Në Qendrën Multifunkionale çdo vit festohet 8 Prilli, Dita Ndërkombëtare e Romëve.

Në kuadër të kësaj feste, Bashkia në bashkëpunim me aktorët e tjerë vendor organizon aktivitete të ndryshme përgjatë një jave, aktivitete të natyrave të ndryshme ndërgjegjësuese, edukuese dhe promovuese.

Temat dhe mesazhet që përçojnë janë të ndryshme, por të gjitha synojnë promovimin e diversitetit dhe dialogut ndërkulturor.

12 qershori “Dita Botërore kundër shfrytëzimit të mituve për punë është aktiviteti ndërgjegjësues dhe sensibilizues që bashkon të gjithë institucionet dhe organizatat në mbrojtje të fëmijëve dhe të drejtave tyre.

Më 30 korrik 2024, në kuadër të Ditës Botërore kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore ka nisur fushata ndërgjegjësuese në Muriqan dhe Ura e Bunës ku specialist nga shërbimi social kanë marrë nismën për ndërgjegjësimin e qytetarëve për pasojat negative të dhurimit të parave dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.

20 Nëntori organizohet çdo vit në Bashkëpunim me institucionet dhe Organizata me qëllim promovimin e të drejtave dhe Mbrojtjes së Fëmijëve.

“Mos Dhuro Para! Fëmija po shfrytëzohet! është slogani i serisë së aktiviteteve që organizohen çdo vit nga Bashkia, Qendra Multifunkionale dhe Organizatat partnere.

Fushatatat dhe aktivitetet ndërgjegjësuese organizohen nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale në bashkëpunim me partnerët jo vetëm në ditët e shënuara ndërkombëtare apo kombëtare, por janë pjesë e vazhdueshme e planeve të punës të Drejtorisë dhe Qendrave Komunitare “Për familjen”, me synim rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit në lidhje me të drejtat e tyre, por edhe me qëllim njohjen dhe promovimin e shërbimeve që ofrohen për mbështetjen e grupeve vulnerabël.

Në këtë qendër zhvillohen takime ku diskutohen dhe trajtohen tema në përshtatje me problematikat e hasura më shpesh nga ky komunitet si: braktisja e shkollës, martesat e hershme, trafikimi, prindërimi pozitiv.

Përfitues të klasave të prindërimit janë 25 prindër të komunitetit rom dhe egjiptian.

Gjatë vitit 2024 fëmijët e komunitetit rom/egjiptian kanë vizituar ambjente të ndryshme si: Shirokë, Kalaja e Rozafës, Rec etjer

Janë zhvilluar aktivitete edhe në shkolla ku frekuentojnë fëmijët rom, Shkolla “Isuf Tabaku” – Ajasëm dhe kopshti brenda shkollës.

Gjithashtu fëmijët rom/egjiptian janë pjesë e aktiviteteve sociale dhe argëtuese, lojrave psiko- sociale që zhvillohen në qendër dhe jashtë saj, por jo vetëm pasi Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Fondacionin “Shpresë Botën”, SOS -Fshatrat e Fëmijëve dhe Save the Children kanë organizuar aktivitetin kamp veror “I buzëqeshim verës” në datat 18-28 qershor 2024.

Çdo muaj në Qendrën Multifunkionale “Për Familjen” organizohen së paku 3 (tre) aktivitete në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, Fondacionin “Shpresë për Botën dhe organizata tjera me fokus integrimin dhe gjithëpërfshirjen e komunitetit.

- Aktivitete (brenda ose jashtë qendrës) me fëmijët frekuentues të qendrës ;
- Të mitur në konflikt/kontakt me ligjin.
- Kujdesemi për natyrën.
- Mbetjet ushqimore.
- Dita Botërore e Mjedisit
- Dita e alfabetit
- Aktivitet (brenda ose jashtë qendres) me prindër.
- Takime mujore në qendër dhe në kampet rome.
- Takime, fokus grupe të prindërimit pozitiv.
- Organizimi i datëlindjeve të muajt përkatës për fëmijët që frekuentojnë qendrën.
- Organizim I Festave të fundvitit

Familjet rome/egjiptjane, fëmijët e të cilave frekuentojnë rregullisht shkollën/kopshtin, rastet me Urdhër Mbrojtje dhe rastet e referuar nga Avokati i Popullit janë mbështetur çdo muaj me pako ushqimore ofruar nga Fondacioni Shpresë për Botën dhe Foodbank.

Mesatarisht përfitojnë pako ushqimore 20 familje rome/egjiptjane në muaj.

Gjatë vitit 2024 janë mundësuar mesatarisht 150 pako ushqimore për familjet përfituese të Qendrës Multifunkionale. Mbështetja ushqimore është ofruar nga “Shpresë për Botën”, Food Bank dhe Kisha Ungjillore “Shpresë për Shkodën”, “Nisma – Arsis” etj.

Gjatë vitit 2024 janë menaxhuar dhe ndjekur në total 3 raste UMM/UM të dhunës në familje.

Janë referuar për vlerësim nga Avokati i Popullit 7 raste, për të cilët është bërë vlerësim i situatës social-ekonomike dhe përfshirja e tyre në shërbime mbështetëse.

Në bashkëpunim me Shërbimin e Provës monitorohen 2 raste të mitur për veprat penale “Vjedhje” dhe “Drejtim i mjetit në mënyrë të paregullt”.

Gjithashtu monitorohen 6 nëna/gra rome të cilat janë të dënuara për veprën Penale “Shfrytëzim të fëmijëve për lypje” si dhe menaxhohet një i mitur, i cili ka vuajtur dënimin në I.E.V.P Kavajë (Burgu i të miturve).

P10430.Q2.O1.A11. Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror.

Bashkia Shkodër ka aplikuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën Nr. 4307 Prot., datë 10.12.2021 për Fondin Social për Shërbime me Bazë Komunitare 2022 me projekt – propozimin “Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror”, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së financimit të Strehëzës për fëmijët pa kujdes prindëror, strukturë e ngritur nga Bashkia Shkodër në bashkëpunim me ACLI-IPSA.

E përzgjedhur si bashki fituese dhe e vlefshme për financim përmes shkresës të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) Nr. 1134/19 Prot., datë 04.05.2022 “Njoftim për përzgjedhjen fitues të projekt propozimit “Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror””, Strehëza filloi funksionimin e saj të plotë më 01.06.2022.

Me anë të këtij shërbimi të ri dhe alternativ synojmë të ofrojmë një mundësi për fëmijët pa kujdes prindëror, të cilët nuk mund të rriten në një mjedis familjar, duke synuar gjithashtu përfshirjen brenda procesit të deinstitutionalizimit dhe të decentralizimit të nisur në Shqipëri, kryesisht referuar Planit Kombëtar të De-Institutionalizimit 2020-2022 të miratuar së fundmi me VKM Nr. 706, datë 09.09.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit të Fëmijëve 2020-2022” dhe të Planit të Veprimit në zbatim të tij. Struktura përmbush standartet për shërbimet e përkujdesit shoqëror të përcaktuar në VKM Nr. 659, datë 17.10.2005 “Për standartet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”.

Strehëza përdor një model marrëdhëniesh, që paraqitet si alternativë e përkohshme ndaj modeleve institucionale të qendrave rezidenciale dhe në përgjithësi, ndaj institucioneve të mëdha, modele që fatkeqësisht vazhdojnë të funksionojnë në vendin tonë. Organizimi i strukturës, duke filluar prej hapësirave fizike deri te veprimtaritë ditore, janë pjesë përbërëse e ndërhyrjes edukative dhe synojnë riparimin e dështimeve të mëparshme ambientale. Gjithashtu, ky shërbim synon të ofrojë edhe strehim emergjent të sigurtë dhe rehabilitues për fëmijët në situata emergjente apo në rrezik të lartë deri në rehabilitimin e plotë të fëmijëve dhe të familjes biologjike me qëllim që të minimizohet koha e qëndrimit të të miturit në Strehëz.

Në strehëz është planifikuar që të ofrohet shërbim deri në kapacitet maksimal për 8 fëmijë të moshës 6 deri në 18 vjeç. Aktualisht pranë kësaj strukture është përmbushur kapacitetit, janë sistemuar 8 fëmijë, me vendim të Komisionit Multidisiplinar të Bashkisë Po ashtu në Strehëz ofrohet dhe shërbimi emergjent. Ku këtë periudhë janë sistemuar dy raste në shërbimin emergjent, Rastet janë referuar nga NJMf Bashkia Shkoder.

Shërbimi ofrohet nga 7 (shtatë punonjës) i përbërë nga 3 specialistë (në rolin e edukatorëve të cilët punojnë me tre turne) , 2 ndihmës specialiste, sipas standartit 1 edukator për 4 fëmijë, 1 kuzhinier/sanitar, 1 përgjegjës i Strehëzës, personel pjesë e strukturës së Bashkisë Shkodër.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka transferuar fondin për projektin fitues të Bashkisë Shkodër më datë 11.05.2022, përmes shkresës me Nr. 2084 Prot., “Transferim fondesh për financimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki për vitin 2022” dhe shkresës Nr. 69/43 Prot., datë 16.05.2022 e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Akordim i fondeve për financimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki për vitin 2022”. Deri në datë 31.05.2022 financimi dhe vënia në funksion e strehëzës është siguruar nga financimi i projektit “Komunitetit të së ardhmes: ndërhyrje të përfshirjes sociale dhe në tregun e punës për jetimët e Shkodrës”.

Sipas aplikimit kohëzgjatja e projektit është 36 muaj (Janar 2022 – Dhjetor 2024), dhe transferimi i fondit në buxhetin e Bashkisë Shkodër është planifikuar të bëhet në tre këste:

Financimi i vitit të parë në masën 90% të totalit të kostove të ofrimit të shërbimit, ku në fakt ky financim është disbursuar në maj të vitit 2022 në shumën 7,841,995 Lekë që përkon në mënyrë përpjësimore me 7 muaj shërbim.

Viti i dytë i zbatimit të projektit është financiar në masën 60% të vlerës së projektit.

Viti i tretë i zbatimit të projektit financohet në masën 30% deri sa shërbimi do të mbulohet 100% nga Bashkia Shkodër.

Për shkak të tipologjisë së shërbimit të strehëzës dhe mirëfunksionimit të saj deri më tani ka qenë e domosdoshme që në rastin e vitit të tretë të ofrimit të shërbimit, financimi në masën 30% të vlerës së projektit të transferohet në buxhetin e Bashkisë Shkodër që në fillim të muajit janar 2024 për të siguruar vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit rezidencial dhe mbulimin e të gjitha kostove operative jetësore të parashikuara me këtë fond sipas linjave të buxhetit më poshtë.

Ndaj Bashkia Shkodër i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale me shkresën Nr.18910 Prot, datë 04.12.2022 me lëndë “Vënie në dijeni dhe kërkesë për kalim fondi”.

Streheza për fëmijët pa kujdes prindëror vepron si një komunitet me dimension familjar, me karakter edukativ me qëllim edukimin fëmijëve pa familje ose me familje në vështirësi, me asistencë përkujdesjeje ditë e natë, organizimi dhe ndihma e kohës së lirë, mbështetje arsimore, formimin kulturor, shoqërimin dhe integrimin e fëmijëve nepërmjet kurseve të ndryshme.

Struktura synon të mbështesë procesin e zhvillimit të fëmijëve, nëpërmjet një organizimi të jetës që lejon marrëdhënie të qëndrueshme dhe emocionalisht të rëndësishme, dhe t'i shoqërojë dhe mbështesë drejt një procesi gradual të autonomisë.

Strehëza ndodhet në lagjen 3 Heronjtë, dhe ka kapacitet të strehojë deri në tetë fëmijë, me dy vende shtesë të rezervuara për rastet emergjente.

Aktualisht në Strehëzën për fëmijët pa kujdes prindëror që me datë 19 Dhjetor 2023 jetojnë 8 fëmijë.

Gjashtë nga të cilët janë djem dhe dy vajza (nga mosha 5-16 vjeç

Pesë fëmijë frekuentojnë shkollën 9-vjeçare “Mati Logoreci.

Dy më të rriturit janë regjistruar ne Shkollën Profesionale Ndre Mjeda ne Bushat ne deget Teknologji Ushqimore dhe Bujqesi. Femija me i vogel frekuenton kopeshitin “Njomezat”

Organizimi: Organizimi i jetës së përditshme është i strukturuar në mënyrë që:

Të favorizojë realizimin e një përvoje individuale vendimtare për fëmijët për zhvillimin dhe maturimin e tyre personal nëpërmjet një organizimi që lejon marrëdhënie të qëndrueshme mes njeri-tjetrit dhe edukatorëve. Çdo ditë në shtëpinë familje është intensive: me disa angazhime, momente loje, përgatitja e vakteve, pastrimi, këshillimi dhe bashkëndarje që e bëjnë çdo ditë unike. Jeta e përditshme nuk është vetëm tërësia e veprimeve të kryera nga pjestarët që jetojnë në shtëpinë familje, por gjithashtu ne i kushtojmë rëndësi të madhe arsimit dhe edukimit. Brenda një ditë plotësohen së pari nevojat parësore, si të lahet, ushqehet dhe pushojë, nevoja që shumica prej nesh i marrin si të mirëqena, por të cilat nuk janë gjithmonë automatike. Prandaj dita është e strukturuar në mënyrë treguese si ajo e një fëmijë që jeton në një familje "normale", ku ritmet janë lineare dhe shprehitë e fituara të sjelljes së përditshme kanë një rol qetësues, dhe një ndikim të rëndësishëm në mirëqenien e secilit.

Qëllimi i këtij organizimi është që në një të ardhme fëmijët të kenë arritur autonominë dhe vendosjen e marrëdhënieve më të shëndetshme me familjet biologjike.

Të inkurajojë pjesëmarrjen e të gjithëve, secili në raport me rolin që luan, me organizimin dhe rregulloren e brendshme për menaxhimin e jetës së shtëpisë, duke shfrytëzuar në maksimum momentet e takimit me njëri tjetrin për një dialog autentik edukativ.

Të favorizojnë arritjen e përvojave të rëndësishme që mbështesin zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve dhe ta shoqërojnë atë drejt një përvetësimi gradual të mjeteve dhe burimet që synojnë promovimin e autonomisë së tij në një të ardhme.

Dosja personale: për çdo fëmijë është mbajtur dhe përditësohet dosja personale, e cila përbëhet nga sa vijon, seksionet:

Administrative - për dokumentacionin e regjistrimit, vendimet e Komisionit Multidisipinar si dhe vendimet e gjykatës.

Sociale dhe psikologjike - për raportet e ndryshme psiko-sociale, si: FID formular i informacionit të domosdoshëm, raport për vlerësimin e nevojave dhe ecurisë (RVNE), plani i kujdesit, raporte psikologjike. Në muajin Janar dhe shkurt stafi ka plotësuar RVNE dhe PEI për tre fëmijet. Fëmijen me të madh dhe 2 fëmijët më të vegjël të cilët janë bërë pjesë e Strehëzes që në muajin Dhjetor 2023. Janë plotësuar dhe Vlerësimet psiko-social.

Për të gjithë fëmijët gjatë kësaj periudhë janë plotësuar:

-PEI-Plani Individual i Kujdesit

-RVNE-Raporti i Vlerësimit të Nevojave dhe Ecurisë

-Raport psikologjik

- Raport Individual Arsivor
- Po ashtu dhe në muajin Maj nga stafi përgjegjës është bërë rishikim i:
- PEI-Plani Individual i Kujdesit
- RVNE-Raporti i Vlerësimit të Nevojave dhe Ecurisë
- Raport psikologjik
- Raport Individual Arsivor

Arsivore - për dokumentimin e punës edukative; Plani i arsimit që është bërë në bashkëpunim me shkollën, Rishikimi i planit të Arsimit, Raport mujor i arsimit nga edukatorët. etj., relacionet nga takimet e shkollës me mësuesit përkatës.

Në fund të muajit Maj është bërë kërkesa shkolles, që në provimet e klasës së IX-te njëri nga fëmijët të pajisët me test special.

Të dy fëmijët i kanë kryer provimet e klasës së IX-te.

Femija F.P ka dhënë konkursin për pikturë tek Shkolla "Prenk Jakova" ku dhe ka fituar, por pas disa konsultimesh mes vajzes dhe stafit përgjegjës u pa si zgjedhje më e favorshme që të regjistrohet në një Shkollë profesionale dhe me dashirën e te dy me te rinjve pasi bëmë dhe një vizite tek kjo shkollë dhe u njohëm me ambientin, deget dhe kushtet e shkollës vendosem që të regjistrohen tek kjo shkollë.

-Regjistrimi i dy të rinjve në Shkollën profesionale "Ndre Mjeda" në Bushat

Tranferimi në shkollën afer Strehëzës vajzes më të vogël nga shkolla "Pashko Vasa"

Është bërë kërkesa dhe janë tërhequr për të gjithë fëmijët canta dhe mjete shkollore, këto janë ofruar nga Organizata "Shpresa për Botën"

Gjate këtij viti fëmijët janë asistuar nga stafi për ecurinë në mësim dhe kemi marrë pjesë në çdo takim me mesuesit përkatës.

Janë plotësuar dhe raportet në lidhje me ecurinë mësimore të secilit

Shëndetësore – Çdo fëmijë është i pajisur me kartelën shëndetësore për dokumentimin e kontrolleve shëndetësore, vizitat rutinë, vaksinimet, fletoret shëndetësore për raportimin nga edukatorët të medikamenteve të administruara në rastet e rekomanduara nga mjekja. Gjatë këtyre muajve fëmijet nuk kanë patur probleme shëndetësore, përveç ndonjë temperature apo viroze të lehtë stinore.

Në fillim të muajit Maj vajza me e vogël ka patur 2 dite temperature ku më pas kemi marrë mjekën në qëndër Dr. Marita Sopin e cila ka dhënë një recete dhe pas mjekimit të rekomanduar viroza ka kaluar. Vajza me e madhe disa dite rresht në muajin Qershor ka ankuar për dhimbje barku të vazhdueshme dhe pas një vizite tek Dr.P.Belinova pasi bëri dhe një eko zonës së barkut tha se nuk është asgjë shqetësuese por duhet të ushqehet rregullisht të gjitha vaktet dhe të evitojë të nxehtin e madh.

Në muajin tetor është planifikuar të bëhet një vizitë shëndetësore femijes R.B. nga Dr L.Aroni

Në muajin Tetor I është bërë vaksina femijes S.P

Aktivitetet e ndryshme: Momentet rikrijuese të përfaqësuara nga udhëtimet dhe shëtitjet konsiderohen jashtëzakonisht të rëndësishme dhe pasuroese si nga pikëpamja e marrëdhënies ndërmjet fëmijëve me njëri tjetrin po ashtu edhe nga pikëpamja e marrëdhënies edukator- fëmijë. Gjatë këtyre muajve, janë organizuar dalje të ndryshme ku fëmijët janë argëtuar, kanë mësuar gjëra të reja dhe janë përfshirë në një realitet ndryshe nga ai i shtëpisë familje. Fëmijët kanë marrë pjesë në aktivitetet të ndryshme për të promovuar argëtimin dhe socializimin.

Disa nga aktivitetet jashtë shtëpisë gjatë këtyre muajve

-Aktivitetet tek Blu-Sky 2 herë në muaj, ku përveç lojrave të ndryshme që ofron ky ambient fëmijët luajnë dhe kanë mundësi të njihen me bashkmoshatarë të tjerë.

- Aktiviteti i zhvilluar me rastin e festës së Karnavaleve tek Oratori D.Bosko me datë 10 Shkurt. Ku Drejtori i Oratorit ka ftuar fëmijët e Strehëzës për të marrë pjesë
- Aktivitet 2 herë në javë pasdite po tek oratori ku fëmijët së bashku me fëmijët e qytetit bëhën pjesë të lojrave të ndryshme.
- Aktivitet tek Azili i motrave Stigmatine në Shirokë „Një dreke së bashku“
- 2 fëmijet me të rritur 2 herë në muaj ofrojnë shërbim vullnetar në Ambulatorin "Maddonina del Grappa" ku të gjithë së bashku me të rinjtë e Projektit Shpresa Shtëpinë Familje Tedeskini marrin pjesë në festën e organizuar nga motrat Stigmatine.

- Vazhdojnë aktivitetet 2 herë në muaj nga grupi “LER”, grupi i nxënësve të shkollës “Atë Pjetër Meshkalla”, të cilët vizitojnë Shtëpinë familje dite të premtës.
- Aktivitetet në Razem me datë 14 mars, piknik me fëmijet
- Aktivitetet me Rastin e Dites Ndërkombëtare të Ujit, në qendër të qytetit ku fëmijët e Strehëzës përgatitën petulla dhe biskota për vizitorët e tendës dhe kalimtarët.
- Një tjetër aktivitet i zhvilluar së bashku me fëmijët e befotrofit është ai i zhvilluar në Tiranë tek LATITUDE. Aktiviteti i sponsorizuar nga Hako-Hako.
- Aktiviteti tjetër është zhvilluar në muajin prill tek shkolla Pjetër Meshkalla me grupin LER-ku për fëmijët kishin përgatitur lojra psiko-sociale dhe një koktejl.
- Që nga fillimi të Tetorit 2 fëmijët më të rritur 1 herë në javë frekuentojnë aktivitetin (katekizem) së bashku me bashkomoshatarët e tjerë në Famullinë “Zoja e Shkodrës”
- Vajza më e madhe frekuenton kursin e pikturës tek një studio private pikturë.
- Njëri nga fëmijët tre herë në javë shkon në stërvitje futbolli me skuadrën e Don Boskos.(Stërvitjen e ka rifilluar në shtator)
- Ndërsa djali më i madh është pjesë e skuadrës së volejbollit tek Qendra Kulturore.

Gjate periudhës Maj Gusht janë zhvilluar këto aktivitete

- Aktiviteti për festën e luleve datë 6 Maj „Lule je Lule frymon“, ku fëmijët me ndihmën e stafit përgatitën biskota dhe petulla, shporta me lule për të qerasur pjesëmarrësit. Po ashtu u zhvillua dhe një parade përgjatë pedonale. Të gjithë fëmijët dhe stafi u pajisën me certifikate falenderimi për angazhimin dhe performancën.
- Me datë 3 Maj fëmijët kanë marrë pjesë në shirokë në aktivitetin përmblyës të jëvës Europiane.
- Aktivitetet me datë 22.Maj në Ditën Ndërkombëtare të ujit.Edhe për këtë aktivitet fëmijët së bashku me Kuzhinierën përgatitën ëmbëlsira të ndryshme dhe tënden e përgatitur nga Ndërmarrja e Ujit qerasen pjesëmarrësit.
- Një tjetër aktivitet i organizuar nga Strehëza për fëmijë pa kujdes prindëror është ai i Ditës Ndërkombëtare të familjes i zhvilluar me datë 17 Maj në Razem me temë: “Me shumë së Strehëz jemi familje”
- Me datë 1 Qershor për festën e fëmijëve, fëmijët e Strehëzës recituan vjersha dhe u argëtuan tek Sheshi para Bashkisë në lojrat e ndryshme.
- Në javën e dytë të Qershorit deri më 15 korrik, fëmijët e Strehëzës kanë qenë pjesë e kampit veror të D.Bosko, paradite dhe pasdite.
- Me datë 13 Qershor një pjesë e stafit ka marrë pjesë në aktivitetin sensibilizues të organizuar nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale „Mos Dhuro para, fëmijët po shfrytëzohen“
- Nga datat 22 Korrik deri në datën 02 Gusht, fëmijët kanë shijuar ditët me diell në bregdetin e Velipojës.
- Në korrik disa nga fëmijët e Strehëzës kanë marrë pjesë në koncertin ZA Fest.
- Me 15 Korrik kemi bërë një shëtitje të gjithë së bashku në
- Në Korrik një tjetër aktivitet i organizuar në hollin e Bashkisë Shkodër nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, me temë: Të celën “Arkapijat“, ku fëmijët u njohën me trashëgimë kulturore të qytetit, dhe vizituan objekte të ndryshme të kultures.
- Për të vazhduar me një tjetër kamp Veror nga data 2 Gusht deri me 8 Gusht pranë qendres Ravasco fëmijët.Kamp u organizua nga grupi Mendoja nga Milano
- Me dt 9 Gusht deri me 15 Gusht fëmijët kanë marrë pjesë në një tjetër kamp veror pasdite nga një grup vullnetarësh dhe animator, nga Reggio Emilia

- Nga data 16-23 Gusht gjatë kësaj javë fëmijët kanë marre pjesë në kampin veror: Mbeshtetu ne mua“ nga nje grup animatoresh nga Firenze
- Në 24 Gusht fëmijet kanë bërë një shëtitje në Razëm me temë“Eksploruesit e vegjel“.
- Ne muajin gusht ne Strehez kanë ndihmuar ne sistemimin dhe në lyerjen e murit rrethues nje pasdite grupi i Skautistëve të ardhur nga Italia
- Në shtator para fillimit te Shkolles kemi bere shetitje te gjithe se bashku ne Razem.
- Ne tetor me rastin e dites Nderkombetare te te moshuarve se bashku me femijet kemi bere aktivitet me te moshuarit e Azilit ne Shiroke ku kemi ndare nje dreke te gjithe se bashku dhe kemi dhuruar kartolina urimi per gjysherit e e qendres.
- Në kuader të javes Europiane te Mobilitetit Bashkia Shkoder ka dhuruar bicikleta per femijet e Strehezes ku e pranishme ne Strehez per ti dhuruar ishte Nen Kryetarja Teuta Qyteza
- Ne nentor me rastin e dites Nderkombetare te te Drejtave te Femijeve kemi marre pjese ne aktivitetin e organizuar nga Bashkia Shkoder ku bashke me femijet u percollen mesazhe mbi te drejtat e tyre.Streheza mori pjese me nje poezi : KAM TE DREJTE
- Aktivitet PEDALO PER NDRYSHIM, STAFETA PORTOKALLI ne kuader te 16 diteve te aktivizimit kunder dhunes me baze gjinore.
- Me rastin e Dites boterore te Rinise dy ng ate rinjte e Strehezes se bashku me Stafin kane marre pjese ne aktivitete e organizuar nga Bashkia Shkoder.
- Ne Dhjetor Shprese per Boten ka organizuar nje aktivitet ku se bashku me Femijet e Shtepise se Femijes 6-15 kane marre dhuratat e fund vitit nga kjo organizate
- Nje tjetër aktivitet nd Dhjetor ka qene vizita e nje grupi te rinjsh nga Universiteti I Neë Youk Tirane ku kane sjelle dhurata per femijet.
- Po ashtu edhe Bashkia Shkoder ka organizuar nje aktivitet me rastin e festive ku kane marre pjese femijet e Strehezes dhe kane shijuar lojrat e ndryshme falas dhe muzike e kercim nga personazhe te ndryshme te disneyt.
- Me date 22 Dhjetor femijet kane marre pjese ne nje aktivitet leximi tek Qendra Rinore Atelie ku ishte e ftuar autorja per femije Rudina Cupi.
- Dy te rinjte e qendres se bashku me stafin ka marre pjese ne koncertet e darkes dhe festimet e organizuara tek Bashkia Shkoder.
- Ne mbyllje te fundvitit femijte e Strehezes se bashku me stafin ka marre persiper qe per nje dite te shesin biskota dhe punime te ndryshme tek Shtepiza Rinore perballe Bashkise ky fitimet e asaj dite kane shkuar per nje kauze Sociale.

Aktivitete dhe festime brenda Strehezes:

-Aktivitet brenda ambjenteve të Strehëzës:

- Gjatë pasditeve 2 orë në ditë pas orarit të studimit në oborrin e Strehëzës kanë ardhur fëmijët e lagjes për të luajtur të gjithë së bashku lojra të ndryshme.
- Aktivitet tjetër gjatë këtij 4 mujori është zhvilluar në muajin Mars : Me teme “Të parandalosh është më mirë se të kurosh“ ku Specilistja L.B nga Drejtoria e Sherbimit Social zhvilloj një takim ndërgjegjësues për fëmijët mbi shëndetin dhe higjienen e gojës.
- Një tjetër aktivitet i mbajtur në kuadër të projektit të edukimit të zhvilluara nga përfaqësues të Organizatës “Animal Need Me“ me temë :*Kujdesi ndaj kafshëve shtëpiake.*
- Në muajin prill në ambjentët e Strehëzës është mbajtur një takim informues: “Shëndeti mbi të gjitha, rëndësia e aktiviteti fizik“
- Në muajin Qershor 2 fëmijët më të rritur kanë marrë saramentin e Pagezimit dhe Krezmimit dhe më këtë rast kemi bërë një festë të vogël në Strehëz

- Në Qershor njëra nga vajzat ka mbushur 7 vjece dhe e kemi festuar së bashku me fëmijët e lagjes dhe stafin po ashtu ka marrë dhuratë nga Organizata ‘Shprese për boten‘
- Nga muaji Shtator dhe deri ne Dhjetor ne Strehez jane mbajtur tema dhe lojra te ndryshme nga nje animatore e fshatit SOS ne kuader te nje baskpunimi me Bashkine

Gjatë këtij viti kemi patur vizita nga;

-Drejtuesit e Organizates ‘‘Shprese per boten‘‘

Shkolla Ate Pjeter Meshkalla

Grupe te ndryshme te rinjsh nga Firenze, Reggio Emilia, Milano

Gjatë mujve të verës të shtunave fëmijët kanë marrë pjesë në shikimn e filmave në Kinema të shoqëruar nga stafi përgjegjës 2 Here ne muaj dite te premtë aktivitet me grupin Ler Shkolla Ate Pjeter Meshkalla.

Trajnime

Kanë marrë pjesë në trajnime të ndryshme

- Përgjegjesja ka marrë pjesë në seminarin me teme: ‘‘Prokurimi i sherbimeve kujdesit social‘‘
- Pasojat e institucionalizimit-Procesi i Ri-integrimit – Fshatrat Sos
- Ëorkshop dy ditor ‘‘Rritja e njohurive të aktorëve lokal në lidhje me Sherbimin e kujdestarise në Bashkinë Shkodër‘‘- Fshatrat SOS
- Fuqizimi i të rinjeve- Xixellonjat
- Në muajin Muajin Prill një pjesë e personelit kanë qenë pjesë e ërkshopit 5 ditor ‘‘Përgaditja për lënien e kujdesit‘‘, ëorkshop i realizuar nga SOS- Fshatrat e Fëmijëve në Shqipëri
- Trajnim me teme : Te rinjte ne konflikt me ligjin
- Ëorkshop 3 ditor 21-23 tetor 2024 me teme: Procesi I Deinstitutionalizimit të femijëve nga institucionet e Perkujdesit Shoqëror,baza ligjore, bashkpunimi nderinstitutional , praktikat e sukseshme dhe sfidat, te zhvilluara nga Nisma Arsis dhe Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale.
- Trajnim ne kuader te 16 diteve te aktivizimit kunder dhunes me teme: Rritja de ndergjegjesimi per sigurine e grave, zhvilluar nga OSCE ne Bashkine Shkoder.

Proceduarat e ndryshme

- Gjatë vitit 2024 është bërë përgatitja e gjithë dokumentacionit për përmbylljen e gjithë faturave të vitit 2023 (ilace, ushqime, shërbimet e transportit, dritat dhe ujin.
- Plotësimi i formularit të zbatimit të kontratës përfundimtare të ushqimeve
- Raportimi për cdo 4 mujor të 2023 tek Komiteti i Biresimeve.
- Planet mujore dhe raportet mujore
- Urdhërat e dorëzimit dhe parashikimet e km/karburantit mujore
- Urdhërat e dorëzimit per mjetet kancelarike dhe materialet e pastrimit
- Urdhëri i komisionit për proçedurën e ushqimeve për vitin 2024
- Grafik levrimi ushqimesh
- Ndryshimi I urdherit te per proceduren e Furnizimeve me Ushqime per Strehezen
- Përgatitja për likujdimin e faturave të veshmbathjes
- Përgatitja për likujdimin e faturave të dezinfektimit
- Përgatitja për likujdimin e faturave të ushqimeve
- Përgatitja për terheqjen e cekut dhe procedures se honorareve per bonus te femijeve
- Përgatitja e Urdherit per mirembajtjen e objekteve ndertimore
- Kolaudimi I fikseve te zjarrit
- Përgatitja e Autorizimeve për lëvizjen e automjetit të Strehëzës.
- Formular referimi për shërbim psikologjik tek Qendra Sos Fshatrat –Shkodër

- Regjistrimi I perfituesve te Strehezes ne Shkolle te Mesme
- Pergatitja e dokumentacioneve te nevojshme per perfitim burse shkolle
- Aplikimi per karte Identiteti per 2 nga te rinjte e Strehezes.
- Aplikimi per hapjen e nje Nr.IBANI per 2 te rinjte.
- Regjistrim dhe plotesim formulari regjistrimi per dy te rinjte ne kurs tek Akademia Afrodite perkatesisht ne kurs manikyr/pedikyr dhe berber.

Gjatë këtij 12 mujori janë kryer dhe procedurat për zërat:

- Vaj dhe Karburant
- Kolaudimi
- Siguracion automjeti
- Materiale kancelarike
- Ushqime
- Materiale pastrimi
- Veshmbathjet
- Dezinfektimi
- Honoraret

Në muajin Maj kanë qene për inspektim, Inspektoriati Shteteror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore Në muajin Gusht kemi patur monitorim nga Sherbimi Social Shtetëror, ku kemi raportuar dhe për Fondin Social 2023.

P10430.Q1.O1.A12. Bashkëpunimi me Fondacionin “Shpresë për botën”, për përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe familjet në nevojë.

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me organizatën “Shpresë për botën”, që ka si qëllim mbështetjen e 3 institucioneve rezidenciale; Shtëpisë së foshnjës, Shtëpisë së fëmijës shkollor dhe Qendrës së zhvillimit, është arritur që të përmirësohet cilësia e jetës së fëmijëve dhe të rinjve që jetojnë në institucionet rezidenciale, si dhe është rritur pjesëmarrja e fëmijëve në aktivitete të ndryshme sociale, kulturore dhe sportive, me qëllim integrimin e tyre. Gjatë kësaj periudhe janë organizuar festimet e ditëlindjeve për fëmijët në këto institucione rezidenciale. Vazhdon të ofrohet mbështetje me transport për të mundësuar takimet e fëmijët me prindërit biologjikë me qëllim mbajtjen dhe fuqizimin e lidhjeve afektive mes tyre. Këto aktivitete janë organizuar gjatë kësaj periudhe në të tre institucionet rezidenciale të Bashkisë Shkodër. Për disa fëmijë është mundësuar të realizohet takimi me familjet biologjike pranë banesave të tyre në qytete të tjera të Shqipërisë.

P10430.Q1.O1.A13 Fuqizim dhe shtrirje e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve.

Njësitë e qeverisjes vendore kanë autoritetin për ngritjen në nivel bashkie dhe në nivel njësie administrative stuktura të posaçme për mbrojtjen e fëmijëve sipas Ligjit Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”. Në bashkinë Shkodër vazhdon të jetë funksionale njësia e mbrojtjes së fëmijëve si një njësi e posaçme brenda strukturës së drejtorisë së shërbimeve sociale dhe ka për detyrë

parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje. Për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, drejtori i strukturës përgjegjëse ose punonjësi i njësisë së mbrojtjes së fëmijëve mbledh grupin teknik ndërsektorial, të cilët janë aktorët përgjegjës për zbatimin e masave të mbrojtjes së fëmijës si dhe për zbatimin e planit individual të mbrojtjes për ndjekjen dhe menaxhimin e rastit.

Gjatë vitit 2024 janë organizuar disa mbledhje të grupit teknik ndërsektorial me qëllim trajtimin, menaxhimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje si dhe janë marrë masa mbrojtëse për fëmijët në nevojë për mbrojtje, duke vendosur fëmijën pranë një strukture të përkujdesjes alternative. Në zbatim të Ligjit Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” neni 46 pika gj bashkitë janë përgjegjëse për financimin e Planit Individual të Mbrojtjes së Fëmijës dhe Planit për Aftësim Prindëror. Në këtë kuadër për funksionimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, Bashkia Shkodër ka planifikuar të financojë shërbimet sociale mbështetëse, si pako ushqimore dhe higjieno-sanitare, si dhe veshmbathje për fëmijët me masë mbrojtëse dhe familjen me qëllim fuqizimin social ekonomik të familjes si qeliza bazë e shoqërisë.

P10430.Q1.O1.A14. Shërbime alternative për fëmijët dhe familjen & të trashëguara

Sigurimi i mbrojtjes shoqërore për fëmijët pa kujdes prindëror dhe i të drejtave të tyre është një ndër sfidat më të rëndësishme për Bashkinë e Shkodrës, por edhe për shoqërinë civile, duke kërkuar një vëmendje më të veçantë për këtë target grup. Gjatë kësaj periudhe janë identifikuar familje me fëmijë në rrezik institucionalizimi dhe po punohet për fuqizimin e tyre dhe paralelisht po punohet me fuqizimin e familjeve që kanë fëmijë në institucione rezidenciale, me synim deinstitutionalizimin e tyre. Janë realizuar fushata ndërgjegjësuese me aktorë të ndryshëm publik dhe jo publik, por edhe me komunitetin për të rritur ndërgjegjësimin dhe informacionin mbi shërbimin e kujdestarisë ligjore si mundësia më e mirë për fëmijët pa kujdes prindëror. Fokusi i këtij shërbimi është zgjerimi i formave alternative me bazë familjen për fëmijët, drejt deinstitutionalizimit të shërbimeve të përkujdesjes. Fokusi i këtij shërbimi është zgjerimi i formave alternative me bazë familjen për fëmijët, drejt deinstitutionalizimit të shërbimeve të përkujdesjes. Informimi mbi këtë shërbim dhe advokimi i familjeve kujdestare të interesuara, vazhdon të jetë sfidë e cila do të ketë vëmendjen e veçantë të Bashkisë Shkodër, në mënyrë që paralelisht ky shërbim të sigurojë mbrojtjen shoqërore për fëmijët pa kujdes prindëror dhe respektimin e të drejtave të tyre.

P10430.Q2.O1.A1. Mbështetja e personelit të çerdheve (paga/sigurime shoqërore) & të trashëguara.

Është realizuar në kohë sigurimi i mbështetjes së funksionimit të punonjësve të drejtorisë së ndihmës ekonomike dhe të paaftësisë, të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli u bazua tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar.

Furnizim me EE dhe ujë për çerdhet - të trashëguara.

Janë likuiduar faturat e energjisë elektrike dhe ujit për muajin janar 2024 më pas i kanë kaluar Drejtorisë së përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike.

P10430.Q2.O1.A2 Mbështetja e personelit të çerdheve (paga/sigurime shoqërore).

Plani i parashikuar për paga dhe sigurime për personelin e Çerdheve është 35,764 mijë lekë dhe realizimi për 12 mujin 2024 është 33,629 mijë lekë.

P10430.Q2.O1.A3. Materiale mbështetëse për çerdhet (kancelari).

Ky aktivitet është realizuar brenda vitit 2024.

P10430.Q2.O1.A4 Furnizim me ushqime për çerdhet në Bashkinë e Shkodrës.

Është realizuar furnizimi me ushqime për çerdhet në Bashkinë e Shkodrës për vitin 2024.

P10430.Q2.O1.A5. Materiale mbështetëse për mirëmbajtje për çerdhet.

Blerje Materiale e Pastrimit: detergjentë dhe materiale për pastrim dhe materiale higjeno- sanitare për të gjitha Çerdhet e Bashkisë Shkodër. Likuidimi i faturave të energjisë elektrike dhe uji janë në proces gjatë gjithë vitit. Disa procedura prokurimi janë mbartur për tu realizuar gjatë vitit 2025.

P10430.Q2.O1.A6. Subvencionimi për mbështetjen e shërbimit pa pagesë në çerdhe për fëmijët e familjeve në nevojë dhe fëmijët me aftësi të kufizuar.

Subvencionimi për mbështetjen e shërbimit pa pagesë në çerdhe për fëmijët e familjeve me aftësi të kufizuar me fond 1,122 mijë lekë. Përdoret për rastet e familjeve në nevojë dhe fëmijëve me AK. Për vitin 2024 kanë përfituar këtë shërbim 5 fëmijë në çerdhe.

P10430.Q3.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit të Drejtorisë në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të shërbimit për administrimin e drejtorisë së ndihmës ekonomike dhe të paafëtisë.

Është realizuar në kohë sigurimi i mbështetjes së funksionimit të punonjësve të drejtorisë së ndihmës ekonomike dhe të paafëtisë, të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli u bazua tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar.

P10430.Q3.O1.A2 Ndihma ekonomike me transfertë të kushtëzuar

Në zbatim të Ligjit Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr 597, datë 14.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.

Përfitues të skemës së ndihmës ekonomike kanë qenë:

Në muajin Janar - 1811 familje, nga të cilat: 1610 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 201 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Shkurt - 1822 familje, nga të cilat: 1622 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 200 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Mars - 1834 familje, nga të cilat: 1636 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 198 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Prill - 1827 familje, nga të cilat: 1629 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 198 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Maj - 1827 familje, nga të cilat: 1626 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 201 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Qershor - 1792 familje, nga të cilat: 1591 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 201 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Korrik - 1780 familje, nga të cilat: 1584 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 196 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Gusht - 1797 familje, nga të cilat: 1599 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 198 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Shtator - 1780 familje, nga të cilat: 1578 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 202 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Tetor - 1770 familje, nga të cilat: 1569 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 201 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Nëntor - 1772 familje, nga të cilat: 1569 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 203 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Dhjetor - 1751 familje, nga të cilat: 1552 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 199 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Diferenca e mbetur papaguar për munges fondi, për muajin Dhjetor 2023, për 278 familje në vlerën 2 234 754 lekë, është paguar me çeljen e fondeve të reja të viti kalendarik 2024.

Gjithashtu duhet të theksojmë faktin se pagesa e muajit Dhjetor 2023, për familjet që trajtohen me fondin e kushtëzuar të bllok ndihmës deri në 6%, për 203 familje në vlerën 785 641 lekë, është paguar me çeljen e fondeve të reja të viti kalendarik 2024.

Në zbatim të Vendimit nr. 854, datë 26.12.2024 “Për shpërblimin e disa kategorive të veçanta, për vitin 2024”, përfitues të shpërblimit të fundvitit kanë qenë 1755 familje/individë.

Për kryerjen e këtyre pagesave mujore të çelura nga Shërbimi Social Shtetëror janë si më poshtë: Ndhma Ekonomike: Janar-Shkurt 29 961 000 lekë, Mars-Prill 27 937 000 lekë, Maj-Qershor 27 935 000 lekë, Korrik-Gusht 28 087 000 lekë, Shtator-Tetor 28 472 000 lekë, Nëntor-Dhjetor 30 407 000 lekë, shpërblimi i fundvitit 26 325 000 lekë.

Fondet faktike për pagesën e ndihmës ekonomike për vitin 2024 janë: 197 426 012 lekë.

P10430.Q3.O1.A3 Pagesë PAK dhe Invaliditeti me transfertë të kushtëzuar.

Në zbatim të Ligjit Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr.8626 datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” të ndryshuar, Ligjit nr.8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit” i ndryshuar, Ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 “Statusi i invalidit” të ndryshuar.

Numri i personave të trajtuar me pagesë paaftësie ka qenë: në muajin Janar 3653, në Shkurt 3711, në Mars 3769, në Prill 3785, në Maj 3803, në Qershor 3818, në Korrik 3792, në Gusht 3798, në Shtator 3828, në Tetor 3844, në Nëntor 3875, në Dhjetor 3886.

Numri i invalidëve të punës të trajtuar me shtesë kempit ka qenë: në muajin Janar 2995, në Shkurt 2820, në Mars 2927, në Prill 2910, në Maj 2932, në Qershor 2997, në Korrik 3009, në Gusht 3000, në Shtator 2995, në Tetor 2984, në Nëntor 3000, në Dhjetor 3014.

Në zbatim të Vendimit nr. 854, datë 26.12.2024 “Për shpërblimin e disa kategorive të veçanta, për vitin 2024”, përfitues të shpërblimit të fundvitit kanë qenë 3878 persona.

Mbetet detyrimi i papaguar për muajin Dhjetor 2024, për mungesë fondi 272 600 lekë. Kjo diferencë do të paguhet me çeljen e fondeve të reja të viti kalendarik 2025.

Për kryerjen e këtyre pagesave mujore fondet e çelura nga Shërbimi Social Shtetëror janë si më poshtë: PAK: Janar - Shkurt 134 705 000 lekë, Mars -Prill 125 689 000 lekë, Maj-Qershor 120 336 000 lekë, Korrik-Gusht 123 719 000 lekë, Shtator - Tetor 122 875 000 lekë, Nëntor - Dhjetor 110 830 000 lekë, shpërblimi i fundvitit 65 055 000 lekë.

Fondet faktike për pagesën e aftësisë së kufizuar për vitin 2024 janë: 803 208 890 lekë.

P10430.Q4.O1.A1. Ngritja, vendosja në funksion dhe konsolidimi i Qendrave Komunitare “Për Familjen” & të trashëguara

Në vitin 2016 filloi krijimi i rrjetit të shërbimit social në komunitet. Për herë të parë u ngritën qendrat komunitare “Për familjen”, të cilat ofrojnë shërbime sociale si informim, orientim, këshillim, shërbim në familje, mbështetje psikosociale, etj. Në vazhdim të krijimit dhe zgjerimit të rrjetit për ofrimin e shërbimit social në territor, janë ngritur dhe vënë në funksion në total 13 qendra komunitare “Për Familjen”, të shtrira në territorin e Bashkisë së Shkodrës. Gjatë kësaj periudhe, sa i përket konsolidimit të shërbimit komunitar në qendrat komunitare “Për Familjen”, janë rritur shërbimet e ofruara, aktivitetet dhe përfituesit, pranë këtyre qendrave. Duke u mbështetur në shërbimet e ekzistuese, eksperiencën e krijuar dhe nevojat sociale në komunitet, Bashkia e Shkodrës synon të mbështesë zhvillimin e integruar dhe të vazhdueshëm të mirëqenies sociale të familjes si qeliza bazë e komunitetit tonë të shtrirë në të gjithë territorin.

Likuidimi i faturave të energjisë elektrike dhe uji janë në proces gjatë gjithë vitit.

Disa nga procedurat janë realizuar gjatë vitit 2024 dhe një pjesë është mbartur për tu realizuar gjatë vitit 2025.

P10430.Q4.O1.A2. Blerje Kancelari për Qendrat Komunitare “Për Familjen”

Ky aktivitet është realizuar plotësisht.

P10430.Q4.O1.A3. Ngritja, vendosja në funksion dhe konsolidimi i Qendrave Komunitare Multifunktionale & të trashëguara.

Në vitin 2016 filloi krijimi i rrjetit të shërbimit social në komunitet. Për herë të parë u ngritën qendrat komunitare “Për familjen”, të cilat ofrojnë shërbime sociale si informim, orientim, këshillim, shërbim në familje, mbështetje psiko- sociale, etj. Në vazhdim të krijimit dhe zgjerimit të rrjetit për ofrimin e shërbimeve sociale në territor, janë ngritur dhe vënë në funksion në total 13 qendra komunitare “Për Familjen”, të shtrira në territorin e Bashkisë së Shkodrës.

Në kuadër të rrjetit për ofrimin e shërbimeve sociale dhe gjithashtu në kuadër të nevojave të territorit, përveç qendrave komunitare, Bashkia e Shkodrës, është angazhuar edhe në ngritjen e qendrave multifunktionale të specializuara si më poshtë:

- Qendra Rinore”Atelie” – e cila i dedikohet përfshirjes edukative, artistike, sociale dhe kulturore të të rinjve, duke krijuar hapësirat e nevojshme dhe aksesin në sipërmarrje, kulturë, art, teknologji informacioni, etj. Kjo qendër është realizuar në kuadër të zbatimit të projektit YES Future, financuar nga programi IADSA.
- Qendra komunitare multifunktionale “Për Familjen” – është një qendër e është ndërtuar, në tetor 2018, në kuadër të zbatimit të projektit ESERE “Fuqizimi ekonomik dhe social për romët dhe egjiptianët, një shtysë për përfshirjen sociale” në bashkëpunim me UNDP, financuar nga BE.
- Qendra “Harmonia” për ofrimin e shërbimit të specializuar për trajtimin e fëmijëve me autizëm- e ngritur në vitin 2021, në kuadër të projektit “Krijimi i shërbimit të specializuar ditor për fëmijët me çrregullime të spektrit autik në Bashkinë e Shkodrës” në kuadër të thirrjes për projekte “Askush të Mos Mbetet Pas”, një program i përbashkët i Kombeve të Bashkuara, i

financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), e cila ofron shërbime për fëmijët e diagnostikuar me çrregullime të spektrit autik.

- Qendra Multifunkionale Xixëllonjat me hapësira për qendër komunitare “Për Familjen”, qendër shëndetësore për lagjen, kopsht&çerdhe dhe zyrë administrative të bashkisë Shkodër, hapësira për të rinj, hapësira për të moshuar. Kjo ndërhyrje është kryer në zbatim të projektit “Shërbime multi-funkionale të Shkodrës – Model i përfshirjes sociale dhe zhvillimit të komunitetit”, të financuar nga Programi i Konvertimit të Borxhit për Zhvillim (IADSA), i qeverisë Italiane dhe Bashkisë Shkodër dhe projektit EU4Municipalities “Nxitja e përfshirjes sociale dhe zhvillimit të komunitetit”.
- Çdo Qendër Komunitare “Për Familjen” (13 qendra) dhe Qendra Multifunkionale kanë në përbërje personel specialistësh të fushës sociale që shërbejnë, të financuar nga Bashkia e Shkodrës e cila njëkohësisht financon edhe kostot operative të funksionimit të këtyre qendrave.

P10430.Q4.O1.A4 Shpenzime për mirembajtjen dhe sigurimin e funksionimit të plotë të Qendres Rinore Atelier.

Janë në proces gjatë gjithë vitit pagesat për shërbime nga të tretë nga Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike për Qendren Rinore Atelier. Disa procedura janë mbartur për tu realizuar gjatë vitit 2025.

P10430.Q4.O1.A5. Shpenzime për sigurimin e funksionimit të plotë të qendrës rinore Ky aktivitet është realizuar.

P10430.Q4.O2.A1. Shtëpi Familje për persona me aftësi të kufizuar nga Opera Madonnina del Grappa & të trashëguara

Opera Madonnina del Grappa, është një organizatë e licencuar që ofron shërbim të përkujdesit social të tipit shtëpi-familje, për PAK të braktisur nga familja dhe të deinstitutionalizuar. Kjo organizatë, është krijuar dhe vepron në qytetin e Shkodrës që prej vitit 1992 ku filloi aktivitetin e saj në mbështetje të personave dhe familjeve më në nevojë. Në vitin 1994 filloj ristrukturimin i plotë i ish spitalit psikiatrik të fëmijëve në Shkodër, duke sjellë përmirësimin e kushteve të jetesës dhe trajtimit të fëmijëve, por në mënyrë të veçantë ky projekt realizoi krijimin për herë të parë në Shqipëri të Qendrës Ditore për fëmijët më aftësi të kufizuar dhe të krijimit të Shtëpisë Familje. Aktualisht në shtëpinë familje të Opera Madonnina del Grappa marrin shërbim 18 persona me aftësi të kufizuar. Qëllimi i kësaj strukture është rehabilitimi dhe përfshirja në jetën sociale e komunitare nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme me karakter edukativ e integruar duke ju ofruar përfituesve të saj shërbim rezidencial konform standarteve të miratuara nga Ministria e Linjës. Mbështetja e shtëpive – familje të “Opera Madonnina del Grappa” është një domosdoshmëri, për të ofruar shërbimin sipas standarteve të përcaktuara në ligj për personat me aftësi të kufizuara dhe përmbushjen e nevojave sipas rasteve specifike. Përveç pagesës për personelin, Bashkia Shkodër mbështet “Opera Madonnina del Grappa” duke mbuluar kuotën ushqimore për personat me aftësi të kufizuar të sistemuar pranë “Opera Madonnina del Grappa”, energjinë elektrike, ujë, gaz, karburant, shpenzime mjekësore etj. sipas marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Shkodër dhe “Opera Madonnina del Grappa”.

P10430.Q4.O2.A2. Projekti “Shpresa” për personat e braktisur dhe me aftësi të kufizuara & të trashëguara

Projekti Shpresa, është një organizatë e licencuar që ofron shërbim të përkujdesit social të tipit shtëpi-familje, për PAK-të e braktisur nga familja dhe të deinstitutionalizuar. Kjo organizatë, është krijuar dhe vepron në qytetin e Shkodrës që prej vitit 1995. Projekti “Shpresa” ka 7 shtëpi-familje, të shpërndara në komunitet dhe aktualisht marrin shërbim 62 persona me aftësi të kufizuara. Projekti “Shpresa”, duke ofruar shërbime alternative për personat me aftësi të kufizuara, të cilët janë pa asnjë përkujdes dhe interesim familjar, dhe me problematika të ndryshme, ka nevojë për mbështetje financiare dhe vëmendje të shtetit. Mbështetja e projektit “Shpresa” është një domosdoshmëri, për të ofruar shërbimin sipas standarteve të përcaktuara në ligj për personat me aftësi të kufizuara dhe përmbushjen e nevojave sipas rasteve specifike. Në këto qendra përfitojnë shërbime të përkujdesit shoqëror, rehabilituese dhe shëndetësore 64 individë me aftësi të kufizuara.

P10430.Q4.O2.A3. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara, më 3 Dhjetor & të trashëguara.

3 Dhjetori - Dita Botërore e Personave me Aftësi të kufizuara, synon ndërgjegjësimin e institucioneve, shoqërisë civile, donatorëve, por edhe të mbarë komunitetit për t’u bërë pjesë dhe për t’u përfshirë në procesin e integritit të personave me aftësi të kufizuara në jetën politike, sociale, ekonomike e kulturore. Në kuadër të ditës ndërkombëtare për personat me aftësi të kufizuara janë realizuar disa aktivitete. Qëllimi ynë është mposhtja e të gjitha barrierave, jo vetëm barrierat fizike të betonit, por ato kulturore dhe sociale të cilat pengojnë integritin e personave me aftësi të kufizuara në fusha të ndryshme të jetës. Kjo ditë synon ndërgjegjësimin e institucioneve, shoqërisë civile, donatorëve, por edhe të mbarë komunitetit për t’u bërë pjesë dhe për t’u përfshirë në procesin e integritit të personave me aftësi të kufizuara në jetën politike, sociale, ekonomike e kulturore.

P10430.Q4.O2. A4. “Asnjë Fëmijë Jashtë”

“Asnjë fëmijë jashtë” është një aktivitet social-kulturor që organizohet që nga viti 2005, me rastin e festave të fundvitit. Protagonistë të këtij aktiviteti janë fëmijët e familjeve në vështirësi social-ekonomike. Ky aktivitet nuk është realizuar për vitin 2024.

P10430.Q4.O2. A5. Mbështetja e trupës muzikore të Personave me Aftësi të kufizuara” & të trashëguara

Që nga viti 2005 në qytetin e Shkodrës zhvillon veprimtarinë e saj trupa muzikore The DOOR Albania, e vetmja në rajonin e Ballkanit. “Trupa muzikore e PAK-ve” përbëhet nga një grup të rinjsh me aftësi të kufizuara, të gjithë ish nxënës të shkollës speciale “3 Dhjetori”. Kjo trupë muzikore angazhohet në aktivitete të ndryshme që realizohen në territorin e bashkisë Shkodër, por jo vetëm. Kursi synon integritin e fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilët janë shumë të aftë në veglat frymore dhe përmes angazhimit përcjellin mesazhin: Mundësi integrimi për të gjithë. Trupa Muzikore përbëhet nga 32 të rinj me aftësi të kufizuara. Gjatë kësaj periudhe kjo bandë ka punuar dhe vazhduar provat dhe ka arritur të marrë pjesë dhe të performojë në aktivitete të ndryshme.

P10430.Q4.O2.A6. Shpërblim për jetimët me rastin e festave të fundvitit.

Në territorin e Bashkisë së Shkodrës ofrojnë shërbim rezidencial për fëmijë pa përkujdes prindëror 3 institucione të ndryshme të ndara sipas grupmohave. Këto institucione ofrojnë shërbime për të rinjtë

deri në moshën 18 vjeçare. Në ndihmë të kësaj shtrese është realizuar si vitet parardhëse shpërblimi i jetimëve të dalë nga strukturat rezidenciale, banorë të Bashkisë Shkodër, me rastin e festave të fundvitit. Qëllimi i kësaj ndihme është lehtësimi i situatës së tyre ekonomike dhe krijimi i një atmosfere sa më të mirë festive.

P10430.Q4.O2.A7. Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje.

Njësitë e qeverisjes vendore, si autoritete përgjegjëse në luftën kundër dhunës në familje, kanë detyrim ligjor ngritjen dhe funksionimin e sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje. (ligji nr.9669 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, i ndryshuar me ligjin nr.47/2018 dhe VKM nr. 334, datë 17. 02. 2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit tij”, i ndryshuar me VKM Nr.327, datë 02.06.2021). Në bashkinë e Shkodrës, që në shkurt të vitit 2017, nga drejtuesit e institucioneve vendore, rajonale dhe organizatave të shoqërisë civile që veprojnë me trajtimin e rasteve të dhunës në familje, është arritur firmosja e marrëveshjes së bashkëpunimit për riorganizimin dhe ngritjen e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij. Në kuadër të ndërgjegjësimit të shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, Bashkia Shkodër ka realizuar një sërë aktivitete për ndërgjegjësimin e komunitetit në lidhje me dhunën me bazë gjinore gjatë kësaj periudhe. Janë planifikuar, organizuar dhe zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese në kuadër të 8 marsit, ditës ndërkombëtare të gruas dhe në zbatim të kartës evropiane për barazi mes burrave dhe grave, të nënshkruar në vitin 2017, sipas një kalendarit të paracaktuar. Janë organizuar aktivitete sensibilizuese, informuese, të shpërndara në Qendrat Komunitare “Për Familjen”, shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie dhe institucionet kulturore të Bashkisë Shkodër si: Biblioteka “Marin Barleti”, Muzeu “Oso Kuka”, Teatri Migjeni, Galeria e Arteve etj. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative. Krahas këtyre aktiviteteve, fushatat e komunikimit online, me qëllim rritjen e informimit dhe sensibilizimit të komunitetit për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, janë organizuar vazhdimisht përgjatë të gjithë kësaj periudhe me anë të postimeve në mediat sociale të Bashkisë Shkodër dhe Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik. Gjatë kësaj periudhe ka vazhduar ofrimi i shërbimeve për viktimat e dhunës në familje dhe konsolidimi i tyre. Për të gjithë rastet janë hartuar dhe dërguar raportet përkatëse të monitorimit çdo 60 ditë në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër. Në varësi të nevojave viktimat e dhunës në familje, kanë marrë mbështetjen e duhur psikologjike dhe ligjore nga stafi i Qendrave Komunitare “Për familjen” të Bashkisë Shkodër dhe organizatat partnere që ofrojnë të tilla shërbime në Bashkinë Shkodër.

P10430.Q4.O2.A8. Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore & të trashëguara.

Barazia e grave dhe burrave përbën një të drejtë themelore për të gjithë dhe një vlerë thelbësore për çdo demokraci. Për t’u arritur kjo e drejtë, duhet që ajo jo vetëm të njihet me ligj, por edhe të zbatohet me efektivitet në të gjitha sferat e jetës: politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Me gjithë rastet e shumta të njohjes zyrtare dhe përparimin e bërë, barazia e grave dhe burrave në jetën e përditshme ende nuk është bërë realitet. Gratë dhe burrat nuk gëzojnë të drejta të njëjta në praktikë. Ende vazhdojnë të ekzistojnë pabarazitë shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore. Këto pabarazi janë rezultat i disa nocioneve shoqërore të ndërtruara mbi bazën e stereotipave të shumta të pranishme në familje, arsim, kulturë, mjetet e komunikimit, në botën e punës, në organizimin e shoqërisë. Janë aq të shumta fushat e jetës në të cilat mund të veprohet, përmes përdorimit të një qasjeje të re dhe realizimit të ndryshimeve strukturore. Për këtë, Bashkia e Shkodrës, pas nënshkrimit të kartës evropiane për barazi gjinore, është angazhuar në hartimin dhe miratimin e planit vendor gjinor si një mjet i rëndësishëm i zbatimit në

praktikë të angazhimeve publike të ndërmarra nga Bashkia Shkodër në lidhje me parimet e barazisë, planifikimit dhe zbatimit të nevojave dhe të drejtave të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, si dhe vajzave dhe djemve, nga të gjitha grupet e shoqërisë. Gjatë kësaj periudhe janë planifikuar, organizuar dhe zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuere në kuadër të 8 marsit, ditës ndërkombëtare të gruas dhe në zbatim të kartës evropiane për barazi mes burrave dhe grave, të nënshkruar në vitin 2017, sipas një kalendari të paracaktuar. Janë organizuar aktivitete sensibilizuese, informuese, të shpërndara në Qendrat Komunitare “Për Familjen”, shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie dhe institucionet kulturore të Bashkisë Shkodër si: Biblioteka “Marin Barleti”, Muzeu “Oso Kuka”, Teatri Migjeni, Galeria e Arteve etj. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative.

P10430.Q4.O2.A9. TVESA@SH– Konsolidimi i sistemeve për fuqizimin e viktimave në Shqipëri @Shkodër.

Projekti: “Konsolidimi i sistemeve për fuqizimin e viktimave në Shqipëri @Shkodër (TVESA@SH)”, zbatohet nga organizata Të Ndryshëm të Barabartë në rolin e Liderit të Projektit, ku Bashkia Shkodër dhe organizata KMOP (Greqi) janë partnerë. Projekti është përzgjedhur për financim në kuadër të thirrjes për propozime: EuropeAid/170610/DD/ACT/AL – “Partneritete në nivel lokal për avancimin e përfshirjes sociale në Shqipëri”, i financuar nga Bashkimi Evropian me fonde të programit IPA. Ky projekt sa i takon pjesës së Bashkisë Shkodër parashikon ndërhyrjen në infrastrukturën e qendrës komunitare “Për Familjen” Nj.A. Dajç, fshati Shirq, si dhe fuqizimin e kësaj qendre duke ofruar shërbime në ndihmë të grave dhe fëmijëve viktimë të dhunës të të gjithë bashkisë.

Buxheti total i projektit është 39,651,431.8 Lekë, nga të cilat financimi i Bashkimit Evropian do të jetë në masën 90% të kostove të pranueshme në vlerën 35,686,290.3 Lekë. Buxheti i dedikuar për Bashkinë Shkodër është në vlerën 8,739,629.5 Lekë nga të cilat 90% në vlerën 7,865,673.7 Lekë do të financohen nga donatori dhe 10% do të jetë bashkëfinancim I Bashkisë Shkodër me anë të burimeve të veta (staf ekzistues).

Shpenzimet e TVSH-së dhe garancisë 5% të punimeve nuk njihen si kosto të pranueshme nga donatori. Fondi me vlerë 447,000 lekë i cili mbulon vlerën e TVSH-së dhe garancisë 5% të punimeve, është marrë nga teprica e fondeve nga buxheti i miratuar tek programi 9240 “Arsimi i mesëm profesional”, artikull 231, me kod projekti 1410562 me emërtim “Rikonstruksioni i objektit të ish-shkollës veterinarë”, kontrata me Nr. 18397/12 Prot., datë 20.12.2021 me vlerë 10,056,694 lekë. Ky fond kalon tek programi 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”, kod 231, me emërtim “Mbulim i vlerës TVSH dhe 5% garanci”. Fondi me vlerë 200,000 lekë i cili mbulon vlerën e TVSH-së është marrë nga teprica e fondeve nga buxheti i miratuar tek programi 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët” nga fondi i zërave shpenzime korrente të trashëguara nga viti 2023.

Projekti është miratuar me VKB nr. 49, datë 27.09.2022 “Për miratim shtesë plani ne buxhetin e Bashkisë Shkodër”.

Gjatë kësaj periudhe u realizua aktiviteti ndërgjegjësuere me temë: “Prindërimi i mirë” në klubin social, me 5 përfitues. Prindërit kuptojnë domethënien e prindërimit të mirë dhe rolit të tyre, cilat janë llojet e prindërimit, rëndësinë e prindërimit të mirë, të mësojnë teknika bazë si të rrisin vet-vlerësimin e fëmijëve. U zhvillua aktiviteti me fëmijët e kujdesit alternativ me temë: “Punë krijuese me fëmijët”. Ky aktivitet i ndihmon fëmijët në aftësitë e tyre krijuese dhe stimulues për fantazinë e tyre. Aktiviteti Ndërgjegjësuere me temë: “Higjena orale”, në të cilin prindërit dhe fëmijët ndërgjegjësohen për rëndësinë e higjenës së gojës, ruajtjen dhe parandalimin e prishjes së dhëmbëve dhe mirëushqyerjen e

fëmijëve. Gjithashtu u realizua aktiviteti ndërgjegjësues me temë: “Pse mbrojtja fillon në familje?” U zhvilluan: aktiviteti ndërgjegjësues me temë: “Kanceri i qafës së mitrës”, aktiviteti ndërgjegjësues me temë: “Prindërimi pozitiv”. Prindërimi pozitiv mbështet rritjen e shëndetshme dhe plotësimin e nevojave të fëmijës. Aktiviteti ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare të gruas me temë: “Unë jam një Grua e Fortë”. Përfituesit dhe gratë frekuentuese të Klubit ndanë përvojat e tyre personale se si implementojnë nisma të vogla në familjet e tyre, për të kontribuar në arritjen e barazisë gjinore dhe të drejtave të barabarta. Aktiviteti ndërgjegjësues për rëndësinë e aktiviteti fizik. Aktiviteti fizik ka shumë efekte përfituese për shëndetin, pavarësisht nga mosha. Sesion informues në kuadër të javës europiane të vaksinimit. Gjatë takimit u diskutua mbi rëndësinë që kanë vaksinat për shëndetin e fëmijëve. Më së shumti u ndalëm tek rëndësia e vaksinës HPV, vaksinë e cila do të aplikohet kryesisht tek vajzat 13 vjeç. Aktiviteti u realizua në bashkëpunim me stafin e qendrës shëndetësore Dajç.

Sesion informues me temë: “Këshilla mbi abuzimin seksual tek fëmijët apo tek të rinjtë”.

Gjatë takimit u diskutua për dhunën seksuale: Çfarë është abuzimi seksual i fëmijëve? Kush janë abuzuesit? Çfarë mund të bëjnë familjarët? Çfarë mund të bëjë një shok/shoqe? Si të kërkojnë ndihmë dhe ku? Pjesë e aktivitetit ishin nxënës të shkollës 9 vjeçare “Pjetër Gaci” dhe “Lucë Agraja” Dajç.

Në alternativa e kujdesit kemi zhvilluar shumë aktivitete me fëmijët përfitues si ditën e verës dhe pranverës, Bajramin dhe Pashkët ku fëmijët kanë lyer vezët si simbolikë e tyre. Në ditën e librit fëmijët zhvilluan një konkurs dhe në fund u shpërblyen me një libër. Dita e tokës në alternativën e kujdesit u prit me mbjellje lulësh e bimësh. Gjatë kësaj periudhe kemi ndjekur edhe film dokumentar për zogjtë.

Është bërë rialokim fondi, të cilat më pas do përdoren për zërin ushqime tek fëmijët.

Gjatë muajit qershor u zhvilluan aktivitete të ndryshme me tema si: “Festa e 1 Qershorit”.

Në aktivitet morën pjesë 17 përfitues: “Rëndësia e njohjes së aktiviteteve për moshat e caktuara” me pjesëmarrës 8 përfitues.

Gjithashtu zhvilluam një sesion informues për ndihmën juridike falas online. Gjatë takimit pjesëmarrësit u njohën mbi:

- Ndhmën juridike parësore,
- Ndhmën juridike dytësore,
- Përrjashtim nga taksat dhe tarifat gjyqësore.

Prej datës 18-28 qershor të vegjëlit e Kujdesit Alternativ janë përfshirë në Kampin Veror. Aktivitetet e këtyre ditëve në qendër të tyre kishin lojën, si instrument që nxit imagjinatën dhe krijimtarinë e fëmijëve.

Përsa i përket muajit korrik u zhvilluan aktivitete me temë: “Diskutim me prindër në lidhje me vijueshmërinë e rregullt e fëmijëve në shkollë.”; “Kujdesi gjatë ditëve të nxehta” me pjesëmarrës 4 përfitues; “Të jesh prind, partneriteti dhe fëmijët” me pjesëmarrje 5 përfitues. Në muajin gusht kemi zhvilluar takim mbi: “Diskutim me përfitues të klubit në lidhje me regjistrimin e fëmijëve për përfshirjen e tyre në kursin e gjuhës angleze. Pjesëmarrës ishin 10 përfitues të klubit. Qëllimi i aktiviteteve është që të zhvillojmë sa më shumë aktivitete prind-fëmijë pasi kanë një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e fëmijëve. Përmes këtyre aktiviteteve synojmë përfshirjen e pjesëmarrësve, bashkëpunimin dhe qasjen me komunitetin, krijimi i grupeve vullnetar, ofrimin e mbështetjes psiko-emocionale, riintegrimin e përfituesve në komunitetin ku jetojnë dhe në tërësi mbështetje për fuqizimin e tyre.

P10430.Q4.O2. A10. Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi.

8 Marsi njihet si "Dita e Gruas", në të gjithë botën. Në këtë ditë reflektohet mbi kurajon dhe veprimet e grave të thjeshta të cilat luajtën një rol të rëndësishëm në historinë e të drejtave të grave. Në Ditën Botërore të Gruas, në ditët e sotme, ashtu si në të shkuarën, punohet për barazinë gjinore të gruas, pavarësinë e saj, eliminimin e padrejtësive politike, për kushte më të mira pune dhe jetese. Për herë të parë 8 Marsi në Shqipëri u kremtua në vitin 1942 të shekullit të XX-të në grupe të vogla grash. Në kuadër të 8 marsit, Ditës Ndërkombëtare të gruas u realizua një fushatë ndërgjegjësuere e shtrirë përgjatë të gjithë javës. Janë organizuar aktivitete sensibilizuese, informuese, të shpërndara në Qendrat Komunitare "Për Familjen", shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie dhe institucionet kulturore të Bashkisë Shkodër si: Biblioteka "Marin Barleti", Muzeu "Oso Kuka", Teatri Migjeni, Galeria e Arteve etj. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative. Synimi i kësaj fushate ishte promovimi i rolit të gruas në shoqëri.

P10430.Q4.O2. A11. Kujdesi social ndaj moshës së tretë.

Dita Ndërkombëtare e të Moshuarve është një ditë e veçantë për personat e moshës së tretë në të gjithë botën. Pleqëria është një prej rregullave të pandryshueshme të krijimit dhe një nga periudhat e rëndësishme të ciklit të jetës. Diskutimet janë përqëndruar në tema të tilla si: plakja e popullsisë dhe ofrimi i kujdesit shëndetësor për personat e kësaj moshe, puna vullnetare, kujdesi social dhe gjetja e mënyrave sa më përfshirëse për personat e moshuar, në fuqinë punëtore. Një problem shqetësues në vendin tonë është ndryshimi i dinamikave brenda familjes shqiptare, ku si pasojë e ndryshimeve dhe zhvillimeve social-ekonomike, kulturore, etj, fëmijët kanë prirje për të jetuar vetëm, për të emigruar dhe për t'u shkëputur nga familja. Një ndryshim i tillë në konceptin dhe traditën e familjes shqiptare, ka bërë që të kemi një rritje të të moshuarve që jetojnë vetëm, pa përkujdesjen dhe vëmendjen e nevojshme. Nuk ka të dhëna mbi numrin e saktë të moshuarve që jetojnë në territorin e bashkisë së Shkodrës. Një pjesë e madhe e kësaj kategorie jetojnë në shtëpi, vetëm, shpesh pa përkujdesje të veçantë dhe në varfëri e në kushte shumë të papërshtatshme. Pranë qendrës komunitare "Për Familjen" Nr.4, Bashkia e Shkodrës ofron shërbime ditore, të cilat konsistojnë në: informim, këshillim për problemet shëndetësore kryesore që prekin moshën e tretë, mundësi për kohën e lirë, ofrim çaji, kafeje, shtyp i ditës, pjesëmarrje në aktivitete social-kulturore, etj. Të moshuarit marrin rregullisht këshilla mjekësore dhe bëjnë vizita periodike për matjen e presionit të gjakut dhe të glicemisë në gjak. Festojnë rregullisht ditëlindjen duke organizuar festa ose dreka në ambjentet e qendrës dhe jashtë saj.

P10430.Q4.O2.A12. "Fuqizimi dhe zhvillimi i shërbimeve ditore për moshën e tretë".

Bashkia Shkodër është shpallur fituese me projektin "Fuqizimi dhe zhvillimi i shërbimeve ditore për moshën e tretë" është shpallur fitues në kuadër thirrjes për projekte "Askush të Mos Mbetet Pas", një program i përbashkët i Kombeve të Bashkuara, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Nëpërmjet këtij projekti synohet të financohet krijimi dhe fuqizimi i shërbimeve sociale me bazë komunitare të qëndrueshme dhe të standardizuara në mbështetje dhe përfshirje të moshës së tretë, që synojnë e tyre, rritjen e aksesit në shërbime dhe mundësi, me qëllim final promovimin e përfshirjes sociale të tyre.

Programi "Askush Të Mos Mbetet Pas", faza e dytë (LNB2) mbështetet mbi përvojën e gjerë të OKB-së në adresimin e përfshirjes sociale dhe nevojave të grupeve të rrezikuara. Projekti mbështet zbatimin e vizionit të sektorit social në Shqipëri, në përputhje me Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG-të) dhe aspiratat e vendit drejt integritimit evropian. Askush Të Mos Mbetet Pas (LNB2) shfrytëzon ekspertizën teknike dhe njohuritë e agjencive të OKB-së që synojnë ndikim dhe shtrirje më të madhe duke u fokusuar në nivel bashkie dhe në organizmat respektiv në nivel kombëtar. Qëllimi i

fazës së dytë të këtij programi (2021 - 2025) është fuqizimi i personave dhe grupeve të rrezikuar për të pasur akses të barabartë në shërbimet dhe mundësitë publike, të thonë fjalën e tyre në vendimmarrje publike që ndikojnë në jetën e tyre dhe të vënë para përgjegjësisë zyrtarët në detyrë.

Meqenëse ofrimi i shërbimeve realizohet kryesisht në nivel lokal, edhe ndërhyrja fokusohet në nivel lokal. Dy prej tre rezultateve pasqyrojnë këtë shtysë - duke fuqizuar përfituesit në nevojë për masa për mbrojtje sociale për të pasur akses dhe për të kontribuar në përfshirjen e tyre sociale (rezultati 1), dhe duke i aftësuar bashkitë të ofrojnë shërbime dhe të promovojnë mbrojtjen dhe përfshirjen sociale (rezultati 2). Rezultati i tretë pasqyron qëllimin e projektit për ankorimin e ndërhyrjeve të tij në nivel sistemi; që është kontributi në hartimin dhe zbatimin e mëtejshëm të politikave të përshtatshme për përfshirjen sociale, përfshirë edhe financimin.

Janë realizuar një serë aktivitete të planifikuara në kuadër të projektit.

P10430.Q4.O2. A13. Punësim dhe mësim për përfshirje sociale.

Bashkia Shkodër ka aplikuar në thirrjen e Skemës së Granteve “Inclusive Edu-Jobs - Drejt politikave dhe shërbimeve përkatëse të kontekstit që rrisin punësimin dhe rezultatet arsimore të romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri”, ku Autoriteti Financues përfaqësohet nga “Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë”, më 14.07.2024 me projektin “Punësim dhe mësim për përfshirjen sociale”. Projekti me nr. ref: IPA/2022/432-813 është përzgjedhur fitues për lidhjen e kontratës së grantit. e cila u nënshkrua më 28.09.2024

Buxheti i financuar nga Autoriteti Financues (donatori) për Bashkinë Shkodër është 60,000 Euro (6,404,700 Lekë), për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit. Projekti është duke u zbatuar me llogari jashtë thesari. Kontributi i Bashkisë Shkodër do të jetë mbulimi i vlerës së TVSH 20% dhe kosto të tjera në vlerën 300,000 lekë sipas nenit 14.4 të kontratës së grantit.

Nëpërmjet projektit “Puno dhe Mëso për Përfshirjen Sociale” synojmë të reduktojmë hendekun socio-ekonomik të komunitetit rom dhe egjiptian për të rritur pjesëmarrjen e tyre në komunitetin e Shkodrës.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është:

Ulja e hendekut socio-ekonomik të komunitetit rom dhe egjiptian drejt integritimit konkret në shoqërinë e qytetit.

1. Krijimi i mundësive për punësim dhe vetëpunësim;
2. Rritja e numrit dhe performancës së fëmijëve të regjistruar në shkolla duke i mbështetur me bursë.

Aktivitetet kryesore:

- **Puna në Komunitet**

- Aktiviteti 1- Krijimi i procedurave të brigadës***

- A1.1 Procedurat e përzgjedhjes së punonjësve në Programin e Punëve në Komunitet***

- Për shkak të çështjeve administrative, implementimi i Programit të Punëve në Komunitet ka patur vonesa. Këto çështje kanë gjetur zgjidhje në muajin gusht 2024 për të vazhduar me aplikimin e Bashkisë Shkodër për PPPK, në datën 29 gusht 2024.

- Koordinatori i projektit ka realizuar takime në zonat e qytetit ku jetojnë komuniteti R/E për t'i informuar për programin e punësimit. Bazuar në listat e ofruara nga AKPA për punëkërkues të papunë të komunitetit R/E janë përzgjedhur 13 persona të interesuar për punësim të cilët plotësojnë edhe kriteret e VKM- Nr.535 për PPPK. Këto punonjës kanë nënshkruar kontratat individuale të punës dhe Marrëveshjen tripalëshe mes Bashkisë Shkodër dhe AKPA me 30 shtator 2024.

- Aktiviteti 2- Punët në komunitet***

A.2.1 Punët në zonat turistike

Në zbatim të Programit të Punëve Publike në Komunitet, punonjësit e përzgjedhur nga listat e AKPA janë të punësuar nga data 1 tetor në pozicionet e punëve si më poshtë:

1. Lulzime Karmeshtna, sanitare te shkolla Pashko Vasa
2. Aferdita Behari, sanitare te konvikti i shkollës së Muzikës
3. Nuriye Rexha, ndihmëse te kopshti Bep Tusha
4. Rexhep Hamzi, Ndërmarrja e Shërbimeve e Punëve Publike
5. Melidjon Domi, Ndërmarrja e Shërbimeve e Punëve Publike
6. Anjeza Muhaxhiri, sanitare tek Qendra Multifunksionale “Për familjen”
7. Suela Shkallina, sanitare tek Qendra Multifunksionale “Për familjen”
8. Muhamet Kapllani, roje te shkolla Pyjore
9. Durim Liku, Ndërmarrja e Shërbimeve e Punëve Publike
10. Lutfi Muharremi, Ndërmarrja e Shërbimeve e Punëve Publike
11. Laura Liku, sanitare tek Qendra Komunitare Qendra Komunitare nr. 5
12. Rrezartë Muharremi, sanitare tek qendra “Harmonia”
13. Gjergji Jashari, Magazina e ushqimeve për kopshtet e cerdhet.

Sipas projektit, paga e punonjësve është me dy burime financimi, nga AKPA dhe nga fondet e projektit. Kontratat e dyta për shtesën e pagës për punonjësit e cila paguhet me fondet e projektit janë nënshkruar me 16 dhjetor 2024. Do vazhdohet me procedurën e likuidimit të pagave.

Gjatë kësaj periudhe tetor-dhjetor të gjithë punonjësit janë paraqitur në punë duke patur si evidencë listë- prezencat dhe foto gjatë punës. Gjithashtu, personat përgjegjës në vendet e punës ku ata punojnë janë të kënaqur me punën e tyre!

Në projekt është parashikuar që të këtë një mbikqyrës për punonjësit e përfshirë në programin e punëve në komunitet.

Përzgjedhja e mbikqyrësit/ ekspertit të punës në komunitet është bërë me procedurë prokurimi; kontrata e shërbimit është lidhur me 26.12.2024.

Për realizimin e punëve në komunitet, sipas buxhetit të parashikuar janë blerë materiale si prerëse bari me procedurë prokurimi; janë në proces blerje karburanti dhe paisje të tjera pune me procedurë prokurimi.

● **Bursat**

Aktiviteti 1 – Përzgjedhja e fëmijëve/ familjeve përfitues të skemës së bursave

A1.1- Hartimi i skemës së pjesëmarrjes – Aktivitet i realizuar

Bashkia Shkodër ka shpallur thirrjen publike për Programin e Bursave “Back to school” në datën 26 mars 2024 në faqen web. Shkollat e caktuara në thirrjen publike janë:

1. Pashko Vasa
2. Ndre Mjeda
3. Liria
4. Ali Lacej
5. Mati Logoreci
6. Isuf Tabaku
7. Edith Durham
8. Ruzhdi Daca

Shkolla Liria ka numrin më të madh të nxënësve R\Ë me rreth 105 nxënës dhe gjithashtu numrin më të madh të aplikantëve.

A1.2 Procedurat e përzgjedhjes së nxënësve – Aktivitet i realizuar

Pas fazës së aplikimeve, janë dorëzuar në total 83 aplikime, konkretisht: 59 aplikime nga shkolla Liria; 19 aplikime nga shkolla Ali Lacej; 2 aplikime nga shkolla Ndre Mjeda, 2 aplikime nga shkolla Isuf Tabaku; 1 aplikim nga shkolla

Pashko Vasa. Në vazhdim është krijuar një komision vlerësimi me urdhër të brendshëm me 2 maj 2024. Grupi i punës vendosi kriteret e vlerësimit si më poshtë:

- Rezultatet mësimore
- Frekuentimi në shkollë
- Ssituata ekonomike e familjeve të nxënësve

Pas marrjes në dorëzim të dokumentacionit të aplikantëve, komisioni i vlerësimit vendosi miratimin e listës së përfituesve të programit të bursave “Back to school” me 21 maj 2024. 30 nxënës janë përzgjedhur , konkretisht : 21 nxënës nga shkolla Liria, 7 nxënës nga shkolla Ali Lacej, 1 nxënës nga shkolla Isuf Tabaku dhe një nxënës nga shkolla Pashko Vasa.

Aktiviteti 2- Implementimi i skemës së bursave

A2.1- Blerja e materialeve shkollore për nxënësit - Aktivitet i realizuar

Për të ndihmuar familjet e nxënësve përfitues të programit të bursave është planifikuar të jepen materiale shkollore. Blerja e materialeve shkollore si canta, materiale didaktike, libra paisje kancelarike për 30 nxënësit është realizuar me procedurë prokurimi. Këto materiale shkollore u shpërndanë me fillimin e vitit të ri shkollor 2024- 2025 pranë Qendrës Multifunkionale “Për familjen” me 6 shtator 2024.

Skema e bursave gjithashtu përfshin një pagesë prej 50 euro për cdo nxënës për një periudhë 10 mujore. Për realizimin e këtyre pagesave, Bashkia Shkodër ka lidhur një Akt-Marrëveshje me Postën Shqiptare, filiali Shkodër që është nënshkruar me 2 maj 2024.

Janë realizuar disbursime të pagesave të bursave për muajt: maj 2024, shtator 2024, tetor 2024, nëntor 2024.

Nga programi i bursave vazhdojnë të përfitojnë të gjithë nxënësit.

A2.2 Mbështetja për nxënësit

Në zbatim të planit për klasat pas shkolle, Ekspertja e zgjedhur me procedurë prokurimi për programin e Bursave ka zhvilluar takime me nxënësit përfitues të bursave. Gjatë muajve tetor, nëntor, dhjetor janë zhvilluar klasat pas shkolle në ambjentet e shkollës “Liria” me nxënësit e kësaj shkolle të cilët përbëjnë edhe numrin më të madh të përfituesve të bursave (21 nxënës). Ekspertja ka raportuar rregullisht me foto dhe ka ndjekur ecurinë e të gjithë nxënësve në lidhje me frekuentimin dhe rezultatet.

P10430.Q4.O2. A14. HOLD ON - Nxitje e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë financiar në kuadër të programit Erasmus+.

HOLD ON do të kontribuojë në rritjen e aksesit të të rinjve në shërbimet joformale të shëndetit mendor të bashkëmoshatarëve në pika shërbimi që nuk ofrohet shërbimi mjekësor, siç janë institucionet arsimore, organizatat rinore, qendrat e punës, qendrat sportive dhe qendrat kulturore, duke siguruar që të arrihen të rinjtë më vulnerabël.

Për më tepër, do të kontribuojë në përmirësimin e shëndetit mendor, ofrimin e trajnimeve dhe burimeve për profesionistët që punojnë me të rinjtë, por nuk lidhen me shëndetësinë, në menyrë që të rinjtë të njohin problemet e shëndetit mendor dhe të krijojnë mjedise mbështetëse për ofrimin e mbështetjes joformale të bashkëmoshatarve të tyre.

Projekti do të rrisë ndërgjegjësimin e publikut të gjerë për mirëqenien mendore të të rinjve. Projekti synon që përfituesit të jenë rinjtë e moshës 14-29 vjeç, si dhe profesionistët që punojnë me të rinjtë, jo në fushën e mjekësisë.

Në këtë kuadër, qëllimi i përgjithshëm i projektit është: Përmirësimi i aksesit e të rinjve në shërbimet mbështetëse të shëndetit mendor dhe angazhimi proaktiv i tyre në përmirësimin e rezultateve të shëndetit mendor.

Projekti është në proces realizimi. Janë realizuar aktivitetet si më poshtë:

Projekti Hold On

Aktivitetet e realizuara

Paketa e punës nr. 2 WP2

a.

1. Krijimi i një pyetsori (Google forms) me 19 pyetje në bashkëpunim me 5 partnerët e tjerë, për të rinjtë në gjimnaze dhe universitete me tematikë shëndetin mendor.
2. Shpërndarja e këtij pyetësori në grupet e interesit të lartpërmendura.
3. Hartimi i një raporti të përbashkët (nga 22 faqe word afërsisht për partner) për gjetjet nga pyetsori i google forms.

b.

1. Zhvillimi i 6 moduleve me tema të ndryshme të shëndetit mendor (në bashkëpunim me partnerët) si vijon:
 - Çfarë është mbështja e bashkëmoshatarit? (42 slides)
 - Kurs e-learning për advokimin e shëndetit mendor tek të rinjtë.
 - Kuptimi i çrregullimeve të shëndetit mendor.
 - Identifikimi i shenjave të sfidave të shëndetit mendor.
 - Si ta ofrojmë mbështetjen emocionale?
 - Kujdesi për shëndetin mendor dhe vetë-menaxhimi në procesin e mbështetjes nga bashkëmoshatarët.
2. Modulet janë përgatitur në anglisht dhe shqip.
3. Është krijuar një faqe webi <https://holdonproject.eu/>.
4. Kjo faqe webi përmban të gjitha modulet ku të rinjtë mund të rregjistrohen, të bëjnë teste të ndryshme me llogari publike ose private duke ruajtur anonimat sipas dëshirës së tyre.
5. Është bërë pilotimi i kursit online në këtë faqe webi, është publikuar edhe në faqet zyrtare të Kryetarit/Bashkisë dhe Shërbimeve Sociale:

<https://www.facebook.com/100063543730287/posts/953398520121597/?mibextid=wwXlfr&rdid=SizmGz6eS8SQaCNg>

6. Në proces (krijimi i grupeve të mentorimit nga ekspertë sipas instruksioneve të partnerit lider në funksion të nxitjes së shëndetit mendor).

c.

7. Në tetor është bërë konferenca e përbashkët në Athinë për të diskutuar situatën e përgjithshme të të rinjve dhe qasjen që kanë ata për shëndetin mendor.

Paketa e punës nr. 3 WP3

a.

1. Zhvillimi i intervistave me profesionistë që punojnë me të rinjtë për të ditur qasjen me të rinjtë dhe si kanë ndryshuar ata para dhe pas COVID-it, sipas sugjerimeve të partnerit lider.
2. Është hartuar një raport (30 faqe word), me të dhëna zyrtare nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe gjetjet nga intervistat.

b.

3. Eshtë krijuar një liber, online (version digjital), me sugjerime nga të gjithë partneret për ushtrime të thjeshta që nxisin përmirësimin e Shëndetit mendor.
4. Libri është hartuar në Anglisht dhe Shqip.
5. Pas hartimit të librit është bërë konsultimi me profesionistët e fushës nëse kanë sugjerime shtese.
6. Në proces po hartohet raporti mbi këto sugjerime

Paketa e punës nr. 4 WP4

1. Eshtë bërë paraqitja tek të gjithë partneret për çdo institucion/organizatë që ofron një shërbim për të rinjtë edhe është bërë vendndosja në harte me vendndodhjen perkatese.
2. Eshtë krijuar një platformë online në formë forumi ku të rinjtë nga e gjithë vendet e partnereve ndajnë çështje të shëndetit të shëndetit mendor.
3. Në proces do bëhet pilotimi për platformën.

Qëllimi i këtyre aktiviteteve është të krijojë grupe mbështetëse që të rinjtë të krijojnë një hapësirë, në të cilën mund të flasin dhe përmirësojnë shëndetin e tyre mendor përtej barrierave kulturore dhe sociale.

P10430.Q4.O2. A15. “Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen”.

Projekti “Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen”, është shpallur fitues në kuadër të thirrjes për projekte “Askush të Mos Mbetet Pas”, një program i përbashkët i Kombeve të Bashkuara, i financuar nga Agjencia Zvicëranë për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Objektivat e projektit:

OS.1 Krijimi dhe fuqizimi i shërbimeve ditore për fëmijët dhe familjen pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” Nr.5 dhe Qendrës Multifunksionale Xixëllonjat.

OS.2 Përfshirja dhe fuqizimi i familjeve përmes shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen” pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” Nr.5 dhe Qendrës Multifunksionale Xixëllonjat.

Aktivitetet kryesore të projektit:

A.1: Ofrimi i shërbimeve edukative paschkollore pranë hapësirave të Qendrave Komunitare “Për Familjen” Nr. 1 dhe Qendrës Multifunksionale Xixëllonjat në lagjen Nr.1 dhe 5.

A.2: Zhvillimi i një kampi veror për fëmijët përfitues të shërbimeve pranë Qendrave Komunitare “Për Familjen” Nr. 5 dhe Qendrës Multifunksionale Xixëllonjat në lagjen Nr.1 dhe 5.

A.3: Zhvillimi i një aktiviteti final përmbyllës me fëmijët dhe prindërit përfitues të shërbimeve pranë Qendrave Komunitare “Për Familjen” Nr. 5 dhe Qendrës Multifunksionale Xixëllonjat në lagjen Nr.1 dhe 5.

Përgjatë kësaj periudhë janë realizuar një pjesë e aktivitete të planifikuara në kuadër të projektit.

P10430.Q4.O2.A16. “Realizimi i Aktiviteteve për Rininë” Qendra Rinore "Atelie".

Për vitin 2024 në Qendrën Rinore “Atelie”, u realizuan iniciativa rinore e përmuajshme “Kinerinore”, vizitat studimore nga të rinjtë në strehën e kafshëve “Animals Need Me” dhe në shtëpinë e fëmijeve 0-5 vjeç. U organizua nga të rinjtë ekspozita “Terapi shpirti” të artistes së re Sibel Nimani.

Në kuadër të projektit Bibliotech në bashkëpunim me UNICEF Albania, u zhvillua trajnimet “Marketingu digjital”, strategjitë dhe llojet e marketingut digjital; “Sipërmarrja dhe Inovacioni”; “Përdorimi i AI në mënyrë të përgjegjshme”.

U zhvillua trajnimi për gjimnazistat “Tomorrow’s Entrepreneurs” në kuadër të konkurseve kombëtare “TechInovators”. Në Qendrën Rinore u zhvillua projekti 3 ditor “Up Shift for Air Quality” i zbatuar nga UNICEF Albania.

Në bashkëpunim me Shoqatën e Shkrimtarëve të Shkodrës u zhvillua aktiviteti “Akorde Rinore” me tematikën të rinjtë dhe letërsia dhe u realizua konkursi “Të rinjtë në poezi”.

U realizua aktiviteti edukues dhe ndërgjegjësues për drejtësinë miqësore për të miturit përmes rekreacionit dhe artit, në kuadër të projektit “Mbështetje për funksionimin e rrjetit lokal ndërinstytucional, koordinimin efektiv dhe menaxhimin e rasteve të fëmijeve në konflikt me ligjin”.

U zhvillua trajnimi “Fuqizimi i së drejtës për arsim: Shprehja e të drejtave të njeriut përmes artit”.

Aktiviteti “Për lundrim të sigurt të fëmijëve në internet” u zhvillua nga Shkolla Ismail Qemali.

Në kuadër të ditës ndërkombetare të Gruas u zhvillua aktiviteti ‘Nxitja e barazisë, nxitja e sfidave tek vajzat dhe gratë në jetën e përditshme përmes advokimit të të rinjve”.

U zhvillua projekti 4 ditor “Themis 2024”, Parlamenti Evropian Rinor, mbi temë “Promovimi i Barazisë dhe Gjithëpërfshirjes”.

U realizua projekti “Ajër i pastër për komunitetet vulnerabël” në bashkëpunim me Institutin për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit.

U realizua shfaqja “Porta e Fjalës” me regji nga Ema Andrea me synim hapjen e një dialogut mbi viktimat e dhunës.

U realizua shfaqja “LUFTA” me regji nga Julian Hurdha, bazuar mbi veprën e Edëard Albee. U shfaq filmi me metrazh të shkurtër “Mbjellja e Pemëve” në bashkëpunim me COD.

U zhvillua sesioni informues nga Caritasi Dioqezan për mundësitë që ofron projekti “Your Job Shkodër”.

U zhvillua “Shkolla Pranverore Evropiane” në partneritet me projektin “Bashkitë për në Evropë”, ku të rinjtë mësuuan për historinë e BE-së, institucionet, politikat dhe programet e Bashkimit Evropian.

Në bashkëpunim me Save the Children e zhvilluan sesionet e trajnimeve për “Aftësitë e buta”; trajnimet për të drejtat e fëmijeve: seancat e bootcampit për mbështetjen e ideve të biznesit për të rinjtë.

Në bashkëpunim me organizatën YEA! u zhvilluan trajnimet për konkursin YEA!Aëards si dhe kurset pas-shkollë “After School” për lëndet matematikë, fizikë, gjuhë shqipe, SYT, design, anglisht, gjermanisht, CPS/CPH/ITSS/NËTK dhe në kuadër të projektit “Fiziomobil 2024” u realizuan 13 takime terapiet për pacientët përfitues të projektit si dhe u zhillua trajnimi “Teori-Praktikë Identifikimi i hershëm i problematikave të zhvillimit psiko-motor” në kuadër të të njejtit projekt.

Në Qendrën Rinore “Atelie” u zhvillua Tryeza e Rrumbullakët si përmbyllje e projektit “Buxhetimi përgjigjshëm gjinor për të trajtuar situatat e krizave dhe emergjencat-financimi i qëndrueshëm në Bashkinë Shkodër”.

Gjatë muajit Korrik u zhvilluan “Edu Labs” për kercim, për qendrisje në telajo, për muzik dhe për “Edu Lab si të lehtësojmë punën në grup”, një nisëm rinore nga të rinjtë e Qendrës Rinore “Atelie” për të rinjtë e Shkodrës, gjithashtu gjatë muajve të verës u zhvillua aktiviteti argetues “Fund day”.

U zhvillua trajnimi 2-ditor për SME dhe Start Up, për të rinjtë e moshës 18 - 29 vjeç. Qëllimi i këtij trajnimi ishte ofrimi i një informacioni të përgjithshëm mbi aspektet ligjore të fillimit dhe drejtimit të një biznesi, gjenerimit të ideve të biznesit, mundësitë e përfitimit nga skema të ndryshme financiare si dhe trajnim për shkrimin e projekt-propozimeve sipas këtyre skemave. Ky aktivitet u realizua nga Bashkia Shkodër në kuadër të Ditës së Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla e të Mesme.

U realizua aktiviteti "Mjedisi i pastër, e ardhmja e sigurtë", për pastrimit e plazhit të Velipojës! Bashkëpunimi i Këshillit Vendor Rinor, Bashkisë Shkodër, Qendrës Rinore Atelie dhe organizatës Save the Children për një mjedis më të pastër dhe një të ardhme më të sigurtë.

Në Qendrën Rinore “Atelie” është duke u zhvilluar trajnimi dy ditor “Kërkimi i kanaleve ndërsektoriale për punësim të denjë”. Trajnimi kishte për qëllim marrjen e njohurive teorike dhe praktike për të komunikuar me tregun e punës dhe sigurimin e një punësimi të denjë pas përfundimit të kursit. Pjesë e trajnimit janë edhe përfaqësues të Burimeve Njerëzore, të shoqërisë civile dhe përfaqësues të strukturave shtetërore në sektorin e punësimit dhe formimit profesional. Trajnimi u zhvillua në kuadër të projektit “Rrugëtimi i adoleshentëve dhe të rinjve drejt fuqizimit, mirëqenies dhe qëndrueshmërisë” që “Save the Children” dhe fondacioni “Ndhimë për Fëmijët” në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër.

Në ambientet e Qendrës Rinore “Atelie” u promovua libri i katërt i shkrimtares Marjana Sulejmani, “Dhimbje Shpirti”. Gjatë aktivitetit u interpretuan poezitë e autorës, ku u trajtuan në aspekte të ndryshme poetike. Ky aktivitet ishte një bashkëpunim midis Qendrës Rinore dhe Shoqatës së Shkrimtarëve.

Në Qendrën Rinore “Atelie” u zhvillua seminari “Pastoralizmi dhe perspektivat e zhvillimit të tij në Shqipëri” me qëllim promovimin e transhumancës si vlerë jomateriale e trashëgimisë botërore tashmë e mbrojtur nga UNESCO. Ky seminar u zhvillua nga Shoqata Vlerat Baritore në mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm baritor me mbështetjen e Qendrës Rinore “Atelie”, Bashkia Shkodër.

Në Qendrën Rinore “Atelie” u zhvillua trajnimi “Sipërmarrësia dhe aftësitë arsimore të të rinjve”, me qëllimin që të rinjtë të mësojnë dhe të rrisin kapacitetet e tyre për sipërmarrjen, biznesin, sipërmarrjen sociale, duke i njohur ata fillimisht me terma dhe koncepte bazë dhe më pas me anë të shëmbujve praktik. Ky trajnim u zhvillua në kuadër të projektit “Youth Educational Entrepreneurship and Skills”, u realizua nga organizata “Pertej Barrierave” me mbështetjen e Qendrës Rinore “Atelie”, Bashkia Shkodër.

U shfaq filmi me metrazh të shkurtër “TEA & KEJSI”. Ky aktivitet u organizua nga Qendra për Hapje dhe Dialog #Shkodër në kuadër të programit “Kinemaja në Rajone”, në bashkëpunim me Këshillin Vendor të Rinisë Shkodër. Pas shfaqjes, të rinjtë pjesëmarrës morën pjesë në një diskutim të shkurtër, duke ndarë disa mesazhe të vlefshme.

Në Qendrën Rinore "Atelie" u realizua me sukses ëorkshopi 5 ditor në kuadër të Projektit "European EU CARE", me titull "EUCARES; Eë are all stories". Gjatë ëorkshopit pjesëmarrësit u njohën me teknika të "storytelling" për trajtimin e traumes kolektive dhe shërimin e pasojave sociale, ku ditën e fundit të ëorkshopit të rinjtë prezantuan punën e kryer prej tyre. Ky ëorkshop u organizua nga Intelektualet e rinj, Shprese (IRSH) me mbështetjen e Bashkisë Shkodër dhe u zhvillua njekohësisht në 7 shtete të ndryshme të Ballkanit.

Janë zhvilluar gjirimet e Pod Cast-it "Jepi Za", nje nisem rinore nga të rinjtë e Qendrës Rinore "atelie për të rinjtë e Shkodrës, më qëllim promovimin e të rinjve në qytetin e Shkodrës.

Aktiviteti "Pedalojmë për Familjen" synon rritjen e ndërjegjësimin rreth çështjeve të mbrojtjes dhe forcimit të familjes, promovimin e një mjedisi mbështetës për fëmijet, të rinjtë dhe anëtarët e komunitetit dhe solidarizimin me sfidat që hasin familjet. Ky aktivitet u organizua ne Bashkepunim me Save the Children.

Në Qendrën Rinore Atelie u zhvillua sesioni mbi aftësitë digitale "DIGITAL LITERACY SKILLS FROM NAVIGATING TO PRESENTING".Sesioni u zhvillua me një eksperte në fushën e njohurive digitale, e cila i udhëzoi të rinjtë se si të navigojnë në internet, të përpunojnë informacionin me efikasitet dhe ta prezantojnë atë perpara të tjerëve. Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të projektit BiblioTech, i cili zhvillohet nga Qendra Shqiptare për Zhvillim të Qëndrueshëm @a.s.d.o_, në bashkëpunim me UNICEF Albania @unicefalbania dhe Bashkinë Shkoder @bashkiashkoder.gov.al në kuadër të programit të "Transformimit të Përgjigjes Kombëtare ndaj Trafikimit të qënieve Njerëzore ne dhe nga Shqipëria" mbështetur nga Qeveria Britanike.

U zhvillua Shkolla Pranverore Evropiane, ku mbi 30 të rinj mësuan për rolin e të rinjve në procesin e integritimit evropian. Ky aktivitet u organizua nga Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Bashkimin Evropian si partner në projektin "Bashkitë për në Evropë".

Nga Sektori i Rinisë zhvillua koncerti "Youth Eëave", në kuadër të Ditës Nderkombëtare të Rinisë, me qëllim promovimin e talenteve te reja, sipërmarrësve të rinj dhe promovimin e organizatave të shoqërisë civile që kontribuojnë për të rinjtë e qytetit të Shkodrës.

Zhvillimi I nje koncerti në sheshin para Bashkisë për Promovimin e Talenteve të Reja.

Zhvillimi i panairit ushqimor në kuadër të Ditës Kombëtare të Rinisë.

Në Qendrën Rinore "Atelie" u zhvillua promovimi i librit për fëmijë "Pema në Pelena", nga autorja Rudina Çupi.

Në Qendrën Rinore Atelie u realizua takimi dy ditor, pjesë e një projekti kërkimor të organizuar nga Departamenti i Psikologjisë dhe Punëve Sociale, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi".

Koordinimi I shtëpizës rinore si një initiative e të rinjve për grumbullimin e parave përmes shitjeve të ëmbëlsirave apo pijeve të ngrohta për bamirësi, gjatë muajit Dhjetor.

Në Qendrën Rinore Atelie u zhvillua aktiviteti mbi Barazinë dhe Drejtësinë Gjinore në kuadër të projektit "Youth Care" i cili ka për qëllim fuqizimin e të rinjve për një të ardhme më të drejtë dhe të qëndrueshme.

Në Qendrën Rinore "Atelie" u zhvillua Bootcamp-i tre-ditor dedikuar gjenerimit të ideve për biznese të reja me fokus mbrojtjen e mjedisit në bashkëpunim me Save the Children.

Në kuadër të projektit SUPERSCHOOLS, mbështetur nga RYCO, mirëpritëm në Qendrën Rinore "Atelie" një shkëmbim mes gjimnazit "Jordan Misja" dhe shkollës profesionale "Vasa Pelagiç" nga

Kovini, Serbi, ku 12 të rinj nga Shkodra dhe 12 të rinj nga Kovini bashkëpunuan dhe mësuan në emër të një bote pa kufij, pa konflikte dhe ndarje.

Mbështetje nga Qendra Rinore Atelie për aktivitetin e realizuar në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara.

Mbështetje mbi thirrjen “Skemë Granti për të Rinjtë”, një mundësi financimi për sipërmarrësit e rinj shkodranë të moshës 18-30 vjeç!

Zhvillimi i ekspozitës "Reflektime Portokalli" e cila është një ekspozitë artistike e realizuar në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit, një fushatë ndërkombëtare që synon ngritjen e ndërgjegjësimit dhe promovimin e të drejtave të grave dhe luftën kundër dhunës.

Aktiviteti “Promovimi i Arsimit Profesional” ishte një sukses, me pjesëmarrjen e shumë të rinjve që patën mundësinë të informohen dhe diskutojnë për rrugët e tyre të ardhshme profesionale, një bashkëpunim mes Qendrës Rinore Atelie dhe KVR.

Në ambientet e Qendrës Rinore Atelie, u zhvillua aktiviteti “Monitorimi i Pjesëmarrjes Politike, Ekonomike dhe Sociale të të Rinjve në Shqipëri” në bashkëpunim me Partners Albania.

Në Qendrën Rinore “Atelie” u zhvillua një aktivitet në kuadër të Ditës Evropiane “Për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual” në bashkëpunim me Shkollën “Prenkë Jakova”, mbështetur nga Terre des hommes, UNICEF dhe Ambasada Britanike në Tiranë.

Në Qendrën Rinore “Atelie”, u zhvillua aktiviteti ndërgjegjësues në kuadër të projektit “TËIST - Toëards a Neë Social Entrepreneurship Model in Confiscated Assets in Albania”.

Takimi letrar “Çardaku Poetik” I cili mblodhi së bashku studiues, pedagogë, shkrimtarë dhe të rinj për të promovuar qytetarinë dhe letërsinë shkodrane. Kjo nisëm u realizua nga Admir Dahati, i riu i Qendrës Rinore “Atelie”.

Në Qendrën Rinore “Atelie” u realizua me sukses ëorkshopi “Key Adviser” në bashkëpunim me zyrën e punës. Pjesëmarrësit e workshop-it u pajisën me njohuri të reja mbi këshillimin në karrierë, etikën e punës dhe si të plotesojnë një CV.

Në bashkëpunim me Qendrën “Hapat e Lehtë” në ambjentet e Qendres “Rinore Atelie” u zhvillua një aktivitet mbi promovimin e barazisë, përfshirjes sociale dhe mosdiskiminimit të grave dhe personave LGBTQ+ në Shqipëri.

U zhvillua aktiviteti “Idromeno Film Festival”. Gjatë festivalit u organizuan edhe ëorkshop-e të ndryshme, si ëorkshop-i “Creating a short movie” , dhe sesione për ndarjen e përvojave nga profesionistë të njohur në industrinë e filmit.

Në Qendren Rinore Atelie në bashkëpunim me COD u zhvillua një trajnim me tematikë “Teknikat e vetëprezantimit”e zhvilluar me ekspertin e komunikimit Manjola Lloja,i cili u zhvillua ne formë bashkëbisedimi mes të rinjeve dhe ekspertes.

Eshtë realizuar me suksese promovimi i librit “Ditët e mia” në bashkëpunim me Shoqatën e Shkrimtarëve Shkodër ku autorja Life Hasaj foli për magjinë e poezisë.

Bashkia Shkodër organizoj një sesion informues me të rinjtë për të rritur ndërgjegjesimin për rrezikun ndaj kancerit të gjirit.Gjatë sesionit të rinjte u informua për faktorët e rrezikut dhe rëndesinë e kontrolleve të rregullta.

Në ambjentet e Qendres “Rinore Atelie” u zhvillua një takim frymezues mes Bashkisë Shkodër, UNICEF, ZVA dhe përfaqësuesve të shkollave të mesme të Shkodrës. Gjatë takimit u diskutuan mbi mundësitë e angazhimit, orientimit dhe pjesëmarrjes aktive që të rinjtë nevojitet të kenë në komunitet.

Në Qendrën Rinore Atelie në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër dhe UNICEF u zhvillua aktivitetit “Gamifying Shkodra” – Një lojë që na mbajti të përfshirë për të zgjidhur sfidat urbanistike të qytetit dhe për t’u përballur me ndryshimet klimatike.

Qendra Atelie së bashku me Këshillin Vendor Rinor zhvilluan aktivitetin “Kinemanë Lëvizëse për shfaqjen e filmit “The Volunteer”. Pas filmit u diskutua së bashku me të rinjtë në lidhje me vullnetarizmin dhe idetë e tyre për përmirësimin e Ligjit të Vullnetarizmit.

Në Qendrën Rinore Atelie cdo të shtunë organizohet “Fun Day” me të rinjtë. Organizojmë aktivitete ku të rinjtë të jenë të lire të argetohen nëcdo fushë si karaoke day, movie time, Pantomime, Dance etj.

Në kuadër të “ Muajit të Luftës kundër Trafikimit të Personave” të rinjtë e Qendrës “Rinore Atelie” morën iniciativën sensibilizuese dhe ndergjegjesuese për të krijuar një film të shkurtër me një mesazh të fuqishëm për trafikimin e qenieve njerëzore.

Qendra “Streha realizoj me sukses ëorkshopin me temë “ Ofrimi i shërbimeve afirmuese për personat LGBTI+ dhe grupet e argjinalizuara” në qytetin e Shkodrës. Qëllimi i ëorkshopit ishte të rrisë kapacitetet e organizatave lokale për të ofruar shërbime të drejta dhe gjithëpërfshirëse.

U zhvillua Projekti “Rrugëtimi i të rinjve drejt mirëqenies, fuqizimit dhe qëndrueshmërisë” nga Save the Children në partneritet me Fondacionin “Ndihme për Fëmijet” dhe Bashkinë Shkodër.

Projekti EU4LMI zhvilloj në Qendrën Rinore Atelie sesion informues me tematikë “Jetesa aktive dhe punësimi i mbështetur për personat me aftësi të kufizuara”. Ky projekt synon përmirësimin e partneritetit të AKPA-së me bashkitë për të ofruar mundësi punësimi dhe zhvillimi aftësish për grupet e cënueshme, si përfituesit e ndihmës ekonomike, NEET, PAK dhe nënat e reja jo të përfshira në punësim. Qëllimi është të sigurohet një mbështetje gjithëpërfshirëse dhe integruese për këta individë në tregun e punës.

Në ambjentet e Qendrës Rinore Atelie u zhvillua një ëorkshop 3 ditor për zhvillimin e biznesit që ndihmoj të rinjtë me ide biznesi për të ardhmen.

Ekspozitë në kuadër të muajit të ndergjegjesimit në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore u realizua një ekspozitë me temë “Fëmijet të parët kundër trafikimit”.

Në Qendrën Rinore Atelie u zhvillua me sukses ëorkshop nga Manjola Lloja ku u trajtuan hapat e para të biznesit dhe strategjitë për idetë në projekte reale.

Në Qendrën Rinore ‘Atelie’ u zhvillua njetaki me një grup studentësh të klasës së Turizmit, Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Studentet u njohën me ambjentet e qendres dhe menyrën sesi funksionon qendra.

P10430.Q4.O1.A2. Rikonstruksioni i çerdhes “Manush Alimani” & të trashëguara.

Gjatë vitit 2020, Bashkia Shkodër ka vlerësuar dhe analizuar gjëndjen infrastrukturore të çerdheve në territorin e saj dhe ka lindur nevoja për rikonstruksionin e plotë të godinës së çerdhes “Manush Alimani” për shkak të gjëndjes së saj të amortizuar. Në bazë të verifikimeve që janë bërë ka rezultuar që kjo çerdhe ka nevojë të theksuar për rikonstruksion të plotë, pasi godina është në gjëndje shumë të

amortizuar të dyshemesë, mureve, dyerve, tavanit dhe dritareve. Për vitin 2024 është planifikuar ndërhyrja infrastrukturore pranë kësaj çerdheje. “Rikonstruksioni i Çerdhes “Manush Alimani”. Ka përfunduar faza e rikonstruksionit dhe është likujduar.

P10430.Q4.O1.A2. Rikonstruksioni i çerdhes “Manush Alimani” & të trashëguara.

Proçedura për mobilimin e çerdhes “Manush Alimani” është prokuruar, lidhur kontrata dhe është në fazë zbatimi.

Programi 10661: Strehimi social

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit.

Qëllimi i I i programit të “Strehimi social”.

Q1. Administrimi i programeve të strehimit social.

Objektivi i programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për vitin 2024 është:

O1. Vlerësimi, planifikimi dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të banimit, të komuniteteve të pafavorizuara , përmes ofrimit të alternativave për njëstrehim të gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm

Qëllimi i II i programit të “Strehimi social”.

Q2. Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Objektivi i programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për vitin 2024 është:

O1. Përmiresimi i kushteve të banimit për kategoritë e familjeve të pafavorizuara.

Realizimi i Buxhetit të planifikuar

Programi “Strehimi social”.

| Programi 10661 | Paga+ sigurime | Shpenzime operative | Transferta | Investime | 000/leke Totali |
|------------------------|-------------------|------------------------|------------|-----------|--------------------|
| PBA 2024 | 3,508 | 1,350 | 5,430 | - | 10,288 |
| Plani fillestar 2024 | 3,508 | 2,515 | 7,992 | - | 14,015 |
| Plani i rishikuar 2024 | 3,608 | 1,653 | 7,824 | 6,969 | 20,054 |
| Realizimi viti 2024 | 2,627 | 124 | 2,302 | | 5,053 |
| % e realizimit | 72.8% | 7.5% | 29.4% | 0.0% | 25.2% |

Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është në total 25.2 %, sipas zërave kryesorë më poshtë:

| | |
|--|--------------|
| Shpenzimet korrente (paga+sigurime shoqërore, shpenzime operative, transferime) | 38.6% |
| Shpenzimet kapitale | 0 % |



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara.

Arsyeja e mosrealizimit të fondeve të planifikuara është depozitimi jo në afat i kontratave të qerasë, si rrjedhojë nuk janë likujtuar të gjithë muajt për familjet përfituese. Largimi i përfituesve jashtë vëndit.

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: viti 2024

| Kodi i Programit | 10661 | Emertimi i programit: | Strehimi social | | | | | |
|-------------------------------|---|---|--|--------------------------------------|------------------------------------|---------------------------------------|---|------|
| Qëllimi 1 | Administrimi i programeve të strehimit social. | | | | | | | |
| | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | Kodi i Treguesit te Performances/Produktit | Emërtimi i Treguesit të Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit | |
| <i>Objektivi Specifik 1.1</i> | Vlerësimi, planifikimi dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të banimit, të komuniteteve të pafavorizuara , përmes ofrimit të alternativave për njëstrehim të gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm | 1 | Numri i punonjësve tek sektori i strehimit social | | 3 | 3 | 3 | 100% |
| | | 2 | Numri i banesave sociale funksionale si pjesë e fondit të banesave sociale me qira të bashkisë | 84 | 55 | 100 | 141 | 141% |
| | | 3 | Numri i përfituesve për subvencionim qiraje (raporti në % viti korent kundrejt vitit të kaluar) | 61 | 65 | 47 | 47 | 100% |
| | | 4 | Numri i aplikimeve për subvencionimin e interesave të kredisë | 76 | 100 | 80 | 60 | 75% |
| | | 5 | Numri i familjeve perfituese nga subvencionimi i interesave të kredive nga shteti për familjet në nevojë (kredi të buta për shtëpi | 31 | 35 | 21 | 21 | 100% |
| <i>Qëllimi 2</i> | Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. | | | | | | | |
| <i>Objektivi Specifik 2.1</i> | Përmiresimi i kushteve të banimit për kategoritë e familjeve të pafavorizuara. | 6 | Numri i banesave sociale funksionale si pjesë e fondit të banesave sociale me qira të bashkisë | 79 | 79 | 79 | 79 | 100% |
| | | 7 | Të ardhurat nga qeraja e banesave sociale (mijë lekë) | 914 | 200 | 765 | 1038 | 136% |
| | | 8 | Numri i familjeve që përfitojne banesa sociale me qira | 166 | 130 | 120 | 119 | 99% |
| | | 9 | Nr I aplikimeve pranë qeverisë dhe donatorëve për programet sociale të strehimit në vit, | 1 | 3 | 1 | 1 | 100% |

ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 | | | | | | | | | | | | | | |
|---------------|---|----------------------------|---------------------------|--------------------------------|------------------------------------|------------------------------------|---|--|---|--|---|---------------------------|--------------------------------|-------------------------------------|-------------------------------------|-------------|--------------|
| Programi | Strehimi Social | Kodi i Programit | 10661 | | | | | | | | | | | | | | |
| | në 000/lekë | | | | I | | | II | | | III | | | IV | Luhatjet në Koston për Njësi | | |
| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (viti 2023) | Shpenzimet Faktike (viti 2023) | Kosto për Njësi (sipas vitit 2023) | Sasia (sipas planit të vitit 2024) | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2024) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2024) | Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2024) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2024) | Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar viti 2024) | Sasia Faktike (viti 2024) | Shpenzimet Faktike (viti 2024) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2024) | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III |
| 1 | Shërbimi i Stafit të Strehimit Social | Nr. punonjësish | | | | 3 | 3.508 | 1,169.3 | 3 | 3.608 | 1,202.7 | 3 | 2.627 | 875.7 | 875.7 | - | -327.0 |
| 2 | Familje në nevojë/Individë të subvencionuar për qeranë me burimet e veta | Nr. Familjesh | | | | 65 | 5,430 | 83.5 | 47 | 7,824 | 166.5 | 47 | 2,302 | 49.0 | 49.0 | -34.6 | -117.5 |
| 3 | Familje / Individë të subvencionuar për interesin e Kredisë. | Numri I familjeve | 31 | | 0.0 | 35 | | 0.0 | 21 | | 0.0 | 21 | | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 |
| 4 | Banesa sociale me qera të mirëmbajtura | Numri i njesive te banimit | 74 | 302 | 4.1 | 79 | 1,350 | 17.1 | 79 | 8,622 | 109.1 | 79 | 124 | 1.6 | -2.5 | -15.5 | -107.6 |
| 5 | Projekte per permiresimin e kushteve te banimit te komuniteteve te paforizuara (në numër) | Nr. Projektesh | 1 | | 0.0 | | | | | | | | | | | | |
| 6 | Persona të mbështetur me subvencionim qiraje në tregun e lire dhe perfitues të subvencionimit të interesave të kredisë për banesa me kosto të ulët (në numër) | Nr. i familjeve përfituese | 92 | 9,957 | 108.2 | | | | | | | | | | | | |

Për vitin 2024 në Programin “**Strehimi social**”, në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara, janë parashikuar këto aktivitete.

| Produktet | Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi I aktivitetit | Plani fillestar 2024 | Plani I rishikuar 2024 | Realizimi 2024 |
|--|---|--|-----------------------|----------------------|------------------------|----------------|
| | | | | Totali | Totali | Totali |
| Shërbimi i Stafit të Strehimit Social (nr. punonjësish) | P10661.Q1.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit efektiv të stafit të strehimit social në funksion të përmbushjes së misionit qëllimeve, objektivave dhe përgjegjësive për ofrimin e programeve të strehimit ndaj qytetarëve. | Bashkia Shkodër | Realizuar | 3,508 | 3,608 | 2,627 |
| Familje në nevojë/Individë të subvencionuar për qeranë (numri I familjeve) me burimet e veta | P10661.Q1.O1.A2 Zbatimi I instrumentit financiar "Subvencionimi i qerasë në tregun e lirë" | Bashkia Shkodër | Realizuar | 5,430 | 7,824 | 2,302 |
| Familje / Individë të subvencionuar për interesin e Kredisë. (numri I familjeve) | P10661.Q1.O1.A3 Zbatimi I instrumentit financiar "Subvencionimi i interesave të kredisë, të lehtësuara nga shteti" | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | - | - |
| Banesa sociale me qera të mirëmbajtura (numri I njesive të banimit) | P10661.Q2.O1.A1 Menaxhimi i banesave sociale me qira si pjesë e fondit publik në pronësi të bashkisë. | Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike | Realizuar pjesërisht | 1,350 | 1,643 | 116 |
| | P10661.Q2.O1.A1/1 Menaxhimi i banesave sociale me qira si pjesë e fondit publik në pronësi të bashkisë & të trashëguara | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 10 | 8 |
| | P10661.Q2.O1.A2 Projekte që synojnë përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara të financuara nga buxheti i shtetit | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | - | - |
| | P10661.Q2.O1.A3. Sistemim territori dhe punime riparimi te objekteve banesa sociale(qendra e romeve) | Drejt e përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike | E porealizuar | - | 6,969 | - |
| 10661 Strehimi social | | | | 10,288 | 20,054 | 5,053 |
| Te trashëguara | | | | 3,727 | - | - |
| Totali | | | | 14,015 | 20,054 | 5,053 |

| Aktivitete/Projekte (me transfertë të kushtëzuar) | Buxheti fillestar 000/Lekë | Buxheti i rishikuar 000/Lekë | Realizimi 12 mujor i vitit 2024 000/Lekë |
|--|----------------------------|------------------------------|--|
| P10661.Q1.O1.A2 Zbatimi i instrumentit financiar "Subvencionimi i qerasë në tregun e lirë" | 12,670 | 6,071 | 5,370 |
| Totali | 12,670 | 6,071 | 5,370 |

P10661.Q1.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit efektiv të stafit të strehimit social në funksion të përmbushjes së misionit qëllimeve, objektivave dhe përgjegjësive për ofrimin e programeve të strehimit ndaj qytetarëve.

Është realizuar sigurimi i mbështetjes së funksionimit të punonjësve të sektorit të strehimit në kohë të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Zbatimi i buxhetit për shpenzime

personeli u bazua tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar.

P10661.Q1.O1.A2/A3 Zbatimi i programeve të strehimit social & të trashëguara

Në zbatim të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar, Bashkia Shkodër po zbaton disa nga programet sociale të strehimit, që kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet që kanë nevojë për strehim.

- **“Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë”** si një instrument financiar i programit social të strehimit “Banesa sociale me qira”, mbështet individë/familje që me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë reale në tregun e lirë. Subvencionimi i qirasë realizohet nga Bashkia kur nuk disponon banesa sociale me qira si dhe kur nuk zotërojnë fonde për investime të reja ose blerje banesash në treg. Masa e subvencionit është në varësi të nivelit të të ardhurave të familjes. Subvencioni mund të mbulojë deri në 100 për qind të qirasë sociale, për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ato që janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, pavarësisht nëse nuk e kanë përfituar atë dhe që strehohen në banesa sociale me qira.

Për këtë instrument financiar, në zbatim të programit të banesave sociale me qira, aplikimet kanë qenë të hapura deri në muajin nëntor 2023.

Lista e aplikuesve në këtë program social të strehimit i është përcjellë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me kërkesën për parashikimin e fondeve për financim për vitin 2024, sipas nenit 35, të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar dhe sipas Shtojca A “Formati i aplikimit për fonde nga buxheti i shtetit, kriteret përkatëse dhe informacioni për kategoritë, numrin e aplikimeve dhe planifikimin e fondeve nga NJVV”.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 7, datë 31.01.2024 “Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për ato individë/familje që nuk përballojnë qiranë në tregun e lirë, për vitin 2024”, është miratuar lista me 47 individë/familje përfituese.

Në zbatim të nenit 39, të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social, i ndryshuar përfituesit dorëzojnë kontratën e qirasë brenda afateve kohore ligjore pas miratimit të listës së përfituesve nga Komisioni i Strehimit për të përcaktuar dhe vlerën e subvencionimit të qirasë.

Llogaritja e vlerës së subvencionimit të qirasë bazohet në VKM nr. 362, datë 20.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, shtojca “A”, dhe realizohet në varësi të të ardhurave të familjes sipas përcaktimeve ligjore dhe vlerës mesatare të qirasë në treg të lirë të miratuar me VKB.

Vlerat konkrete të subvencionimit të qirasë për çdo përfitues, përcaktohen sipas kontratave të qirasë, të cilat nuk kalojnë vlerat e përcaktuara sipas shtojcës “A” të VKM-së 362, datë 20.05.2019.

Referuar Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 të Ministrit të Ekonomisë dhe Financave “*Të ardhurat për frymë të NJVV-ve (mijë lekë) financohen deri në 70% nga buxheti i shtetit.*”

Sa më sipër, Bashkia Shkodër bashkëfinancon për këtë instrument financiar të strehimit jo më pak se 30% të vlerës totale të subvencionimit të qirasë në treg të lirë.

Me shkresën me nr 4474/3 prot datë 22.04.2024 me lëndë “ Për transferim fondi nga buxheti i shtetit për programin e subvencionimit të qirasë” administruar nga Bashkia Shkodër me nr. 8620 prot datë

24.04.2024 jemi njoftuar për transferimin e fondit për këtë program.

Me transferimin e fondit është bërë e mundur dhe ka filluar procedura e likuidimit për programin e subvencionimit të qirasë.

Gjatë procedurës së likuidimit të qirasë u evidentua nga struktura përgjegjëse, gabimi material (përlllogaritje) e vlerës për përfituesen Violetë Ndoc Lulashi me nr.rendor 17, në tabelën bashkëlidhur VKB –së nr.7 datë 31.01.2024 “Për miratimin e listës së përfituesve për programin social të strehimit “Banesa sociale me qira” për instrumentin financiar “Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë” për vitin 2024.”

Në mbledhjen e Komisionit të Strehimit të datës 22.05.2024, u relatua nga struktura përgjegjëse e strehimit gabimi i evidentuar, u shqyrtua nga Komisioni dhe u miratua, sipas procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, me nr. 11004/3 prot, datë 22.05.2024.

Me datë 31.05.2024 Këshilli Bashkiak miratoi me vendim nr.35 “Për një ndryshim në VKB-në nr.7, datë 31.01.2024 “Për miratimin e listës së përfituesve për programin social të strehimit “Banesa sociale me qira” për instrumentin financiar “Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë” për vitin 2024”.

Në fazën e dytë për instrumentin financiar “Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë” për vitin 2025, në zbatim të programit social të strehimit “Banesa sociale me qira” aplikuesit janë njoftuar me shkresë zyrtare për plotësim dokumentacioni.

Sipas njoftimit për thirrjen e mbledhjes së Komisionit të Strehimit me shkresë nr. 29063 prot, datë 24.12.2024 , u mbledh komisioni me datë 27.12.2024. Nga ana e strukturës përgjegjëse të strehimit në bashki, u prezantua lista e aplikuesve dhe dosjet përkatëse të paraqitura për instrumentin financiar “Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë” për vitin 2025, në zbatim të programit social të strehimit “Banesa sociale me qira”.

Në zbatim të VKM-së nr. 362, datë 29.5.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes” është hartuar lista e aplikuesve me të dhënat sipas dosjeve të aplikuesve të renditura sipas sistemit të pikëzimit të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak.

Në zbatim të VKM-së nr. 459, datë 03.07.2019, struktura përgjegjëse e strehimit në bashki ka dërguar në ministri kërkesën për shtesë të fondeve sipas numrit të aplikimeve për këtë program/instrument financiar.

Lista e propozuar për miratim përmban 74 aplikues të renditur sipas sistemit të pikëzimit, nga të cilët 38 janë përfitues të këtij programi/instrumenti financiar për vitin 2024, dhe pas përditësimit të dokumentacionit do të risubvencionohen për vitin 2025. Pas miratimit në Komisionin e Strehimit, aplikuesit do të njoftohen për depozitimin e Kontratës së Qirasë edhe pse të gjithë aplikuesit janë vënë në dijeni paraprakisht që kriter kryesor është depozitimi i Kontratës së Qirasë me akt noterial.

Me depozitimin e kontratave, Komisioni i Strehimit dërgon për miratim në Këshillin Bashkiak listën e përfituesve dhe vlerat përkatëse të subvencionimit sipas kontratave të qirasë të depozituara.

Struktura përgjegjëse e strehimit, vuri në dispozicion informacionin e hollësishëm për çdo aplikant i cili ka përmbushur kriteret për këtë instrument. Komisioni verifikoi dokumentacionin sipas dosjeve individuale të aplikuesve.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikuesve, Komisioni i Strehimit sipas rendit të ditës vendosi:

1. Miratimin e listës së përfituesve për programin social të strehimit “Banesa sociale me qira” për instrumentin financiar “Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë” për vitin 2025”.

- “**Subvencionimi i interesave të kredisë, të lehtësuara nga shteti**”, është një instrument financiar në zbatim e mbështetje të programit social të strehimit “Banesa me kosto të ulët”. Familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët kanë të drejtë të përfitojnë kredi me kushte lehtësuese që jepet në formën e subvencionimit të interesave të kredisë për ato familje që me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesat e kredisë të ofruara nga institucionet financiare për blerjen e një banese me vlerë jo më të madhe se mesatarja e vlerave të tregut në Njësinë e Vetëqeverisjes Vendore dhe me sipërfaqe jo më të madhe se normat e strehimit të përcaktuara.

Në zbatim të VKM nr. 384, datë 12.6.2019 ndiqen procedurat e parashikuara për zbatimin e programeve sociale të strehimit. Informacioni në lidhje me programet sociale të strehimit në zbatim është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë. Gjithashtu, specialisti i strehimit pranë Bashkisë ka qenë i gatshëm për ofrimin e informacionit dhe mbështetjes së nevojshme për qytetarët, ku çdo ditë pranë Zyrës me Një Ndalesë, janë bërë aplikime nga qytetarët. Kuotat e vëna në dispozicion nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për këtë instrument financiar për vitin 2020, janë 100.

Gjatë tre viteve të zbatimit të këtij instrumenti financiar, janë miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak katër lista përfituesish. Listat e përfituesve, sipas marrëveshjes trepalëshe ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Bashkisë Shkodër dhe tre institucioneve financiare/bankave (BKT, Intesa Sanpaolo dhe Raiffeisen Bank), në zbatim të procedurave ligjore u janë dërguar për zbatim institucioneve financiare dhe Entit Kombëtar të Banesave, Drejtoria Rajonale Shkodër.

Deri tani ka disa përfitues të kredituar nga bankat dhe disa përfitues në proces të kreditimit.

Meqënëse Bashkia Shkodër kishte në dispozicion 100 kuota të miratuara, dhe këto kuota nuk janë plotësuar akoma edhe pse janë miratuar katër lista përfituesish nga Bashkia Shkodër, në lidhje me kuotat në dispozicion për vitin aktual, **Bashkia ka shpallur përsëri Thirrje.**

Bashkia Shkodër ka shpallur në faqen zyrtare web të internetit njoftimin me listën e aplikuesve për instrumentin financiar “Subvencionimi i interesave të kredisë, të lehtësuara nga shteti” dhe ka vijuar me procedurën e njoftimit shkresor për të gjithë aplikuesit, për plotësimin dhe dorëzimin e dokumentacionit pranë sporteleve të Zyrës me Një Ndalesë të bashkisë.

Pas plotësimit dhe dorëzimit të dokumentacionit nga qytetarët/aplikuesit, vijon procedura e shqyrtimit, vlerësimit, pikëzimit dhe miratimit të dokumentacionit me listën e përfituesve, e cila dërgohet për miratim pranë Komisionit të Strehimit dhe me vendim të Këshillit Bashkiak, shpallet lista e përfituesve.

Nga lista që ka patur 78 aplikues kanë depozituar dokumentacion vetem 44 aplikues, nga ku 31 aplikues janë kualifikuar si përfitues të këtij programi, 13 aplikime kanë rezultuar të pasuksesshme, 10 prej të

cilave për mosplotësim të kriterit ekonomik (tejkallim të ardhurash) si dhe 3 aplikime për mungesë dokumentacioni.

Struktura përgjegjëse filloi procedurën për njoftimin e Komisionit të Strehimit, e cila u zhvillua me datë 22.05.2024. Komisioni i Strehimit është i ngritur me VKB-së nr.2, datë 22.01.2020 “Për miratimin e ngritjes, përbërjes dhe funksionimit të Komisionit të Strehimit”; Urdhërit nr. 494, datë 12.04.2024 “Për përcaktimin e anëtarëve të Komisionit të Strehimit pranë Bashkisë Shkodër” i ndryshuar; Vendimit nr. 144, datë 14.07.2020 të Kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Strehimit, strukturës përgjegjëse të strehimit iu la si detyrë, mbledhja e informacionit të përditësuar nga bankat dhe EKB-ja si dhe informacion nga ministria përgjegjëse për vlefshmërinë e kuotave të vëna në dispozicion të 2019. Komisioni i Strehimit të Bashkisë Shkodër mbajti procesverbalin me nr.11004/3 prot, datë 22.05.2024.

Numri i kuotave të paezuruara në këtë mbledhje ka rezultuar 16, pra 16 kuota të paezuruara.

Drejtoria e Shërbimeve Sociale, në zbatim të detyrave të lëna, i është drejtuar me shkresën nr.11294 prot, dt.23.05.2024, bankave që kanë marrëveshje me ministrinë përgjegjëse, me shkresën 11409 prot, datë 24.05.2024 EKB-së, për familjet përfituese të cilat kanë bërë shtyrjen e afatit të procedurave të kreditimit si dhe email Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me datë 31.05.2024.

Nga informacionet e përditësura, të marra nga bankat dhe nga Enti Kombëtar i Banesave, rezulton që nga 100 kuotat të cilat kanë qënë të parashikuara, janë ezauruar përkatësisht me BKT-në 36 kuota, me Raiffeisen 5 kuota dhe me Intesa SanPaolo 15 kuota.

Ndërsa nga Enti Kombëtar i Banesave ka ardhur përgjigja se 23 përfitues kanë bërë kërkesë për shtyrjen e afatit për vazhdimin e procedurave të kreditimit.

Në kthimin e përgjigjes, Ministria përgjegjëse konfirmoi vlefshmërinë e kuotave dhe vazhdimin e procedurës deri në ezaurimin e kuotave të paezuruara.

Sa më sipër, mbas konfirmimeve zyrtare të ardhura nga institucionet përgjegjëse, rezultoi të lirohen 5 kuota.

Në total nga 100 kuota të vëna në dispozicion, 21 kuota ishin të paezuruara.

Struktura përgjegjëse njoftoi Komisionin e Strehimit se mbledhja e radhës do të zhvillohej me datë 18.06.2024. Komisioni i Strehimit të Bashkisë Shkodërvendosi të paraqesë për miratim pranë Këshillit të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore, listën shtesë të përfituesve dhe masën e subvencionimit të interesave të kredisë për individë/familje që përfitojnë banesa me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, e cila u dërgua pranë strukturës përgjegjëse për strehimin në bashki, e shoqëruar me Procesverbalin e Komisionit të Strehimit të Bashkisë Shkodër me nr.13022/3 prot. datë 18.06.2024.

Në vijim struktura përgjegjëse, në zbatim të pikës 18 të VKM nr.384 datë 12.06.2019 “Për caktimin e dokumentacionit për të përfituar sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, e dërgon për miratim listën shtesë të përfituesve pranë Këshillit Bashkiak që duhet ta marrë në shqyrtim në mbledhjen e parë të radhës.

Me datë 28.06.2024 Këshilli Bashkiak miratoi vendimin nr.39 “ Për miratimin e listës shtesë së përfituesve dhe masën e subvencionimit të interesave të kredive për individë/familje që përfitojnë banesa me kosto të ulët me kredi të lehtësuara nga shteti”.

Pas miratimit në Këshill Bashkiak, struktura përgjegjëse pranë Bashkisë Shkodër ka përcjellur listën e përfituesve Entit Kombëtar të Banesave, insitucioneve financiare që kanë nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e linjës për zbatimin e këtij programi.

Drejtoria e Shërbimeve Sociale me shkresën nr.12442 prot., datë 07.06.2024 me lëndë “Njoftim për shpallje në faqen web për aplikime për të përfituar nga programet sociale të strehimit që zbaton Bashkia Shkodër ” ka hapur shpalljen për aplikime.

Aplikimet janë kryer online në portalin qeveritar E-albania dhe kanë qënë të hapura deri në muajin nëntor. Gjatë kësaj periudhe ka patur rreth 60 aplikime. Në vijim do të procedohet me fazën e dytë të aplikimeve.

P10661.Q2.O1.A1 Menaxhimi i banesave sociale me qira si pjesë e fondit publik në pronësi të bashkisë

Fondi publik i banesave sociale me qira në pronësi të Bashkisë Shkodër përbëhet nga dy godina të dala jashtë funksionit dhe të përshtatura për strehim social, si dhe ndërtime të reja me kontenier, të cilët aktualisht janë funksionale.

Bashkia Shkodër administron tre Banesa Sociale me Qira, pjesë e fondit publik të banesave sociale me qira në pronësi të bashkisë, të cilat, kanë 79 njësi banimi në total, ku momentalisht përfitojnë rreth 71 familje të sistemuara pranë këtyre banesave sociale.

Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me nr. 2691 prot., datë 07.03.2016 që Bashkia Shkodër ka lidhur me Ministrinë e Zhvillimit Urban është realizuar rikonstrukcioni i ish- konviktit të shkollës Pyjore, me qëllim përshtatjen në banesa sociale me qira për strehimin e jetimëve që kanë dalë nga institucionet e përkujdesit shoqëror dhe aktualisht jetojnë në konviktet e qytetit, si dhe familjeve njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë dhe ndodhen në situatë të vështirë social-ekonomike.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 26, datë 10.05.2022 “Për disa shtesa në VKB-në nr. 49, datë 30.10.2020 “Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve për programin e banesave sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr. 6” (pranë ish-konviktit të shkollës Pyjore) janë miratuar listat e përfituesve që kanë nënshkruar kontrata qiraje 1-vjeçare.

Sa i përket vitit 2024 lidhja e kontrata është në proces, pasi familjet janë njoftuar disa herë për rinovimin e dokumentacionit dhe shlyerjes së detyrimeve por për shkak të kategorisë vulnerabel që i përkasin akoma nuk kanë arritur ta konkludojnë këtë proces.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr.18, datë 20.2.2023 “Për miratimin e listës shtesë të përfituesve pranë banesave sociale me qira, të administruara nga Bashkia Shkodër”, është miratuar lista shtesë me 2 (dy) familje përfituese.

Përfituesit pranë këtyre banesave përfitojnë edhe shërbime integruese dhe zhvilluese, me qëllim fuqizimin social-ekonomik, shërbime që ofrohen nga Qendra Komunitare “Për Familjen” nr. 6. Janë rreth 24 njësi banimi me qira ku përfitojnë rreth 20 familje, mes të cilave një familje në kushtet e nevojës emergjente për strehim, miratuar me VKB nr. 60, datë 07.11.2022.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr.47, datë 31.07.2024 është miratuar edhe vendimi “Për strehimin emergjent të zj. Xh. B dhe të miturve të saj në njësitë e banimit tek banesat sociale me qira pranë qendrës komunitare “Për familjen” nr. 6 (ish-konvikti i shkollës Pyjore)”.

Gjithashtu me vendim të Këshillit Bashkiak nr.63, datë 30.09.2024 është miratuar edhe vendimi “Për strehimin emergjent të familjes Bejtja në njësitë e banimit tek Banesat Sociale me qira pranë qendrës komunitare ” Për Familjen” nr.6 (Ish konvikti i shkollës Pyjore).

Në administrimin e Bashkisë Shkodër janë edhe 27 kontenier (godina sociale, me kontenier 1+1 dhe 2+1)”, që synojnë përmirësimin e kushteve të banimit të minoritetit kombëtar Rom për 27 familje të këtij minoriteti në Bashkinë Shkodër.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 29, datë 03.06.2021 “Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve për programin e banesave sociale të ngritura për komunitetin Rom dhe për miratimin e “Rregullores së administrimit të banesave sociale me qira të ngritura për komunitetin Rom”, është miratuar lista e përfituesve dhe kanë nënshkruar kontratat e qirasë me afat 1-vjeçar.

Sa i përket vitit 2024 lidhja e kontrata është në proces, pasi familjet janë njoftuar disa herë për rinovimin e dokumentacionit dhe shlyerjes së detyrimeve por për shkak të kategorisë vulnerabël që i përkasin akoma nuk kanë arritur ta konkludojnë këtë proces.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 18, datë 20.2.2023 “Për miratimin e listës shtesë të përfituesve pranë banesave sociale me qira, të administruara nga Bashkia Shkodër”, është miratuar lista shtesë me 3 (tre) familje përfituese.

Aktualisht, janë sistemuar pranë këtyre godinave sociale 24 familje përfituese.

Sa i përket ish-konviktit të shkollës Veterinare si banesa sociale nën administrimin e Bashkisë Shkodër me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 24, datë 10.05.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve pranë banesave sociale me qira tek ish-konvikti i shkollës Veterinare dhe të “Rregullores për administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira të Bashkisë Shkodër”, është miratuar lista e përfituesve dhe kanë nënshkruar kontratat e qirasë me afat 1-vjeçar përveç dy familjeve.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 18, datë 20.2.2023 “Për miratimin e listës shtesë të përfituesve pranë banesave sociale me qira, të administruara nga Bashkia Shkodër”, është miratuar lista shtesë me 2 (dy) familje përfituese.

Aktualisht, janë sistemuar 25 familje pranë këtyre banesave sociale.

Është miratuar në Këshillin Bashkiak Shkodër vendimi nr.21 datë 29.04.2024 “Për miratimin e masës së qirasë mujore për Banesat Sociale me Qira, në administrimin e Bashkisë Shkodër”, me Nivelin i qirasë për BSQ miratohet çdo vit dhe është i vlefshëm deri më 31 janar të vitit pasardhës.

Me vendime të Këshillit Bashkiak janë miratuar Rregulloret përkatëse për administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira të Bashkisë Shkodër, për zbatimin dhe funksionimin e këtyre programeve sociale të strehimit, me qëllim rregullimin e marrëdhënieve dhe përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet përfituesve dhe strukturës përgjegjëse administruese.

P10661.Q2.O1.A2 Projekte që synojnë përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara të financuara nga buxheti i shtetit.

(përmirësim i infrastrukturës kryesisht në zona informale që janë në proces legalizimi)

Programet sociale të strehimit janë programe, të cilat kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm për individët dhe familjet që nuk janë në gjendje ekonomike dhe sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave.

Bashkia Shkodër prej disa vitesh, po zbaton projekte me synim rritjen e fondit të banesave sociale për familjet dhe individët më në nevojë, duke rikonstruktuar dhe vënë në përdorim objekte publike, pronë

të Bashkisë Shkodër, si në ish-konviktin e shkollës Pyjore dhe në ish- konviktin e shkollës Veterinare, ndërtimin e 27 konteniervë për komunitetin rom e egjiptian.

Bashkia Shkodër ka përzgjedhur aplikimin në thirrjen me programin “përmirësim i infrastrukturës kryesisht në zona informale që janë në proces legalizimi“ duke marrë parasysh impaktin e lartë që do të ketë investimi në këtë zonë. Rikualifikimi i zonave informale dhe integrimi i plotë me qytetin është një objektiv strategjik i bashkisë, që ndikon direkt me rritjen në aksesin e banorëve me shërbimet e bashkisë, rritjen e sigurisë dhe mbi të gjitha përmirësimin e cilësisë së jetesës në një zonë informale e cila do të transformohet dhe zhvillohet sipas standardeve më të mira. Numri i lartë i përfituesve është një tjetër element që na orienton drejt aplikimit me projekt propozimin Ndërtimi i rrugëve Fermentim“ duke qenë se impaktohen mbi 1000 banorë direkt dhe indirekt ndikon në të gjithë zonën e njësisë administrative „rrethina“ duke i rritur aksesin dhe shërbimet dhe zhvilluar një zonë ekzistuese tashme të qytetit të Shkodrës. Zgjedhja e këtij programi vjen edhe si rezultat i kërkesave të shumta për investim në këtë zonë gjatë zhvillimit të dëgjësive publike në kuadër të hartimit të buxheteve ndër vite. Duke qenë se projekti në fjalë ka një vlerë të lartë investimi, e cila nuk mund të përballohet me fondet vjetore të investimeve të kryera nga bashkia Shkodër, propozohet realizimi i këtij investimi me mbështetjen e buxhetit të shtetit. Projekti i propozuar ka një impakt në një numër të lartë të target grupeve të cilat synohet të mbështen nga ky program.

Projekti i propozuar “Rikonstruksion i rrugëve Fermentim” parashikon rikonstruksionin e një sipërfaqeje prej rreth 10,500 m² duke ndërhyrë në infrastrukturën nëntokësore dhe mbitoksore në një gjatësi lineare prej 3.5 km dhe impaktuar direkt përmirësimin e cilësisë së jetesës për mbi 1000 banorë. Investiminë përmirësimin e infrastrukturës në këtë zonë ka efikasitet të lartë pasi i shërben jo vetëm banorëve të kësaj lagje, por edhe banorëve të Dobraçit, Golemit, Bardhaj duke shkurtuar distancën për të aksesuar shërbimet publike bazë në qytet. Banorët të cilët përfitojnë nga ky investim i përkasin kategorive shumë vulnerabël dhe me të ardhura mesatare mujore shumë të ulëta. Banorët që kanë përfitimin më të madh nga ky investim janë ato që i përkasin kategorisë PAK, për të cilët aktualisht qarkullimi në atë zonë është i pamundur pa mjete ndihmëse.

Me VKB nr. 9, datë 31.1.2024 është miratuar në parim vlera e bashkëfinancimit dhe lista e përfituesve për realizimin e projektit “Rikonstruksion rruga Fermentim”.

Me shkresën nr. 8086/21 prot. datë 20.06.2024 ardhur nga ministria me lëndë “ Njoftim mbi fituesit e projekteve të strehimit për vitin 2024”, administruar pranë Bashkisë Shkodër me nr. 13350 prot.,datë 24.06.2024.

Referuar nenit 19 të ligjit nr. 22/20218 “Për strehimin social”, i ndryshuar”, VKM-së nr.325, datë 29.05.2024 “Për përcaktimin e rregullave për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale, Bashkia Shkodër përfiton sipërfaqe ndërtimore apo në këmbim të saj, vlerën monetare e cila kalon në llogarinë e posacme të Bashkisë Shkodër në favor të fondit të banesave sociale. Gjatë vitit 2024 kanë kaluar në favor të fondit social të banesave sociale 35,529,640 lekë, nga ky kontribut.

P10661.Q2.O1.A3. Sistemim territori dhe punime riparimi te objekteve banesa sociale (qendra e romeve)

Sistemimi i territorit dhe punimeve të riparimit të objekteve banesa sociale (qendra e romeve) është mbartur për tu realizuar gjatë vitit 2025.